



المؤسسة الإسلامية للشباب

**Fondazioni i Rinisë Islame**  
**Stiftung der Islamischen Jugend**  
**Foundation of Islamic Youth**

---

Seebacherstrasse 67  
CH-8052 Zürich  
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

[www.islamischen.ch](http://www.islamischen.ch)  
✉ [Islamischen@freesurf.ch](mailto:Islamischen@freesurf.ch)  
[info@islamischen.ch](mailto:info@islamischen.ch)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

# PREZENTIMI I PËRGGJITHSHËM I FESË ISLAME

Ali Tantavi

Botuar nga: Përpyekja Rinore

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

PARATHËNIE.....	10
FEJA ISLAME.....	12
Ç'ËSHTË ISLAMI?.....	12
DEFINICIONET.....	21
E VËRTETA E DUKSHME DHE BESIMI.....	23
PARIMET E BESIMIT.....	25
PARIMI I PARË.....	25
PARIMI I DYTË.....	27
PARIMI I TRETË.....	28
PARIMI I KATËRT.....	31
PARIMI I PESTË.....	34
PARIMI I GJASHTË.....	37
KUFIZIMI TERMINOLOGJIK.....	41
PARIMI I SHTATË.....	42
PARIMI I TETË.....	44
BESIMI NË ALL-LLAHUN XH.SH. ....	45
EKZISTIMI I ALL-LLAHUT XH.SH. ....	46
ALL-LLAHU XH.SH. ËSHTË KRIJUES I BOTËVE.....	54
ALL-LLAHU XH.SH. ËSHTË SUNDIMTAR DHE ZOT I BOTËVE.....	55

VETËM ALL-LLAHU XH.SH. E MERITON ADHURIMIN .....	56
TEWHIDULLAH BESIMI NË NJËSHMËRINË E ZOTIT .....	57
SHPIRTI DHE DOMETHËNIA E IBADETIT .....	58
THELBËSORJA NË ADHURIMIN E ALL-LLAHUT XH.SH. ....	59
LEJIMI DHE NDALIMI I TAKON VETËM ALL-LLAHUT XH.SH. ....	62
DASHURIA NDAJ ALL-LLAHUT XH.SH. DHE FRIKA NDAJ TIJ .....	63
AJETET QË BËJNË FJALË PËR ATRIBUTET E ALL-LLAHUT XH.SH. ....	65
AJETET E QARTA DHE MË PAK TË QARTA (MUHKEM DHE MUTESHABIH).....	70
QËNDRIMI I MUSLIMANËVE NDAJ KËTYRE AJETEVE DHE TË PERCEPTUARIT E TYRE.....	70
FORMAT E SHPREHJES SË IBADETIT .....	71
QËLLIMI I IBADETIT .....	73
PËRKUFIZIM .....	74
HULUMTIMET SHKENCORE .....	75
DYSHIMI DHE PËRGJIGJJA NË TË .....	76
POLEMIKA JOFRYTDHËNËSE .....	76
E VËRTETA NË KËTO ÇËSHTJE.....	77
FORMAT E SHPREHJES SË IMANIT .....	79
IMANI DHE VEPPRA.....	79
IMANI SHTOHET .....	80

LËNIA E VEPRAVE NUK NXJERR NGA BESIMI, POR PERSONIN E EKSPOZON DËNIMIT NË AHIRET .....	81
REZULTATET DHE FRYTET E IMANIT.....	82
DHIKRI .....	82
NDËRMJET FRIKËS DHE SHPRESËS .....	85
MBËSHTETJA NË ALL-LLAHUN XH.SH. ....	86
FALËNDERIMI ALL-LLAHUT XH.SH. ....	88
DURIMI .....	89
NËSHTRUESHMËRIA NDAJ GJYQIT DHE CAKTIMIT TË SHERI'ATIT.....	91
RIGOROZITETI DHE DHEMBSHURIA .....	94
PENDIMI DHE KËRKIMI I FALJES.....	96
BESIMI NË DITËN E GJYKIMIT .....	101
NE DHE VDEKJA.....	101
JETA PAS VDEKJES .....	102
PËRGATITJA PËR VDEKJE .....	103
ÇASTI I VDEKJES – DËSHMI E BESIMIT.....	104
DYSHIMI I PARËNDËSISHËM .....	105
DITA E KIJAMETIT .....	105
KOHA E DITËS SË GJYKIMIT .....	106
FILLIMI I DITËS SË GJYKIMIT.....	108

SHFAQJET E PËRMASAVE KOZMIKE.....	109
FRYERJA NË SUR - BORI .....	110
RINGJALLJA DHE HASHRI – TUBIMI .....	111
DHËNIA E LLOGARISË .....	114
DËSHMITARËT DHE DËSHMITË .....	115
TË DËSHMUARIT E PEJGAMBERËVE.....	116
LIBRAT DHE SUHUFET – FLETUSHKAT .....	116
MBROJTJA E PASTAJ PRANIMI .....	118
VËREJTJA E PARËNDËSISHME .....	120
DHËNIA E LLOGARISË DHE REZULTATET E SAJ.....	121
KALIMI MBI XHEHENNEM .....	121
XHENNETI DHE XHEHENNEMI .....	122
HYRJA NË XHENNET .....	124
PËRSHKRIMI I XHENNETIT.....	125
BANORËT E XHENNETIT DHE GJENDJA E TYRE.....	127
XHEHENNEMI.....	130
HYRJA NË ZJARR.....	131
XHEHENNEMI ËSHTË BURG .....	132
TENTIMET E DALJES .....	133

BISEDAT E TYRE DHE GRINDJET .....	135
DIALOGU NDËRMJET BANORËVE TË XHENNETIT DHE XHEHENNEMIT .....	136
A'RAF – BEdENET .....	136
BESIMI NË KADERIN - CAKTIMIN E ZOTIT.....	138
DOMETHËNIA E KADERIT DHE KADASË .....	138
SHPËRBLIMI DHE DËNIMI .....	139
NJERIU KA ZGJEDHJE .....	140
NJERIU ËSHTË I DETERMINUAR .....	141
NJERIU ËSHTË I LIRË DHE KA MUNDËSI ZGJEDHJEJE NË KUFIJTË E FUQISË NJERËZORE .....	141
SHPËRBLIMI DHE DËNIMI JANË TË LIDHURA ME LIRINË.....	142
PESHOJAT E DREJTËSISË.....	143
TEKSTET NGA KUR'ANI DHE HADITHI MBI KADERIN.....	145
DISKUTIMI I PAFRYTSHËM .....	148
KËRKIMI I ARSYETIMIT DUKE U THIRRË NË KADERIN.....	149
ÇFARË ËSHTË QËNDRIMI YNË, E ÇFARË KA QENË I PARAARDHËSVE TANË PËR ÇËSHTJEN E KADERIT? .....	150
SHKAKU I DHËNIES SË SHENJTËRISË TË VDEKURVE .....	152
ÇRREGULLIM I CILI NUK KA ARSYETIM .....	152
BESIMI NË GAJB BOTËN E PADUKSHMË .....	153
BOTA E PADUKSHME .....	153

SI BESOJMË NË TË PADUKSHMEN? .....	154
GAJBI NË TË CILIN DUHET BESUAR .....	155
BOTA E GAJBIT .....	157
DYSHIMI DHE PËRGJIGJJA NË TË .....	157
LLOJET E GAJBIT .....	158
GAJBI ËSHTË SHUMËLLOJESH.....	158
DYSHIMI DHE PËRGJIGJJA NË TË .....	159
LIBRAT, MELEKËT DHE PEJGAMBERËT A.S. ....	160
SHPALLJA, MUNDËSIA DHE NEVOJSHMËRIA E SAJ.....	160
DYSHIMI DHE PËRGJIGJJA NË TË .....	162
MELAIKET .....	163
DISA REZULTATE DHE FRYTET E BESIMIT NË MELAIKET .....	167
XHINNËT .....	168
KUR'ANI RRETH XHINNËVE .....	168
SHEJTANËT .....	170
KUR'ANI RRETH SHEJTANËVE .....	171
SHEJTANËT NË FORMË TË NJERIUT .....	174
BESIMI NË PEJGAMBERËT A.S. ....	175
THELBI DHE REALITETI I PEJGAMBERËVE .....	177

PEJGAMBERI NUK E DI GAJBIN .....	180
PEJGAMBERËT JANË TË SHUMTË, NDËRSA THEMELET DHE PARIMET E MISIONEVE TË TYRE JANË UNIKE.....	181
PYETJA DHE PËRGJIGJJA NË TË.....	182
ISLAMI NUK BËN DALLIM MES PEJGAMBERËVE .....	184
KUR'ANI RRETH PEJGAMBERËVE .....	185
MU'XHIZET .....	187
KERAMETET .....	188
MU'XHIZEJA DHE MAGJIA (SIHRI) .....	189
MU'XHIZET E MUHAMMEDIT A.S.....	191
BESIMI NË LIBRA .....	207
KUR'ANI.....	207
BESIMI NË LIBRAT.....	210
SUHUFET E IBRAHIMIT A.S. ....	211
TEVRATI.....	212
ZEBURI.....	213
INXHILI.....	213
PËRFUNDIM.....	214
KY ËSHTË BESIMI ISLAM .....	214

Ky libër nuk u dedikohet dijetarëve apo juristëve islamë (fakihëve), por muslimanëve që nuk merren me shkencat fetare dhe jomuslimanëve që dëshirojnë ta njohin Islamin

## PARATHËNIE

Falënderimi i takon All-llahut dhe nga Ai ndihmë dhe udhëzim kërkojmë.

Dëshmoj se nuk ka hyjni tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është rob e I Dërguar i Tij dhe mësues i këtij ummeti.

All-llahu xh.sh. i krijoi njerëzit dhe xhinnët (krijesa të padukshme) që t'i nënshtrohen dhe ta adhurojnë, por mënyra në të cilën i shfaqet adhurimi duhet të jetë në harmoni dhe në pajtim të plotë me Sheriatin e All-llahut, pra ashtu siç e përcaktoi Ai.

Muhammedi a.s. thotë: “Jeni të obliguar t'i përmbaheni sunnetit tim dhe praktikës së pasardhësve të mi - halifëve, që janë në rrugë të drejtë dhe udhëzojnë drejt saj.

All-llahu ia shpalli fenë e vet Muhammedit a.s. dhe plotësisht e përsosi. I Lartmadhëruari në një ajet kur'anor thotë: “Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, dhe jam i kënaqur që Islami të jetë fe e juaj”. (Maide, 3).

Duke besuar thellë në atë që vjen nga All-llahu, duke dëshiruar t'i afrohem i Atij dhe t'i nënshtrohemi fjalës së Të Dërguarit të All-llahut: “Përcillni nga unë qoftë madje edhe një ajet!”,

konsideroj se obligim dhe detyrë parësore e çdo besimtarë që merret me studimin e shkencave islame, është që t'i përhapë njohuritë kur'anore dhe ato të Sunnetit e të botohen libra që i shpjegojnë të gjitha këto dhe udhëzojnë në to, ashtu që ta pasurojnë bibliotekën kosovare që të jenë në shërbim të muslimanëve me atë që do t'u sjellin dobi në këtë botë dhe në ahiret dhe që t'ua shpjegojnë konceptet dhe pikëpamjet e drejta të Sheri'atit, që kanë të bëjnë me jetën, ibadetin (adhurimin), mirësjelljen, lidhjen dhe raportin ndaj All-llahut xh.sh.

All-llahu xh.sh. thotë: “E kush flet më bukur se ai i cili fton tek All-llahu, i cili punon vepra të mira dhe thotë:Unë vërtet jam musliman!” (Fussilet, 33).

Përkthimi dhe botimi i librave është rruga e vërtetë për përhapjen e njohurive islame dhe pasurimin e bibliotekës sonë, meqë askush nuk mund t'i mohojë nevojat e shqiptarëve muslimanë për Tefsirin (komentimin e Kur'anit) dhe shkencat e Tefsirit, për Hadithin dhe shkencat e tij, për Teuhidin, Fikhun dhe kulturën islame.

Pikësypnim yni kryesor duhet të jetë: shërbimi ndaj Fesë Islame duke iu përmbajtur Librit të All-llahut dhe Sunnetit të Të Dërguarit të Tij, ndërsa e gjithë kjo për hir të dashurisë ndaj të tjerëve, duke e transmetuar atë që na e urdhëroi Krijuesi i botëve, duke iu afruar vetëm Atij, duke shpresuar në mëshirën e Tij dhe duke iu frikësuar dënimit të Tij.

E lus All-llahun xh.sh. që kjo punë të pranohet si punë tejet e sinqertë meqë bëhet në emër të Tij, dhe e lus të ma pranojë këtë vepër mua dhe të gjithë atyre të cilët ndihmuan dhe dhanë kontributin e tyre për botimin e këtij libri, si dhe të na shpërblejë me të mirat e Tij.

Përkthyesi

## FEJA ISLAME Ç'ËSHTË ISLAMI?

Me një rast u thashë nxënësve të mi: “Sikur të vinte një i huaj dhe t’u thoshte se disponon vetëm me një orë kohë të lirë dhe për këtë kohë dëshiron të mësojë se ç’është Islami, si do t’ia shpjegonit Islamit për një orë?”. Ata m’u përgjigjën: “Kjo është e pamundur meqë është e domosdoshme që ta studiojë teuhidin, texhvidin, tefsirin, hadithin, fikhun, usuli – fikhun dhe të thellohet në problemet dhe çështjet nga të cilat nuk mund të dilet për pesë vjet”. Unë në këtë thashë: “Subhanallah, a nuk ka ndodhur që një beduin (fshatar, banor i shkretëtirës) të vijë tek Resulullahu, sal-lall-llahu alejhi ve selem, të qëndrojë tek ai një ditë apo një pjesë të ditës, e që për këtë kohë të shkurtër ta mësojë Islamit, që më pastaj t’ia përcjellë popullit të vet, duke u bërë udhëzues dhe mësues i tij, misionar dhe përhapës i Islamit. Madje edhe më shumë se kjo, a nuk e ka shpjeguar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve selem, tërë fenë me tri fjali në hadithin për Xhibrilin a.s., duke diskutuar me të për Islamit, imanin dhe ihsanin – bamirësinë? Atëherë, përse të mos e shpjegojmë edhe ne sot Islamit për një orë?”.

Prandaj, ç’është Islami dhe si hyhet në të?

Çdo religjion, i vërtetë apo i falsifikuar, çdo shoqatë, e dobishme apo e dëmshme, çdo parti, e mirë apo e keqe, i ka themelet dhe bazat e veta ideore, si dhe parimet ideologjike, të cilat e përcaktojnë qëllimin e saj dhe e orientojnë drejtimin e saj, duke u shërbyer anëtarëve dhe pasuesve të saj si statut.

Ai që dëshiron të anëtarësohet në njëren prej shoqatave të përmendura, së pari i analizon parimet e saj, e nëse pajtohet me to, me kurrështje dhe me vetëdije i pranon pa kurrfarë dyshimi në to, kërkon të hyjë në shoqatën përkatëse, të inkuadrohet në radhën e anëtarëve dhe ithtarëve të saj, kështu që atëherë detyrohet që t'i kryejë të gjitha aktivitetet me të cilat e obligon statuti i shoqatës dhe e paguan anëtarësinë e caktuar. Pas kësaj është i obliguar që me veprimtarinë e tij të tregojë sinqeritet në pranimin e parimeve dhe përcaktimeve të shoqatës, vazhdimisht duke u rikujtuar që të mos veprojë diç që mund t'i kundërvihet asaj. Me moralin dhe sjelljet e tij ai duhet të paraqesë shembull të përkryer të atyre parimeve, si dhe të misionarit praktik të tyre.

Anëtarësimi në shoqatë pra, do të thotë: njohja e sistemit të saj, besimi në parimet e saj, nënshtrimi ndaj përcaktimeve të saj, si dhe veprimi praktik në pajtim me ato përcaktime. Ky është qëndrimi i përgjithshëm, i cili aplikohet edhe në Fenë Islame. Prandaj, ai që shpreh dëshirë të hyjë në Islam, së pari duhet t'i aprovojë parimet e tij dhe pa ngurrim t'i përvetësojë, ashtu që të bëhet musliman i vërtetë. Këto parime, shkurtimisht mbështeten në besimin që kjo botë materiale nuk është e vetmja që ekziston dhe se jeta e kësaj bote nuk është e tërë jeta. Njeriu ka ekzistuar edhe para lindjes, por do të ekzistojë edhe pas vdekjes. Ai nuk e ka krijuar veten, por ka qenë i krijuar para se ta ketë njohur veten. Njeriun nuk e kanë krijuar materiet joorganike që gjenden rreth tij, sepse ai posedon mendjen, kurse ato jo, porse e ka krijuar i Vetmi All-llah xh.sh. nga asgjëja (nga mosekzistenca), sikurse edhe të gjitha botët tjera. Ai është i Vetmi që jep jetë e jep vdekje, Ai të gjitha i ka krijuar dhe nëse dëshiron, të gjitha mund t'i shkatërrojë. Ky Zot nuk i ngjason asnjëherë nga këto krijesa. Çdoherë ka qenë, nuk është i krijuar, gjithmonë do të jetë dhe kurrë nuk do të zhduket. Është i Fuqishëm dhe fuqia e Tij nuk njeh kufij. Të gjitha i di dhe asgjë nuk mund t'i fshehet diturisë së Tij. Është i drejtë, por drejtësia e Tij nuk përcaktohet me kriteret e drejtësisë

njerëzore. Ai i ka vendosur ligjet e Gjithësisë, të cilat ne i quajmë ligje natyrore dhe të gjitha i ka krijuar me masë. Çdo sendi ia caktoi detajet dhe formën, si dhe gjithë atë që do t'u ndodhë qenieve të gjalla dhe jo të gjalla nga lëvizja e qetësia, konstantja e ndryshueshmëria, aktiviteti e pasiviteti. Njeriut ia dhuroi mendjen me të cilën ai gjykon për gjëra të shumta, të cilat ia ka nënshtruar atij dhe me të cilën realizon atë që e zgjedhë vet. Pas kësaj jete të përkohshme e ka krijuar jetën e përhershme – botën tjetër, në të cilën bamirësit do të shpërblehen me Xhennet, ndërsa mëkatarët do të dënohen me Xhehennem.

Zoti është Një i Vetmi, nuk ka shok që krahas Tij adhurohet, nuk ka kush që të afron tek Ai dhe që ndërmjetëson pa lejen e Tij. Ibadet i sinqertë vetëm Atij i bëhet – në të gjitha format.

Të gjitha krijesat e dukshme, që dallohen me shqisa, si dhe krijesat e padukshme i takojnë Atij. Disa nga ato janë jo të gjalla, e disa të gjalla, të ngarkuara me obligime. Veçori e disa krijesave të gjalla është vetëm e mira, e ato janë melaiKET (engjëjt), disa kanë veçori vetëm të keqen, e ata janë shejtanët (djajtë), ndërsa karakteristikë e disa krijesave është edhe e mira edhe e keqja, e këta janë xhinnët dhe njerëzit. Ai, All-llahu xh.sh., i zgjodhi disa nga njerëzit dhe u dërgoi melaiKE me ligj të Tij – Sheri'at – që t'ua shpallin njerëzve, e ata janë Pejgamberët.

Këto sheri'ate (ligje) të All-llahut xh.sh. janë të përmbledhura në libra dhe suhufë (broshura), të cilat janë të shpallura nga lartë ( nga qielli). E fundit nga ato e shfuqizon të mëparshmen, apo e korrigjon. Libri i fundit është Kur'ani. Përmbajtjet e të gjithë librave para Kur'anit janë shtrembëruar, apo janë zhdukur dhe harruar tërësisht. I vetmi Kur'ani ka mbetur i ruajtur nga ndryshimet dhe shkatërrimi. Ndërsa Pejgamberi i fundit ishte Muhammed ibn Abdullah Arebi

Kurejshi. Me të edhe u vulos dhe mori fund misioni i pejgamberisë, kurse fetë morën fund me shpalljen e tij, kështu që pas tij nuk do të ketë pejgamber tjetër.

Kur’ani është Ligji islam. Ai që pohon se Kur’ani është nga All-llahu xh.sh. dhe beson në të, përgjithësisht dhe në detaje, quhet besimtar. Besimi në këtë aspekt nuk i është i njohur askujt përveç All-llahut xh.sh., sepse njerëzit nuk i hapin zemrat njerëzore, e as që dinë se çka ka në to. Prandaj, që muslimanët dikë ta konsiderojnë si njërin prej tyre, ai është i obliguar ta deklarojë këtë besim me shqiptimin e shehadetit, i cili shqiptim bëhet kështu: “Besoj se nuk ka hyjni tjetër pos All-llahut dhe besoj se Muhammedi, sal-lall-llahu lejhi ve selem, është I Dërguar dhe rob i Tij”.

Njeriu që i shqipton këto fjalë bëhet musliman, d.m.th.bëhet banor i vërtetë i shtetit islam, në të cilin muslimani i gëzon të gjitha të drejtat, duke pranuar që t’i kryejë të gjitha obligimet me të cilat e obligon Islami.

Këto obligime, apo detyrime fetare janë të pakta, të lehta dhe në to nuk ka kurrfarë mërzie e as vështirësi.

Obligimi i parë: Që në mëngjes, para lindjes së diellit, t’i falë dy rekate të namazit të sabahut, qetë e duke e thirrë në të Zotin e tij, duke iu lutur për mirësi dhe duke kërkuar mbrojtje nga dënimi. Para kësaj merr abdest, apo thënë më ndryshe, i lanë pjesët e caktuara të trupit apo nëse është xhunub (i papastër), lahet i tëri.

Në mesditë t’i falë katër rekate të namazit të drekës, e pastaj pak më vonë edhe katër rekatet e ikindisë. Pas perëndimit të diellit i falë edhe tre rekate të namazit të akshamit, dhe në fillim të natës katër rekate të namazit të jacisë.

Këto janë pesë namazet e obligueshme. Kryerja e tyre nuk zgjat më tepër se gjysmë ore. Për kryerjen e tyre nuk është i caktuar vendi apo personi i caktuar – personeli fetar – pa të cilin këto namaze nuk do të ishin të plota. Në to, sikurse edhe në të gjitha obligimet tjera fetare, nuk ka ndërmjetës midis muslimanit dhe Zotit të tij.

Obligimi i dytë: Gjatë vitit ekziston muaji i caktuar në të cilin muslimani e ndryshon kohën e ushqimit ashtu që mëngjesin e han në fund të natës në vend se në fillim të ditës, kurse e shtyen drekën deri në perëndim të diellit, duke u përmbajtur gjatë ditës nga ushqimi, pija dhe marrëdhëniet seksuale. Ky muaj për shpirtin e agjëruesit është muaji i pastrimit, për barkun e tij muaji i pushimit, për trupin e tij muaji i përmirësimit të sjelljes dhe shëndetit të tij. Ky muaj është një nga format e angazhimit në bamirësi dhe barazi në jetë.

Obligimi i tretë: Nëse pas plotësimit të nevojave të veta personale dhe nevojave të familjes së tij mbetet si tepricë një pjesë e caktuar e pasurisë, për të cilën ai gjatë tërë vitit nuk ka pasur nevojë, është i obliguar që nga ajo pasuri – pas kalimit të një viti – t’u ndajë 2,5 për qind të varfërve dhe atyre që kanë nevojë për një ndihmë të këtyllë. Për muslimanët kjo dhënie nuk paraqet kurrfarë barre, ndërsa është në dobi të madhe për ata që kanë nevojë. Ajo po ashtu është shtyllë e fortë e ndihmesës së ndërsjellë dhe ilaç për sëmundjen e varfërisë – njërës nga sëmundjet më të rënda të shoqërisë sonë.

Obligimi i katërt: Islami në bashkësinë e vet i ka rregulluar takimet familjare dhe atë:

- Takimin në nivel të mbledhjeve të lagjeve, të cilat mbahen pesë herë në ditë – si orët e mësimin në shkollë. Kjo është kryerja e namazit me xhemat, me ç’rast çdo besimtar e përforcon dëgjueshmërinë e tij ndaj All-llahut xh.sh. gjatë takimit pranë Tij. Qëllimi i kësaj mbledhjeje është

që të fortët t'u ndihmojnë të dobtëve, të diturit t'i mësojnë të paditurit ndërsa të pasurit t'u ndihmojnë të varfërve. Kohëzgjatja e këtij takimi, për afërsisht është pesëmbëdhjetë minuta, ashtu që nuk i paraqet kurrfarë pengese punëtorit në punë, e as tregtarit në tregti. Nëse takimi përfundon e ndonjë musliman nuk është i pranishëm në të, ai nuk dënohet për shkak të mungesës, por i mbetet shpërblimi i mangët për mospjesëmarrjen në të.

- Takimi në nivel të tubimit të lagjeve të qytetit, i cili mbahet një herë në javë – është Namazi i Xhumasë. Ky namaz zgjat më pak se një orë, ndërsa pjesëmarrja në të është e domosdoshme për muslimanët.

- Takimet në nivel të mbledhjes së qytetit që mbahen dy herë gjatë vitit, e këta janë Namazi i Bajramit të Ramazanit dhe Namazi i Bajramit të Kurbanit apo Haxhit. Pjesëmarrja në këto namaze nuk është e obligueshme, ndërsa kohëzgjatja e tyre është më pak se një orë.

- Takimi në nivel të kongresit gjithëmusliman që mbahet çdo vit në Mekken e Bekuar. Ky në të vërtetë është cikli drejtues, veprimor dhe ideor. Muslimani është i obliguar që së paku një herë gjatë jetës së tij (kuptohet, po qe se kushtet materiale ia mundësojnë një gjë të tillë), të jetë i pranishëm në këtë takim – e ky është Haxhi.

Këto janë obligimet themelore fetare me të cilat obligohet muslimani. Në obligimet fetare bën pjesë gjithashtu edhe përmbajtja nga veprat e caktuara, vepra për të cilat të gjithë njerëzit e mençur në botë pajtohen se janë të dëmshme dhe se jemi të obliguar që të largohemi nga ato, siç janë: mbytja pa të drejtë, sulmi ndaj njerëzve, të gjitha format e ushtrimit të dhunës, pijet dehëse që janë me pasoja shkatërrimtare, amoraliteti i cili shkatërron nderin, shëndetin dhe ngatërron farefisninë, kamata, gënjeshtria, mashtrimi, tradhtia, si dhe mosdëgjueshmëria ndaj prindërve,

betimi dhe dëshmia e rrejshme e shumë vepra të tilla të ngjashme si këto, shëmtimin e të cilave e njëj dhe e ka të ditur çdo mendje e shëndoshë.

Nëse muslimani e lë pas dore kryerjen e ndonjë obligimi apo vepron diç nga ajo që është e ndaluar, e pastaj kthehet dhe pendohet duke kërkuar falje nga All-llahu xh.sh., Ai me të vërtetë do t'ia falë. Por, nëse nuk pendohet dhe nuk kthehet nga vepra e ndaluar, mbetet ende musliman dhe llogaritet në radhët e muslimanëve, mirëpo konsiderohet mëkatar dhe meriton dënim në botën e ardhme- në ahiret, me atë dallim se dënimi i tij është i përkohshëm e jo i përhershëm, siç është dënimi i pabesimtarit.

Por, nëse e mohon ndonjërin nga bazat dhe parimet e besimit, apo dyshon në to, e refuzon obligimin apo ndalesën e bazuar në ixhma (ixhma-pajtimi i të gjithë dijetarëve rreth një çështjeje), apo nëse madje mohon ndonjë fjalë nga Kur'ani, atëherë ai del nga feja, konsiderohet renegat dhe i merret shtetësia islame. Dalja nga feja është mëkati më i madh në Islam, ashtu që mund të krahasohet me shkallën e tradhtisë më të madhe në ligjet bashkëkohore, dënimi për të cilën, po qe se nuk pendohet - është dënimi me vdekje.

Muslimani ndonjëherë e lëshon ndonjë obligim apo bën diç nga ajo që është e ndaluar, duke e pranuar obligimin dhe ndalesën, por edhe pse ende mbetet musliman, megjithatë bëhet mëkatar. Ndërsa, sa i përket besimit – imanit, ai është i pandashëm, ashtu që sikur t'i besonte p.sh. 99 për qind të parimeve të besimit, kurse t'i mohonte 1 për qind, konsiderohet si mosbesimtar.

Ndonjëherë muslimani nuk është mu'min, ngjashëm me atë i cili anëtarësohet në ndonjë shoqatë, merr pjesë në mbledhjet e saj, paguan anëtarësinë dhe i kryen obligimet e anëtarëve të saj, por nuk i pranon parimet e saj e as që është i bindur në vërtetësinë e tyre. Ai i bashkangjitet asaj

shoqërie vetëm e vetëm që ta spiunojë apo që t'i shkaktojë dëm. Ai është hipokriti-munafiku, i cili me gjuhë e shqipton shehadetin dhe sipërfaqësisht i kryen obligimet fetare.<sup>1</sup> Mirëpo, ai në realitet nuk është besimtar, e as nuk është i shpëtuar tek All-llahu xh.sh., ndonëse te njerëzit konsiderohet si musliman, sepse njerëzit gjykojnë sipas manifestimeve të jashtme, e vetëm All-llahu xh.sh. i njeh fshehtësitë dhe atë që gjendet në zemra.

Prandaj, kur njeriu i pranon parimet ideore të Islamit, e ato parime janë: besimi absolut në All-llahun xh.sh. duke mos i përshkruar Atij ndonjë shok apo ndërmjetës, besimi në melaiiket (engjëjt), në pejgamberët, në librat-shpalljet, në jetën e ardhme, në caktimin (kaderin) e All-llahut xh.sh. dhe shqiptimi i shehadetit. Kush beson thellë në të gjitha këto e pastaj i falë namazet e obliguara-farzet, e agjëron Ramazanin, nëse është i pasur e jep zekatin në pasuri, nëse ka mundësi ta kryejë haxhin një herë në jetë, largohet nga veprat e ndaluara, të cilat me ixhma-njëzëri janë të ndaluara, konsiderohet se është musliman-mu'min. Mirëpo, fryti i besimit nuk vërehet në njeriun, e as që ndjehet kënaqësia e tij, e as që konsiderohet musliman i vërtetë përderisa në jetën e vet nuk ta ketë pasuar rrugën e muslimanit – mu'minit.

---

<sup>1</sup> Hipokrizia (nifaku) është shprehje publike e besimit dhe fshehje e mosbesimit. Me këtë nuk kanë të bëjnë fjalët e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve selem, kur thotë: “Shenjat e munafikut janë tri. Ai që gënjën, nuk e mbanë fjalën, apo nuk e kryen punën e besuar-amanetin, nuk konsiderohet vetëm për këtë shkak mosbesimtar (kafir), sepse kjo është hipokrizi shoqërore e jo ajo e vërteta, d.m.th. hipokrizia në besim, të cilën e kemi përmendur.

I Dërguari i All-llahut xh.sh., Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve selem, shumë shkurt, në një fjali, e cila konsiderohet si një nga thëniet më thelbësore dhe më koncize, e ka paraqitur programin e asaj rruge. Një fjali e cila përmban ne vete çdo të mirë, të mirën e kësaj dhe të botës së ardhme.

Kuptimi i asaj fjalie është që besimtari gjatë kohës së punës dhe pushimit, kur është në vetmi dhe në shoqëri, në seriozitet dhe në shaka, në çdo situatë në të cilën gjendet, e ka ndërmend se All-llahu xh.sh. është i informuar për të dhe se e shikon. Kështu, duke e pasur në mendje faktin se Ai e shikon, nuk bën mëkate e as që frikësohet e dëshpërohet, duke e ditur se Ai është me të. Nuk ndien vetmi, duke e kujtuar atë e as që ndien nevojë për dikë, duke kërkuar ndihmë nga Ai dhe duke e lutur Atë. Po edhe nëse e bën ndonjë mëkat apo gabon – është e natyrshme që njeriu ndonjëherë edhe të gabojë – kthehet dhe pendohet, e All-llahu xh.sh. me të vërtetë ia falë atij gabimin.

E gjithë kjo është marrë nga definicioni i bamirësisë (ihsanit) në fjalët e Pejgamberit s.a.v.s.: “Ta adhurosh All-llahun xh.sh. ashtu sikur ta shohësh, sepse edhe pse ti atë nuk e sheh, Ai ty me të vërtetë të sheh”. Kjo në pika të shkurtra është Feja Islame. Pason shpjegimi i gjerësishëm për të: për besimin në këtë libër, ndërsa për Islamin dhe ihsanin (bamirësinë) në librat vijues – insha Allah.

## DEFINICIONET

Është e domosdoshme që në këtë kaptinë, në të cilën flasim për besimin, ta shtjellojmë shpjegimin e disa shprehjeve profesionale që janë karakteristike për fjalorin e dijetarëve, të cilat shpeshherë përmenden edhe në librat fetarë. Këto janë shprehjet DYSHIMI, MENDIMI dhe DITURIA. Përmes shpjegimit të këtyre termave, dëshirojmë të arrijmë deri te definicioni i besimit.

Dekarti në metodën e tij të njohur dhe para tij Gazaliu në veprën MUNKIDHU MINE-D-DALAL, nisen nga dyshimi që të arrijnë deri te besimi. Dekarti dyshon duke e marrë dyshimin si rrugë të arritjes deri te bindja, pra ç'është dyshimi?

Sikur p.sh. të gjendeshe në Mekke e dikush të të pyeste se a bie momentalisht shi në Taif (qytet në Arabinë Saudite), nuk do të ishe në gjendje të përgjigjesh as “po” e as “jo”, sepse është e mundur që në atë kohë në Taif moti të jetë me shi, siç ekziston mundësia që qielli në të të jetë i kthjellët-pa shi. Mundësia që atje bie shi është ta marrim shembull 50 për qind, kurse mundësia që të mos bie shi, po ashtu, 50 për qind. Që të dy mundësitë janë të njëjta dhe nuk ekziston argumenti, i cili peshon në njërin apo anën tjetër. Ky është dyshimi.

Por, sikur të shikoje në pjesën lindore (e Taifi është në pjesën lindore) e të shihje retë se si nga largësia paraqiten në skajet e horizontit, në ty do të dominonte-me përparësi të lehtë-mendimi se në Taif bie shi. Ky dominim i lehtë i mundësisë së reshjes së shiut quhet mendim. Në këtë rast ti thua: “Mendoj se tani në Taif bie shi”. Mundësia është p.sh. 60 për qind për “po”, d.m.th. se bie shi, ndërsa 40 për qind për “jo” – se nuk bie shi.

E sikur të shihje se si retë janë shtuar dhe janë dendësuar, se qielli është bërë i vranët dhe i turbulluar dhe se nga ai shkrepin rrufetë, tek ti forcohet mendimi se në Taif bie shi, kështu që për përgjigjen “po” – bie shi, mundësia bëhet 70 apo 75 për qind. Kjo është ajo që dijetarët tanë e quajnë mendim dominues. Në këtë rast ti atij që të pyet i thua: “Te unë dominon mendimi se tani në Taif bie shi”. Por, sikur të shkosh në Taif e me sytë e tu të shihje se bie shi, duke e ndier në fytyrën tënde, atëherë bëhesh i bindur në reshjen e tij. Këtë bindje të fortë dijetarët tanë e quajnë dituri apo njohje.

Kështu fjala dituri ka shumë kuptime: 1 – Dituri e përgjithshme, e cila është përballë paditurisë. 2 – Dituria e cila është përballë artit dhe filozofisë, kështu që kimia dhe fizika janë shkencë, ndërsa pikturimi dhe poezia arte. Qëllimi i njohjes në këtë kuptim është e vërteta-realiteti, arma e saj është mendja kurse mjeti i saj është të menduarit, eksperimentimi dhe hulumtimi. Ndërkaq qëllimi i artit është bukuria, arma e tij ndjenja, ndërsa mjeti i tij është shija. 3 – Dituria e cila ka kuptimin e bindjes së fortë, e cila është përballë dyshimit dhe mendimit dhe pikërisht ajo është qëllimi i këtij studimi.<sup>2</sup>

Dituria e domosdoshme dhe teorike

---

<sup>2</sup> Sa i përket shkencës në kuptimin profesional, si matematika dhe kimia, dijetarët tonë për të kanë dhënë më tepër definicione, megjithatë më e qarta është ajo e Sartunit: “Shkencë është grumbull njohurish të realizuara dhe të sistematizuara...” Me fjalën “njohje” përjashtohen ndjenjat dhe imagjinata, me fjalën “të realizuara” përjashtohen teoritë dhe supozimet, ndërsa me fjalën “të sistematizuara” përjashtohen njohuritë e shkapërderdhura dhe të shpërndara.

Diturisë deri te e cila arrihet me shqisa dhe me të vëzhguar nuk i nevojitet argumenti. Nuk është e nevojshme të argumentohet se kodra, të cilën e sheh pranë vete ekziston, sepse ti domosdo e di se ajo ekziston, sikur që çdonjëri, i cili posedon logjikë, kur e sheh, e di se ekziston. Kjo dituri quhet dituri e domosdoshme.

Njohuria se sipërfaqja e katrorit të hipotenuzës së trekëndëshit kënddrejt është e njëjtë me shumën e sipërfaqes së katrorit të dy kateteve, dëshmon argumentin mendor. Shkencëtari apo studenti, i cili arrin deri te njohuria e këtij argumenti, e di këtë fakt, mirëpo njeriu i thjeshtë e i paditur, nuk është i njohur, e as që beson në të, madje edhe ta shihte pranë vetes trekëndëshin, në çdo anë të tij të ishte i vendosur katrori, derisa nuk arrin te njohja e këtij argumenti. Kjo njohuri quhet njohuri teorike, deri te e cila arrihet vetëm me anë të dëshmisë racionale.

## **E VËRTETA E DUKSHME DHE BESIMI**

Dituri teorike llogaritet ajo së cilës në thelb i nevojitet argumenti dhe nuk është e kuptueshme me vetë shqisat e as me vështrim, megjithatë, është e përgjithshme dhe e shtrirë ashtu që i është e njohur edhe të diturit edhe të paditurit, edhe të madhit edhe të voglit dhe bëhet më afër diturisë së domosdoshme. Shembulli i kësaj është njohuria se pjesa e Tokës është më e vogël se Toka në tërësi, se buka e ndarë është më e vogël se ajo e plota. Edhe pse është fakt se në thelbin e diturisë teorike kërkohet argumenti, ti nuk do ta gjesh asnjërin, i cili në këtë do të dyshonte dhe kërkon për këtë argument. Sikur nga fëmija i vogël ta merrje çokollatën e plotë, e t'ia kthesh atë të

përgjysmuar, nuk do ta pranonte. Sikur të mundohesh që ta bindish se ajo që ia ktheve është më e madhe, nuk do të mund ta bindish, sepse fakti se një pjesë është më e vogël se tërësia është e vërtetë e dukshme, sikur që edhe argumenti i identitetit - apo fakti se ndonjë send me të vërtetë është ai send. Sikur dikush të të thoshte: “Më argumento se lapsi të cilin e mbanë në dorë nuk është lugë e çajit,”- do t’i thoshe: “Kjo është e dukshme, nuk ka nevojë që të argumentohet, sepse lapsi është laps...!”

Të vërtetat e dukshme, a priori janë fakte racionale, të cilat i pranojnë të gjithë njerëzit dhe askush për to nuk kërkon argument. Kur e vërteta e qartë hyn në nënvetëdije dhe zë vend në të, duke lënë gjurmë në ide dhe vetëdije dhe duke e drejtuar njeriun në të menduarit dhe të vepruarit e tij të vetëdijshëm, ajo quhet fe (ideologji), ndërsa bindja e fortë në të iman (besim).

Mirëpo, ne e dimë se njerëzit ndonjëherë besojnë edhe në të pavërtetën-gënjeshtren. Shohim sot, në mesin e ithtarëve të drejtimeve (shkollave) të devijuara dhe parimeve të rrejshme, ata të cilët janë mishëruar me to edhe me shpirt edhe me trup, i kanë pranuar fshehurazi e haptazi, duke sakrifikuar veten dhe pasurinë në rrugën e ndihmës për ato drejtime. A mund t’i quajmë këta njerëz besimtarë?

Përgjithësisht “jo”! Megjithatë, mund t’ua përshkruajmë besimin duke e konstatuar si të pavërtetë atë në të cilën besojnë, në pajtim me fjalët e Të Lartësuarit: “A nuk i ke parë ata, të cilëve u është dhënë një pjesë e librit? Besojnë idhuj e djallëzi...” (En-Nisa, 51).

Është e mundur t’ua përshkruajmë emrin e besimit duke e kufizuar me përshkrim, në pajtim me fjalët e Të Lartësuarit: “Dhe shumica e tyre nuk e beson ndryshe All-llahun, vetëm se duke i shoqëruar (zota të tjerë).” (Jusuf, 106).

Mirëpo, sa i përket besimit në kuptimin e ngushtë-specifik, në kuptimin e të cilit kthehet kur të përmendet përgjithësisht dhe vetëm në të udhëzohet, kuptimin në të cilin mendohet sa herë që të përmendet imani (besimi) dhe derivatet e tij në Kur'an, Sunnet dhe terminologjinë e dijetarëve, ajo do të thotë:

- Besimi në All-llahun xh.sh. si Zot i Vetëm;
- Sundimtar i Cili bën ç'të dojë dhe cakton si të dojë;
- Zot që vetëm Atij i drejtohet ibadeti (adhurimi), duke mos i përshkruar shok në asgjë që bën pjesë në kategorinë e ibadetit (adhurimit);
- Besimi në gjithë atë që ia shpalli Të Dërguarit-Muhammedit a.s. prej lajmeve për: melaiket, pejgamberët, Ditën e Gjykimit dhe caktimin e All-llahut xh.sh. – kaderin – në të mirë e në të keq.

Poseduesi i këtij lloj besimi është mu'min, e nëse diç nga kjo gjymton apo braktisë, apo hamendet në pranimin e tij ose dyshon në të, humb cilësinë e imanit-besimit dhe pushon së llogarituri në mesin e besimtarëve.

## **PARIMET E BESIMIT**

### **PARIMI I PARË**

Atë që e ndjej me shqisat e mia, nuk dyshoj në ekzistencën e tij.

Kjo është e vërteta logjike, e pranuar, e gjithënjohur. Mirëpo është evidente dukuria që kur në mesditë shkoj nëpër shkretëtirë, e më paraqitet qartë në sy një liqe i vogël, e kur të arrijë deri te ai shoh vetëm rërë (zallë), sepse atë që e kam parë ka qenë fatamorganë. E fus penën e shkrimit në gotë të ujit dhe e shoh si të thyer, por nuk është e thyer. Njeriu merr pjesë në ndonjë ndej të mbrëmjes, ku është biseduar për xhinnët dhe shpirtligët, e pastaj kthehet në shtëpi, e nëse rruga është e shkretë pa këmbësorë dhe e errët, kurse ai mendjelehtë e me imagjinatë të gjerë sheh pranë vetes xhinnin apo shpirtligun, e vështron dhe e ndien praninë e tij, por në të vërtetë nuk ekziston asgjë nga ajo që ai kinse e sheh.

Magjistarët dhe falltorët shfaqin sende të çuditshme, të cilat ti i sheh, por ato në realitet nuk ekzistojnë. Prandaj, shqisat gabojnë, mashtrojnë dhe imagjinojnë, apo imagjinon pronari i tyre, pra a thua për këtë shkak të dyshojmë në ekzistencës e asaj që e ndiejmë? Jo, sepse të dyshoja në tërë atë që e shoh, e dëgjoj dhe e ndiej, do të më ngatërroheshin të vërtetat – faktet me fantazinë dhe do të bëhesha i njëjtë si njeriu i çmendur.

Mirëpo, shtojmë edhe një kusht për arritjen e njohjes, apo bindjes së fortë në ekzistimin e asaj që e ndiejmë, e ky është që mendja në bazë të përvojës paraprake, të mos gjykojë se ajo që e ndiejmë është iluzion – imagjinatë apo mashtrim i shqisave, ndërsa mendja është ajo që është mashtruar herën e parë, duke menduar se fatamorgana është liqe uji, e kur e sheh për herë të dytë, e di se ajo është fatamorganë. Mendja gjykon pas shikimit të penës së thyer në gotën e ujit – herën e parë – se është e pathyer, siç edhe ka qenë, edhe pse syrit i duket e thyer.

Sendet, në të cilat shqisat gabojnë apo mashtrojnë, janë të kufizuara, të pakta dhe të njohura, kështu që nuk e dobësojnë parimin e përmendur, e as që ndikojnë në të. Në ato sende bëjnë pjesë edhe veprat e magjistarëve të Faraonit, si edhe ajo që sot magjistarët e bëjnë në cirk.

## PARIMI I DYTË

Ekzistojnë gjëra që nuk i kemi parë e as nuk i kemi ndier, por besojmë thellë në ekzistimin e tyre, njëlloj sikur që besojmë thellë në ekzistimin e asaj që e shohim dhe e ndiejmë. Jemi të bindur thellë në ekzistimin e Indisë dhe Brazilit, e nuk i kemi vizituar asnjëherë. Besojmë se Leka i Madh e ka pushtuar Persinë, ndërsa Velid ibn Abdul-Meliku e ka ngritur xhaminë emevite, por nuk kemi marrë pjesë në betejat e Lekës së Madh as që kemi qenë dëshmitarë të ngritjes së xhamisë së Emevive.

Sikur çdonjëri të mendonte në vete, do të shihte se sendet në ekzistimin e të cilave besojmë por nuk i kemi parë, janë më shumë në numër se ato të cilat i kemi parë (shtetet, qytetet dhe ngjarjet historike të cilat kanë ndodhur dhe ndodhin sot e kësaj dite). E si është thellë i bindur në ekzistimin e atyre sendeve, e nuk i ka ndier me shqisat e veta?

Është i bindur thellë në ekzistimin e tyre atëherë kur për to e kanë lajmëruar grumbujt e njerëzve njëri përmes tjetrit, mundësia e të cilëve që të merren vesh mes veti e t'i trillojnë këto sende, e që pastaj t'i transmetojnë rrejtshëm, praktikisht ka qenë e pamundur.

Prandaj parimi i dytë është: Ashtu siç arrihet deri te bindja e fortë përmes shqisave dhe vështrimit, po ashtu arrihet edhe përmes dëshmimeve të transmetuesve, në sinqeritetin e të cilëve besojmë përmes lajmeve të vërteta.

## PARIMI I TRETË

Sa është largësia e njohurisë që e arrijnë shqisat, dhe a janë ato në gjendje ta kuptojnë krejt atë që ekziston?

Shembulli i shpirtit dhe i shqisave është sikur shembulli i njeriut të cilin sundimtari e ka burgosur në kështjellë, duke ia mbyllur të gjitha dyert dhe dritaret dhe duke mos i lënë asgjë, përveç disa vrimave të vogla – të çarave në muret e kështjellës, përmes të cilave shikon lumin që rrjedh në anën lindore, vrima nga e cila shihet kodra që gjendet në anën perëndimore, vrima e cila shikon në pallatin, i cili ngrihet në anën veriore dhe vrima e cila shikon fushën që shtrihet në anën jugore.

Burgu është shpirti, kështjella është trupi, ndërsa vrimat janë shqisat. Shqisa e të pamurit mbikëqyr botën e ngjyrave, shqisa e të dëgjuarit botën e zërave, shqisa e shijimit botën e shijeve, shqisa e të nuhaturit botën e aromave dhe shqisa e të prekurit botën e sendeve.

1 – Tani pyetemi: A ka arritur çdonjëra prej shqisave të përmendura ta zbulojë gjithë atë që gjendet në botë mbi të cilën ka vigjëlur? Kur i burgosuri vështron përmes vrimës nga e cila

shikon në lumë, nuk e sheh të tërin, por vetëm një pjesë të tij, njëlloj sikurse syri, kur e vështron botën e ngjyrave nuk e sheh të tërën por vetëm një pjesë të saj.

Unë nuk e shoh buburrecin kur lëvizë në largësi prej tri miljesh edhe pse buburreci ekziston atje, e as që i shoh bakteret dhe mikroorganizmat në gotën e ujit të pastër, edhe pse në gotë gjenden me miliona baktere. Po ashtu nuk i shoh elektronet, të cilat qarkullojnë në mes të atomit, siç qarkullojnë yjet në kupën e qiellit. Më pastaj, ai buburrec posedon zë, por unë nuk e dëgjoj, sepse veshi im i pranon vetëm vibracionet me forcë (intensitet), prej njëzet mijë deri në njëzet e pesë mijë fonesh, prandaj çdo zë që është më i dobët se kjo nuk e dëgjon, ndërsa çdo zë që është më i fortë e shpon timpanin e veshit dhe shkakton dhembje. Unë nuk e ndiej erën e sheqerit, edhe pse buburreci dhe miza e ndiejnë dhe vërsulen tek ai. Ndaj shqisat, nga botët mbi të cilat u është dhënë pushteti, zbulojnë vetëm një pjesë të tyre.

2 – Mandej, a nuk është e mundur që ndërmjet botës së ngjyrave, mbi të cilën vigjëlton syri, dhe botës së zërave mbi të cilën vigjëlton veshi, të ekzistojë një botë tjetër, të cilën në thelb nuk e njoh, sepse nuk posedoj shqisa për njohjen e saj?

A nuk është e mundur që ndërmjet lumit e kodrës – në raport me të burgosurin e kështjellës, të ekzistojë një kopsht i madh të cilin ai as nuk e sheh e as nuk e njeh, sepse nuk gjenë vrimë përmes së cilës do ta vështronte? Prandaj a ka të drejtë që për shkak se nuk e sheh, ta mohojë ekzistimin e tij?

Njeriu i verbër nga lindja ka mundësi që përmes dëgjimit të arrijë deri te njohuria se deti është i kaltër, ndërsa livadhi i gjelbër, por nuk është në gjendje që të kuptojë se ç'është ajo kaltërsi, apo ai gjelbërim. I shurdhëti përmes arsimimit kupton se meloditë përbëhen prej: vargjeve, takteve dhe

shkallëve – notave, mirëpo nuk është në gjendje ta ndjejë thelbin e muzikës. Pra, a ka të drejtë i verbëri ta mohojë ekzistimin e gjelbërimit, apo i shurdhëti ta mohojë realitetin e melodisë, për shkak se nuk e ndien?

Në brendësinë e dhomës me qetësi të madhe, gjenden të gjitha meloditë dhe tingujt, të cilat momentalisht emetohen nga të gjitha radiostacionet. Ti nuk i ndien, sepse nuk janë ngjyrë të cilën e sheh me sy, e as zë të cilin e dëgjon me veshë, ato janë valët e llojit tjetër, të cilat kanë zë, por veshi nuk i ndien, mirëpo, kur ta përdorish radion, e cila këta tinguj – pasi që i pranon nga radiostacioni – i kthen te ti, atëherë i dëgjon ato.

Ti nuk i ndien ndryshimet e vogla të shtypjes atmosferike, sepse nuk posedon shqisë me të cilën do t'i ndjeje, mirëpo, nëse e përdorë barometrën do t'i ndiesh, ashtu siç nuk i ndien vibracionet dhe dridhjet e qeta, mirëpo radari i ndien. Prandaj, ka shumë gjëra të cilat nuk hynë në sferën e ndjenjave apo shqisave, sepse nuk janë ngjyra të cilat shihen, zëra të cilët dëgjohej, sende të cilat preken, aroma të cilave u merr erë e as ushqim i cili shijohet. Pra, a kam të drejtë që ta mohoj ekzistimin e tyre për shkak se shqisat e mia të kufizuara nuk i ndiejnë?

3 – A janë shqisat të përsosura?

Popujt e mëparshëm i kanë kufizuar shqisat në pesë, duke mos përfytyruar mundësinë e shtimit të numrit të tyre. Mirëpo, sot tek njeriu janë zbuluar shqisa të tjera, të reja, të cilat All-llah xh.sh. i ka depozituar në të, e ajo që pranon shtim – rritje, nuk është e përsosur.

Unë i mbyll sytë, pastaj e shtriej dorën dhe e mbledh, duke ndier se a është e shtrirë apo e mbledhur, e nuk e kam prekur e as nuk e kam parë. Me çfarë shqise këtë e kam ndier? Këtë e kam

ndier me të ashtuquajturit muskuj apo shqisa muskulore. Po ashtu ndjej lodhje apo plogështi, ndjej mërzi, gëzim dhe dekurajim, duke mos i ndier këto me asnjërën nga pesë shqisat, por me të ashtuquajturën shqisë e brendshme.

Unë ec pa m'u marrë këmbët, ndërsa foshnja – në fillim të ecjes – rrëzohet Çiklisti dhe argëtuesit e cirkut, të cilët ekzekutojnë çudira, me cilën shqisë e mbajnë baraspeshën? Ekziston shqisa e tetë, e kjo është shqisa e baraspeshës. Shkencëtarët e kanë zbuluar vendin në të cilin All-llahu xh.sh. e ka vendosur atë, e ajo është një substancë e vogël e lëngët në veshin e brendshëm, me ndihmën e së cilës mbahet baraspesha. Në kuadër të eksperimenteve të tyre këta shkencëtarë e kanë hequr këtë substancë tek lepuri, ashtu që më vonë ai ka filluar të ecë duke rrëshqitur, sikur të ishte i dehur. Parimi i tretë pra, është se nuk kemi të drejtë që t'i mohojmë gjërat vetëm pse nuk i ndiejmë ato me shqisat tona.

## PARIMI I KATËRT

Kemi thënë se shqisat kanë aftësi të kufizuara, sepse unë me sytë e mi nuk e shoh krejt atë që është e dukshme. Kjo është e vërtetë, mirëpo All-llahu xh.sh. na ka pajisur me aftësi, me të cilat e përmbushim mungesën e shqisave, e kjo është imagjinata, apo fantazia.

Unë edhe pse nuk jam në gjendje ta shoh shtëpinë time nga Mekka në Damask, jam në gjendje ta përfytyroj atë sikur e shoh. Prandaj, imagjinata i plotëson shqisat, pra a i ka ajo kufijtë e vet, apo është e lirë, e pakufizuar? A jam në gjendje të përfytyroj diç që me shqisa nuk e kam ndier?

Imagjinata sipas mendimit të psikologëve është dylojëshe: imagjinatë destruktive, siç ishte përfytyrimi im i shtëpisë nga Mekka në Damask, dhe imagjinata kreative apo konstruktive, siç është imagjinata e poetëve, tregimtarëve, piktorëve, artistëve e të tjerëve. Shikoni në imagjinatat e këtyre artistëve, a kanë imagjinuar diç që nuk ekziston në realitet?

Skulptori që ka gdhendur statujën e Venerës ka ardhur me figurën të cilës ne nuk ia kemi parë çiftin, e as me atë të cilës plotësisht i ngjason apo i përgjigjet, mirëpo, a është ajo diç e re, apo skulptori i saj i ka marrë pjesët nga realiteti dhe mes veti i ka ndërlidhë? Ka marrë hundën më të bukur të cilën e ka parë, buzët më të bukura dhe trupin më të bukur, duke i ndërlidhur këto në mes veti dhe kështu ka ardhur me diç të re. Megjithatë kjo e reja është e përbërë nga pjesët e së vjetrës.

Në statujën e Mëzatit asirian me krahë në muzeumin e Parisit nuk ka asgjë të jashtëzakonshme, përveç që skulptori i tij ka marrë kokën e njeriut dhe e ka vendosur në trupin e mëzatit, e pastaj ia ka shtuar krahët e shpendit. Pra, figura dhe pamja e re është e përbërë nga pjesët e vjetra.

Po ashtu shtaza e çuditshme të cilën e ka përfytyruar Kazvini, si dhe fantazia e poetëve, sado thellë që kanë hyrë në fushën e metaforave, krahasimeve, metonimive dhe hiperbolave magjike, ato nuk dalin nga suazat e bashkimit të pjesëve – të shpërndara e të shkapërderdhura nga realiteti. Nëse do të thelloheshim edhe më shumë në bashkimin e jashtëzakonshëm të këtyre (pjesëve nga realiteti), do të vërenim se edhe vetë imagjinata është e pafuqishme t'i marrë me mend të gjitha ato sinteza. Merrni për shembull, një pjesë nga bota e ngjyrave dhe një pjesë nga bota e zërave dhe thuani: Se a ka kënduar ndonjë këngëtar melodi me aromë të pakëndshme, apo era përkatëse

është e ngjyrës së kuqe, e pastaj këtë fotografi ia paraqitni imagjinatës suaj dhe do të shihni se nuk jeni në gjendje që ta përfytyroni, edhe pse e tëra kjo fotografi nuk ka dalë prej botës reale.

Ne nuk jemi në gjendje që ta përfytyrojmë melodinë me aromë, e as erën e kuqe. Pastaj, mundësitë tona janë t'i përfytyrojmë vetëm tri dimensione: gjatësinë, gjerësinë dhe lartësinë, dhe nuk jemi në gjendje që ta përfytyrojmë dimensionin e katërt, siç nuk jemi në gjendje ta përfytyrojmë rrethin pa cirkonferencë apo trekëndëshin pa kënde. E atëherë si ta përfytyrojmë botën e ardhme dhe atë se çka ka në të, duke qenë se ajo botë plotësisht dallohet nga kjo. Me të vërtetë bota e ardhme në raport me këtë botë, është si kjo botë në raport me botën e foshnjës në barkun e nënës. Sikur të ishim në gjendje që të vëmë kontakt me foshnjën në mitrën e nënës dhe ta pyetnim – po ta marrim se është në gjendje të na përgjigjet – duke i thënë: “Ç’është Gjithësia”?, – ajo do të na përgjigjej: “Gjithësi janë të gjitha këto dukuri që më mbulojnë dhe këto errësira që më rrethojnë”.

Po t'i thoshim: “Këndej ekziston një Gjithësi tjetër në të cilën gjenden Dielli dhe Hëna, nata dhe dita, toka dhe deti, fusha dhe kodra, shkretëtirat shterpe dhe kopshtet e shtruarat!”, nuk do ta kuptonte domethënien e këtyre fjalëve, por edhe sikur t'i kuptonte, nuk do të ishte në gjendje ta përfytyronte kuptimin e tyre të vërtetë. Andaj, Abdullah Ibni Abbasi r.a. ka thënë.

“Nga gjërat e ahiretit ne dunjallëk janë vetëm emrat-emërtimet (e tyre)! (Thënë ndryshe, vetëm emrat e asaj që gjendet në dunjallëk dhe ahiret janë të përbashkët, derisa thelbi plotësisht ndryshon). Për këtë arsye, vera (që pihet, - sh.p.) në botën e ardhme nuk është si vera në dunjallëk, as zjarri i xhehennemit nuk është si zjarri i dunjallëkut, e as Ura e Siratit, e shtrirë përtej xhehennemit, nuk është si urat tjera të ngritura mbi lugina e lumenj”.

Pra, parimi i katërt është: Imagjinata njerëzore është në gjendje ta përfshijë vetëm atë deri te e cila kanë arritur shqisat.

## PARIMI I PESTË

Kur syri e shikon thuprën e drejtë, të përthyer në gotën e ujit të pastër, mendja nuk mashtrohet me atë që syri e ka parë, sepse e di se thupra ende ka mbetur e drejtë. Kur syrit i duket rëra e shkretëtirës si ujë, mendja e di se ajo është fatamorganë-mashtrim, dhe se nuk është ujë por rërë. Kur ta shikojmë magjistarin në cirk se ai i nxjerr nga goja njëqind faculeta, kurse nga mëngët e palltos njëzet lepuj, mendja kupton se ajo është fanitje dhe mashtrim. Pra, mendja është bërë gjykatës, dhe ky gjykim i saj është lagpamës. Mirëpo, a është ajo (mendja) gjykatës mbi të gjitha, dhe a është largësia e gjykimit të saj e pafund?

Mendja nuk është në gjendje që të kuptojë asgjë derisa nuk përkufizohet me dy gjëra, me kohë dhe hapësirë, pra ajo që nuk është e përkufizuar me kohë dhe hapësirë, mendja-vetvetiu-nuk është në gjendje ta kuptojë.

Sikur profesori i historisë të thoshte: “Ka shpërthyer lufta ndërmjet arabëve dhe persianëve, mirëpo kjo luftë nuk është zhvilluar para Islamit e as pas tij, e as në ndonjë kohë tjetër, por në të vërtetë ka shpërthyer”, - këtë nuk do ta kuptoje apo besojë, e as që do ta pranojë. E sikur profesori i gjeografisë të thoshte. “Ekziston qyteti, i cili nuk është në rrafshinë e as në kodër, as

në tokë e as në det, nuk është në Tokë e as në Gjithësi, as në çfarëdo hapësire, mirëpo ai ekziston”, - ti këtë nuk do ta kuptoje, nuk do ta pranoje, e as që do t’i besojë.

Prandaj, mendja nuk gjykon ndryshe, përveç se brenda kufijve të kohës dhe hapësirës, ashtu që ajo që është jashtë atyre kufijve, nga çështja e shpirtit, caktimit të All-llahut xh.sh., lartësisë dhe cilësive të Tij, mendja nuk është në gjendje të gjykoj për to.

Pastaj, mendja është e kufizuar. Nuk mund të gjykoj mbi të pakufizuarën, e as që është në gjendje ta kuptojë atë. Prezentoja vetes amshueshmërinë e besimtarit në Xhennet! Mendja e besimtarit është e bindur se ajo është e vërtetë dhe kjo bindje (jekin) i ka ardhur përmes lajmit të të sinqertit – Të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve selem. Mirëpo, shiko se mendja jote a e kupton amshueshmërinë? Përqëndroje mendimin mbi të, e do të shohësh se si e përfytyron qëndrimin e tyre në Xhennet një shekull apo dy, njëqind, një milion apo një mijë milionë shekuj, pastaj do të konstatosh se mendja jote mbetet e pafuqishme dhe pyet: “E çka pas kësaj?”. Ajo dëshiron që me atë ta caktojë kufirin. Ajo nuk është në gjendje ta kuptojë amshueshmërinë, e kur ta pandehë arritjen deri te ajo, vjen në kundërshtim i cili dëshmon për kotësinë dhe mashtrimin e saj.

Filozofi gjerman, Emanuel Kanti, e ka shkruar librin e njohur në të cilin vërteton se mendja nuk është në gjendje që të sjell gjykime për diç tjetër, përveç se për botën materiale. Mirëpo, atë të cilën e ka thënë Kanti, shumë më parë e kanë thënë ulematë (dijetarët) tanë, duke e përsëritur dhe vërtetuar aq shumë saqë është bërë si e vërtetë përgjithësisht e njohur, kurse të folurit për të – përsëritje e zakonshme. T’i shohim kundërthëniet e njohura të Kantit si u paraprijnë dijetarët tanë të cilët kanë shpjeguar me argumente matematikore se “rrethi i çoroditur – circulus vitosus” (se çdo send shkakton tjetrën dhe kështu me radhë deri në fund), është i gabuar dhe gënjeshtër.

Njëri nga argumentet më të afërta të tyre është ky: nga pika (M), p.sh. nxjerr dy rreze, d.m.th. dy vija të drejta, të cilat largohen në mes veti-siç mund të shihet në fotografi dhe pandeh (përfytyron) gjatësinë e çdo vije deri në pafundësi (B,B). Pastaj i bashkon këto dy vija me vija diagonale në distancë të barabartë (C-H; C1-H1; C2-H2), dhe kështu derisa nuk të arrish deri te vija (B,B). A është ajo vijë e kufizuar apo e pakufizuar?

Nëse thua se është e kufizuar, do të të thuhet se ajo vijë është ndërmjet dy pafundësive. Prandaj, si mund të jetë e kufizuar? E nëse thua se është e pakufizuar, e merr përgjigjen se ajo është vijë e cila i bashkon dy pika (B, B), prandaj si mund të jetë e pakufizuar?

Pra ajo është e kufizuar dhe e pakufizuar, e kjo është kundërthënie!

Pra, është vërtetuar se mendja humbë baraspeshën (çrregullohet të perceptuarit e saj) kur bën përpjekje që të gjykoj për të pakufizuarën, njëllon siç bie në kundërthënie absurde, kur gjurmon atë që nuk ka fund-pafundësinë.

Mendja, pra nuk është në gjendje që të gjykojë, e as që është i drejtë gjykimi i saj, përveç se për sendet e kufizuara materiale. Ndërsa sa i përket asaj ç'është jashtë kufijve të materiales, apo të padukshmes-botës metafizike, mendja për të nuk mund të gjykojë. E atë që e ka vërtetuar Kanti, e para tij edhe ulematë tanë, gjendet në librin SHERHUL-MEVAKIF nga Sejjidi, mesazhi MEKSADUL-ESNA nga Gazaliu dhe në librat tjerë të akides.

## PARIMI I GJASHTË

Të gjithë njerëzit, edhe besimtarët edhe pabesimtarët, ata të cilët janë rritur në shtëpitë e ibadetit (adhurimit) në xhamia dhe kisha, apo të edukuarit në strehimoret e amoralit dhe rezillëqeve, kur i godet ndonjë fatkeqësi e madhe-katandisje fati nga e cila humbin durimin dhe nuk gjejnë ilaç, nuk kërkojnë ndihmë dhe mbrotje në asnjë nga këto krijesa, por kërkojnë ndihmë dhe strehim te fuqia e cila është prapa atyre krijesave, fuqia të cilën nuk e shohin, por në shpirtra dhe zemra e ndiejnë ekzistimin, madhësinë dhe lartmadhërinë e Saj.

Kjo i ndodh një numri të madh të nxënësve në ditët e provimeve, si dhe shumë të sëmurëve kur dhembjet u shtohen dhe mjeku bëhet i paaftë për to. Të gjithë i kthehen Zotit të tyre dhe i përkushtohen Atij me adhurim. Pra, a keni pyetur ndonjëherë se ç'është shkak i kësaj dhe të ngjashmes me të? Si e dimë që ndonjëri, i cili bie në vështirësi, i kthehet Allahut xh.sh.? Të gjithëve na kujtohen<sup>3</sup> ditët e luftës së kaluar dhe asaj të parës, se si njerëzit iu kthyen fesë duke kërkuar strehim te All-llahu xh.sh. Komandantët dhe eprorët janë drejtuar kah tempujt dhe e kanë ftuar ushtrinë në (namaz) – lutje.

Kam lexuar në revistën MUHTAR, artikullin e përkthyer nga ndonjë revistë tjetër, të botuar në ditët e luftës, nga një i ri-parashutist (në kohën kur parashutistët dhe aterimet kanë qenë diç e re), i cili tregon ndodhinë e tij ku thotë se është ritur në një shtëpi në të cilën askush nga anëtarët e saj

---

<sup>3</sup> Mendoj në njerëzit me moshë mesatare dhe ata të moshuarit të cilëve u kujtohet lufta e fundit më 1939 dhe ajo para kësaj më 1914. Unë i mbaj në kujtesë dhe në bazë të asaj që kam parë me sytë e mi shpreha mendimin tim mbi to.

Zotin nuk e kanë përmendur e as që Atij iu kanë lutur-falur. Ka mësuar në shkolla në të cilat nuk ka pasur orë mësimi fetar e as mësues besimtarë, dhe se është edukuar me edukatë materialiste (laike), apo thënë më mirë, ashtu siç edukohet kafsha e cila nuk di tjetër përveç ushqimit, pijes dhe mbarësismit. Mirëpo, kur për herë të parë është lëshuar me parashutë, duke e parë veten se si bie, para se parashuta të ketë filluar të hapej, filloi të lutet: “O Zot, Krijuesi im!”, dhe me gjithë zemër të lutet, duke u çuditur nga i erdhi ky besim?!

E bija e Stalinit, e cila është rritur e edukuar në vorbull të mosbesimit, para pak kohe i ka botuar memoaret (kujtimet) në të cilat përmend se si i është kthyer besimit, edhe vetë duke u habitur nga kjo kthesë. Mirëpo, në këtë nuk ka kurrfarë çudie, sepse besimi në ekzistimin e All-llahut xh.sh. është diç që është e fshehur në çdo shpirt. Ajo është natyrshmëri-një nga instinktet thelbësore njerëzore, siç është p.sh. instinkti seksual, e njeriu është kafshë e cila beson.

Megjithëkëtë, këtë natyrshmëri njerëzore ndonjëherë e mbulojnë epshet, dëshirat, pasionet dhe nevojat materiale jetësore, e kur ta trondisin tmerret, rreziqet dhe vështirësitë, e hedh nga vetja atë mbulesë dhe paraqitet besimi. Për këtë shkak, ai i cili nuk beson quhet kafir, e në gjuhën arabe fjala “kafir” ka kuptimin: “Ai i cili mbulon”. Është interesante se mbështetjen e kësaj ideje e kam gjetur në dy deklaratat të largëta në mes veti sipas kohës, hapësirës, kushteve dhe qëllimit, mirëpo, të njëjta sipas kuptimit.

Deklaratën e muslimanes së njohur, të devotshmes Rabiye Adevijes, dhe deklaratën e shkrimtarit të njohur francez ateistit Anatoll Fransoa, ku për shkakun e ateizmit dhe mosbesimit të vet thotë: “Njeriu bëhet besimtarë kur si rezultat i analizës së urinës, i paraqitet se ka sëmundjen e sheqerit (në kohën kur insulini nuk ka qenë i njohur)...!”. Ndërsa Rabisë i është thënë: “Filani ka sjellë një

mijë dëshmi për ekzistimin e All-llahut xh.sh”.Ajo në këtë është buzëqeshur dhe ka thënë: “Mjafton një dëshmi”. E pyetën: “Cila”, – në çka u përgjigj: “Sikur të udhëtoje i vetmuar në shkretëtirë, e në një moment të rrëshqiti këmba dhe ra në një pus nga i cili nuk je në gjendje të dalësh, çka do të bëje atëherë?”. Bashkëbiseduesi i saj i tha: “Do të thërrisja: O Zot...!”. “Kjo është dëshmia”,- shtoi Rabija.

Besimi në All-llahun xh.sh. është në thellësinë e shpirtit të çdo njeriu. Kjo është e vërteta të cilën ne muslimanët e njohim, sepse All-llahu xh.sh. na ka lajmëruar se besimi-ïmani është natyrshmëri (instinkt), me të cilën i ka krijuar njerëzit. Këtë të vërtetë evropianët sërish e kanë zbuluar. Dirkemi, profesor i njohur francez i filozofisë, e ka shkruar librin në të cilin thekson se besimi në ekzistimin e Zotit është e vërtetë e qartë-aksiomë. Është e pamundur që njeriu të jetojë dhe të vdesë duke mos menduar për Zotin e kësaj Gjithësie. Mirëpo, ndoshta ka qenë mendjeshkurtër dhe nuk ka arritur deri te Perëndia e vërtetë, por ka adhuruar gjërat tjera përveç Tij, duke konsideruar se ata janë zota apo e afrojnë te Zoti.

E kur të ndodhë diç e re – del ndonjë telashe dhe paraqitet çasti i rrezikut, i kthehet të vetmit All-llah xh.sh. dhe i mohon ata zota të rrejshëm. Mushrikët e fisit Kurejsh e kanë adhuruar Hubelin, Latin dhe Uzatën, gurët dhe statujat. Hubeli është statujë e kuqe të cilën e solli Amër ibn Luhajj nga Siria, nga Shami. I kanë thënë se është zot i madh dhe i fuqishëm, e kur e mori dhe e vuri mbi deve, rrugës i ra dhe dora e kësaj statuje u bë copë e grimë, prandaj ia bënë një dorë tjetër nga ari. Këtij “Zoti” iu thye dora, por edhe krahas kësaj e kanë adhuruar! I kanë adhuruar në momentet e rehatisë dhe sigurisë, e kur lundronin nëpër det dhe kur valët shqetësoheshin (turbulloheshin), duke paralajmëruar fantazmën e përmytjes, nuk kanë thirrur: “O Hubel”, por: “O All-llah!”.

Kjo është e dukshme edhe sot me rastin e anijetherjeve, shpërthimeve të zjarrit, me rastin e rrezikut apo keqësimit të sëmundjes. Atëherë do t'i shohish ateistët se si i kthehen fesë!

Përse? Për shkak se besimi është instinkt, dhe deficioni më i plotë për njeriun është se: “Ai është kafshë religjioze”. Shikoni në këta materialistë-pabesimtarë kur t’u vijë vdekja! A mendoni se Marksi dhe Lenini kur ta kenë parë vdekjen (janë bindur në arritjen e saj) kanë thirrur mjete prodhuese të cilat i kanë adhuruar, apo e kanë thirrur All-llahun? Bëhuni të bindur se nuk kanë vdekur para se t’i jenë lutur Zotit, por atëherë kjo lutje nuk bënë dobi. Edhe Faraoni ka bërë tirani dhe mendjemadhësi duke folur:

“Unë jam më i madhi zot i juaji”, - por kur e përfshiu atë përmbysja – tha: “Besova se nuk ka hyjni tjetër pos Atij që i besuan Beni Israilët (izraelitët)...” (Junus, 90).

Në simpatinë e dashurisë të cilën e ndien i dashuruari, qëndron argumenti se besimi është natyrshmëri-instinkt te njerëzit (shpirtrat e tyre). Dashuria është fotografi e zvogëluar e besimit, si dhe nga format e ibadetit. Francezët, pasi që në mesin e tyre kishte dominuar lënia e fesë, fjalën “adhurim” e kanë përdorur për dashurinë. Në këtë i kanë pasuar edhe disa nga ne, të cilët janë evropianizuar, kështu që në bisedat e tyre filluan të flisnin: “E don dhe e adhuron” dhe “E ka dashuruar deri në adhurim”, e kjo nuk don të thotë asgjë tjetër, vetëm se adhurimi është manifestim natyror i besimit në Zotin, ndërsa dashuria është njëra nga format e besimit.

I dashuruari i nënshtrohet të dashurit të vet dhe i zbaton të gjitha dëshirat e tij, ngjashëm vepron edhe besimtari ndaj All-llahut xh.sh. (i nënshtrohet dhe i zbaton urdhrat e Tij). I dashuruari s’çan kokën edhe nëse të gjithë njerëzit hidhërohen në të, vetëm që ai të cilin e don të jetë i kënaqur me të. I njëjtë është edhe rasti i besimtarit me All-llahun xh.sh. Nuk ua vë veshin hidhërimit të të

gjithë njerëzve, vetëm që Ai të jetë i kënaqur me të. I dashuruari i frikësohet të dashuruarit të vet, i frikësohet hidhërimit të tij dhe është i kënaqur me tërë atë që rrjedh nga ai. Pra, dashuria (të dashuruarit) është dëshmi se besimi-imani është instinkt natyror i njerëzve.

## KUFIZIMI TERMINOLOGJIK

Atë që e kemi thënë më parë nuk don të thotë se dashuria ndaj All-llahut xh.sh. është e njëjtë sikurse dashuria ndaj personit të dashuruar. Jo, sepse i dashuruari i nënshtrohet të dashurit të vet dhe i frikohet, është i kënaqur me sjelljet e tij dhe i jep përparësi kënaqësisë së tij, për shkak të kënaqësisë të cilën e ndien, sepse ai në të e don vetveten. E sikur p.sh. Lejlën ta kishet kapluar rrebulli (sëmundje e lëkurës, - sh.p.) dhe t'ia kishte shëmtuar fytyrën, hundën apo sytë, Mexhnuni nuk do t'i afrohej, e as që do të ndiente përmallim për të. Madje do të ikte dhe do të largohej prej saj. Ky është dallimi midis dashurisë ndaj krijesës dhe Krijuesit.

Këto janë dy dashuri të ndryshme, mirëpo gjuhët njerëzore për shkak të ngushtësisë dhe paafësisë së tyre që t'i përfshijnë kuptimet shpirtërore, përdorin të njëjtën shprehje për shumë kuptime. Kështu kur themi: “Filani i don peizazhet kodrinore”, “Filani e don historinë”, “Filani e don orizin me mish” ndërsa “Prindi e don fëmijën e vet”, “Mexhnuni e don Lejlanë”, ndërsa “besimtari e don All-llahun xh.sh.”, çdonjëra nga këto dashuri dallon nga tjetra. Shembulli i kësaj është edhe fjala “bukuri”. Ky është një nocion, ndërsa ne e përdorim në një mijë kuptime. Në këtë bëjnë pjesë edhe fjalët tona. “All-llahu dëgjon dhe sheh” dhe “Filan njeriu dëgjon dhe sheh”,

me fjalë të tjera nuk është i shurdhër e as i verbër, mirëpo të dëgjuarit dhe të pamurit e tij nuk i ngjason dëgjimit dhe shikimit të robit (njeriut), sepse All-llahu xh.sh. nuk i ngjason asnjërës nga krijesat, e as që Atij i përngjet diç, dhe të gjitha ajetet që flasin për cilësitë (sifatet) e All-llahut xh.sh., janë të përmendura në këtë kuptim. All-llahut xh.sh. asgjë nuk i ngjason.

## PARIMI I SHTATË

Parimi i shtatë është që njeriu me intuitë, ndien se kjo botë materiale nuk është e tëra që ekziston dhe se prapa kësaj fshihet bota e panjohur shpirtërore, duke i vërejtur reflekset të cilat në të i dërgojnë. Kjo, për shkak se njeriu e sheh se kënaqë-sitë materiale janë jetëshkurtëra (të kufizuara) ashtu që kur të realizojë qëllimin dhe ta arrijë kufirin, kënaqësia pushon të jetë kënaqësi dhe shndërrohet në “shprehë”, ashtu që zhduket ëmbëlsia dhe mrekullia e saj dhe bëhet si anekdotat e mësuara përmendsh, apo si ndonjë tregim i vjetër.

I varfëri shikon veturën e të pasurit, e cila kalon pranë tij dhe shikon vilën e tij pranë të cilës qëndron dhe mendon në vete, se e tërë bota do të ishte e tij, sikur të posedonte diç të tillë, mirëpo atëherë kur kjo të bëhej e tij, nuk do ta ndiente atë ëndje dhe kënaqësi. I dashuruari e kalon tërë natën pa gjumë duke imagjinuar për takimin me të dashurën, duke menduar se tërë kënaqësitë e botës janë në dashurinë ndaj saj, e kur e marton atë që e ka dashur dhe kalojnë dy vjet në martesë, treten të gjitha ato shpresa, shuhen kënaqësitë dhe nga ato mbesin vetëm kujtimet. I sëmuri lëngon nga sëmundja dhe vuan duke përfytyruar se e tërë kënaqësia është në

shërimin dhe kalimin e dhembjeve, e kur t'i kthehet shëndeti dhe i harron ditët e sëmundjes, nuk sheh më në shëndet asgjë nga ato kënaqësi që i përfytyronte. I riu e dëshiron me gjithë shpirt “famën”, duke u gëzuar kur ndonjë radiostacion e kumton emrin e tij apo ndonjë gazetë e boton fotografinë e tij, e kur ta arrijë famën dhe kur emri dhe personaliteti i tij dëgjohet, fama i bëhet gjë e rëndomtë.

Mandej, ndodh që njeriu ta dëgjojë melodinë në natën e qetë, të cilën e këndon këngëtari i dashur për të, ashtu që e mallëngjen në thellësi të shpirtit dhe e ngritë në botën shpirtërore. Ose lexon rrëfimin nga shkrimtari i shkathët dhe e ndien sikur ai e udhëheq rrugëve të botës magjepsëse, në të cilën përveç mrekullive ka edhe poezi e aromë, e kur rrëfimi përfundon, ndien sikur ka qenë në ëndrrën e ëmbël të mallëngjyer nga e cila është zgjuar, kot duke tentuar që t'i kthehet ëmbëlsisë dhe joshjes së saj.

I përjeton momentet e njohjes-zbulimit, kur shpirti pastrohet përmes të menduarit dhe përsiatjes, duke u liruar nga presioni i materies, ashtu që në kohët e pastërtisë dhe pavarësisë ngrihet derisa nuk arrin të kufiri prej të cilit e sheh Tokën dhe atë që gjendet në të aq të imët saqë nuk meriton shikimin, për shkak se ndien kënaqësi shpirtërore dhe ëndje, së cilës nuk i është e barabartë kënaqësia e ushqimit të cilën e ndien i urituri, as kënaqësia të cilën e ndien dorëshliri ndaj të pafatit, e as kënaqësia e pasurisë dhe autoritetit për varfanjakun e mjerë.

Shpirti vazhdimisht pretendon dhe e synon atë, botën më të lartë shpirtërore, botën e panjohur nga e cila i ka të njohura vetëm këto reflektime, të cilat shpërndahen para se t'i paraqiten, i humbin dhe i zhduken këto momente të këndshme – fryma freskuese, të cilat shkapërderdhen para se të paraqiten. Atëherë kupton se kënaqësitë materiale janë jetëshkurtëra, se kënaqësitë

shpirtërore janë me vëllim më të madh se ato materiale dhe se lënë gjurmë më të thella në shpirt. Siç bëhet thellë i bindur (nëpërmjet intuitës e jo dëshmisë racionale) se kjo jetë materiale nuk është e tëra që ekziston dhe se bota e panjohur, e fshehur pas botës së materies, është e vërteta ekzistuese, për të cilën shpirtrat mallëngjehen, duke bërë përpjekje që të ngjiten tek ajo, por nga kjo i pengon ky trupi i dendur, i cili nuk e lejon që lirisht të fluturojë kah ajo (botë shpirtërore). Ky është argumenti psikologjik për ekzistimin e botës tjetër.

## PARIMI I TETË

Besimi në ekzistimin e botës tjetër është rezultat i domosdoshëm i besimit në ekzistimin e Allahut xh.sh. Shpjegimi i kësaj është se All-llahu xh.sh. është i drejtë, e I Drejti nuk lejon dhunën dhe as që e lë tiranin pa dënim, sikur që nuk e lë të shkelurin pa drejtësi. Megjithatë, ne në këtë botë shohim ata të cilët jetojnë dhe vdesin si mizorë – e nuk dënohen, dhe ata të cilët jetojnë e vdesin si të shkelur – pa drejtësi. E çka do të thotë kjo? Dhe si ndodh kjo pranë ekzistimit të Zotit xh.sh. dhe drejtësisë së Tij? Kjo jep të kuptosh se “bota e ardhme”, në të cilën bamirësi do të shpërblehet, ndërsa mëkatarin do të dënohet, është e domosdoshme”.

Tregimi nuk mbaron me përfundimin e kësaj bote, sepse, sikur në TV të shfaqej filmi e të ndërprehet në mes të shfaqjes dhe të kumtohet se filmi ka “përfunduar”, askush nga shikuesit nuk do të besonte në këtë, dhe do të thërrisnin: “Çka ndodhi me heroin? Ku është mbarimi i tregimit?”. Ata presin nga autori që tregimin ta realizojë deri në fund dhe ta nxjerrë në shesh

përfundimin e heronjve të tij. E tillë është gjendja me Krijuesin e njerëzve, e si pra njeriu i mençur të beson se “tregimi i jetës përfundon me vdekje?”. Si, kur llogaria ende nuk është rregulluar, e as tregimi nuk është plotësuar? Andaj, mendja bëhet thellë e bindur se ky kozmos ka Zotin e vet dhe se pas kësaj bote është ahireti – bota e ardhme.

Se ajo botë e panjohur, një refleks shkëlqimi të së cilës shpirti e ka vërejtur në melodinë e qetë dhe në tregimin genial, dhe në momentin e inspirimit e ka ndër erën e saj, nuk është botë e idealit të cilën e ka krijuar Krijuesi i Platonit. E ka vërejtur se kënaqësia më e madhe e kësaj bote - kënaqësia e marrëdhënies seksuale - nuk zgjatë më shumë se gjysmë minuti, dhe ka arritur deri te njohja se ajo është vetëm një shembull i kënaqësive të Ahiretit. Ajo është kafshata e ushqimit, të cilën e shijon, e nëse të pëlqen e blenë dhe e han derisa të ngopesh, apo si modeli i tregtarit, të cilin e sheh, e nëse je i kënaqur me të e kërkon mallin. Me të vërtetë ajo kënaqësi është fotografia e zvogëluar (shembulli) e kënaqësive në botën tjetër, të cilat janë të përhershme dhe nuk kanë kufij, të cilat ndalen, kënaqësi që nuk shndërrohen në “shprehi-rëndomshmëri”, si kënaqësitë e kësaj bote, por amshueshëm mbesin kënaqësi, bëhen gjendje të përhershme.

## **BESIMI NË ALL-LLAHUN XH.SH.**

Besimi në All-llahun xh.sh. përmban katër pikëpamje:

All-llahu xh.sh. ekziston pa krijues dhe pa shkaktarë.

Ai është Krijues i të gjitha botëve.

Ai është Zot dhe Sundues i çdo gjëje.

Ai është i Vetmi Zot, i cili meriton të adhurohet, duke mos i bashkangjitur zota tjerë të rrejshëm.

## **EKZISTIMI I ALL-LLAHUT XH.SH.**

Në parimin e gjashtë kemi thënë se besimi në ekzistimin e All-llahut xh.sh. është e vërtetë themelore dhe e qartë, te njohja e së cilës arrihet me intuitë, para se të pranohet me dëshmi racionale. Atë fare nuk është e nevojshme ta dëshmojmë, edhe pse argumentet e vërtetësisë së saj gjenden në çdo send. Nuk do t'i parashtroj këto argumente, sepse ato janë aq të shumta saqë nuk jemi në gjendje t'i numërojmë të gjitha. Dijetari i Damaskut, shejh Xhemaluddin Kasim, ka përmendur shumë nga ato në librin e vet “Delailu et – tevhid”, edhe pse e ka shkruar para më se gjysmë shekulli, dhe pranë gjithë kësaj sot janë paraqitur argumente të reja, të cilat i ka zbuluar shkenca moderne, të cilat kanë qenë të panjohura para pesëdhjetë vjetësh E kush e shikon librin “All-llahu zbulohet në epokën e shkencës” të cilin e kanë shkruar tridhjetë dijetarë eminentë nga lëmi i shkencave natyrore dhe astronomike, pastaj librin “Shkenca fton në fe”, do të hasë se si dijetari i vërtetë, ashtu edhe njeriu i rëndomtë janë besimtarë, e se ateizmi paraqitet te dijetarët e rrejshëm të cilët kanë kuptuar njohuri të vogla dhe me to e kanë shkatërruar besimin natyror (Islamin). Nuk kanë arritur deri te dituria e vërtetë, e cila fton në besim, ashtu që kanë rënë në mosbesim.

Në këto dy libra gjenden artikuj të cilët paraqesin frytin e përsiatjeve të këtyre dijetarëve, siç është p.sh. Frank Alen, i cili ka dëshmuar se mësimi për amshueshmërinë e botës, siç e thotë këtë filozofi grek, është absurd dhe i pamundur dhe se shkencë ka zbuluar se çdo send ka moshë, thënë më ndryshe, ka fillimin i cili e mohon amshueshmërinë e tij. Këto janë fjalët e Robert Moris Bexhit, zbuluesit të radarit, pastaj të kimistit Xhon Klivlend dhe fizikanit Xhon Herbert.

Do të dëshiroja t'i lexoj këta libra dhe atyre të ngjashëm, e ata janë të shumtë. Nuk do të doja që përsëri t'i numëroj argumentet e vjetra të ekzistimit të All-llahut xh.sh., argumente me të cilat janë shërbyer apologjetët, e as argumentet në të cilat janë mbështetur këta dijetarë. Do të përqëndrohem vetëm në argumentet kur'anore, e ato janë të qarta, të dukshme, të pakontestueshme, të fuqishme, të shprehura në gjuhën të cilën e kupton edhe njeriu i rëndomtë, ndërsa e kënaqë shpirtin e dijetarit që e kupton domethënien e tyre, duke u mahnitur me fuqinë, saktësinë dhe qartësinë e tyre. E që të dyve, pra laikut dhe dijetarit, nuk i mbetet gjë tjetër përveç se të thonë: “Kjo është e vërteta!”. All-llahu xh.sh. na paralajmëron në Kur'an, vetëm me një fjalë, se dëshmia për ne është në qenien tonë. E si atëherë ta mohojmë gjykimin, vërtetësinë e të cilit e konfirmon diç që është e shkruar në ballin tonë?! I Lartësuari thotë: “Edhe në veten tuaj, a nuk e shihni?”. E ndiejmë në thellësi të shpirtit tanë se Ai ekziston, kërkojmë strehim te Ai në vështirësitë dhe fatkeqësitë e mëdha. Me anë të natyrës sonë e cila beson dhe instinktit tonë për besim, i shohim argumentet në qenien tonë dhe në botën rreth nesh. Nënvetëdija instinktivisht beson në ekzistencën e Tij, ndërsa vetëdija beson në bazë të argumentit. E si atëherë ateisti e mohon All-llahun xh.sh. kur vetë ai është argument i ekzistimit të Tij?!

Ai i ngjason atij i cili e mban pronën tënde në dorën e vet, dhe thotë se nuk e ka marrë, e as që e ka prekur, apo si ai që i ka rrobat e lagura, nga të cilat pikon uji, e thotë se as që i është afruar ujit.

Kjo është e vërtetë qenësore, por pse shumicës së njerëzve kjo nuk ua tërheq vëmendjen?! Përgjigja në këtë është, për shkak se nuk mendojnë për veten! E kanë harruar All-llahun xh.sh., prandaj Ai ka vendosur që ata ta harrojnë vetveten – (Kur’ani). Ata ikin nga vetvetja, i frikësohen ndarjes, nuk mundet asnjëri nga ata që të mbetet vetë me veten pa punë (pa ndonjë aktivitet). Për këtë shkak argëtohen me biseda boshe, me ndonjë libër të pavlefshëm, apo me ndonjë punë e cila i preokupon dhe në të cilën u kalon jeta, sikur të ishin armiq të vetvetes, armiq që i urrejnë dhe nga të cilët ikin. Sikur jetën personale – e ajo është kapitali kryesor i tyre – ta bartin në shpinë, e të cilën dëshirojnë ta hedhin që të lirohen nga ajo (jeta).

Shiko shumicën e njerëzve, do t’i gesh duke ngrënë e duke pirë, flejnë dhe zgjohen, lakmojnë kënaqësitë, largohen nga dhembjet, përpiqen ta sendërtojnë të mirën në këtë botë për vete, për familjet e tyre dhe për ata të cilët i duan. Njëri nga ata p.sh. zgjohet, e pastron trupin e vet, vesh rrobat, han, shkon në punë, punon për të krijuar pasuri dhe për ta shtuar profitin. Pastaj kthehet në shtëpi, drekon dhe pushon. Mandej përsëri kthehet në punë, apo vendosë që të dëfrehet. Kërkon me çka ta plotësojë kohën e lirë, ta shpenzojë jetën në të, derisa nuk ndien përsëri uri, që prapë të ushqehet, apo e mposhtë dremitja dhe flen. Pastaj e pret ditën e re dhe e përsëritë programin nga dita e mëparshme. I kujtohet e kaluara e tij, e ajo nuk është asgjë tjetër vetëm se ditë, të cilat ndien se i ka kaluar në këtë botë. Mendon për ardhmërinë e tij, e ajo nuk është asgjë tjetër, vetëm se ditët për të cilat supozon se do t’i përjetojë nëkë të botë.

Ndërsa, sa i përket muslimanit, ai në jetën e tij nuk kënaqet që vetëm të hajë dhe të pijë, të përfundojë me vdekje. Ai e di se ka qenë embrion në barkun e nënës para se të jetë lindur, ndërsa para se të bëhej embrion ka qenë spermë në kurrizin e babait, e para kësaj ka qenë gjak, i cili rrjedh në damarët e babit, e ai është formuar nga ushqimi, të cilin e ka ngrënë, e ushqimi ka qenë

bimë, e cila ka mbirë nga toka, apo kafshë e cila ushqehet me bimë. Këto janë etapat gjatë të cilave ka kaluar para lindjes, e për të cilat nuk di asgjë. Zinxhiri i gjatë, numri i vogël i hallkave që janë të dukshme, e të tjerat i fsheh nga sytë tanë errësira e plotë. E si do ta krijojë vetveten me mendjen dhe vullnetin e vet, e ai ka qenë para se të ketë pasur mendje dhe vullnet? Askush nga ne nuk di për veten para vitit të katërt të jetës. Askujt nga ne nuk i kujtohet lindja e vet! Kush e mban mend lindjen e vet? Kujt i kujtohet koha kur ka qenë në barkun e nënës? Nëse ka ekzistuar para se të ketë ditur për ekzistimin e vet, a është e mundur të pohojë se e ka krijuar veten? Pyete për këtë ateistin nëse e takon dhe thuaj: “A e ke krijuar veten me vullnetin dhe mendjen tënde? A je ti ai i cili e ke krijuar veten tënde në barkun e nënës? A ti e ke zgjedhur atë grua që të të bëhet nënë? A e ke sjellur ti maminë që të të nxjerr nga barku i nënës. Atëherë pra mos je krijuar nga asgjëja, pa krijues?”. Kjo është absurde dhe e pamundur. A thua, mos të kanë krijuar këto krijesa, të cilat kanë qenë para teje, kodrat, detet, dielli, planetët?

Dekarti në kohën e eksperimentimit të skepticismit, sipas të cilit është i njohur, ka dyshuar në çdo gjë, por kur ka arritur te vetja, nuk ka mundur të dyshojë në ekzistimin e vet. Sepse, ai është personi i cili dyshon, e është e domosdoshme që të dyshimi të ekzistojë ai i cili dyshon. Prandaj, e ka thënë thënien e tij të njohur: “Mendoj, pra ekzistoj!”. Ekziston, nuk ka dyshim në ekzistimin e vet, e kush pra e ka krijuar? A e kanë krijuar këto qenie materiale? Këto janë sende që nuk kanë mendje, e ai është intelekt. A mund të të japë mend ai i cili nuk i ka? Ai që nuk posedon diç, as nuk mund të të japë diç. I tillë ka qenë qëndrimi i Ibrahimit, babait të Pejgamberëve (alejhisselam), kur e ka parë babain e vet duke skalitur statujat me daltë dhe e përpunon nga guri figurën të cilën populli i tij e merr si perëndi. Guri të cilin e përpunon dora e njeriut, e pastaj ai e adhuron!? Zot të cilin e punoj dhe kërkoj nga ai që të krijojë atë që unë e dëshiroj!? Këtë mendja

e shëndoshë nuk e pranon. E ku është atëherë Zoti i Vërtetë?<sup>4</sup> Filloi Ibrahimimi alejhis- selam të hulumtonte dhe të mendonte. Ra nata dhe u paraqit në qiell ylli shkëlqyes. Nuk doli nga toka sikurse guri nga i cili përpunohen statujat. Nuk e ka punuar njeriu me dorën e vet, që pastaj ta adhurojë. I tha popullit të vet se e ka gjetur “Zotin e Vërtetë”. Në këtë u lajmërua Hëna dhe u zhduk ylli. Sheh se Hëna është më e madhe dhe më shndritëse, dhe tha se Hëna është Zoti. Pastaj lindi Dielli, i cili e largoi pishtarin e Hënës dhe drita e të cilit e përfshiu Tokën. Ibrahimimi a.s. tha: “Ky është Zoti”. Por, Dielli perëndon dhe e lë tokën në errësirë. Çfarë është ky zot i cili perëndon dhe e braktisë mbretërinë e tij? Jo, Dielli nuk është zoti që më krijoi. As këto krijesa nuk janë zota. E as unë nuk jam zot. Nuk e krijova vetveten, e as që jam i krijuar nga asgjëja. Mbetet vetëm një mundësi e ajo është e drejtë dhe e vërtetë, e të gjitha të tjerat janë të pavërteta: pas të gjitha këtyre sendeve qëndron Zoti i Gjithëfuqishëm, i cili i ka krijuar ato, mua dhe të gjitha sendet tjera. Këto argumente Kur’ani i ka prezentuar në një fjali të vetme, e cila paraqet muxhize – cilësi mbinatyrore të Shpalljes së Zotit xhile shanuhu dhe dëshmi të pakontestueshme ateistit, i cili i nënshtrohet arsyes dhe e respekton, e ky është ajeti: “A janë të krijuar nga asgjëja apo vetveten e kanë krijuar?!”

Pseudodijetarët, ateistët e kufizuar, thonë se “natyra është ajo e cila e krijoi njeriun, ajo ia dhuroi mendjen”. Disa mësues këtë na e thonin kur kemi qenë të vegjël, në kohën e Luftës së Parë Botërore dhe pas saj, ata mësues të cilët e kanë ndier erën e “kulturës së re”, së pari nga

---

<sup>4</sup> Kjo është metoda të cilën e ka përdorur Ibrahimimi a.s. në thirrjen e popullit të tij në besimin në Një All-llah të Vetëm, e nuk është në pyetje dyshimi dhe gjurmimi personal i tij për All-llahun s.v.t. (subhanehu ve te’ala).

Stambolli, e pastaj nga Parisi, dhe kanë menduar se janë të arsimuar. E fjala “të arsimuar” apo “arsimues” në atë kohë kishte kuptimin, të cilin sot e ka fjala “progresiv”. Çdo kohë i ka fjalët dhe shprehjet e veta me të cilat na përqeshin, siç i kanë përqeshur indianët në Amerikë me perla dhe rroba të larme, që si kompensim për këtë t’ua marrin token. Më vonë kur u rritëm, kemi pyetur: “Ç’është natyra?” Fjala natyrë (tabia) në gjuhën arabe ka formën e aktivitetit, ndërsa kuptimin e pasivitetit dhe objektit. E nëse është e ndërtuar dhe krijuar, kush e krijoi? Thonë: “Natyra është rastësi, ligj i probabilitetit dhe mundshmërisë”. Kemi pyetur: “A e dini se kujt i ngjason kjo bisedë?” I ngjason shembullit të dy njerëzve, të cilët kanë humbur rrugën në shkretëtirë dhe në atë bredhje kanë hasur në një pallat të madh, të bukur e të rregulluar me mure të stolisura, me qilima të shtrenjtë, me orë, me llambadarë. Njëri nga ata tha: “Këtu ka qenë një shkëmb i madh, e ka ndodhur një vërshimë, erë e madhe dhe faktorë tjerë klimatikë dhe me kalimin e shumë shekujve, rastësisht, ka rezultuar muri”. “E qilimat?” – pyeti i pari. “Fluturoi dhe u shpërnda leshi nga delet, e pastaj është bashkuar. Mandaj ka ardhur ngjyra, e është ngjyrosur, dhe kështu është formuar ky qilim i mrekullueshëm”. “E orët?”. I tha: “Hekuri është shkrirë nën ndikimin e faktorëve të kohës, pastaj është thërrmuar dhe janë formuar rrathët dhe me kalimin e shumë shekujve ka rezultuar kjo formë.” A nuk do të thoni se ky është i marrë? A rastësitë kanë bërë që qeliza e mëlçisë, e cila shihet vetëm me anë të mikroskopit, të kryen procese të shumta kimike, për të cilat nevojiten vegla të shumta me të cilat do ta mbushje një dhomë të madhe dhe të cilat prapëseprapë mund të kryejnë vetëm një pjesë të atyre proceseve?! Kjo qelizë e shndërron në glukozë tepricën e sheqerit që gjendet në gjak, e kullon vrerin, i rregullon yndyrërat në gjak, prodhon rruza të kuqe të gjakut, e kryen edhe procese të tjera. Rastësitë kanë bërë që në gjuhën e njeriut të ekzistojnë 9.000 gjëndra për të shijuar, në çdo vesh nga 100.000 qeliza për dëgjim, në çdo sy 130.000.000 qeliza të cilat e pranojnë dritën.

Pastaj Toka dhe mrekullitë e fshehtësitë e saj, ajri i cili e rrethon atë, qeniet e gjalla që i mban në vete e të cilat nuk shihen, pastaj format e mrekullueshme të fjollës së borës e cila bie nga qielli. E ka krijuar me aq precizitet, ka bërë më të asi bukurie e cila ka ardhë në shprehje dhe është zbuluar kohëve të fundit. Vështroje Tokën dhe mineralet e saj, fshehtësitë të cilat janë të depozituara në të, llojet e kafshëve dhe bimëve, shkretëtirat kolosale, detet e gjera, kodrat e larta, luginat e thella. Mandej krahasoje Tokën me Diellin, e do ta shohësh të vogël, të parandësishme në raport me të dhe madhësinë e tij. E Dielli i cili është më i madh se Toka me miliona herë, në krahasim me galaktikën është sikur kokërr e zallit në shkretëtirën më të madhe. Dielli, i cili është larg nesh më tepër se njëqind milionë kilometra, nëse do ta matnim largësinë e tij me vitet e dritës (e shpejtësia e dritës është 300.000 km/s), nga ne është larg 8 minuta. Sa është atëherë largësia e yjeve, drita e të cilave deri te ne arrin për miliona vite të dritës? Viti i dritës u përgjigjet dhjetë mijë miliardë kilometrave. Sa kilometra ka atëherë në një milion vite të dritës? Këto galaktika nga të cilat njëra është Rrugë e Qumështit, për të cilën astronomia nuk di më tepër përveç se që ajo është hapësirë e ndriçuar, ndonëse kanë madhësi kolosale, të cilën mendja nuk mund ta përfytyrojë, lëvizin me shpejtësi marramendëse e cila i kalon kufijtë e numrave. E si atëherë nuk vjen deri te ndeshja e ndërshjellë e tyre? Kam lexuar nga një astronom se mundësia e ndeshjes së tyre është e ngjashme me mundësinë e ndeshjes së gjashtë bletëve, sikur të ishin nisur për në atmosferë e cila e rrethon Tokën. Hapësira e kësaj atmosfere në krahasim me bletët, është sikur raporti ndërmjet kësaj atmosfere dhe galaktikave të panumërta.

I tërë ky kozmos është në qendër të lëmshit kolosal, i cili paraqet “semaued – dunja-n”, qiellin më të afërt. Ky lëmsh është masë konkrete dhe trup e jo hapësirë e zbrazët. Top i cili përfshinë këtë gjithësi dhe atë çka gjendet në të si sistemi diellor dhe yjet tjera, ndaj të cilave Dielli është si molla

ndaj bjeshkës, dhe galaktikave në të cilat gjenden yje të panumërta, e mbyllë këtë kozmos përbrenda. Ky lëmsh, i cili është i mbrojtur dhe i siguruar, ka dyer të cilat hapen dhe mbyllen. All-llahu xh.sh. e di gjerësinë e saj, ndoshta është sa kjo e para, apo më e madhe nga kjo, të cilën e përfshinë lëmshi tjetër më i madh, pastaj gjithësia e tretë dhe lëmshi i tretë. Pastaj e katërta, e pesta, e gjashta dhe gjithësia e shtatë. Përmbi to gjenden trupa të madhësisë dhe gjerësisë së jashtëzakonshme, a ata janë Arshi dhe Kursia.<sup>5</sup>

E mrekullia më e madhe dhe një nga argumentet më të mëdha të ekzistimit të All-llahut xh.sh. është se kjo gjithësi ekziston edhe në atë formë të zvogëluar, saqë mendja nuk mund ta kuptojë precizitetin dhe imtësinë e saj, njëlloj sikur që nuk mund ta kuptojë gjerësinë e gjithësisë, e ky është atomi. Ai nuk mund të shihet përveç se me ndihmën e mikroskopit elektronik. Ai është trup të cilin shkencëtarët e vjetër dhe filozofët e kanë quajtur monadë-pjesë, e cila më nuk mund të ndahet. Në qendrën e këtij atomi gjendet kozmosi – mikrokozmosi dhe në të ka bërthamë rreth së cilës qarkullojnë elektronet, siç qarkullojnë yjet në Gjithësi. Bërthama në krahasim me atomin është si kokrra e grurit e krahasuar me një pallat shumë të madh. Ai vetë është më i rëndë se 1.800 elektrone. Pra, a është tërë kjo vepër rastësie?<sup>6</sup> Besimtarët i gëzon fakti që këto fjalë

---

<sup>5</sup> Këtë që e kam thënë mbi qiellin është të kuptuarit tim të ajeteve Kur'anore dhe ligjeve të All-llahut xh.sh. mbi gjithësinë, të cilat i kanë zbatuar shkencëtarët. Nuk kam hasur në dikë që është i mendimit të njëjtë. E kam spjeguar këtë tezë në librat tjerë.

<sup>6</sup> Kam shkruar këtë kaptinë, siç e cekta edhe në hyrje, duke mos pasur pranë asnjë libër, në të cilën do të drejtohesha, prandaj kam shkruar atë çka më ka rënë ndërmend dhe çka më është kujtuar, dhe i cekta këta shembuj. Kush dëshiron t'i gjejë të dhënat më të plota, do t'i gjejë ato në librin i cili tash vonë ka dalur nga shtypi: "Medicina – mihrab i imanit"

boshe, siç janë “natyra”, “rastësia” më nuk shqiptohen nga gjuhët e shkencëtarëve. Kanë mbetur ende në përdorim vetëm te laikët, të cilët mendojnë se dinë, e nuk janë as afër shkencëtarëve të vërtetë.

## **ALL-LLAHU XH.SH. ËSHTË KRIJUES I BOTËVE**

Kjo është pikëpamja e dytë e besimit në All-llahun xh.sh. Ajo don të thotë, të besosh se vetëm All-llahu xh.sh. është Krijues i të gjitha botëve: botës shtazore, bimore, i yjeve, botëve që për ne janë të njohura dhe të panjohura. Ato i ka krijuar nga asgjëja dhe në to ka caktuar ligje të mrekullueshme për të cilat kimia, fizika, medicina, astronomia kanë zbuluar fare pak. Vetëm All-llahu xh.sh. e di precizitetin dhe madhështinë e tyre. Ai e di se sa gjethe ka në çdo pemë, formën e çdo gjendjeje dhe pozitën e saj, sa baktere ka në tokë, gjatësinë e tyre, gjerësinë, pjesët nga të cilat janë të përbëra, elementet jolëvizëse dhe ato lëvizëse në atom, numrin e tyre, ndryshimet që ndodhin në to, lëvizjet apo të ndenjurit qetë, zhvillimin apo transformimin. Të gjitha këto janë të regjistruara te Ai në Libër. Ai është Zot i të gjitha botëve. Ai i krijoi, kujdeset për to, i shndërron nga një gjendje në tjetrën. Ai në çdo atom të këtyre botëve ka dhënë argument, i cili të mençurin e udhëzon tek Ai. Pikëpamja e dytë e imanit është e domosdoshme. Mirëpo, a mjafton vetëm të besohet në të, që njeriu të bëhet besimtar?

Sikur të vinte ndonjëri dhe të pohonte se All-llahu është Krijues dhe Zot, a do të ishte kjo e mjaftueshme që këtë person ta konsiderojmë besimtar? Jo, nuk mjafton vetëm kjo. Shumica e popujve të vjetër pohonin kështu. Pabesimtarët e fisit Kurejsh, të cilëve (fillimisht) u është dërguar Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve selem, që t'i largojë nga shirku (idhujtaria) dhe dogmat e tyre të gabuara e të luftojë kundër tyre, kur kanë qenë të pyetur për Krijuesin, e kanë pranuar dhe nuk e kanë mohuar. Vetë Iblisi (djalli), krijesa më e keqe, nuk ka mohuar se All-llahu xh.sh. është Krijues dhe Zoti i tij. Kjo vërehet në fjalët e All-llahut xh.sh.:

“Zoti im, më le deri në Ditën e Gjykimit”.

## **ALL-LLAHU XH.SH. ËSHTË SUNDIMTAR DHE ZOT I BOTËVE**

Pikëpamja e tretë e besimit është: All-llahu xh.sh. është Sundues dhe Zot i botëve. Ai disponon me to sipas dëshirës së Tij, jep jetë dhe vdekje. A mund ta largosh nga vetja vdekjen dhe ta bësh veten të amshueshëm në këtë botë? Ai jep sëmundje dhe shëndet. A mund ta shërosh atë, të cilit All-llahu ia ka marrë shëndetin? Ai jep pasuri dhe sprovon me varfëri, dërgon vërshime dhe shkatërron. A mundet ai të cilit i janë dhënë fëmijët vajza t'i shndërrojë në meshkuj? A mundet gruaja shterpë të lindë? Ai ua cakton vdekjen disa fëmijëve, kurse të tjerëve ua mundëson ta arrijnë pleqërinë e thellë. Dërgon valët e ftohta dhe acarin në rajone të caktuara, në rajone të tjera

dërgon valë të ngrohta, ndërsa disa të tjera i godet me tërmete. Dukuri të dukshme dhe evidente, e njeriu nuk mund t'i pengojë.

## **VETËM ALL-LLAHU XH.SH. E MERITON ADHURIMIN**

Shumica e njerëzve pohojnë se All-llahu xh.sh. është Sundues dhe Zot, se në mënyrë sovraane sundon (drejton) me kozmosin. Mirëpo, a mjafton ky pohim që dikush të jetë besimtar? Jo, është e domosdoshme që kësaj t'i shtohet edhe pikëpamja e katërt, e kjo është se vetëm Ai meriton të jetë i adhuruar. Nëse ke pranuar se All-llahu xh.sh. ekziston, se Ai është Zot i botëve, Pronar i të gjithave, atëherë mos adhuro askënd tjetër përveç Tij dhe mos iu drejto askujt tjetër në çfarëdo forme të adhurimit. All-llahu xh.sh. më ka udhëzuar në kuptimin e sures “En-Nas”, në të cilën është përgjigjja drejtuar atij i cili e pranon ekzistimin e All-llahut, pushtetin dhe zotërimin e Tij, por i bën shirk në planin e adhurimit. Nuk kam hasur që ndonjëri nga mufesirët ta ketë përmendur këtë kuptim dhe shpresoj që ai të jetë i drejtë. All-llahu xh.sh. thotë: “Mbështetem në Zotin e njerëzve, Sunduesin e njerëzve, Hyun (të adhuruarin) e njerëzve”. Pse është përsëritur shprehja “njerëzve”? Pse në vend të kësaj shprehjeje nuk është përdorur përemri dhe të thotë: “Zotin e njerëzve, Sunduesin dhe Të adhuruarin e tyre?”.

Mua më duket, e All-llahu e di më së miri, sikur dëshiron t’u thotë njerëzve: Këto janë tri pikëpamje, të ngjashme mes veti dhe të rrumbullakuara. Çdo pikëpamje është e pavarur krahas

lidhshmërisë së saj me tjetrën. Ai është Zot i njerëzve d.m.th. është Krijues dhe Mbrojtës, Ai është Sundues, d.m.th. Pronar i tyre i cili sundon me ta sipas dëshirës së Tij. Ai është i adhuruari i njerëzve, d.m.th. i Vetmi i cili vërtet e meriton adhurimin. Nuk është e lejuar që në adhurim Ai të ketë ortak. Sipas kësaj, besimtari duhet të besojë në të tri pikëpamjet, apo t'i mohojë që të tria. Ç'është me ju që i vërtetoni dhe i konsideroni për të vërteta të parën dhe të dytën, ndërsa pikëpamjen e tretë e mohoni? Si bëni dallime mes gjërave të njëjta? I pranoni disa e i refuzoni disa Që të tri pikëpamjet janë në të njëjtin rang dhe nuk mund të bëhet dallimi midis tyre.

## **TEWHIDULLAH BESIMI NË NJËSHMËRINË E ZOTIT**

Besimi se All-llahu xh.sh. është Zot i botëve dhe pronar i të gjithave, është vepër e zemrës. Kjo është dispozitë të cilën njeriu e pranon. Por besimi se vetëm Ai meriton të adhurohet nuk reduktohet vetëm në suazat e dispozitës dhe parimit por përfshin edhe sjelljen, veprën dhe ibadetin (adhurimin). Pra kush refuzon ta adhurojë All-llahun xh.sh. apo në adhurim i bashkangjet ortak, nuk është besimtar. E po që se realizohet besimi se All-llahu xh.sh. është Krijues dhe Zot i botëve – çka do të ishte atëherë ibadeti? E para që na bie ndër mend është se ibadeti përfshinë dhikrin, namazin, agjërimin, leximin e Kur'anit e ngjashëm me këto, të cilat na afrojnë te All-llahu xh.sh. Kjo është e vërtetë. Mirëpo, ibadeti nuk kufizohet vetëm në këtë. Çdo vepër e dobishme, e lejuar me Sheri'at, të cilën besimtari e punon duke e dëshiruar me këtë

shpërblimin e All-llahut xh.sh. është ibadet. Ushqehet që të jetë i fortë për zbatimin e asaj që i është urdhëruar. Marrja e ushqimit nga ana e tij me këtë nijet (qëllim) është ibadet. Martohet që veten dhe bashkëshorten e vet ta bëjë të virtytshëm dhe të përmbajtur, prandaj edhe martesja e tij është ibadet. Të fituarit e pasurisë me këtë qëllim, si dhe shpenzimi i saj për nevojat e familjes është ibadet. Po ashtu edhe marrja e diturisë është ibadet. Marrja e gruas me punët e shtëpisë, shërbimi bashkëshortit të saj dhe përkujdesja e saj për fëmijët është ibadet. Çdo vepër e lejuar, nëse ai që e bënë atë e ka nijjetin me të cilin është i kënaqur All-llahu xh.sh., është ibadet. Kuptimi i ibadetit është i gjerë dhe i përfshinë të gjitha veprat e dobishme të njeriut. Ky është kuptimi dhe domethënia, e cila shprehet me fjalët e All-llahut xh.sh.: “Xhinnët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë”.

## SHPIRTI DHE DOMETHËNIA E IBADETIT

Ibadeti ka shpirtin dhe trupin (formën). Shpirti i tij është besimi i cili e ka nxitë në të dhe qëllimi për shkak të të cilit është bërë. Trupi (forma) i ibadetit është vepër e gjymtyrëve, shqiptimi i gjuhës dhe lëvizjet e rupit. Namazin e përbëjnë, p.sh. lëvizjet e trupit dhe shprehjet, qëndrimi dhe ulja, përkuljet dhe rënia në tokë (ruku e sexhde), leximi i Kur'anit, dhikri (përmendja e All-llahut) dhe tesbihi (lavdërimi i All-llahut). E tëra kjo është trupi, ana formale e namazit. Nëse nxitës i kësaj nuk është besimi i drejtë dhe i pastër, si dhe nëse me këtë nuk synohet realizimi dhe nënshtrimi ndaj urdhrave të All-llahut xh.sh. dhe kërkimi i kënaqësisë së Tij, atëherë namazi është trup i vdekur dhe formë pa shpirt.

## THELBËSORJA NË ADHURIMIN E ALL-LLAHUT XH.SH.

Telbësore dhe qenësore në adhurim është që të besojmë se vetëm All-llahu xh.sh. është Ai, i cili sjell dobi dhe dëm. Këtë duhet pak më shumë ta sqarojmë. All-llahu xh.sh. është Krijues i çdo gjëje. I krijoi botët dhe krejt çka ka në to. Nëse do t'i vështroni këto gjëra, do të shihni se All-llahu xh.sh. i cili i krijoi të gjitha këto, ka bërë që disa nga to të dominojnë ndaj të tjerave dhe të ndikojnë në to: zjarri po e preku drurin e thatë e djeg, uji e shuan zjarrin po që se derdhet në të, njeriu e merr malarjen nëse e kafshon mushkonja (e malarjes) e nëse në trupin e të sëmurit futet kinina shërohet. I Lartësuari ka krijuar një lidhje ndërmjet këtyre gjërave. Lidhja e tyre bëhet në masën të cilën Ai e ka caktuar, ashtu që nga to lindin gjëra të reja. Klori është materie e dëmshme, natriumi është materie e dëmshme, por kur të lidhen nga to formohet materia e dobishme, e domosdoshme për njeriun – kripa e kuzhinës. Nga kjo mund t'i nxjerrim konstatimet vijuese:

1 – Kemi hasur se lidhjet dhe raportet i pasojnë rregullat e caktuara të cilat nuk ndryshojnë. Ato janë ligjet e All-llahut xh.sh. në Gjithësi, të cilat profesionalisht i quajmë ligje natyrore.

2 – Këto lidhje mes gjërave, të cilat i kemi quajtur ligje natyrore, nuk janë të tërat të dukshme siç është e dukshme dhe e qartë lidhja në mes të zjarrit dhe drurit të cilin e djeg, dhe në mes të zjarrit e ujit, i cili e shuan atë. Nuk janë të gjitha kështu të thjeshta dhe të qarta, por shumica e tyre janë më precize dhe më kuptimplote. All-llahu xh.sh. për çdo sëmurje ka përcaktuar ilaçin shërues, por nuk e ka vendosur në vend të dukshëm, dhe nuk e ka bërë të gatshëm dhe të përgatitur për përdorim, por e ka bërë të fshehur në vende të çuditshme dhe në gjendje në të cilat nuk pritet që

të gjendet. Penicilin e ka bërë në materien, e cila duket sikur të jetë helm vdekjeprurës, siç ka bërë që parfumet më të këndshme dhe ngjyrat më të bukura të gjenden në njërën nga materiet më kundërmuese dhe më të keqe, në materien e zezë e të lemeritshme, e cila quhet katran. Nga ai fitohen parfumet dhe ngjyra! Dhe nuk gjendet në gjendje të ngjashme, përkatëse, por elementi frytdhënës dhe i nevojshëm është përzier me materiet tjera dhe ndarja e tij kërkon prova, eksperimente dhe përpjekje të shumta. Kush e ka lexuar librin “Mësuesja e përjetshme”, e ka kuptuar se si për përfitimin e një grami radium është kërkuar filtrimi i masës shumë të madhe të materieve të ndryshme si dhe realizimi i procedurave dhe proceseve të cilat kanë pasuar pas kësaj, kanë zgjatur me vite.

3 – Deri më tani, nuk kemi zbuluar nga ligjet e Gjithësisë, të cilat i ka vendos Zoti i Gjithësisë, përveç se sa pika e ujit nga deti. Kemi parë në to mrekulli të mëdha dhe këto pak gjëra që i kemi zbuluar i kemi klasifikuar në grupe dhe lloje, të cilat i kemi quajtur shkencat. Kështu kanë lindur biologjia, kimia, fizika, fiziologjia, medicina dhe shkencat tjera. Çdonjëri nga këto lëmi shkencore i janë përkushtuar njerëz të caktuar që merren ekskluzivisht me to për t'i perceptuar dhe kuptuar ligjet e All-llahut xh.sh. në to dhe për të zbuluar edhe më tepër për to.

4 – Kemi zbuluar se në Gjithësi ka gjëra që na dëmtojnë dhe të cilat na bëjnë dobi. Dobia dhe dëmi janë dylojesh:

a) Ajo e cila ndodh për shkak të shkaqeve të jashtme, të dukshme e që janë në pajtim me ligjet e natyrës që i kemi zbuluar, si p.sh. kur pushon së rrahuri zemra e ndokujt pas marrjes së helmit. Gjatë përvojës dhe eksperimenteve kemi kuptuar ndikimin e tij në zemër.

b) Ajo e cila ndodh pa shkaqe të jashtme, të dukshme dhe e cila nuk bazohet në ndonjë ligj të njohur, siç është rasti kur pushon së rrahuri zemra e njeriut me trup të shëndoshë, befaz nga goditja në zemër, shkak i së cilës është i panjohur. Të dy këto kategori apo lloje janë nga All-llahu xh.sh., Ai i Vetmi jep dobi apo dëm.

5 – All-llahu xh.sh. e ka krijuar njeriun me prirje kah e dobishmja, dhe njeriu shërbehet me të gjitha mjetet që këtë edhe ta realizojë. All-llahu xh.sh. njeriun e krijoi me prirje natyrore që ta urrejë dëmin dhe ai i përdorë të gjitha mjetet dhe dinakërinë që ta largojë atë nga vetja. Kërkon ndihmë dhe në këtë përdorë tërë forcën. Disa lloje të kërkimit të ndihmës feja i lejon e disa i ndalon, dhe i konsideron të kundërta me imanin (besimin). Atëherë pra, cili kërkim i ndihmës është i lejuar, e cili i ndaluar? Nëse të sëmuret fëmija dhe ti e thirr mjekun që ta kontrollojë dhe t'ia japë ilaçin, ke bërë atë çka është e lejuar, sepse për mjekim je shërbyer me ligjin natyror, të cilin e ka caktuar Krijuesi i Gjithësisë dhe me njeriun i cili e njeh atë ligj. Por, sikur ta ftoje pseudomjekun për t'i dhënë ilaçet pa njohuri dhe pa respektimin e ligjeve natyrore, kjo do të ishte mënyrë e ndaluar e kërkimit të ndihmës. Sikur të shkoje te varri i mjekut dhe atë ta thirrje në ndihmë, do të ishte kjo mënyrë e ndaluar e kërkimit të ndihmës. Por nëse shkenca e mjekësisë është e paaftë, apo ilaçi nuk të bën dobi, e je ndihmuar në shërim me dua (lutje) apo sadaka (dhënie të lëmoshës), apo ke kërkuar nga njeriu i devotshëm që të bëjë dua për ty, kjo është mënyrë e lejuar e kërkimit të ndihmës. Nëse je ndalur tek varri i njeriut të mirë e të devotshëm dhe ke kërkuar nga ai ndihmë, atëherë kjo është mënyrë e ndaluar e kërkimit të ndihmës. Dhënia e ilaçit pacientit të sëmurë si mjet për shërim është e lejuar. Mirëpo, po e more recetën mjekësore, e të bësh nga ajo hajmali dhe ta varish rreth qafës së të sëmurit, apo po ta futje në ujë e t'i japish të pijë nga ai ujë, me bindje se kjo do ta shërojë, me këtë ke vepruar atë që është e ndaluar.

Kërkimi i dobisë nga gjërat të cilat All-llahu xh.sh. nuk i ka bërë të dukshme, me shkaqe të jashtme të asaj dobie, është i ndaluar. Gruaja sterile nëse kërkon ndihmë nga mjeku dhe nga barërat, të cilat All-llahu xh.sh. i ka dhënë, të cilat janë të prodhuara në pajtim me ligjet e natyrës, atëherë ajo nuk ka bërë asgjë që është e ndaluar, apo që është në kundërshtim me fenë. Mirëpo, sikur të besonte, sikur që kanë besuar plakat në Siri, se trokitja në hallkën e vendosur në xhaminë Handelite në kodrën Kasjun (te Damasku), xhumanë e parë të muajit Rexheb, ndihmon që të mbetet gruaja shtatzënë, apo nëse do të shërbehej me lidhjen e leckës në dritaren e njëjës nga tyrbet si mjet për arritjen e shtatzënisë, atëherë ajo do ta bënte atë që është në kundërshtim me besimin e pastër islam. Pra, nga kjo është e qartë se të ndihmuarit me ligje natyrore, të drejtuarit në njeriun i cili i njeh këto ligje dhe marrja e mjeteve të zakonshme për realizimin e dobisë është e lejuar, por me kusht që të besojmë dhe ta kemi ndërmend se vetëm All-llahu xh.sh. është Ai i cili sjell dobi, e jo dikush tjetër.

## **LEJIMI DHE NDALIMI I TAKON VETËM ALL-LLAHUT XH.SH.**

Dobitë deri te të cilat arrijmë në pajtim me ligjet natyrore janë dobi të kësaj bote. Sepse, All-llahu xh.sh. e ka nxitur mendjen tonë në zbulimin e ligjeve të reja natyrore, e jo në zbulimin e asaj që është prapa materies-metafizikës. Në këtë botë punojmë në prokurimin e dobisë dhe largimin e dëmit në kufijtë e materies. Në botën tjetër nuk mund të prokurojmë as dobi e as dëm. E pasi që

All-llahu xh.sh. e ka caktuar shkakun e dobisë së Ahiretit, e ai shkak është kryerja e vaxhibeve-obligimeve, me të cilat na ka obliguar dhe pasi që e ka caktuar shkakun e dëmit të ahiretit, e ai është teprimi i harameve - asaj që na e ka ndaluar. Pra, ndalimi dhe lejimi, në të cilat ndërtohet shpërblimi dhe dënimi, i takojnë ekskluzivisht All-llahut xh.sh. Nuk është e lejuar që dikush të thotë sipas mendjes së vet: “Kjo është hallall - e lejuar, kjo është haram - e ndaluar”. Askush nuk ka të drejtë të urdhërojë diçka që All-llahu xh.sh. nuk ka urdhëruar, e as të ndalojë diçka që All-llahu xh.sh. nuk e ka ndaluar. E kush ia jep të drejtën e lejimit dhe ndalimit dikujt tjetër krahas All-llahut xh.sh., ai atë e adhuron dhe me këtë bën shirk – idhujtari.

## **DASHURIA NDAJ ALL-LLAHUT XH.SH. DHE FRIKA NDAJ TIJ**

Njeriu dashuron dhe urren. E pëlqen ushqimin e shijshëm, pamjen e bukur. Burri e dashuron gruan. Nganjëherë e tepron në këtë dashuri, ashtu që ndodh që në atë dashuri të përzihen edhe disa forma të adhurimit, por përkundër kësaj, ajo është e kufizuar sikurse çdo dashuri tjetër njerëzore. E duam dobinë, të cilën e arrijmë nga ajo që e dashurojmë, apo kënaqësinë të cilën e ndiejmë në afërsinë e personit të dashur. Por, kur të dashurin e godet sëmundja e cila e shëmton dhe nga e cila i shpëputen gjymtyrët dhe i shuhet bukuria, kjo dashuri përfundon dhe zhduket. Madje mund të shndërrohet në përbuzje dhe urrejtje. Ndërsa dashuria, të cilën e ndien besimtari ndaj All-llahut xh.sh. është absolute dhe e pakufizuar. Aq më tepër, atë që e duam nga dunjallëku,

e duam në emër të Krijuesit, i cili atë e ka krijuar, na e ka nënshtruar dhe na ka dhënë influencë që të shërbehemi me të, apo të kënaqemi me pamjen, apo preken e tij.

Njeriu frikësohet nga shumë krijesa: i frikësohet zjarrit, bishës së egër, helmit vdekjeprurës, njeriut mizorë. Por kjo frikë është e kufizuar. Ajo reduktohet në largimin nga dëmi, i cili fshihet në atë që na frikëson, dhe kur të jetë i sigurt nga dëmi i mundshëm, atëherë e braktisë frikën. Ndërsa frika nga All-llahu xh.sh. është absolute dhe e pakufizuar. Dashuria ndaj All-llahut xh.sh. dhe frika nga Ai bëjnë pjesë në bazat e besimit islam. Këto dy cilësi janë shpirti i ibadetit. Është e nevojshme të përmendim se dashuria ndaj All-llahut xh.sh. nuk do të thotë thurje e këngëve të dashurisë Atij, siç e ka bërë këtë Ibnul Faridi, as emërtimi i saj me “dashuri hyjnore”, siç ia përshkruajnë këtë Rabije Adevisë. Po ashtu duhet përmendur se frika nga All-llahu xh.sh. nuk don të thotë droje, e cila shpie në urrejtje, e as pikëllim i cili shpie në tronditje e amoralitet. Dashuria ndaj All-llahut xh.sh. realizohet me nënshtrueshmëri, me dhënien e përparësisë kënaqësisë së Tij ndaj epsheve të shpirtit e mashtrimeve të shejtanit, si dhe me pasimin e të Dërguarit të Tij (s.a.v.s.):

“Thuaj: Nëse e doni All-llahun, më pasoni mua” (Ali Imran, 31).

Pra, pasimi është kriter i dashurisë. Ndërsa frika nga Ai arrihet me largimin nga ajo që e ka ndaluar dhe me dhënien përparësi kënaqësisë së sevapit dhe shpërblimit në ahiret, ndaj kënaqësisë së mëkatit në këtë botë. Nënshtrueshmëria (bindja) ndaj All-llahut xh.sh. nuk është si nënshtrueshmëria ndaj krijesave të Tij. Ne jemi të dëgjueshëm ndaj disa njerëzve, duke iu nënshtruar me këtë urdhrin të All-llahut xh.sh., siç është nënshtrueshmëria ndaj Pejgambëit (s.a.v.s.), apo duke iu përgjigjur kërkesave të natyrës, apo nga frika prej rreziqeve. Populli i nënshtrohet

sunduesit, fëmija e dëgjon babain, gruaja e dëgjon burrin, njeriu e respekton atë që i ka bërë mirë në atë që nuk e dëmton. Dikush ndonjëherë është i detyruar të nënshtrohet, pra nënshtrohet duke iu frikësuar telasheve dhe shqetësimeve. Të gjitha këto nënshtime dhe dëgjueshmëri (përveç nënshtimit ndaj Pejgamberit s.a.v.s., sepse ajo paraqet nënshtueshmëri ndaj All-llahut xh.le shanuhu), janë të kufizuara. Sepse, nënshtimi absolut i takon vetëm All-llahut xh.sh. Nënshtimi në të gjitha, në atë që na pëlqen dhe në atë që nuk na pëlqen, në atë – urtësinë dhe përshtatshmërinë e së cilës e kuptojmë dhe atë që nuk e kuptojmë. Kjo nënshtuarje është fryt i dashurisë ndaj All-llahut xh.sh. dhe ajo është dëshmi e saj.

## **AJETET QË BËJNË FJALË PËR ATRIBUTET E ALL-LLAHUT XH.SH.**

Në këtë libër iu shmanga hyrjes në çështjet dhe problemet skolasitike dhe paraqitjes së divergjencave (mospajtimeve) mes skolasitikeve. Por, kur është në pyetje problemi i ajeteve, të cilat flasin për cilësitë e All-llahut xh.sh., nevojitet që për këtë të themi diç më tepër, sepse ky është problem për të cilin gjerë e gjatë është diskutuar. All-llahu xh.sh. e përshkruan vetveten në Kur'an me shprehjet, të cilat në themel janë emërtuar që të udhëzojnë në kuptimet tokësore dhe qëllimet njerëzore, edhe pse askush nuk është sikur Ai, Sundues dhe Krijues. I Lartësuar është i pastër nga ajo që t'u ngjasojë krijesave. Këto shprehje, kur përdoren edhe për All-llahu xh.sh., nuk mund të kuptohen me të njëjtën domethënie sikurse kur përdoren për krijesat. Them i p.sh.

filani është i ditur, filani sheh, e themi se All-llahu xh.sh. di dhe sheh. Por, mënyra në të cilën njeriu di dhe sheh nuk është sikurse dituria dhe shikimi i All-llahut xh.sh. Po ashtu themi se mësuesi është ulur në katedër dhe themi se All-llahu xh.sh. është ngritur mbi Arsh. Dimë kuptimin leksikor të fjalës “istivaun” (zë vend, të ngriturit) dhe e përdorim kur është në pyetje mësuesi. Mirëpo nuk është e mundur që të njëjtën domethënie ta kemi për qëllim kur themi:

“Mëshiruesi i cili qëndron mbi Arsh.” (Ta-ha, 5).

Dijetarët islamë në këtë janë unikë. Të gjithë pohojnë dhe pranojnë se ajetet për atributet janë fjalë të All-llahut xh.sh. Kur All-llahu xh.sh.thotë: “E pastaj është ngritur mbi Arsh” (Isteva ale-l-Arshi), askush nuk mund të thotë se nuk është ngritur. Të gjithë ata pranojnë se me fjalën “Isteva”- “është ngritur”, nuk ka për qëllim domethënien leksikore, njerëzore, në ajetin: “E pastaj është ngritur mbi Arsh”. Por, edhe krahas kësaj, pasi që janë pajtuar në mendimin se duhet braktisur dhe lënë mësimin për privimin e All-llahut xh.sh. attributeve si dhe mësimin, i cili bazohet në krahasimin e All-llahut xh.sh. me qenie të tjera, këta alimë me të madhe ndahen në atë se çka kanë për qëllim këto fjalë. Shtrohet pyetja se këto ajete a kanë domethënie konkrete apo metaforike. A shpjegohen dhe a komentohen ato apo jo? Ata të cilët janë përcaktuar për komentimin e tyre thonë se “hakika” – është kuptim i drejtë dhe përdorimi i vërtetë i shprehjes për domethënien e së cilës është emërtuar. Ky është definicioni i “hakikes” të shumica e stilistikëve. Është e pakontestueshme se këto shprehje në gjuhën arabe janë të emërtuara para shpalljes së Kur’anit dhe se janë të emërtuara për udhëzime në domethënie tokësore, materiale.

Aq më tepër, nuk janë në gjendje t’i shprehin ndjenjat dhe emocionet njerëzore, e të mos flasim për shpjegimin e attributeve të All-llahut xh.sh., Krijuesit të njerëzve. Skenat e bukurisë dhe

format e saj janë të panumërta, ndërsa te ne për të gjitha ato ka vetëm një fjalë “xhemil-bukur”. Gjuhët janë të paafta ta përshkruajnë ndjenjën e së bukurës. Rasti i njëjtë është edhe me dashurinë, llojet dhe kategoritë e saj, përjetimet e ndryshme, si dhe varfërinë dhe kufizimin e shprehjeve gjuhësore për t’i përshkruar këto lloje dhe kategori. Si mundën pra, t’i përfshijnë cilësitë e All-llahut xh.sh. dhe t’i shpjegojnë mënyrat e tyre? Nëse “Hakika” – thelbi , është përdorimi i vërtetë i shprehjes në domethënien për të cilën është emërtuar, ndërsa shprehjet “Isteva” – është ngritur, “xhae” – ku ardhur, “hadiun”- ai i cili i lë me shpresa të rrejshme, “jemkuru” – kurthëtar, “nesijehum” – i ka harruar, janë të emërtuara për të udhëzuar në domethëniet tokësore, materiale, njerëzore, ndërsa në ajetet: “Është ngritur mbi Arsh”, “Ka ardhur Zoti yt”, “Ai i lë me shpresa të rrejshme”, “Dhe All-llahu i ka ngatërruar”, “E i ka harruar” - nuk janë të përdorura në këtë domethënie për të cilat janë emërtuar, atëherë këto shprehje nuk janë “hakika” në pajtim me definicionin e përmendur të hakikës. Ndërsa ata të cilët mohojnë se këto shprehje janë të përdorura në domethënien metaforike – mexhaz, e ndër ta është edhe Ibni Tejmijje, e definojnë “hakikën” me tjetër definicion dhe thonë: “Komentimi i këtyre shprehjeve me shpjegime metaforike dhe bindja se kjo ka pasur për qëllim është i papranueshëm, sepse njohuritë metaforike janë po ashtu njerëzore”. I kam vështruar me vëmendje këto ajete dhe kam parë se ato mund të klasifikohen në tre grupe:

1. Ajetet që flasin për All-llahun xh.sh., siç është ajeti: “Mëshiruesi është ngritur mbi Arsh”. Nuk themi se nuk është ngritur, sepse atëherë do të mohonim diçka që All-llahu xh.sh. ka pohuar dhe konstatuar. Po ashtu nuk themi se është ulur në Arsh siç ulet njeriu në karrige, sepse atëherë do ta krahasonim Krijuesin me krijesën. Por besojmë se ky është të folurit e All-llahut xh.sh., dhe se All-llahu me këtë ka pasur për qëllim domethënien e vërtetë, detajet e së cilës ne nuk i kuptojmë,

sepse këtë hollësisht nuk na e ka shpjeguar, e mendja e njeriut është e paaftë që ta kuptojë këtë të vërtetë.

2. Ajetet që janë përmendur me stil të njohur tek stilistikët si “mushakele” – zeugmë d.m.th. emërtimi i nocionit me shprehje të papërshtatshme, vetëm për shkak se vjen në lidhje me të. P.sh. siç ka thënë dikush: “Thonë: Na propozo diç, do ta përgatisim fërgimin e saj. Kam thënë: Ma fërgoni pallton dhe këmishën”. Dhe siç janë fjalët e Ebu Temmamit për betejën te vendi Amuri, me të cilat u përgjigjet astrologëve që kanë pohuar se fitorja vjen vetëm pas pjekjes së fiqve dhe rrushit: “Nëntëdhjetë mijë, sikur luajtë e Sheres, janë pjekur lëkurat e tyre para pjekjes së fiqve dhe rrushit”. Ajetet e paraqitura në këtë stil janë të shumta: “Kanë harruar All-llahun, prandaj Ai i ka harruar ata.” Fjala “kanë harruar” ka ardhur me domethënien e saj leksikore, e ajo është mungesa e fakteve nga mbamendja. Por fjalia “fe nesijehum” – “e i ka harruar ata”, ka ardhur për shkak të “mushakeles”. Me të nuk mendohet kjo domethënie, sepse All-llahu xh.sh. nuk harron. “Dhe nuk ka qenë Zoti yt harrestar”. Thënë me fjalë të tjera, fjala “kanë harruar” është përdorur në domethënien për të cilën është emërtuar, ndërsa fjalia “e i ka harruar ata” është përdorur në tjetër domethënie. I njëjtë është edhe ajeti: “Ai është me ju kudo që të jeni”. Të gjithë janë të pajtimit se kjo përcjellje është me dituri, e jo me Qenie (Zot), ngase fillimi i ajetit vërteton se All-llahu xh.sh. është ngritur mbi Arsh. Të së njëjtës natyrë janë edhe ajetet: “E ata (hebrenjtë) i bënë kurthë një dredhi (mbytjen e Isait) e edhe All-llahu u bëri kurthë atyre, e All-llahu është kurthngrehësi më i mirë”. “Dhe intriga kanë kurdisur, e All-llahu i ka mënjanuar”. “Vërtet, hipokritët mundohen ta mashtronjë All-llahun, por Ai i mashtron ata”. (En-Nisa, 142). Këto ajete nuk mund të perceptohen në pajtim me domethënien e tyre leksikore, por duhet t’i kuptojmë në domethënien çfarë i ka hije Të Lartësuarit.

3. Ajetet, qëllimin dhe domethënien e të cilave e shpjegojnë ajetet tjera, siç është ajeti: “Çifutët flasin: Dora e All-llahut është e shtrënguar!” Qofshin të shtrënguarat duart e tyre dhe qofshin të mallkuar, pse thonë atë”. Jo, duart e Tij janë të hapura, Ai furnizon sa të dojë!” (Maide, 64). Në domethënien e këtij ajeti na bënë me dije ajeti: “Mos e bën dorën tënde të shtrënguar (mos u bë koprrac) dhe mos e hap tepër!” (Isra, 29). Nga ky ajet kuptohet se me zgjatjen e dorës ka për qëllim fisnikërinë dhe shpirtmadhësinë, e nuk pretendohet domosdo që All-llahu xh.sh. ka dy duar, siç janë duart e njerëzve dhe kafshëve. I Lartësuar është All-llahu xh.sh. që t’i përngjajë dikujt. Në Kur’an thuhet: “Përpara duarve të mëshirës së Tij”, – d.m.th. përpara mëshirës së Vet. “Përpara duarve të vuajtjes së rëndë”, – d.m.th. para vuajtjes së rëndë. “Nuk i vjen gënjeshtër para duarve të Tij” – d.m.th. nuk i vjen gënjeshtër nga asnjëra anë. E as mëshira, as vuajtja, as Kur’ani nuk kanë dy duar të vërteta.<sup>7</sup>

---

<sup>7</sup> Ekziston dallimi në mes All-llahut xh.sh. dhe këtyre shprehjeve abstrakte, të cilat paraqesin disa veprime apo sende. All-llahu xh.sh. është i Gjallë dhe ne nuk e kemi parë Atë, e që ta dimë se nuk ka dorë, për dallim nga gjërat e lartpërmendura. Kur janë në pyetje cilësitë e All-llahut xh.sh. është obligim i besimtarit që të besojë në to ashtu siç janë përmendur në Kur’an dhe Sunnet, pa te’vil.

## **AJETET E QARTA DHE MË PAK TË QARTA (MUHKEM DHE MUTESHABIH)**

All-llahu xh.sh. ka treguar se në Kur'an ka ajete me domethënie të qarta (muhkemat) dhe ajete të cilat janë më pak të qarta (muteshabihat), e ato janë ajetet, kuptimi i të cilave nuk është plotësisht i qartë. Të shumta janë kuptimet e këtyre ajeteve nga ana e dijetarëve, komentimet e tyre janë të paqarta dhe jo të sigurta, kështu që është bërë e vështirë apo e pamundshme njohja e domethënive të këtyre ajeteve (muteshabihat). Në këtë kategori të ajeteve bëjnë pjesë edhe ajetet që flasin për atributet e All-llahut xh.sh. Në besimtarin mbetet që të mos thellohet tepër në domethënien e tyre, e as mos t'i shqyrtojë dhe hulumtojë për t'i nxitur njerëzit në shqyrtimin e tyre.

## **QËNDRIMI I MUSLIMANËVE NDAJ KËTYRE AJETEVE DHE TË PERCEPTUARIT E TYRE**

Muslimanët e parë, e ata janë autoritetet më të larta dhe njohësit më të mirë të Islamit, nuk kanë polemizuar për këto ajete, e as nuk kanë folur për to, se kjo është “hakika” – domethënie e vërtetë, apo kjo është “mexhazi” – metafora. Nuk kanë hyrë në shpjegimin dhe komentimin e tyre, por kanë besuar në to, ashtu siç kanë ardhur nga All-llahu xh.sh. në pajtim me qëllimin dhe synimin e All-llahut xh.sh. Pas paraqitjes dhe zgjerimit të teologjisë skolastike dhe futjes së

dyshimit në besimin islam, është paraqitur gjenerata e re e dijetarëve, të cilët morën mbi vete përgjegjësinë që të përgjigjen në këto dyshime. Ata kanë polemizuar për këto ajete (të cilat flasin për atributet e All-llahut xh.sh.) dhe i kanë kuptuar ato në mënyrën në të cilën i kanë kuptuar arabët, duke kaluar nga domethënia themelore e fjalës në tjetrën, po qe se nuk ka qenë e mundur të kuptohet në domethënien e saj themelore. Kjo quhet “mexhaz” – metaforë, apo “te’vil” - shpjegim. Ky është objekt i mosmarrëveshjes së gjatë mes dijetarëve. Unë them se është e vërtetë që këto ajete janë të shpallura nga All-llahu xh.sh. Kush mohon diç nga ato, ka dalur nga feja. Kush e braktisë plotësisht domethënien e tyre, apo kush i kupton në domethënien njerëzore, i përdorë ato në All-llahun xh.sh. dhe e bën Krijuesin si krijesat, po ashtu ka dalur nga Islami. Rruga që shpie në shkretëtirë është e rrezikshme. Shpëtimi është në shmangien prej asaj rruge dhe në pasimin e rrugës dhe metodës së autoriteteve të para (as’habëve) dhe të ndalurit në kufijtë e tekstit. Kjo është feja ime.<sup>8</sup>

## FORMAT E SHPREHJES SË IBADETIT

Zemra që beson se dobia dhe dëmi janë në duart e All-llahut xh.sh., se të lejuarit dhe të ndaluarit i takojnë All-llahut xh.sh., se dashuria absolute, frika dhe nënshtrimi i takojnë vetëm Atij, (kjo zemër) është e mbushur me lavdërim ndaj Tij, ndien domethënien e fjalës “All-llahu ekber” – All-

---

<sup>8</sup> Do t’i cekim këtu fjalët e Imam Malikut: “Istevaja” – ngritja është e ditur, “si “ është e panjohur, besimi në të është vaxhib, ndërsa të pyeturit për të është bid’at – risi (shënim i përkthyesit)

llahu është më i Madhi. Çdo gjë pranë Tij mbetet imtësi. Në mesin e veprave të njeriut, ka vepra që udhëzojnë në lavdërimin absolut, siç janë duaaja – namazi, rukuja – përkulja dhe nderimi – sexhdeja, zotimi, sakrifica, tesbihi, shehadeti. Besimtari këto vepra ia kushton vetëm All-llahut xh.sh. I falet vetëm Atij, ruku dhe sexhde i bën vetëm Atij, vetëm Atij i thotë: “Subhaneke” (i pastër Je nga të gjitha mungesat dhe të metat), vetëm nga Ai falje kërkon. Sepse, të gjitha këto janë forma të shprehjes së lavdërimit absolut, e që është thelbi i ibadetit. Njëra nga format më të theksuara të këtij lavdërimi absolut është duaaja-lutja. Në aspektin gjuhësor ajo do të thotë thirrje. Sheri’ati nuk ndalon ta lutësh, d.m.th. ta thërrasish njeriun e gjallë, i cili e dëgjon zërin tënd, për të të ndihmuar me diturinë apo forcën e tij në punë të dobishme për ty. Nuk do të flasim për këtë lloj të duasë-lutjes. Duaaja në të cilën këtu mendojmë, dhe e cila përbën thelbin e ibadetit është në kërkimin e dobisë dhe largimin e dëmit pa shkaktarin e dukshëm, material. Kjo është duaaja-lutja e cila i drejtohet vetëm All-llahut xh.sh. në mënyrë direkte dhe pa ndërmjetës. Shëndeti nuk kërkohet nga mjeku, sepse ai vetëm e përcakton ilaçin, ndërsa shërimin e jep All-llahu xh. sh. Këto gjëra sidomos nuk kërkohen nga të vdekurit, apo gjërat jo të gjalla, sepse vetëm All-llahu xh.sh. dhuron dobinë pa shkaktarin e jashtëm, të dukshëm. Besimtari ndërmerr masa dhe bën atë që është në fuqinë e tij, e mandej kërkon pasojat dhe rezultatit nga All-llahu xh.sh. Atë së cilës njerëzit nuk ia dinë shkaqet, e kërkojnë vetëm nga All-llahu xh.sh. Besimtari lutet dhe thotë: “O Zot” duke besuar se dyert e Tij janë të hapura dhe se do t’i pranohet lutja, nuk e lutë tjetërkënd përveç All-llahut xh.sh. e as dikë krahas Tij, e as që merr dikë tjetër si ndërmjetës midis tij dhe All-llahut xh.sh. Kjo është duaaja, e cila paraqet thelbin e ibadetit.

## QËLLIMI I IBADETIT

Kemi thënë më parë se ibadeti ka trupin – formën, e ato janë fjalët të cilat i shqipton gjuha dhe veprat të cilat i kryejnë gjymtyrët, e se shpirti i tij është besimi, i cili e ka nxitur në ibadet dhe qëllimi për shkak të së cilit është kryer, d.m.th. rezultatet që janë synuar nga zbatimi i tij. Tashmë e kam shpjeguar pjesën e cila flet për besimin, e tani shkurtimisht do ta paraqes pjesën e dytë, e ajo është qëllimi i ibadetit. Kuptimi i vërtetë dhe qëllimi i ibadetit është që motivi dhe synimi të jenë kënaqësia e All-llahut xh.sh. Nuk e kryejmë atë për shkak të pasurisë, apo famës, apo të nxisim me të admirimin e njerëzve, e as që e marrim si mjet për arritjen e kënaqësive të kësaj bote, e as që me të dëshirojmë dikush të na konsiderojë të ndershëm dhe të vyer. Ky qëllim i drejtë quhet ihlas-sinqeritet. Qëllimet tjera që gërshetohen dhe përzihen me këtë quhen nifak-hipokrizi. Ajo që e përcakton cakun e veprave është nijjeti-qëllimi. All-llahu xh.sh. nuk do të na pyesë në Ditën e Gjykimit vetëm për veprat tona, por do të na pyesë edhe përse i kemi bërë ato. Ndodh që vepra vetvetiu të jetë e mirë, por qëllimi nuk është i drejtë (nijjeti nuk është i pastër), nuk kryhet sqerisht në emër të All-llahut xh.sh., kështu që vlefshmëria e saj shndërrohet në kontrast, mirësia në shëmtueshmëri.

Namazi është p.sh. vepër e mirë, mirëpo nëse ai që falet ka për qëllim që njerëzit ta shohin dhe ta konsiderojnë të ndershëm e që t'i dhurojnë dhurata, e nuk falet për t'iu nënshtruar urdhrin të All-llahut xh.sh., duke kërkuar kënaqësinë e Tij, namazi i tillë është vepër e keqe, edhe pse namazi në thelb është vepër e mirë. Kështu edhe hixhreti i muhaxhirëve ka qenë i ndryshëm edhe pse forma e jashtme e tij ka qenë e njëjtë. Të gjithë kanë marrë pjesë në udhëtim, kanë shkuar në të njëjtën kohë, rrugës së njëjtë. Ai person që ka pasur për qëllim ruajtjen e fesë dhe arritjen e kënaqësisë së

Zotit të tij, hixhreti i tij ka qenë në emër të All-llahut xh.sh., dhe për të do të jetë i shpërblyer me shpërblimin e muhaxhirit. Ndërsa, ai që ka pasur për qëllim martesën në Medine dhe u është bashkangjitur muhaxhirëve, apo ka pasur disa punë tregtie dhe ky ka qenë i vetmi cak i udhëtimit, atëherë udhëtimi i tij është për këtë botë, e jo për All-llahun xh.sh.

Qëllimet janë ato që e ndajnë adetin nga ibadeti. Kush zgjohet vonë, shkon në punë me nxitim dhe tërë ditën është i zënë me punë, ashtu që asgjë nuk ha dhe nuk pi deri në perëndim të diellit, ka bërë atë që kërkohet nga agjëruesi, por nuk e ka arritur sevabin dhe shpërblimin e agjëruesit, sepse nuk e ka pasur për qëllim të agjërojë. Veprat e rëndomta të cilat janë të lejuara, nëse ai i punon ato dhe me këtë dëshiron ta arrijë kënaqësinë e All-llahut xh.sh., po qe se e ka nijjetin e pastër i llogaritet ibadet. Prandaj kemi thënë se të gjitha veprat e dobishme të njeriut (besimtarit) me nijjet të pastër janë ibadet. Ibadeti e përfshinë tërë jetën, kështu që besimtari është në devotshmëri duke ngrënë, duke pirë, duke ecur, duke ndenjtur, duke fituar pasuri dhe duke u martuar. Në këtë kontekst mund të kuptohet drejt ajeti kur'anor: “Xhinnët dhe njerëzit i krijova vetëm që të më dhurojnë”. Ibadeti në këtë kuptim gjithëpërfshirës është qëllimi i krijimit.

## PËRKUFIZIM

Nga kjo mund të konstatojmë se besimi në njëshmërinë e All-llahut xh.sh., e kjo është pjesa e katërt dhe më e rëndësishme e besimit në All-llahun xh.sh., do të thotë të besosh se dobia dhe dëmi janë në duart e All-llahut xh.sh., të kërkosh dobinë vetëm nga Ai përmes ligjshmërisë që e

ka vendosur në Gjithësi, e cila quhet ligj i natyrës, apo drejtpërdrejt përmes duasë, lutesh dhe kërkon vetëm nga Ai, e jo nga dikush tjetër. Në këtë nuk ia shoqëron askënd, e as nuk merr ndërmjetës. Kërkon ndihmë vetëm nga Ai, apo përmes mjeteve të cilat i ka bërë shkaktarë të dobisë, duke pasur parasysh se Zoti është Ai që sjell dobi, e jo mjeti. Dhe vetëm Atë ta duash me dashuri absolute, e cila nxit në nënshtrueshmëri absolute, që vetëm nga Ai të frikësohesh, me frikën që të detyron në shmangien prej të ndaluarës, që vetëm Atë ta lavdërosh (me fjalë e vepra) dhe që me ibadetin tënd të synosh arritjen e kënaqësisë së Tij, e jo dunjallëkun dhe atë që gjendet në të.

## **HULUMTIMET SHKENCORE**

Pasi që All-llahu xh.sh. na ka pajisur me mendje, na ka urdhëruar të vëzhgojmë dhe të hulumtojmë sekretet e ekzistencës, ligjet të cilat i ka krijuar në të, pra obligim e kemi që ta zbatojmë urdhrin e All-llahut xh.sh. Atëherë pra, të studiuarit e shkencave natyrore dhe zbulimi i sekreteve të ekzistencës është ibadet, por me kusht që të mos ndalesh në të njohurit e ligjit, por të mendosh për All-llahun xh.sh., i cili e ka krijuar atë, e që me këtë meditim të shtohet imani yt dhe sinqeriteti në ibadet. Ekziston edhe kushti i dytë, e ai është që këto zbulime t'i përdorish me qëllim që t'u sjellish dobi njerëzve dhe me çka All-llahu xh.sh. është i kënaqur, e jo në atë që sjellë dëm, që i shqetëson ata dhe shkakton trazira në tokë.

## DYSHIMI DHE PËRGJIGJJA NË TË

Shumica pyesin: “Përse pabesimtari, i cili vepron atë që u shërben njerëzve, jep lëmoshë, ndërton spitale, hap shkolla, edhe përkundër kësaj nuk ka për këtë shpërblim në Ahiret?”. Përgjigjja është: “Me të vërtetë All-llahu xh.sh. asnjërit nuk do t’ia humbë mundin, as mashkullit e as femrës, e as bamirësit nuk do t’ia shkurtojë frytin e bamirësisë së tij”. A nuk është shpërblim më i madh t’ia japë mirëbërësit atë që e kërkon. Pra, nëse ka qenë besimtar, ka besuar në ahiret dhe e ka kërkuar shpërblimin e Tij, All-llahu xh.sh. do t’ia japë këtë shpërblim. E nëse vetë bamirësi dëshiron vetëm dunjallëkun, famën, të përmendurit për të mirë, që për të të shkruajnë gazetat dhe që historia t’ia shënojë emrin, All-llahu xh.sh. do t’ia japë atë që e ka kërkuar. Ai nuk e dëshiron Ahiretin, e pse ti dëshiron t’ia japësh atë dhe zemërohesh nëse ai nuk e fiton shpërblimin e Ahiretit?

## POLEMIKA JOFRYTDHËNËSE

Librat apologetikë janë përplot me polemika për atributet dhe qenien e All-llahut xh.sh., a është dituria e Tij e njëjtë sikur edhe Qenia (Zot), apo ajo është cilësi e diturisë në Qenie. Pastaj polemika për dallimin ndërmjet sifati-dhatijje, siç janë dituria dhe fuqia dhe sifat-ul-e’al, siç është krijimi dhe furnizimi, pastaj polemika për të folurit e All-llahut xh.sh., të cilat sollën pa nevojë deri te ngatërresa e madhe dhe çrregullimi, kanë qenë sprovim i madh për përgjegjësit në doktrinën e krijimit të Kur’anit. Pastaj polemika për të bukurën dhe të shëmtuarën, të mirën e më

të mirën, caktimin e Zotit-kada dhe kader, vullnetin e njeriut etj. E vërteta dhe rruga e drejtë në këto çështje është në refuzimin e debatimit dhe polemizimit për to. Ato janë, thënë me fjalorin gjyqësor, pretendim formalisht i refuzuar. Sepse as'habët dhe tabi'inët nuk kanë diskutuar për këto çështje. Feja u ishte më e pastër, imani më i plotë dhe ata janë shembulli jonë në fe.

E dyta, kush me kujdes i studion mësimet e sekteve të ndryshme, do të vërejë se të gjitha janë të bazuara në një themel, e ai është matja e Krijuesit me peshojat e krijesave dhe përdorimi i logjikës së mendjes njerëzore dhe gjendjeve të tyre shpirtërore në All-llahun xh.sh., e ky është mashtrim, sepse Krijuesi nuk krahasohet me krijesa dhe asgjë nuk është si Ai. E treta, këto çështje, për të cilat kanë polemizuar janë pjesë e gajbit-botës së padukshme. Tanimë është theksuar më herët në parimin e pestë të besimit islam, se të gjykuarit e mendjes është i kufizuar në botën materiale dhe se ajo nuk mund të gjykojë për të mbinatyrshmen, metafizikën, nuk mund ta njohë dhe ta kuptojë.

## **E VËRTETA NË KËTO ÇËSHTJE**

Ju ftoj në atë që është më afër të vërtetës dhe më e dobishme për ne, që të kalojmë nga diskutimi mbi atributet e Allahut xh.sh. në çështjen e sjelljes në jetë e cila shpie te kënaqësia e Tij. Pra në vend se të polemizojnë mbi temën e pafrytshme lidhur me Kur'an, e ajo ka të bëjë me atë se a është Kur'ani i krijuar apo jo, themi: Allahu xh.sh. e ka shpallur Kur'anin që të punojmë sipas tij, t'i zbatojmë urdhërat e tij dhe të mos i tejkalojmë ndalesat e tij. Dhe në vend të diskutimit mbi

diturinë e All-llahut xh.sh. – a është ajo njësoj si dhe Zoti-Qenia, apo është cilësi jashta Qenies, themi: Nëse All-llahu xh.sh. di të gjitha mbi ne, të gjitha gjërat tona të fshehta e publike, kur jemi vetëm e në shoqëri, atëherë duhet ta pasojmë rrugën që është në harmoni me sheriatin e Zotit tonë, dhe që të shoh te ne, atë që do Ta bëj të kënaqur. Kjo është e vërteta dhe rruga e drejtë.

Shembulli i atij që vepron kështu dhe i atij që polemizon për atributet e All-llahut xh.sh., është si shembulli i nxënësve në shkollë, të cilëve u thuhet se: “Nesër vjen komisioni kontrollues, i cili do t’ju pyesë”. Nxënësi i mençur do të thotë: “Nëse ky komision do të na pyesë, atëherë duhet që të përgatitem mirë, të mësoj dhe asgjë të mos e lë pa mësuar”. Ndërsa, kur ahmaku diskuton për këtë komision, si do të pyesë, a të gjithë anëtarët e tij do të pyesin, apo vetëm ndonjëri, e është numri i tyre çift apo tek, a vijnë me veturë, apo me aeroplan? Nuk pushon me këto dhe pyetje të ngjashme gjithnjë deri te momenti i provimit, e asgjë nuk përgatitet. All-llahu xh.sh. në Ditën e Gjykimit nuk do të na pyesë asgjë për atë se në çka apologetët e kanë formuar polemikën e vet, si vendosën drejtime të ndryshme dhe i mbushën librat e tyre me to. Sikur të ishte kjo nga kushtet e imanit, për to do të diskutonin I Dërguari i Zotit dhe as’habët e tij. T’i lëmë të gjitha këto, se kjo është mbeturinë e filozofisë greke, koha e së cilës ka kaluar. Shumica e teorive dhe dëshmimeve të saj janë rrënuar dhe kanë dalë nga përdorimi. Vendin e saj e kanë zënë çështjet e metafizikës, filozofisë së re, e cila nuk paraqet mashtrim dhe bredhje më të vogël nga ajo e mëparshmeja. Ta vendosim librin e All-llahut xh.sh. pranë vetes dhe të mbështetemi në të. Ajo që është përmendur në të, nga gajbi vetëm një pjesë e tij është ekspozuar gjerësisht. Besojmë atë që ka ardhur në të, ndërsa ajo çka na ka mbetur e panjohur ia lëmë dhe ia besojmë Atij, i cili e ka shpallur.

## FORMAT E SHPREHJES SË IMANIT

Nxënësi që beson se provimi është afër (nuk kanë mbetur deri te ai më shumë se shtatë ditë), e mandej nuk përgatitet, e as nuk interesohet për të, por është i zënë me lojë dhe argëtim,-nuk është plotësisht i bindur për afërsinë e provimit. I humburi, të cilin e udhëzon për në rrugë të drejtë, duke e vërtetuar udhëzimin tënd, e pastaj shkon në të majtë, në vend se të shkojë në të djathtë, nuk është plotësisht i bindur në sinqeritetin e udhëzuesit. Shenjat e imanit të plotë paraqiten në veprat e besimtarit dhe sjelljen e tij.

## IMANI DHE VEPRA

Imani nuk ndahet nga veprat, sepse vepra është rezultat i drejtpërdrejtë dhe fryt i imanit. Ajo është dukuria e tij dhe shenjë me të cilën paraqitet para njerëzve. Prandaj, All-llahu xh.sh. e ka identifikuar imanin me vepra të mira.

All-llahu xhle shanuhu thotë: “Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të cilëve kur u përmendet All-llahu u rrëqethen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre. Dhe të cilët falin (rregullisht) namazin dhe që japin nga ajo me çka Ne i furnizuar, Të tillët janë besimtarë të vërtetë”. (Enfal: 2-4).

“Besimtarë janë vetëm ata që i besuan All-llahut dhe Të Dërguarit të Tij dhe kur janë me të (Të Dërguarin) për ndonjë çështje të përbashkët (të rëndësishme), nuk largohen pa i kërkuar leje atij”. (Nur: 52).

“Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët: ata të cilët janë të përlurur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit, dhe ata që i shmangen të kotës (fjalë a punë), dhe ata që rregullisht e japin zekatin, dhe ata që e ruajnë nderin e vet (sa i përket jetës intime)”. (Mu’minun: 1-9).

“Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t’i ktheni fytyrat tuaja kah Lindja ose Perëndimi, por mirësi e vërtetë është kush i beson All-llahut, Ditës së Gjykimit, engjëjve, librit, peygamberëve dhe pasurinë që e do, ua jep të afërmeve, udhëtarëve, lypsarëve dhe për lirin e robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zekatin, dhe ata që e zbatojnë premtimin kur e japin, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të sinqertit dhe të tillët janë ata të devotshmit.” (Bekare: 177).

## **IMANI SHTOHET**

Disa dijetarë kanë shikuar në imanin nga aspekti i dogmës dhe besimit, i cili nuk pranon ndarje. Njeriu mund të jetë një nga dy mundësitë: besimtar apo pabesimtar. Nuk ka hamendje ndërmjet tyre, prandaj këta dijetarë kanë thënë se imani nuk shtohet e as nuk pakësohet. Mirëpo, shumica e dijetarëve kanë shikuar në iman të lidhur apo të identifikuar me vepër të mirë, dhe kanë parë se

imani shtohet me shtimin e veprave të mira. Kjo është e vërteta të cilën kategorikisht e vërtetojnë tekstet kur'anore.

“E kur u lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi”. (Enfal, 1)

“...sa u përket besimtarëve, atyre u është shtuar besimi”. (Tevbe, 4)

“Kjo vetëm ua shton atyre besimin dhe mbështetjen”. (Ahzabë, 22).

## **LËNIA E VEPRAVE NUK NXJERR NGA BESIMI, POR PERSONIN E EKSPONON DËNIMIT NË AHIRET**

Dijetarët e Ehli-Sunnetit pajtohen se të vepruarit e haramit-të ndaluarës pa mohuar ndalesën e tij, si dhe lënia e vaxhibit-obligimit pa e mohuar obligueshmërinë e tij dhe pa e përbuzur atë, kryesin ia ekspozon dënimit të ahiretit, por kjo nuk e nxjerr nga feja, e as nuk është arsye e banimit të përhershëm në zjarr. Ndërsa ajo që përmendet në hadithin: “Se zinaçari gjatë kryerjes së aktit amoral, nuk është besimtar”, ka domethënien se gjatë kohës së atij akti nuk i bie ndër mend se All-llahu xh.sh. e sheh, e sikur kjo t’i binte ndër mend, do të largohej prej zinasë, prej turpit nga All-llahu xh.sh. Sikur ndonjë i çoroditur të bëhej gati për të bërë zina, por kupton se babai e shikon, a mund ta kryejë atë që e ka pasur për qëllim, apo turpi nga babai do ta ndalonte prej kësaj vepre? Pra, si nuk do ta pengonte turpi nga All-llahu xh.sh., po ta kishte ndër mend dhe të ishte i vetëdijshëm që Ai e sheh?

## REZULTATET DHE FRYTET E IMANIT

Frytet e imanit janë vepra të zemrës që Resulullahu, sal-lall-llahu alejhi ve selem, i ka përkufizuar në hadithin sahih, me fjali të shkurtër e gjithëpërfshirëse, që konsiderohet si shembull i të folurit konciz e të thukët dhe dëshmi e retorikës pejgamberike, me të cilën as për së afërmi nuk mund të krahasohet retorika njerëzore, e këto janë fjalët e tij, me të cilat e definoi ihsanin-bamirësinë: “Ta adhurosh All-llahun sikur Ta shohësh, sepse nëse ti nuk e sheh, Ai ty të sheh”.

## DHIKRI

I pari nga frytet e imanit është dhikri-të përmendurit e All-llahut xhle shanuhu. Kam lexuar për një njeri të devotshëm, se fillimi i rrugës së tij ka qenë biseda me dajën i cili ka qenë shumë i devotshëm dhe të cilin vazhdimisht e ka përcjellur. E ka pyetur: “O daja im, çka të punoj që të bëhem sikur ti?”. Daja iu përgjigj: “Thuaj për çdo ditë nga tri herë All-llahu më shikon, All-llahu më përcjell”. Këtë e ka thënë gjatë tërë javës. Pastaj e urdhëroi që këtë ta thotë tri herë pas çdo namazi. E la që këtë ta bëj shtatë ditë, e pastaj e këshilloi që këtë ta thotë me zemër në vend të shqiptimit me gjuhë. Kështu iu bë shprehë që vazhdimisht të bëjë dhikër dhe të vetëkontrollohet. All-llahu xh.sh. nuk i ka kushtuar asgjë kujdes më të madh në Kur’an se sa dhikrit. Askënd nuk e ka lavdëruar ashtu siç i ka lavdëruar ata të cilët bëjnë dhikër. Dhikri në gjuhën arabe, në të cilën është shpallur Kur’ani, është dylojesh: dhikri me zemër dhe dhikri me gjuhë. Që të dy këto lloje përmenden në Kur’an. Në dhikrin me zemër tregohet me fjalët e All-llahut xh.sh.: “...unë e

harrova peshkun dhe përveç shejtanit, nuk më nxiti kush të harroj që të ta përkujtoj ty atë...” (Kehf, 63), d.m.th. që të më kujtohet dhe të më bie ndër mend. Në këtë lloj të dhikrit tregohet, po ashtu me fjalët e All-llahut xh.sh.:

“Përkujtoi të mirat e Mia ndaj teje dhe ndaj nënës sate”, - (Maide, 110).

“O besimtarë, përkujtone të mirën e All-llahut ndaj jush”,- (Maide, 11).

Në dhikrin me gjuhë na tregojnë fjalët e Të Lartësuarit:

“Përkujtoju në Libër Ibrahimin...”,- (Merjem, 42).

“E, përmendju në këtë libër”,- (Merjem, 16).

“Më përmend te zotëriu yt...”,- (Jusuf, 42).

“Dhe përmendni emrin e All-llahut gjatë kësaj...”,- (Maide, 4).

Pra, nëse dëshiron të sendërtohet te ti cilësia e atij që e përkujton All-llahun xh.sh., kujtoje me zemrën tënde në vetmi, në shoqëri, në treg, në rrugë. Le të të bie ndër mend në çdo kohë dhe në çdo situatë se All-llahu xh.sh. të sheh, prandaj puno vetëm atë me të cilën Ai është i kënaqur. Nëse e kryen vaxhibin, përkujtoje se e kryen duke iu nënshtruar urdhrit të Tij, e nëse largohesh nga ajo që është e ndaluar, përkujtoje se e braktisë atë, duke e dëgjuar fjalën e Tij. Nëse e vepron të lejuarën, syno atë në çka do ta fitosh sevabin. Nëse të ofrohen dy rrugë, zgjedhe atë e cila do të të ofrojë në Xhennet, e do të të largojë nga zjarri. E nëse harron dhe gabon, e pastaj të bie ndër mend, pendohu dhe kërko falje.

“Ata të cilët All-llahut i frikësohen, posa iluzioni i shejtanit t’i ngacmojë, All-llahun e përkujtojnë dhe menjëherë vijnë në veti”,- (A’raf, 201).

Kujtoje dhe përmende All-llahun xh.sh. me gjuhë, sepse me të vërtetë dhikri më i vlefshëm është dhikri me gjuhë krahas pranisë së zemrës, sepse nëse mungon të menduarit, nuk e kupton atë që e shqipton gjuha, atëherë dhikri i tillë është të folurit pa domethënie e kuptim, i ngjashëm me dhikrin e shitësit të kuleçëve në Siri, i cili bërtet: “All-llahu Kerim”, duke mos pasur për qëllim dhikrin e All-llahut xh.sh. por shitjen e kuleçëve, apo si dhikri i shitësit të sallatës i cili thërret: “All-llahu është i amshueshëm”. Në disa raste dhikri mund të jetë mëkat, si p.sh. kur të përmendet All-llahu xh.sh. gjatë pirjes së alkoolit apo në këngët e shfrenuara, e nëse me të synohet të bëhet shaka, atëherë përmendja e tillë është kufër-mosbesim. Dhikri më i vlefshëm është leximi i Kur’anit, përveç në situatat e caktuara kur ligjdhënësi ka caktuar dhikër të posaçëm siç është p.sh. rasti në ruku dhe sexhde, dhe dhikri i cili transmetohet nga Resulullahu, sal-lallahu alejhi ve selem. Ndërsa, sa i përket asaj që sot quhet ndejë e dhikrit, te dijetarët tanë ka qenë e njohur si vallëzim, jo vetëm për shkak të qëndrimeve, përkuljeve dhe ngritjeve me lëvizje ritmike dhe melodi të njohura. Krahas këtyre, në ato ndeja të dhikrit nuk shqiptohet fjalia “La ilahe il-lall-llah”, por diçka si “ah” dhe “eh”. Në librin “Hashijetu ibn Abidin”, që konsiderohet si një nga veprat me të rëndësishme të Medh’hebit Hanefit, shkruan se kjo vepër është haram, përveç nëse këtë e vepron në gjendje të mposhtur apo të pandieshme, pa qëllim. E kush e konsideron atë të lejuar, mundemi madje të gjykojmë për daljen e tij nga feja.

## NDËRMJET FRIKËS DHE SHPRESËS

Besimtari gjithnjë duhet të jetë ndërmjet frikës nga dënimi i All-llahut xh.sh. dhe shpresës në faljen e Tij. I kujtohet se All-llahu xh.sh. shpejt llogarit dhe se ashpër dënon, prandaj e kaplon frika. E më pas i kujtohet se Ai shumë falë dhe se është Mëshiruesi më i Mëshirshëm, pra e kaplon shpresa. Nëse zemrën e tij e mbush vetëm frika, atëherë vetëm se e ka humbur shpresën në mëshirën e All-llahut xh.sh.: “Vetëm pabesimtarët humbin shpresën në mëshirën e All-llahut”, - (Jusuf, 87).

E nëse në zemrën e tij është shpresa, atëherë nuk i frikësohet dënimit të All-llahut xh.sh.: “Dënimit të All-llahut nuk i frikësohet vetëm populli të cilit shkatërrimi i është afër”, - (A’raf, 99).

Tashmë kemi thënë se Krijuesi nuk u përngjet krijesave. Frika nga Ai nuk është sikurse frika nga krijesat e Tij. I frikësohesh luanit, i cili vjen drejt teje duke i treguar dhëmbët e vet dhe duke e mbushur hapësirën rreth teje me erë të keqe, ndërsa ti je i vetmuar dhe pa armë. Mirëpo, frika nga All-llahu xh.sh. nuk është si frika nga luani, sepse rreziku nga luani po të tentonte të të sulmojë është e mundshme të evitohet. Ndërsa All-llahu xh.sh. është Zot i luanit dhe Krijues i tij, caktimin e të Cilit nëse e sjell, nuk është e mundur ta pengojmë. I frikësohesh vërshimit shkatërrues të lumit, në shtratën e të cilit gjendesh, dhe i cili të afrohet e nuk ke mundësi ta parandalosh. Por kjo frikë nuk është sikur frika nga All-llahu xh.sh. i Cili e ka dërguar vërshimën, e ndalë kur të don, bën që të shteret dhe e kthen kur të dëshiron. U frikësohesh sëmundjeve dhe fatkeqësive, humbjes së shokëve dhe pasurisë, por kjo nuk është sikur frika nga All-llahu xh.sh. në duart e të cilit është çdo gjë. Nëse don të sprovon me të, e nëse nuk don, të shëron me të. Nuk ka asgjë që do të shëronte nga ajo me çka All-llahu xh.sh. të ka sprovuar. Besimtari duhet të jetë ndërmjet

frikës dhe shpresës. Kur të qëndrojnë në namaze e thotë: “Er-Rrahmanir-Rrahim” – Mëshiruesit – Mëshirëbërësit, e kaplon ndjenja e shpresës, e kur të thotë: “Maliki jevmi-din” – Sundimtarit të Ditës së Gjykimit – ndien frikë. Te shumica e muslimanëve sot dominon shpresa mbi frikën dhe shpresa e faljes për frikën nga dënimi. Edhe pse muslimani i cili vetëm kryen vaxhibet (obligimet) dhe largohet prej harameve (ndalesave) u përket të devotshëmve, megjithatë ai humbë gradat e pozitave e larta në Xhennet. Ai është sikur nxënësi i cili e merr notën më të ulët kaluese. Nuk ngel, por nuk fiton mirënjohje dhe shpërblim.

## **MBËSHTETJA NË ALL-LLAHUN XH.SH.**

All-llahu xh.sh. thotë: “Nëse në All-llahun besoni, në Të mbështetuni”.-(Junus, 84). “Vërtet, All-llahu i do ata të cilët në Të mbështeten.”- (Ali Imran, 159).

Ç’është mbështetja në All-llahun xh.sh.? Çfarë është kuptimi dhe domethënia e saj? Më parë është thënë se All-llahu xh.sh. ka bërë mes gjërave që krijoi të dobishmen dhe të dëmshmen, siç i ka bërë disa ligje kozmike shkaktare të dobisë, e disa shkaktare të dëmit. A do të thotë atëherë, se mbështetja në All-llahun xh.sh. ka kuptimin e lënies dhe mospërdorimit të mjeteve dhe shkaqeve të dobisë dhe dëmit?

Në mesin e sufive ka pasur të tillë që kanë konsideruar se mbështetja në All-llahun xh.sh. nënkupton mosveprimin e shkaqeve dhe mospërdorimin e mjeteve. Nuk punon në mbledhjen e furnizimit, pret që ai t’i vjen pa punë, e lë të sëmurin pa mjekim dhe shpreson që të shërohet pa

ilaçe, shkon në shkretëtirë pa ushqim dhe shpreson që ai t'i vijë vet, nuk kërkon dituri dhe beson se dituria do t'i vijë pa kërkimin e saj. Kjo është në kundërshtim me Sheri'atin. Sheri'ati thotë:

“E kur të kryhet namazi, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkonitë begatitë e All-llahut”.(Xhumu'a, 10). “O robër të Zotit, mjekohuni.”, “Kërkojeni furnizimin”, “Kërkimi i ditorisë është obligim”, pra kush e lë kërkimin e ditorisë dhe pohon se ajo i vjen vetë, ai i kundërvihet Sheri'atit dhe natyrës. Ka edhe të tillë që jetojnë vetëm me materie dhe për materien dhe konsiderojnë se shkaqet prodhojnë rezultate, se ilaçi vetvetiu shëron, se vetëm mundi është ai i cili shpie deri te suksesi.

Kjo i kundërvihet realitetit, sepse ndodh që të ekzistojnë shkaqet dhe mjetet por të mos japin rezultate. Ndodh mjekimi, por mungon shërimi. Ndodh që në spital të jenë dy të sëmurë në të njëjtën dhomë, me të njëjtën sëmundje, mjeku u është i njëjtë, ilaçi po ashtu, njëri vdes e tjetri shërohet. Apo, bujku e punon tokën me mjete më moderne, hedhë në të farën më të mirë, përdorë plehun më të mirë, por bën dimër i ashpër apo vapë e madhe, apo thatësi, apo vërshim shkatërrues dhe tërë ky mund të shkon huq. Shkaqet dhe mjetet nuk shkaktojnë domosdo rezultatit. E as mospërfillja e tyre nuk është e lejuar. Arsyeja thërret ndërsa Sheri'ati urdhëron që njeriu ta përdorë mjetin, e pastaj të lutet dhe të kërkojë nga All-llahu xh.sh. realizimin e rezultatit. “Së pari lidhe deven, e pastaj mbështetju All-llahut xh.sh. që ta ruaj”. Mësoi të gjitha mësimet e pastaj mbështetu në All-llahun xh.sh. dhe kërko prej Tij sukses në provim. Kjo është mbështetja dhe shpresa e vërtetë në All-llahun xh.sh., e nuk është në lënien pas dore të mjeteve, shkaqeve dhe në mospërfilljen e ligjeve të All-llahut xh.sh. në botë, e as në të harruarit se All-llahu xh.sh. është Ai i Cili sjell dobi dhe dëm, e sidomos jo në kërkimin e dobisë nga dikush tjetër. Mjetet dhe shkaqet janë të nevojshme, përdorimi i tyre është nënshtrim ndaj urdhrorit të Sheri'atit dhe pasim i

ligjeve të All-llahut xh.sh. në botë. Por vetëm mjetet nuk janë të mjaftueshme, sepse rezultatet janë në dorë të All-llahut xh.sh. Njëmend, mbështetet në All-llahun xh.sh. ai i cili e investon tërë mundin në realizimin e të dëshiruarës, përdorë të gjitha mjetet dhe beson se ai që mundëson arritjen deri te caku është vetëm All-llahu xh.sh. Prandaj shpreson në Të dhe kërkon nga Ai atë që e dëshiron.

## FALËNDERIMI ALL-LLAHUT XH.SH.

Pas kësaj duhet të jetë i kënaqur me All-llahun xh.sh. pa marrë parasyshë se çka i ka dhënë apo i ka refuzuar, e kjo arrihet me cilësinë e falënderimit. “E kush është falënderues-në dobinë e vet është falënderues”,- (Neml, 40). “All-llahu do t’i shpërblejë falënderuesit”,- (Ali Imran, 144).

Falënderimi është një nga frytet e imanit. Nëse njëri nga robtë e All-llahut xh.sh. të bën mirë, e nuk i falënderohesh, je i pakujdesshëm dhe bën mëkat ndaj tij, edhe pse ai është vetëm ndërmjetës, e bamirës i vërtetë është All-llahu xh.sh., i Cili të ka dhuruar dëgjim, shikim, shëndet, siguri, të ka nënshtruar krejt çka ka në tokë, të ka dhënë begati, të cilat nuk mund t’i numërosh! Njeriu e njeh vlerën e begatisë, kur ta humbë atë. Nëse ndonjëherë i nevojiten paratë e nuk i ka, atëherë e njeh begatinë e pasurisë, e kur pasurohet e harron këtë (mirësi). Nëse i dhemb dhëmbi, begatinë më të madhe e sheh në pushimin e dhembjes, e kur i pushon dhembja, harron në të. Nëse ndërpritet rryma dhe shtëpinë e përfshinë errësira, e njeh begatinë e dritës, e kur të vijë rryma, nuk mendon më për vlerën e saj. E kur nuk je në gjendje t’i numërosh begatitë e All-llahut

xh.sh. ndaj teje, a nuk do të jeshë falënderues për to? All-llahut xh.sh. mund t'i falënderohesh me gjuhë duke i shprehur mirënjohje “Elhamdulillah” – Falënderimi i qoftë All-llahut xh.sh. “Rabbi leke-l-hamd” – Zoti im, Ty të takon falënderimi. E mund ta falënderosh me veprimin tënd, ashtu që një pjesë të këtyre begative ta përcjellësh edhe në ata të cilëve u mungon ajo.

Falënderimi i të pasurit është që t'u shpërndajë të varfërve, falënderimi i të fuqishmit është që ta ndihmojë të dobët, falënderimi i udhëheqësit është që ta vendosë drejtësinë. E po qe se je i pasur dhe në sofrën tënde ke pesë lloj ushqimesh, kurse fqiu yt është i uritur dhe nuk i jep asgjë, nuk je nga ata të cilët janë falënderues, edhe në qoftë se një mijë herë thua me gjuhë: “Falënderimi i takon All-llahut xh.sh.”. All-llahut xh.sh. mund t'i falënderohesh edhe me zemër ashtu që je i kënaqur me Të dhe me atë që ta ka dhënë. Nuk zemërohesh dhe nuk e pakëson begatinë që e posedon, askujt nuk ia ke zilinë në atë që All-llahu xh.sh. ia ka dhënë. E kush e bashkon falënderimin me zemër, sepse është i kënaqur me All-llahun xh.sh. dhe falënderon me vepër, duke ua ndarë tepicën e begatisë atyre që s'kanë dhe duke e falënderuar Atë me gjuhë, që sa më tepër të thotë: “El hamdu lil-lah”, ai me të vërtetë është nga ata të cilët janë falënderues.

## DURIMI

Muslimani gjendet mes dy begative: nëse e godet ndonjë e mirë dhe falënderon, për këtë ka shpërblim, e nëse e godet fatkeqësia dhe bën sabër, për këtë ka shpërblim. Vetëm se shpërblimi i të varfërit durimtar është i njëjtë apo edhe më i madh nga shpërblimi i të pasurit falënderues. “Ata

të cilët kanë qenë durimtarë, Ne me siguri do t'i shpërblejmë me shpërblim të shumëfishtë për atë që kanë bërë”,- (En-Nahl, 96).

Kjo jetë e dunjasë nuk është vend i lumturisë së pakufishme e as nuk është pa gjëra të pakëndshme siç janë humbja e shëndetit, pasurisë, të dashurve, tradhtisë së shokut, apo humbjes së sigurisë. Kjo është natyra e saj e cila nuk ndryshon.

All-llahu xh.sh. thotë: “Ne do t’ju sprovovjmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta, e edhe nga frytet, po ti përgëzoi durimtarët”.- (Bekare, 155).

Sepse ata me kalimin e kohës i harrojnë humbjet, ndërsa gjejnë shpërblimin, e të tjerët bartin në vete dhembje e nuk do të gjejnë asgjë. Vështirësitë dhe fatkeqësitë janë të pashmangshme. E ti ose do t’i shërosh me durim e të fitosh shpërblimin, ose do të pezmatohesh e të shqetësohesh për shkak të tyre, ashtu që pezmatimi dhe shqetësimi do ta shtojnë vuajtjen, e nuk do të mbrojnë nga ajo që të ka goditur. Ky është një lloj i durimit-durim në fatkeqësi.

Lloji i dytë i durimit është të përmbajturit nga mëkati dhe veset. Durimi i të riut, i cili sheh pjesët e zbuluara të trupit të femrës, epshi i tij anon dhe e dëshiron vesin, por ai e ulë shikimin nga frika nga All-llahu xh.sh. Ai i di rrugët e kënaqësive të ndaluara, por veten e ndalon që të shkelë në to, edhe pse diç anon kah ato. Durimi i nëpunësit të cilit i ofrohet rryshfeti i cili është i barabartë me pagën e tij gjashtëmujore, por e refuzon këtë edhe pse i nevojiten të hollat. Durimi i nxënësit në provim, kur është në gjendje që ta vjedhë përgjigjen nga libri, por këtë nuk e bën, edhe pse nga kjo i varet suksesi. Veset janë të ëmbla dhe kush përmbahet nga ato, duke pasur mundësi që t’i bëjë, ai është prej durimtarëve.

Lloji i tretë i durimit është të qëndruarit në devotshmëri dhe vepra të mira, ngritja herët për namaz të sabahut dhe braktisja e kënaqësisë së gjumit dhe shtratit të ngrohtë në mëngjesin e ftohtë, durimi i urisë dhe etjes gjatë Ramazanit në verën përcëlluese, të detyruarit e shpirtit që e do pasurinë në dhënien e zekatit dhe sadakasë, të qëndruarit në praktikimin e Islamit, në këtë kohë të prishur, në të cilën feja është kthyer si e huaj dhe e pazakonshme, ashtu si edhe ka filluar, në të cilën kohë ai i cili i përmbahet Islamit, është sikur ai që mbanë prush në dorë, në të cilën besimtari i është ekspozuar talljes së njerëzve të pagdhendur, padrejtësive dhe ofendimeve të pushtetmbajtësve, zvogëlimit të pagës, dëbimit nga shtëpitë. Kush e duron këtë në emër të Allahut xh.sh. duke shpresuar shpërblimin e Tij, ai është prej atyre: “Të cilët janë të durueshëm dhe në Zotin e vet mbështeten... Ata do të fitojnë shpërblimin e dyfishtë për shkak se ishin të durueshëm... Këtë mund ta arrijnë vetëm të durueshmit, këtë mund ta arrijnë vetëm shumë të lumturit”.

## **NËSHTRUESHMËRIA NDAJ GJYQIT DHE CAKTIMIT TË SHERI'ATIT**

Kemi thënë se imani është vepër e zemrës, fshehtësi të cilën vetëm All-llahu xh.sh. e di, ndërsa për njerëzit, janë shenjat e dukshme. Prandaj besimtarin nga kafiri e dallojmë përmes fjalëve dhe veprave të tij. Islami është shenjë e jashtme e imanit. Ai gjuhësisht ka kuptimin e përkushtimit. Fëmija i përkushtohet babait nga besimi në të, e dashura i përkushtohet të dashuruarit nga

simpatia ndaj tij, i mposhturi i dorëzohet fitimtarit nga frika prej tij. Ndërsa, sa i përket besimtarit, ai i dorëzohet gjykimit dhe caktimit të Zotit të vet me përkushtim absolut, i nënshtrohet çdo urdhri të Tij, madje edhe në qoftë se nuk e di urtësinë dhe qëllimin e tij, braktisë krejt çka është ndaluar, madje edhe nëse nuk e di shkakun dhe fshehtësinë e ndalesës. Ky përkushtim ka dy anë, anën praktike, e ky është përkushtimi me fjalë dhe vepra, për të cilin insha All-llahu do të bëhet fjalë në librin e veçantë “Islami”, dhe anën shpirtërore, të cilën tani e shqyrtojmë. Kjo ana tjetër është kënaqësia shpirtërore me dispozitat e Sheri’atit, siguria dhe të zënët besë në të dhe të zbatuarit e obligimeve-vaxhibeve, ndërsa e braktisin të ndaluarën-haramin me kënaqësi dhe bindje, e jo me mërzi dhe bezdisje.

All-llahu xh.sh. thotë: “Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në konfliktet mes tyre”, – kjo është ana praktike, “e pastaj të mos ndiejnë pakënaqësi në zemrat e tyre nga gjykimi yt dhe derisa të mos binden sinqerisht”,- (Nisa, 65) – kjo është ana shpirtërore.

Nuk mjafton vetëm ta marrim Pejgamberin s.a.v.s. për gjykatës, nëse në zemër nuk ka besim dhe bindje në saktësinë e gjykimit të tij, kënaqësisë dhe të zënët besë në të.

“Kur thirren besimtarët për gjykim ndërmjet tyre te All-llahu dhe te I Dërguari i Tij, e vetmja fjalë e tyre është të thonë: “Dëgjuam dhe u nënshtroam!” Të tillët janë ata të shpëtuarit”. - (Nur, 51).

Ka njerëz të cilët vazhdimisht pyesin për urtësinë dhe qëllimin e çdo urdhërese e ndalesë të Sheri’atit, kinse nënshtrohen vetëm nëse ia njohin urtësinë. Nuk ka dyshim se dispozitat e Sheri’atit kanë urtësinë e vet. Mirëpo, herë-herë ato na tregohen të qarta dhe të dukshme, e herë-herë mbeten të fshehura e të panjohura. Pra, a do t’i kundërshtojmë Zotit, nëse nuk e kemi të

qartë urtësinë e dispozitave të Tij?! Përfytyro dhe paraqitja vetes këtë, që kurdoherë që i urdhëron diç fëmijës tënd, ai nuk e kryen atë përderisa nuk i bëhet i qartë qëllimi yt nga ai urdhër si dhe urtësia dhe qëllimi i tij, madje nëse situata të jetë kritike, pa pasur kohë për shpjegim, apo nëse në të ekziston ndonjë sekret i cili nuk guxon të zbulohet! A nuk do ta konsideroje këtë fëmijë për të padëgjueshëm? A nuk pret nga ai që të dëgjojë në çdo situatë, sepse është fëmija yt, ndërsa ti je babai i tij. Apo, sikur një epror ushtarak të merrte urdhrin e komandës, dhe refuzon që ta kryejë derisa të mos i shpjegohet plani i urdhrit dhe qëllimi i dhënies së tij, a nuk meriton dënim? Obligimi i njeriut ndaj All-llahut xh.sh. nuk matet me obligimet e fëmijës ndaj prindit, e as me obligimin e ushtarit ndaj eprorit. Obligimi ynë ndaj Të Lartësuarit është që t'i nënshtrohemi me dëshirë apo me dhunë, u pajtua kjo apo jo me dëshirën tonë, e jo që gabimisht t'i interpretojmë argumentet dhe arbitrarisht t'i hulumtojmë ato, që ndoshta të mos gjejmë mendime në fikh, të cilat do t'i kënaqnin dëshirat tona, e as ta imitojmë kulturën dhe zakonet e huaja, të cilat i kemi pranuar si dëshmi kundër Sheri'atit, ashtu që t'i komentojmë dhe interpretojmë (në mënyrë të gabuar) tekstet të cilat nuk komentohen (te'vil) dhe të devijojmë nga rruga e drejtë e hulumtimit dhe polemizimit, vetëm e vetëm që të mund të themi se feja jonë nuk është në kundërshtim me këto ligje dhe mendime. E posa të ndryshojnë ligjet e shoqërisë, apo burimi i kësaj kulture të huaj nga Perëndimi deri në Lindje, i ndryshojmë hulumtimet dhe mendimet tona dhe vijmë me komente të reja. Jo kështu, por t'i drejtohem Sheri'atit për të gjykuar, të punojmë sipas dispozitave të tij dhe të bëhemi të kënaqur me të. Kjo është veti e besimtarit, i cili njëmend vërteton saktësinë e kësaj feje.

## RIGOROZITETI DHE DHEMBSHURIA

Një nga manifestimet dhe dëshmitë e imanit është që dashuria dhe urrejtja të bëhen në emër të All-llahut xh.sh. E duam të nënshtruarin dhe të devotshmin, e madje edhe nëse prej tij nuk kemi dobi personale, ndërsa e urrejmë të prishurin dhe mizorin, edhe nëse prej tij nuk patëm ndonjë dëm personal. Aq më shumë, e urrejmë dhe e braktisim madje edhe nëse kemi dobi prej tij, apo na lidhin lidhjet më të forta me të. Kjo, për shkak se vëllazërimi mbi baza të besimit është më i fortë te besimtari se sa vëllazërimi në bazë të lidhjes së gjakut, ndërsa lidhja ideologjike është më e fortë nga ajo e origjinës. All-llahu xh.sh. i tha Nuhit a.s. se djali i tij është kafir dhe nuk bën pjesë në familjen e tij, ngase vepra nuk është e mirë. E ka refuzuar ekzistimin e dashurisë ndërmjet besimtarëve dhe jo të nënshtruarve, të cilët luftojnë kundër fesë, pa marrë parasysh se sa janë të forta lidhjet tjera ndërmjet dy grupeve.

I Lartësuarit thotë:

“Nuk gjenë popull që e beson All-llahun dhe Ditën e Gjykimit e ta dojë atë që e kundërshton All-llahun dhe Të Dërguarin e Tij”.- (Muxhadele, 22).

Nuk i detyron me dhunë që ta pranojnë Islamin, por ndalon që të bëhen pengesë në rrugën e tij dhe që të luftojnë kundër thirrjes së tij. E nëse binden në vërtetësinë e thirrjes sonë dhe hynë në fenë tonë, bëhen sikur ne. E nëse ndaj thirrjes sonë sillen në mënyrë të qetë, edhe ne qetë do të sillemi ndaj tyre dhe do t'i mbrojmë të drejtat e tyre, madje edhe nëse qëndrojnë në fenë e tyre. Besimtari dashuron dhe urrenë për shkak të fesë. Kur dashuron shquhet me fisnikërinë e shpirtit, natyrën e butë, me frymen e zemërgjerësisë dhe sakrificës. Është i përlulur me vëllain e vet dhe

nuk e konsideron këtë nënçmim. E kur urrenë, në të paraqitet zemërimi në emër të All-llahut xh.sh., rreptësia në mbrojtjen e fesë dhe guximi në luftën kundër armikut. Ai ndërlihdë në vete dhembshurinë dhe rreptësinë, butësinë dhe ashpërsinë, dhembshurinë dhe butësinë ndaj vëllezërve të vet, ndërsa rreptësinë dhe ashpërsinë ndaj armiqtve të Islamit dhe ndihmësve të shejtanit.

“Muhammedi është i dërguar i All-llahut, e ata që janë me të (as’habët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve, ndërsa të mëshirshëm ndërmjet vete”.- (Fet-h, 29).

“Ndaj besimtarëve të përrulur e ndaj pabesimtarëve krenarë, dhe qortimit të askujt nuk do t’i frikohen”.- (Maide, 54).<sup>9</sup>

Kështu ka qenë gjendja e besimtarëve kur kanë qenë muxhahidë-luftëtarë, e pasi që e lanë xhihadin dhe i shkelën dispozitat e Sheri’atit, rreptësinë që e patën (kundër armikut) e drejtuan kundër vetes, e u bënë të butë ndaj bashkëpunëtorëve të shejtanit, kështu që All-llahu xh.sh. për shkak të mëkateve tona, na e ngarkoi në qafën tonë atë i cili nuk i frikohet Atij, e cili nuk është i mëshirshëm ndaj nesh, ashtu që i ka përvetësuar tokat tona dhe është bërë gjykatës yni.

---

<sup>9</sup> Krahas këtij xhihadi nuk i harrojmë fjalët e të Lartësuarit: “All-llahu nuk ju ndalon që të bëni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk ju luftojnë për shkak të fesë dhe të cilët nuk ju dëbojnë nga vatrata tuaja.” (Mumtehine, 8)

## PENDIMI DHE KËRKIMI I FALJES

All-llahu xh.sh. e ka krijuar njeriun dhe ka mbjellë në të dashurinë ndaj dunjasë, shpresa të vazhdueshme, dëshirën për mbledhjen e pasurisë, pasionin ndaj gjinisë tjetër, zemërimin, prirjen për të dënuar dhe hakmarrur. E caktoi shejtanin që t'ia paraqesë të bukura veprat e shëmtuara e të liga, ia bën të ëmbla mëkatet dhe ia dha (njeriut) shpirtin i cili vazhdimisht e nxitë në të keqe, duke pretenduar haramet dhe duke e ndihmuar në këtë shejtanin. Rezultat i gjithë kësaj është se njeriu bën mëkate. Si duhet të veprojë për t'i shpëtuar dënimit për mëkatet e bëra? All-llahu xh.sh. nga mëshira e Vet ndaj tij ia ka hapur dyert e pendimit. Mund ta shlyesh nga fleta (faqja) jote çdo mëkat, të cilin e ke bërë sikur fare të mos ishte. E në vend të veprës së keqe, ndoshta do të shënohet vepër e mirë. Sikurse libri i tregtarit, në të cilin është e shënuar se i ke borxh njëqind dinarë, e ai jo vetëm që me kënaqësi dëshiron të ta ulë dhe shlyejë borxhin, por madje nga fleta e borxhit tënd ndaj tij e bartë në fletën e borxhit të vet ndaj teje. I Lartësuari thotë: “Por atyre të cilët pendohen dhe bëjnë vepra të mira, të tillëve All-llahu të këqijat ua shndërron në të mira, e All-llahu është Mëshirues, ndaj Ai falë shumë”,- (Furkan, 70).

Dyert e pendimit janë të hapura gjithnjë derisa njeriu është i gjallë. Nëse pendohet me pendim të sinqertë, do t'i jetë i pranuar pendimi. Dyert e pendimit mbyllen në çastin e vdekjes, në momentin kur shpirti vjen në fyt, në atë moment kur njeriu ballafaqohet me të vërtetën dhe sheh me sy atë për të cilën Pejgamberi s.a.v.s. e ka lajmëruar. Atëherë tevbeja-pendimi i tij është sikur vjelja e të vjelurës. Sepse, tevbeja është vullnetarisht kthim spontan All-llahut xh.sh., e kur të jetë i kthyer me dhunë, nuk i bën dobi dëshmia, pasi ta ketë humbur të drejtën për zgjedhje. All-llahu xh.sh. thotë:

“Pendimi i pranueshëm tek All-llahu është vetëm ai i atyre që e bëjnë të keqen me mosdije e pastaj shpejtë pendohen; të tillëve All-llahu ua pranon pendimin e All-llahu është më i Dijshmi, më i Urtë. Nuk është pendimi (i pranueshëm) i atyre që vazhdimisht bëjnë punë të këqija dhe vetëm atëherë kur t’i vjen vdekja ndonjërit prej tyre, thotë: “Unë me të vërtetë tani pendohem!”, e as i atyre që vdesin duke qenë jobesimtarë”,- (Nisa, 17-18).

Kushti i parë i tevbës është ndërprerja e veprimit të mëkatit dhe vendimi i thellë se më nuk do t’i kthehet. Sikur të shkoje rrugës dhe një njeri nga dritarja e shtëpisë e hedhë në ty ujin e ndyer dhe pasi që i bërtet fillon të të kërkojë falje, por ende vazhdon ta derdhë ujin në ty, apo e ndërpre në derdhjen, por të kërcënohet se të njëjtën gjë do ta bëjë edhe nesër, a do ta pranojë kërkimin e faljes së tillë nga ai person? Tevbeja ka shpirtin dhe trupin. Shpirti i saj është ndjenja e neverisë së mëkatit, ndërsa trupi i saj është ndërprerja e bërjes së mëkatit. Sikur dikush të shkonte rrugës dhe të shihte tabelën e cila i tregon se është në rrugë të gabuar, ndien se ka gabuar, dhe pikërisht kjo ndjenjë është baza. Sepse, po të mos ishte ndjenja e gabimit, nuk do të ishte udhëzimi kah caku i drejtë. Por, sikur ai të kënaqej vetëm me atë njohje se është në rrugë të gabuar, e nuk do të vepronte në pajtim me atë që kërkon ajo, por vazhdon të shkojë rrugës së gabuar, atëherë nuk do t’i bënte aspak dobi njohja, se ajo është rrugë dhe drejtim i gabuar. Aq më tepër, për këtë do të kishte mëkat dhe dënim edhe më të madh. Sepse ai, i cili devijon e nuk di, ka ndonjë arsyetim, por ai i cili e njeh rrugën dhe me qëllim e ndërron drejtimin nga ajo, nuk ka kurrfarë arsyetimi.

Kushti i dytë është të bëjë bamirësi në vend të së dëmshmes dhe ta përmirësojë të keqen, d.m.th. ta shndërrojë tevbën në ndryshim të veprës dhe përmirësim të sjelljes.

“Zoti juaj vetes ia ka caktuar mëshirën, nëse dikush nga ju bën ndonjë vepër të keqe pa e ditur, e pastaj pendohet e përmirësohet-e vërtetë All-llahu falë dhe është i Mëshirshëm”, (En’am, 54).

“E kush pendohet pas punës së keqe dhe përmirësohet, s’ka dyshim, All-llahu ia pranon atij pendimin”,- (Maide, 39). “...përveç atyre që pas kësaj pendohen dhe përmirësohen...”,- (Ali Imran, 89).

“...vetëm ata të cilët pendohen dhe përmirësohen dhe haptazi e shfaqin këtë, se Unë jam pranues i pendimeve dhe Mëshirues”,- (Bekare, 160).

Me përmirësim konsiderohet që braktisja jote e mëkatit të jetë e njëmendtë dhe sinqerisht të vendosish se më nuk do t’i kthehesh. Edhe nëse ke marrë vendim të sinqertë, e pastaj të ka mposhtur epshi, apo rrethanat të kanë shtyer që t’i kthehesh mëkatit, dhe përsëri pendohesh, tevbeja jote është e pranuar, madje edhe nëse e përsëritë mëkatin dhe tevben disa herë. Por, nëse në vendimin tënd në fillim është përzier lëkundshmëria, e i ke thënë vetes: “Nëse dëshira ime bëhet e papërmbajtur do t’i kthehem, e pastaj do të pendohem”, atëherë tevbeja jote nuk është e sinqertë, e as e pranuar. Kjo është sa i përket pendimit për mëkatet ndaj All-llahut xh.sh. Mjafton që ta braktisish mëkatin duke u penduar për veprimin e tij dhe sinqerisht të vendosësh që nuk do ta përsërisish më. Ndërsa, sa u përket të drejtave të njeriut, nëse ndokujt i ke bërë padrejtësi, apo e ke marrë pasurinë e tij, e ke shqetësuar trupin apo e ke ngacmuar nderin e tij, apo ke dëshmuar rrejshëm kundër tij, e ke përgojuar apo tradhtuar, apo ke përhapur për të mendim të keq, është e domosdoshme që në këto dhe raste të ngjashme t’ia kthesh të drejtën e tij, e që ai ose të ta falë, apo All-llahu xh.sh. ty të të mëshirojë, e të dëmtuarin Ai ta kënaqë në vend teje. Në të kundërtën tevbeja jote nuk do të pranohet, ndërsa i dëmtuari në Ditën e Gjykimit do të marrë nga veprat tua

të mira, apo në ty do të ngarkojë pjesën e veprave të veta të këqija. Dyert e tevbës janë të hapura, pa marrë parasysh se sa janë të shumta mëkatet. Askush të mos dëshpërohet e ta humbë shpresën në faljen e All-llahut xh.sh., sepse humbja e shpresës në mëshirën e Tij është më e keqe se vetë mëkati.

“O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar veten tuaj me shumë mëkate, mos e humbni shpresën në mëshirën e All-llahut, se vërtet All-llahu i falë të gjitha mëkatet...”,- (Zumer, 54).

Pra, teubeja është të braktisurit e mëkatit dhe të kthyerit veprës së mirë, ndërsa istigfari është kërkim i faljes nga All-llahu xh.sh. Sheri’ati urdhëron dhe nxitë në të.

“Ai nga toka ju krijoi edhe juve dhe të jetoni në të! Prandaj Atë luteni që t’ju falë dhe Atij pendohuni”,- (Hud 52).

Ngjashëm me këtë ka thënë çdo peygamber duke e këshilluar popullin e vet dhe duke e udhëzuar në rrugën e faljes së All-llahut xh.sh. dhe shpëtimit nga dënimi i Tij. Prej mëkatarëve ka kategori të ndryshme. Sa u përket atyre të cilët kanë vdekur si pabesimtarë, nuk kanë kurrfarë shprese në falje:

“Vërtet All-llahu nuk falë t’i përshkruhet shok”.

Politeistët në thelb janë pabesimtarë më të mëdhenj se Ithtarët e Librit, por sipas gjykimit të këtij ajeti, të gjithë janë të njëjtë. Prandaj, për atë që ka vdekur si pabesimtar nuk thuhet: “Zoti e mëshiroftë”, e as: “Zoti ia faltë”.

Ndërsa, sa u përket mëkatarëve muslimanë të cilët kanë vdekur pa tevbe-pendim, fati i tyre është në duart e All-llahut xh.sh., nëse Ai dëshiron do t'ua falë: “E falë atë çka është më pak se kjo (shirku) kujt dëshiron”, e nëse dëshiron do t'i dënojë me zjarr, por nuk do të mbesin përgjithmonë në të. Askush mos ta marrë si të lehtë dënimin me zjarr dhe le të mos e përbuzë atë. Sepse, zjarrin e dunjasë, i cili është begati, askush nuk mund ta durojë disa minuta, atëherë si po ia eksponojmë veten zjarrit të Xhehennemit për periudha të gjata kohore? E sa i përket të penduarit, All-llahu xh.sh. me mirësinë dhe fisnikërinë e Tij do t'ia falë. Kjo është për atë i cili pendohet pas mëkatit. Ndërsa ai, i cili pendohet, këndellet dhe vjen në vete para plotësimit të mëkatit, përkundër dëshirës së madhe dhe animit kah ai, duke iu frikësuar Zotit të vet, ka shpërblimin më të madh. Sikurse ai të cilin shejtani e mashtron dhe e nxitë në zina (amoralitet) dhe kur të gjitha kushtet për këtë plotësohen dhe vendosë që ta bëjë atë, për një moment e përkujton All-llahun xh.sh. dhe heq dorë nga zinaja, e epshi e tërheq kah zinaja. Kush është ai i cili është i aftë për kthesë të këtillë përveç nëse All-llahu xh.sh. i dhuron forcë nga Ai? Askush le të mos e provojë këtë sprovë. Do t'i ngjante atij i cili merr bakteren e sëmundjes së rrezikshme, nëse shpëton fiton imunitet, i cili e bën më të fortë nga ai të cilit sëmundja nuk i është afuar. Por, mundësia e fitimit të imunitetit është 1 për qind, ndërsa mundësia e pësimit është 99 për qind. Kështu është sa i përket sëmundjes së trupit. Ndërsa sa i përket frenimit nga mëkati, ai nuk e bën imun ndaj kthimit në të (mëkat). Pra, kush e dëshiron shpëtimin nga e keqja, le të largohet nga ajo, le t'ia presë-shkëpusë shkaktarët e asaj, le t'ia bllokojë rrugën e cila shpie te ajo dhe le t'i braktis ata, të cilët e nxisin dhe e thërrasin në mëkat. Sepse, shoku e tërheq shokun me vete, njeriu shkon drejtimit të shokut të vet. Që moti kanë thënë: “Më thuaj me kë shoqërohesh, do të të tregoj se çfarë je.” Le ta kuptojë këtë rinia dhe le të kërkojë nga All-llahu xh.sh. ndihmë dhe udhëzim.

## BESIMI NË DITËN E GJYKIMIT NE DHE VDEKJA

Në bazë të asaj se çfarë qëndrimi kanë ndaj vdekjes, njerëzit ndahen në katër grupe:

- Grupi i njerëzve i cili me poetin – mendjelehtin thërret:

“Çka ka kaluar është zhdukur, çka do të vijë e fshehur është, ndërsa ty të takon momenti në të cilin jeton.”

Nuk mendon për të kaluarën e as që përgatitet për ardhmërinë. Mendon se e djeshmja ka kaluar dhe është zhdukur, e se e nesërmja nuk do të vjen e thotë: “Çka ka kaluar është zhdukur”, e pasha All-llahun nuk është zhdukur, por në llogarinë tonë janë shënuar e mira dhe e keqja, në librin, i cili as të voglën e as të madhen nuk e le pa e shënuar. Ndërsa “ç’do të vijë është e fshehur”, mirëpo është e fshehur për shqisa, por është e pranishme te All-llahu xhile shanuhu dhe pa dyshim do të vijë. Nga tre grupet e para të njerëzve, ky është grupi më i keq. Ky është grupi, i cili nuk e përkujton vdekjen dhe nuk mendon për të.

- Grupi që e përkujton vdekjen, por në mënyrën siç e bën këtë poeti persian Omer-Hajjam-i, i cili me mashtrimet e veta i largoi njerëzit nga rruga e vërtetë. Ai thotë: “Nëse vdekja është e vërtetë, në të cilën nuk ka dyshim, ndërsa jeta e shkurtër dhe nuk qëndron përherë, atëherë pra, ta mbushim me dashuri e dalldisje. Nëse jeta sipas natyrës është e krijuar për telashe e dhembje, pra të ikim nga ajo te gota e verës dhe ta kalojmë me këngë... pije.... e epush.”

- Grupi që e përkujton vdekjen, mirëpo, ngjashëm përkujtimit të Ebu Atahiut, i cili të folurit e vet e mbushi me kujtim për vdekjen dhe me të e angazhoi gjuhën e vet, por nuk përkujtohet – vetëm se pak – për atë çka vjen pas vdekjes. Ai (Atahiu) sikur thotë – me atë i cili ka thënë: “Kam kuptuar se vdekja është cak i çdo sendi të gjallë”, apo me tjetrin i cili ka thënë:”Vërtet, nën gurin e varrit është gjumi i gjatë”.

- Dhe pjesëtarët e së vërtetës, të cilët e kanë kuptuar se vdekja nuk është fund por fillim, se nuk është ëndërr por zgjim. “Njerëzit flejnë, e kur të vdesin zgjohen”. Kanë kuptuar se pas vdekjes ka jetë më e gjatë, e cila nuk ndërpritet. Në të do të kemi ose kënaqësi të përhershme, ose dënim të dhembshëm. Ky është grupi i katërt, grupi i besimtarëve, të cilët janë në rrugë të drejtë.

## **JETA PAS VDEKJES**

Jeta pas vdekjes, në realitet është jetë e vërtetë. Ai që është dritëshkurtër nuk e sheh, ndërsa ai që është i sprovuar me mendje të dobët nuk beson në të. Ndërkaq, ai që posedon shikim me të cilin vërenë dhe mendje me të cilën kupton, sheh se jeta e njeriut është e ndarë në etapa. Kështu një ditë, i mbështjellur rreth vetes, si lëmsh në barkun e nënës, ka jetuar në brendësinë e saj. Po të ishte atëherë në gjendje të meditonte, do të mendonte se ajo është e vetmja jetë, e fort do ta shtrëngonte, duke mos dashur ta braktisë përveç se i detyruar. E po të ishte në gjendje të fliste, do ta konsideronte daljen nga barku i nënës me vdekjen dhe varrosjen në thellësi, edhe pse ajo, në të vërtetë, është lindje dhe kalim në botë më të gjerë, ngjashëm me kalimin në Botën e

Berzahut – jetën e varrezave e cila është ndërmjet këtij dunjallëku të kalueshëm material dhe jetës së ardhme – të amshuar.

## PËRGATITJA PËR VDEKJE

Te njeriu është e mbjellur shpresa e gjatë, e pandërprerë. Kjo, në të vërtetë, është një nga instinktet e saj. Për këtë shkak, edhe pse shqisave tona vdekja i është diç më e afërt, ajo megjithëkëtë është diç më e largët nga ne në mendimet tona. Shohim përcjelljet e të vdekurve se si kalojnë pranë nesh çdo ditë, por ndiejmë se ne do të mbesim. Shkojmë pas xhenazeve, ndërsa mendojmë për dunjallëkun dhe për të bisedojmë. Shikojmë varrezat se si i plotësojnë hapësirat e tokës, e nuk e kujtojmë se edhe ne, një ditë do të bëhemi prej banorëve të tyre. Estagfirullah, përnjëmend, trupat tanë, do të zënë vend në to. E çka janë trupat? Njeriut i përlyhet këmisha, e heq atë dhe e hedh. Foshnja lindet dhe e braktisë shtratin e vet dhe del nga ai. Njeriu vdes, e braktisë trupin e vet dhe e lë. E çka është trupi, nëse jo këmishë, e vesh dhe e zhveshë, e në tokë nuk lihet asgjë tjetër përveç trupit.

Njeriu harron vdekjen, mirëpo, besimtari gjithnjë e përkujton dhe në çdo çast është i gatshëm që ta presë. Përgatitet për të me tevbe – pendim, istigfar – kërkim të faljes dhe kthimin e të drejtave të huaja. Sa herë që të agojë apo errësohet, bën llogari me vetveten, i falënderohet All-llahut xh.sh. për të mirën që e ka udhëzuar dhe i ka ndihmuar, ndërsa kërkon nga Ai falje për të keqen që e ka bërë. E përkujton Ahiretin – botën e ardhme dhe i frikësohet ditës në të cilën fytyrat dhe

shikimet do të jenë të shqetësuara. I frikësohet dënimit pas vdekjes, ndërsa e shpreson shpërblimin, duke u ndihmuar në këtë me sabër - durim, namaz dhe veprimin e së mirës, duke kërkuar kënaqësinë e All-llahut xhile shanuhu dhe duke u kënaqur me atë që është tek Ai.

## ÇASTI I VDEKJES – DËSHMI E BESIMIT

Mendo për fjalët e Të Lartësuarit: “Përse pra, kur arrin shpirti në fyt” dhe vjen çasti i vdekjes nga i cili nuk mund të iket, “e ju në atë moment...” përreth personit – për ju i dashur, i cili është pranë vdekjes “shikoni (se ç’po i ngjet”, duke i shprehur ndjenjat e juaja, e duke kërkuar ndihmën e mjekësisë dhe duke bërë përpjekje, e përqafoni dhe kujdeseni për të, “e Ne jemi më afër te ai se ju, por ju nuk e shihni”, sepse shqisat e juaja ndiejnë vetëm botën e materies, kurse ai vetëm se është në prag të botës tjetër, e cila është pas kësaj bote. “Përse atëherë, nëse nuk jeni nën pushtetin e huaj” – siç mendoni – dhe nuk jeni të varur Zotit të Gjithësisë dhe Pronarit të saj, dhe nëse diç nga kjo është në pushtetin tuaj, “nuk e ktheni atë (shpirtin të mos dalë), nëse të vërtetën e flisni”,-(Vaki’a, 83-87).

Ktheni shpirtin në trup, kur nga ai të ketë dalë. Shërbehuni në këtë me mendjet e juaja, me shkencat e juaja dhe pasuritë e juaja, por nëse nuk jeni në gjendje këtë ta bëni, përse atëherë nuk pranoni se ky kozmos ka Zotin e vet, Zotin, në pushtetin e të Cilit jeni edhe ju, i Cili ju ka ngjallur, i Cili do t’ua marrë shpirtin dhe i Cili pas kësaj përsëri do t’ju ringjallë?

## DYSHIMI I PARËNDËSISHËM

E kam lexuar artikullin e disa ateistëve – pabesimtarëve, në të cilin me përqeshje pyesin e thonë: “Nëse në të njëjtin moment vdes një njeri në Amerikë dhe një tjetër në Kinë, si do t’ua marrë shpirtat e tyre melekui vdekjes...?”.

Përgjigja: 1 – Shembulli i melekut në raport me tokën tonë është si shembulli i njërit nga ne sikur të gjendeshin mbi fole të thneglave ku janë me mijëra thnegla, apo mbi gotën në të cilën gjenden me miliona baktere. Madje edhe më tepër, një melek është më i madh nga kjo në raport me ne, dhe ky lëmsh tokësor në dorën e tij nuk është asgjë tjetër vetëm si një kokërr gruri në dorën e një njeriu...!

2 – Meleku i vdekjes me rastin e marrjes së shpirtave ka ndihmësit e vet. All-llahu xh.sh. thotë: “Kur ndonjërit nga ju i vjen vdekja, të dërguarit Tanë (melaiket), ia marrin shpirtin, duke mos bërë kurrfarë lëshimi”.- (En’am, 61).

## DITA E KIJAMETIT

Besimi në Ditën e Gjykimit – Kijametit është themeli i dytë i besimit islam, dhe vështirë që në Kur’an të përmendet besimi, e që paralel me të të mos përmendet besimi në Ditën e Gjykimit.

Besimtari çdoherë e përkujton Ditën e Gjykimit, kështu që shpesh bën vepra të mira me përmallim për shpërblimin e tij, ndërsa largohet nga e keqja në kufijtë e mundësive të veta, prej frikës nga dënimi i Tij. Nëse para tij paraqitet ndonjë ndalesë, e cila në vete bartë ëmbëlsi dhe kënaqësi, i përkujton vuajtjet e Ahiretit në rast se do ta vepronte, prandaj e braktisë duke hequr dorë nga ëmbëlsia e saj. Ndërsa, nëse ballafaqohet me ndonjë vaxhib – obligim të rëndë, e përkujton shpërblimin e Ahiretit për zbatimin e tij, kështu që e nxitë vetveten në të, duke e zgjuar në vete dëshirën për të. Natën ngrihen nga shtratet që të falin namaz, dhe japin lëmshë në rrugën e All-llahut, edhe kur janë në bollëk edhe kur janë në varfëri. Për ndonjë të mirë ndaj vetes, të tjerëve u japin përparësi, e madje qofshin më të nevojshëm për të. Mendojnë për vështirësitë e dënimit të All-llahut xh.sh., e zemrat e tyre dridhen kur emrin e Tij e dëgjojnë, e pastaj e përkujtojnë mëshirën e Tij ashtu që zemrat e tyre qetësohen, duke gjetur kënaqësi në të kujtuarit e Tij.

## KOHA E DITËS SË GJYKIMIT

All-llahu xhle shanuhu në Kur'an qartë ka thënë se koha e Ditës së Gjykimit nuk i është e njohur askujt nga krijesat, momenti i saj i është i njohur vetëm të Vetmit – All-llahut xhle- shanuhu: “Të pyesin ty (Muhammed) për çastin e Kijametit se kur do të ndodhë ai. Thuaj: “Atë e di vetëm Zoti im, Ai do ta zbulojë në kohën e tij...”,- (Araf, 187). “Siç do të vijë befaz, dhe kur Ai këtë e cakton: “sa çel e mbyll sytë, apo edhe më shpejtë”,- (Nahl, 77).

Mirëpo, në Kur'an thuhet se Ditës së Gjykimit i paraprijnë ngjarje të çuditshme, të cilat do të ndodhin në këtë kozmos. Nga ato ndodhi është edhe dalja e kafshës nga toka e cila njerëzve do t'u flasë. Ky është lajm i vërtetë i cili bën pjesë në gajbin – fshehtësinë, deri te e cili nuk arrihet me mendje njerëzore. Për këtë lajm dimë vetëm aq sa All-llahu xh.sh. na ka lajmëruar, e Ai nuk na ka shpjeguar se çfarë është ajo kafshë, e as çfarë janë cilësitë e saj. Andaj jemi të obliguar të besojmë në këtë dhe ta lëmë çdo bisedë mbi të pa argument të vërtetuar tradicional.

Nga ato ngjarje janë edhe rrënimi i pendës së Je'xhuxhit dhe Me'xhuxhit dhe dalja e tyre nga ajo. All-llahu xhle shanuhu nuk na ka shpjeguar se kush janë Je'xhuxhi dhe Me'xhuxhi, e as cili është ai popull dhe cila është vendlindja e tyre, si dhe ku gjendet penda e tyre. Nëse kemi mundësi që këtë ta konstatojmë me ndihmën e hadithit dhe hulumtimeve, dhe të arrijmë deri te rezultatet të cilat nuk do t'i kundërshtojnë lajmit kur'anor, do t'i pranojmë ato. Në të kundërtën, e vërtetojmë lajmin e Kur'anit, dhe ndalemi në kufijtë e tij. I Lartësuarit thotë: “Dhe të afrohet premtimi i vërtetë, e ai është momenti kur mbeten të shtangur sytë e atyre që nuk besuan...”,- (Enbija, 97).

Përveç këtyre ka edhe gjëra tjera, të cilat transmetohen në hadithet e vërteta, e nuk janë haptazi të përmendura në Kur'an, siç është p.sh.: se dituria do të zhduket, do të paraqitet padituria-xhehli, pastaj pirja e alkoolit, prostitucioni, do të zvogëlohet numri i burrave e do të shtohet numri i grave, se amaneti – besimi do të mbetet gjë e rrallë, dhe se ajo çka ka qenë poshtërsi dhe e pavlerë do të ngrihet – do të fitojë në vlerë, ndërsa ajo çka ka qenë e lartësuar dhe e vlefshme do të bie. Pastaj do të pasojë paraqitja e Dexhxhallit dhe zbritja e Isait alejhis-selam për ta ndihmuar Sheri'atin e Të Dërguarit të fundit, Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve selem.

## FILLIMI I DITËS SË GJYKIMIT

Nga ajetet kur'anore për Ditën e Gjykimit<sup>10</sup>, kuptohet se fillimi i saj do të jetë me dridhje të tmerrshme, e cila nuk u përngjan tërmeteve që i njohin njerëzit. Ajo dridhje do të ndodhë (e All-llahu më së miri e di kur) në kohën kur njerëzit ende jetojnë në tokë, ashtu që shoqërinë njerëzore befas do ta godasin frika dhe ankthi i përgjithshëm. Intensiteti dhe tmerrri i saj do të jetë i tillë sa që nëna do ta lë pas dore foshnjën nga gjiu i vet, edhe krahas mëshirës e dashurisë së madhe ndaj saj – me të cilën Zoti e ka frymëzuar. Shtatzënet nga frika do t'i hedhin frytet (foshnjat) nga barqet e tyre, ndërsa njerëzit mendjen dhe vetëdijen thuajse do ta humbin, andaj do të duken si të dehur. “E ata nuk janë të dehur, por dënimi i All-llahut do të jetë i ashpër.”- (HaxhXH, 2).

Mendimin se kjo dridhje do të ndodhë para Ditës së Kijametit e përforcon edhe ajeti kur'anor: “Kur të dridhet toka me dridhjen e saj të fuqishme dhe të nxjerrë toka atë që ka në brendinë e saj, dhe njeriu të thotë: “Ç’është kjo?” (Zelzele, 1-3). Njeriu pra, atëherë do të jetë në Tokë, do të jetë dëshmitar i kësaj dridhjeje, do të pyetet për të dhe do t'i gjurmojë shkaqet e saj.<sup>11</sup>

---

<sup>10</sup> Në kapitujt e parë të librit kam përdorur mënyrën e të folurit të përgjithshëm, të drejtuar besimtarëve dhe pabesimtarëve duke u mbështetur në të më tepër në argumente racionale sesa në ato tradicionale e kam arritur të degët – shartet e imanit – besimit, dhe kur të folurit – pjesa më e madhe – i është drejtuar besimtarit, kam dhënë bazë në argumente tradicionale dhe e kam përforcuar të argumentuarit me ajete Kur'anore.

<sup>11</sup> Disa dijetarë thonë se ajo do të jetë ringjallja për shkak të fjalëve të All-llahut xh.sh.: “dhe të nxjerrë toka atë që është në brendësi të saj”. Që të dy mendimet janë të mundshme prandaj nuk po e sjell mendimin përfundimtar por them “All-llahu a'lem – All-llahu e di më së miri”

## SHFAQJET E PËRMASAVE KOZMIKE

Dita e Kijametit, ajo që do të ndodhë në këtë ditë, si dhe ajo çka do të vijë më pas, bën pjesë – siç kemi cekur më parë – në gjërat metafizike – gajb. Shqisat nuk kanë pushtet mbi ato, siç kanë pushtet mbi krijesat materiale, e as që mendja njerëzore bie gjykim mbi ato, siç gjykon mbi ndodhitë e kësaj bote. E tërë dituria e tij reduktohet në kuptimin e teksteve dhe të njohurit e domethënieve të tyre.

Në Kur'an gjenden tekste të qarta që tregojnë se shumicën e ligjeve kozmike – që ne profesionalisht i kemi quajtur ligje natyrore-do t'i godasin ndryshimet, transformimet e zëvendësimet, ashtu që sikur ekzistimi dhe qëndrueshmëria e tyre të jetë e kushtëzuar me ekzistimin dhe qëndrueshmërinë e kësaj bote, pra kur të përfundojë periudha e saj, përfundon edhe periudha e këtyre ligjeve.

Sikur, bota të cilën e vështron, me Tokën dhe planetët e saj, me gjithë përsosurinë mrekulluese, të cilën e fsheh në vete, është ndërtesë e përkohshme e ngritur nga shkaqet e caktuara dhe për kohë të caktuar.

Nga ato shfaqje dhe transformime kozmike janë: Se kodrat do t'i godasë dridhja e tmerrshme tokësore, e cila do t'i thërrmojë shkëmbinjtë e saj dhe do t'i bëjë si pambukun e gafruar. Kodrat e mëdha do të agojnë si brigje apo bregore të rërëta. Pastaj do të shndërrohen në pluhur e do të lëvizin sikurse rëra e shkretëtirës, pastaj do të agojnë si fatamorganë dhe e tërë Toka do të shndërrohet në lëndinë të rrafshhtë.

Për gjithë këtë na lajmëron Kur’ani, siç na lajmëron po ashtu, se detet do të derdhen njëri në tjetrin, e mandej do të avullohen. Se nyjet e yjeve do të shkapërderdhen dhe orbitat e tyre do të ndërrohen. Hëna me Diellin do të ndeshen. Qielli nga retë do të pastrohet e do të përçahet, e pastaj do të palohet siç palohen letrat në fletoren e madhe. Pastaj, si rezultat i gjithë kësaj do të jetë që Toka do të ndryshohet sikur të jetë Tokë tjetër, dhe qielli do të ndryshohet sikur të jetë qiell tjetër. Për tërë këtë na lajmëron Kur’ani.

## **FRYERJA NË SUR - BORI**

Ne nuk e dimë se si është në thelb ai sur – boria, e as që dimë mënyrën e të fryerit në të. E tëra ajo që thuhet mbi përshkrimin e tij dhe detajet e tij, nëse nuk është e bazuar në argumentin e saktë tradicional, nuk është e besueshme dhe nuk mbështetet në të. Ajo që ka ardhur në Kur’an është: Se në të do të fryhet e do të tmerrohen gjithë çka ka në qiej e në Tokë, e pastaj përsëri në të do të fryhet e do të vdesin krejt çka ka në qiej e në Tokë. Nga ky mendim është e dukshme se në sur, do të fryhet dy herë, ndërsa e mundshme është – dhe kjo është më e drejtë – se të fryerit, nga i cili do të tmerrohen të gjithë, në të vërtetë është të fryerit nga i cili do të vdesin të gjithë dhe pas kësaj askush gjallë nuk do të mbetet, e nuk do vdesin, “përveç atyre që do All-llahu (të mos vdesin)”,- (Ez – Zumer, 68). Pas kësaj do të kalojë periudha, e cila vetëm All-llahut xh.sh. i është e njohur. Ai për këtë nuk na ka njoftuar, e mandej do t’i fryhet surit dhe do t’i kthehet jeta çdo të vdekuri, e do të ngrihen nga varret e tyre: “E të shikojnë” (Ez-Zumer, 68) dhe “kah Zoti i tyre nxitojnë”,- (Jasin, 51).

## RINGJALLJA DHE HASHRI – TUBIMI

Çdo mejjit – i vdekur do të jetë i ringjallur në gjendjen shpirtërore në të cilën edhe ka vdekur, dhe do të konsideron se nga çasti i vdekjes nuk ka kaluar më shumë se një orë, apo disa orë, ngjashëm me atë, i cili duke blerë, shitur apo biseduar e godet vetura dhe e humbë vetëdijen, duke qëndruar në gjendje të pavetëdijshme tri ditë, e kur të kthjellet e të vjen në vete, vazhdon bisedën apo tregtinë, duke mos ditur se që nga atëherë kanë kaluar tri ditë. Ngjashëm do të jetë me njerëzit në Ditën e Ringjalljes, kështu që feja na mëson që ta lusim All-llahun xh.sh. për përfundim të mirë.

All-llahu xh.sh. njerëzve, shembujt për këtë ua ka paraqitur në këtë botë. Nga ata është shembulli i njeriut i cili ka kaluar pranë fshatit të pabanuar, të rrënuar dhe tha: “Si e ngjallë All-llahu këtë pas shkatërrimit të tij?”, e All-llahu e bëri të vdekur atë (pyetësin) njëqind vjet, pastaj e ringjalli dhe i tha: “Sa qëndrove (i vdekur)? – Një ditë, ose një pjesë të ditës!” – u përgjigj ai. Ai (All-llahu) tha: “Jo, por ke qëndruar (i vdekur) njëqind vjet.”- (Bekare, 259).

Edhe banorët e shpellës – Ehlu-l-kehf – të cilët kanë kaluar në gjumë treqind e nëntë vjet, e pastaj janë zgjuar duke menduar se kanë fjetur vetëm disa orë, dhe e dërguan njërin nga ata për të blerë diçka me të holla, qarkullimi i të cilave kishte pushuar e që këtë ata fare nuk e dinin.

E këtillë do të jetë gjendja e njerëzve në Ditën e Ringjalljes, çdonjëri nga ata do të mendojë se ka fjetur pak dhe është zgjuar, dhe njëri me tjetrin do të kundërshtohen: “Mizorët do të betohen se në varreza kanë qëndruar vetëm një çast të shkurtër... E atyre që u është dhënë dituria dhe besimi do të thonë: “Jo, me të vërtetë, keni qëndruar aq sa ju ka caktuar All-llahu, deri në Ditën e Ringjalljes, e ja kjo është Dita e Ringjalljes, por që ju (këtë) nuk e keni ditur...” (Rrum, 55-56).

Do të mendojnë se ende janë në këtë botë, mirëpo situata e lemeritshme do ta shkëpusë çdo lidhje mes tyre: “Atëherë, në atë ditë nuk do të ketë lidhje familjare mes tyre...”,- (Mu’minun, 101).

Njeriu do ta shohë shokun e vet të dashur e të afërt e nuk do të pyesë për të, e as që do të shfaqë brengosje për të. Çdonjëri do të brengoset vetëm për vetveten. Do të ikë nga vëllai i vet, nga babai dhe nëna, si dhe nga gruaja dhe fëmijët e vet. Aq më tepër, të gjitha do t’i sakrifikonte dhe do t’i ofronte për shpagimin e vet, sikur shpagimi të ishte i pranuar. Kështu do të lihen një kohë (All-llahu xh.sh. e di sa do të zgjasë) që njëri me tjetrin të takohen, e pastaj do të jenë të shpjer në Reëdi- mahsher – vend në të cilin të gjithë do të mbliidhen...! Të gjithë drejt atij vendi do t’ua mbathin këmbëve.

Të gjithë njerëzit, nga Ademi alejhis - selam e deri te pasardhësi i tij i fundit, të cilët në shtrat kanë vdekur, në det janë mbytur, bisha e egër i ka ngrënë, nga aeroplani kanë rënë apo në zjarr janë djegur dhe hiri në ajër u është shpërndarë, të gjithë ata do t’i ringjallë Ai i cili për të parën herë nga asgjëja i krijoi. Të gjithë do t’i tubojë dhe kah Reëdi -mahsheri do të jenë të shpjer, ata, xhinnët, shejtanët dhe kafshët.

“Duke shpejtuar drejt atij që i thërret, e jobesimtarët do të thonë: “Kjo është ditë e vështirë!”,- (Kamer, 8).

Pastaj Zoti ynë do të urdhërojë që të vihet me xhennemin, dhe prej së largu do t’ju paraqitet njerëzve, dhe All-llahu xh.sh. do t’ju thotë: “O bijtë e Ademit, vallë a nuk ju kam urdhëruar: që të mos e adhuronit shejtanin, se ai, me të vërtetë është armik i përbetuar i juaji, por vetëm Mua më adhuronit; Kjo është rrugë e drejtë. Ai (shejtani) me të vërtetë, shumë prej jush në humbje i ka

shpër, e vallë, si nuk keni menduar?! Ky është xhennemi me të cilin keni qenë të kërcënuar...”  
,- (Jasin, 60-63). Dhe do të urdhërojë Zoti ynë, që kriminelët të nxirren e të veçohen dhe do të njihen (dalohen), e çdonjëri nga ata do të dëshirojë që të mos ishte qenie njerëzore e do të thotë: “Çfarë fati sikur të isha dhe!”,- (Nebe’e 40).

Pastaj, All-llahu xh.le shanuhu do t’i tubojë pabesimtarët në Xhennem me xhinnë e shejtanë të cilët – krahas All-llahut – i kanë adhuruar dhe si zota i kanë konsideruar dhe emrat e tyre i kanë imagjinuar, mbi të cilët All-llahu xh.le shanuhu asgjë nuk ka lajmëruar, siç kanë qenë nga grekët: Zeusi dhe Afrodita, te romakët: Jupiteri dhe Venusi, te persianët: Hormuzi dhe Ahrimani; te egjiptianët: Habi; te fenikasit: Bali; dhe Lati e Uzati te arabët, të cilët ata i konsideruan pjesëmarrës të All-llahut, xh.sh. Atyre All-llahu xh.sh. do t’u thotë: “Thirni ata, të cilët i keni konsideruar ortak të Mi – e kur t’i thërrasin, ata nuk do t’u përgjigjen...”,- (Kehf, 31). E mandej do t’u thotë: “Çka keni që nuk e ndihmoni njëri-tjetrin?”,- (Safat, 25).

Të pafuqishëm e të dobët do të shikojnë në ata, të cilët janë kryelartësuar, të cilët veten udhëheqës në dunjallëk e kanë konsideruar, ashtu që popujt e vet në shirk dhe mosbesim i kanë shpër, dhe nga ata do të kërkojnë ndihmë, duke u thënë: “Ne ithtarë të juaj kemi qenë, andaj a mund të na lehtësoni diç nga dënimi i All-llahut?”,- (Ibrahim, 21). Do t’u përgjigjen me refuzim dhe do ta pranojnë dobësinë dhe pafuqinë e vet që atyre apo vetes së paku t’i ndihmojnë. Të gjithë do të qëndrojnë të nënshtruar e të përlulur, pasi që mbetën të imët e shumë të vegjël pranë Zotit. Do të zhduken zotat e imagjinuar, do të jenë të shlyera të gjitha thëniet e rrejtshme e të shpikura, do të shkëputen lidhjen shoqërore – djallëzore në mes të mosbesimtarëve dhe atyre të cilët i kanë adhuruar nga krijesat. Çdokush që ka qenë rrejtshëm i adhuruar, do të heq dorë nga ai që e ka adhuruar. Madje edhe shejtani do t’ua pranojë atyre që e kanë pasuar se i ka gënjer e do

të thotë: “E pasi të kryhet çështja, shejtani do të thotë: “Vërtet, All-llahu ju pat premtuar premtim të vërtetë, e unë ju pata premtuar dhe ja, nuk e zbatova premtimin ndaj jush...!”,- (Ibrahim, 22).

Ai do ta hedhë çdo përgjegjësi nga vetja dhe atë përgjegjësi do ta ngarkojë në ta, duke e pranuar dobësinë dhe pafuqinë e vet në këtë botë, siç do të pranojë se nuk ka pasë fuqi asgjë tjetër, përveç pëshpëritjeve e mashtrimeve, se ka qenë plotësisht i pafuqishëm dhe se nuk ka poseduar fuqi që të sjell dobi apo të dëmtojë.

Do të thotë: “...po unë nuk pata kurrfarë pushteti ndaj jush (që t’ju detyroj), përpos që ju thirra (në rrugë të gabuar), e ju m’u përgjigjët; atëherë pra mos më qortoni mua, po qortone veten...”,- (Ibrahim, 22). “S’ka dyshim se intriga e shejtanit është e dobët”,- (En-Nisa, 76).

## **DHËNIA E LLOGARISË**

Të qëndruarit për shkak të dhënies llogari është i domosdoshëm. Do të jetë i vendosur mizani – peshoja e drejtësisë absolute, e cila nuk do të bëjë lëshime as sa pesha e kokrrës së grurit, sa fija e pluhurit, e as sa një elektron i cili në fushën e atomit qarkullon, e as më pak nga kjo. Të gjitha veprat e njerëzve do të jenë të llogaritura, do të jenë të vlerësuara të gjitha rrethanat, do të tregohen të gjitha qëllimet e mira dhe pendueshmëria e zemrës, e do ta paraqesin peshën në anën e veprave të tij të mira në mizan, siç do të tregohet edhe ajo çka ka në zemrën e tij nga dyfytërsia e hipokrizia, e cila do të paraqesë peshën në veprat e tij të këqija në mizan.

Ky do të jetë gjykimi i drejtë i njeriut, të cilit nuk do t'i bëjë dobi asgjë tjetër, përveç veprave të kryera, faljes së All-llahut xh.sh. dhe mëshirës së Tij, të cilës i shpreson dhe të cilën e dëshiron. Nuk do t'i ndihmojë pasuria, të cilën e ka poseduar, përveç asaj që në emrin e All-llahut xh.sh. dhe në rrugën e Tij e ka shpërndarë, e as që do t'i ndihmojë fama, të cilën e ka pasur, përveç nëse e përdorë në nënshtrueshmëri ndaj All-llahut xh.sh. Askush askujt, aspak nuk do të mund t'i ndihmojë, e as që do të gjejë ndonjëri mbrojtës, që për të të ndërmjetësojë, përveç pas lejimit të Zotit të vet. Ndërsa, ndërmjetësimi – shefa'ati në botën e ardhme nuk është sikur ndërmjetësimi në dunjallëk. Kështu ndërmjetësi në dunjallëk vjen te gjyqtari apo te përgjegjësi, duke i treguar për simpatinë dhe dashurinë e vet ndaj tij, apo për autoritetin e tij te ai, duke e obliguar me këtë që të ndërmjetësojë për të, edhe madje nëse këtë ai në thellësi të zemrës nuk e dëshiron, e ia plotëson dëshirën punëtorit, apo e liron të akuzuarin. Mirëpo, sa i përket ndërmjetësimit dhe angazhimit – shefa'atit në Ahiret, ai do të jetë atëherë kur Zoti ynë, me mëshirën e vet, do të dëshirojë që ndokujt t'ia falë, ndërsa me fisnikërinë e Tij ndokujt dëshiron t'i shprehë nderim, ashtu që e bën shkaktar të dukshëm të faljes dhe i lejon që të ndërmjetësojë për të, e këtë ai e bën me lejen dhe caktimin e Tij.

## DËSHMITARËT DHE DËSHMITË

Gjykatat e kësaj bote me të cilat udhëheqin njerëzit, disponojnë me drejtësi të përkufizuar – njerëzore, dhe me metoda të dukshme, të kufizuara të vërtetimit të të dhënave. Ndërsa, sa u përket proceseve të Ahiretut, gjykatës i tyre është Zoti i të gjitha krijesave, drejtësia në to është

absolute për çdokënd, ndërsa argumentet në to janë të dëshmuarit e pejgamberëve, melaiKET (engjëjt), të cilët i kanë numëruar veprat, duke shënuar të mirën dhe të keqen, suhufet (fletushkat) në të cilat mbahen shënimet, si dhe pranimi i mëkatarëve dhe dëshmimi i gjymtyrëve – organeve trupore.

## **TË DËSHMUARIT E PEJGAMBERËVE**

Kur të ndodhë dita e dhënies së llogarive do të sjellen pejgamberët, siç thotë I Lartësuari: “...dhe Libri do të vihet pranë dhe sillen pejgamberët e dëshmitarët.” - (Zumer, 69).

Çdo populli do t’i gjykohe sipas ligjit – Sheri’atit të tij dhe në praninë e Pejgamberit të tij: “Dhe (atë ditë) e sheh secilin popull të gjunjëzuar; secili popull thirret sipas librit të vet...”,- (Xhathije, 28). “Dhe si do të jetë gjendja e atyre (që nuk besuan), kur Ne do të sjellim dëshmitarë nga çdo popull, e ty (Muhammed) do të sjellim dëshmitar kundër tyre?”,- (Nisa, 41).

## **LIBRAT DHE SUHUFET – FLETUSHKAT**

Këto suhufe, në të cilat shënohen të gjitha veprat tona në këtë botë, do të jenë të paluara dhe të fshehura, fshehtësi të cilën nuk do ta dijë askush nga krijesat. E nëse robi – njeriu pendohet për

mëkate që janë të shënuara në të – me pendim të sigurtë, do të shtyhen. Në të kundërtën, nëse nuk pendohet, do të mbeten në to, e kur të vijë Dita e Gjykimit të llogarive, suhufet do të hapen e do të shpallet ajo që gjendet në to, sikurse rezultatet e provimeve shkollore, që janë fshehtësi të nxënësit, në familjen dhe në mesin e shokëve të tij, ashtu që nuk dihet për atë i cili ka ngelur. Mirëpo, këtu turpi dhe poshtërsia do të jenë dëshmi e të gjitha krijesave, e ky është turpi dhe poshtërimi më i madh. Ai, i cili këtu bie nga provimi, do të bie në xhennem, do ta humbë – nëse është pabesimtar – fatin e amshueshëm dhe do të ballafaqohet me dënimin e përhershëm. Suhufet do të jenë të hapura dhe të shpërndara, dhe çdo njeri do ta marrë librin e vet të hapur, dhe do t'i thuhet: “Lexo librin tënd, mjafton të jesh sot llogaritës i vetvetes”.- (Isra, 14). E nëse veprat e mira, të cilat i ka shënuar meleku në anën e djathtë t'i jenë më shumë, libri do t'i jepet në dorën e djathtë, si lajm përgëzues se “lehtë do të japë llogari”. (Inshikak, 8) Kur ta shohë se çka ka në të, do të gëzohet e ngazëlletet, siç gëzohet nxënësi i cili sheh rezultatet e provimit dhe kupton se ka kaluar, duke dëshiruar t'i lajmërojë për suksesin e vet vëllezërit e shokët, duke thënë: “Ja, lexoni librin tim, unë kam qenë i bindur (në dunjallëk) se do ta paraqes llogarinë time.” (Hakka, 19-20).

Ndërsa ai, te i cili veprat e këqija, të cilat i ka shënuar meleku në anën e majtë, janë më shumë, libri i veprave do t'i jepet në dorën e majtë, ashtu që do ta vajtojë veten, duke u bindur në shkatërrimin e vet, e do të thotë: “O i mjeri unë, të mos më jepej fare libri im, dhe mos të kisha ditur për llogarinë time! Ah, sikur të kishte qenë ajo (vdekja e parë) mbarim i amshueshëm për mua – pasuria ime nuk më solli dobi dhe falimento i fuqia ime.”- (Hakka, 25-29). “...e atij të cilit libri i tij i jepet pas shpine, shkatërrimin do ta dëshirojë, dhe në zjarr do të digjet.”- (Muxhadele, 6).

Kriminelët do t'i lexojnë librat e veta e do të shohin se çdo vepër e bërë në të është shënuar, All-llahu për to llogari ka bërë, e ata këtë e kanë harruar, e të habitur do të thonë: “Të mjerët ne, ç’është puna e këtij libri që nuk ka lënë as (mëkat) të vogël e as të madh pa e përfshirë?”, dhe atë që vepruan e gjejnë të gatshme – prezente.”- (Kehf, 49), Do të binden thellë se vetvetes padrejtësi i kanë bërë. “Zoti yt nuk i bën padrejt askujt”.- (Kehf, 49). Dhe do të pendohen për atë që ka kaluar, pasi që i kanë pasuar pëshpëritjet e shejtanit dhe kënaqësitë e shpirtit kah e keqja dhe për këtë shkak do ta urrejnë vetveten, kur do t’u thuhet: “...do të thirren: “Urrejtja e All-llahut ndaj jush është më e madhe se urrejtja juaj ndaj vetvetes, kur keni qenë të thirrur në besim, por keni mohuar.”- (Mu’min, 110).

## **MBROJTJA E PASTAJ PRANIMI**

Kur pabesimtarët japin llogari do të kërkojnë shpëtim, duke mohuar e përgënjeshtuar dhe rrejshëm do të betohen se janë të pafajshëm, duke menduar se janë para gjykatësit nga njerëzit të cilët disponojnë vetëm me atë që është e jashtme dhe e dukshme, e duke harruar se janë para Zotit, të Cilit i është e njohur ajo që gjendet në shpirtin, dhe i Cili di çka zemrat fshehin. “Ata do t’i betohen Atij, sikurse u betoheshin juve”,- (Muxhadele, 18). “Pasha All-llahun, Zotin tonë, ne askënd nuk e kemi konsideruar të barabartë me All-llahun!”,- (En’am, 23). E All-llahu xh.sh. do t’ua lidhë gjuhët e tyre dhe do t’ua ndalojë të flasin, e do t’i urdhërojë gjymtyrët e tyre, me të cilat kanë bërë haramë – vepra të ndaluara, e ato do ta pranojnë atë që e kanë bërë. Do të flasë dora duke e pranuar atë nga harami që ka bërë, e do të flas këmba duke i pranuar haramet nga të cilat

ka shkuar. “Sot Ne ua mbyllim gojët atyre, Neve na flasin duart e tyre, kurse këmbët e tyre dëshmojnë për atë që punuan...”- (Jasin, 65).

E kur pranimi i gjymtyrëve kundër tyre të jetë marrë, dhe të vërtetohet se kanë qenë mëkatarë, ata do t'i qortojnë gjymtyrët e veta: “Përse dëshmoni kundër nesh?”,- u thonë lëkurave të tyre. “ All-llahu na ka bërë që të flasim – ashtu siç i ka dhënë aftësinë e të folurit çdo sendi,- do të përgjigjen!”- (Fussilet, 21).

Këta në dunjallëk janë fshehur – që veprat e shëmtuara t'i bëjnë, edhe pse shohim se si spikeri në ekranin televiziv është në dhomë të rrethuar me mure e me dyer të mbyllura, e që përtej këtyre e shohin me miliona njerëz, e dëgjojnë fjalimin e tij dhe dëshmojnë kundër tij. E nëse këtë njerëzit kanë arritur që ta bëjnë në këtë botë, çfarë është, atëherë pra, dituria e All-llahut xh.sh. dhe qërimi i hesapeve nga Ai në Ahiret? Për këtë shkak Zoti i tyre do t'i qortojë duke u thënë: “Ju nuk jeni fshehur (nga frika), që kundër jush të mos dëshmojnë veshët tuaj, sytë tuaj dhe lëkura juaj...” (Fussilet, 22). E si të ikë njeriu nga lëkura e vet, sytë dhe veshët e vet, kur ato janë me të, në të? – “...por, ngase keni besuar se All-llahu nuk do t'i dijë shumë nga ato që i keni punuar. Dhe kjo bindje e juaj, që keni pasur në Zotin tuaj, ju ka shkatërruar juve, e u bëtë prej atyre që janë në humbje.” - (Fussilet, 22-23).

Ky është fundi i çdo pabesimtari në All-llahun, xh.sh., i atij i cili mohon Ditën e Gjykimit, shikimi i të cilit nuk arrin më larg se nga kjo botë dhe i cili mohon jetën e ardhme, e ajo, pa dyshim, do të vijë. I fsheh mëkatet e veta nga All-llahu xh.sh. e Ai e sheh. Gjymtyrët e tij, me të cilat i bën mëkatet, kundër tij do të dëshmojnë. E si të fshehet nga dëshmitarët, e ai është me ta, dhe nuk

është në gjendje që nga ata të ndahet. Zoti ynë, na mëshiro, na i falë dhe na i mbulo mëkatet tona në Ahiret, siç na i ke mbuluar në këtë botë. Ti je Ai që falë dhe të metat i mbulon.

## VËREJTJA E PARËNDËSISHME

Një grup njerëzish, derisa kemi qenë të vegjël, me ironi na thoshin: “Si do të flasin dora dhe këmba e nuk kanë gjuhë, e as nuk posedojnë mundësinë e të folurit?!”. Pastaj më vonë janë zbuluar aparatet për xhirim dhe filmat me ton, dhe filluan të montohen nëpër banka aparatet e fshehta për xhirim, aparatet të cilat xhirojnë me ndihmën e rrezeve të padukshme<sup>12</sup> dhe të cilat aktivizohen me vetë kalimin e personit pranë tyre. Ashtu që kur hajni vjedh diçka e këtë e mohon, i tregohet filmi i cili i rikthen të gjitha lëvizjet dhe pushimet e shkurtra, pëshpëritjen e tij me vetveten si dhe bisedën me bashkëpunëtorin. Kështu, këto zbulime bashkëkohore janë bërë argumente kundër këtyre injorantëve mendjemëdhenj, të cilat sikur u thonë: “Mjerë për ju, Ai i cili ka bërë që shiriti të flasë në këtë botë dhe ka xhiruar lëvizjet dhe fjalët të cilat nxjerrin në shesh bisedën e fshehtë të hajnave, duke dëshmuar kundër tyre veprën, të cilën e mohojnë... Ai që e ka bërë këtë në botë, po a nuk është në gjendje ta bëjë që dora e këmba të fillojnë të flasin në Ahiret, në botën e ardhme?”

---

<sup>12</sup> Këto janë të ashtuquajturat rreze ultra të kuqe.

## DHËNIA E LLOGARISË DHE REZULTATET E SAJ

Llogaria do jetë shumëllojëshe: Llogaria e lehtë – është llogaria e atyre që librat e tyre do t’u jepen në dorën e djathtë, dhe llogaritë e rënda, si llogaria e fshatit i cili nuk ia vuri veshin urdhrat të Zotit të vet. Ngjashëm, siç do të paraqiten njerëzit në grupe, pas përfundimit të rezultateve të llogarisë, të parët që All-llahut xh.sh. do t’i jenë të afërt, të lumturit dhe të pafatët.

“E nëse është nga ata prej të afërmyve të All-llahut – ai ka kënaqësi, furnizim të mirë dhe kopshte të xhennetit në të! E nëse është nga ata të lumturit, pra, përshëndetje ty nga ata që janë të lumtur (i thuhet)! E nëse është nga ata që kanë përgënjeshtuar dhe në mashtrime kanë mbetur, pra, ata me ujë të valë do të gostiten, dhe djegie në zjarr të xhehennemit. E s’ka dyshim, e gjithë kjo është vërtet e sigurt, - andaj lavdëroje emrin e Zotit tënd të Madhërueshëm!”,- (Vak’ā, 89-96).

## KALIMI MBI XHEHENNEM

Të gjithë njerëzit do të ndeshen me Urën e Siratit, e cila do të jetë e vendosur përmbi Xhehennem, duke shpejtuar me rastin e kalimit përtej saj në përpjesëtim me afërsinë e tyre me All-llahun xh.sh., dhe shumësinë e veprave të mira, e që nga ai do të shpëtojnë të devotshmit, e do të bien në të mizorët. I Lartësuarit thotë: “Dhe nuk ka asnjë prej jush që nuk do t’i afrohet atij. Ky është vendim i kryer i Zotit tënd. Pastaj, do t’i shpëtojmë ata që ishin ruajtur (prej mëkateve), e zullumçarët do t’i lëmë aty të gjunjëzuar.” - (Merjem, 71-72) Në suren “Tekathur” i Lartësuarit

thotë: “Xhehennemin do ta shihni qartë!, e edhe një herë, me të vërtetë qartë do ta shihni!”- (Tekathur, 6-7).

Sa i përket të pamurit të parë: ajo është – e All-llahu xh.sh. më së miri e di – kalimi i të devotshmëve mbi Xhehennemin, i cili do të jetë i përcjellur me shpëtimin e tyre nga ai, dhe të pamurit e dytë: kalimi i mizorëve përmbi Xhehennem dhe rënia e tyre në të. E është e mundshme që të pamurit e parë do të jetë para dhënies së llogarisë, kur Xhehennemi do të paraqitet ashtu që njerëzit do ta shohin, siç e kemi përmendur këtë më parë.

## **XHENNETI DHE XHEHENNEMI**

Përshkrimi i Xhennetit që ceket në Kur’an, si fjalët e Të Lartësuarit:

“...nëpër të cilat do të të rrjedhin lumenj”,- (Bekare, 25), se banorët e tij me bylyzykë të artë dhe të argjendte do të stolisen, rrobat në të nga mëndafshi do t’u jenë, se në të ka lumenj nga qumështi, vera dhe mjalti, dhe se në të do të shërbejnë hyritë me sy të mëdhenj.

E tëra kjo është cekur për shkak të kuptimit më të lehtë, sepse gjuhët njerëzore – në thelb – janë të vendosura për të shprehurit për sendet e kësaj bote. Pa dyshim dihet se lumenjtë e Xhennetit nuk janë si këto të dunjallëkut, as qumështi, mjalti e vera e tyre nuk janë sikurse qumështi, vera dhe mjalti i kësaj bote, as hyritë e Xhennetit sikurse gratë e dunjallëkut, e as shërbëtorët e Xhennetit sikurse shërbëtorët në këtë botë. Po t’u ktheheshim parimeve apo premisave të cilat i

kemi theksuar në fillim të këtij libri, e ato ishin “PARIMET E BESIMIT”, do të shihnim se imagjinata njerëzore është e paaftë që ta kuptojë Xhennetin apo që ta paraqesë realitetin e tij.

Ata mufessirë (komentues të Kur’anit) të cilët në detaje e kanë paraqitur përshkrimin e Xhennetit, në këtë nuk janë mbështetur në argumente, dhe përpjekja e tyre e fundit ka qenë që Ahiretin e kanë krahasuar me dunjallëkun, siç e kanë krahasuar apologetët – mutekeliminët – drejtësinë e All-llahut xh.sh. dhe atributet e Tij me atributet njerëzore të cilat i kanë të njohura, dhe me drejtësinë njerëzore, ashtu që kanë bredhur në situata absurde e në mashtrime, nga të cilat do t’i shpëtonte dhe do t’i largonte ndalja në nass – tekst, pasimi i rrugës së paraardhësve dhe të pranuarit e paaftësisë së mendjes për ta njohur Xhennetin dhe paaftësisë së imagjinatës për ta përshkruar atë.

Ndër këto studime të gabuara dhe diskutime të pafrytshme është edhe ajo që e kanë thënë për hyritë symëdha, dhe se kënaqësia me to është sikurse kënaqësia me gratë e dunjallëkut, duke harruar se kënaqësisë në mënyrë të njohur të kësaj bote – qëllim i tyre është shtatzënia dhe pasardhësit<sup>13</sup>, e nuk ka nevojë për tërë këtë në Ahiret – botën e ardhme. Prandaj, rruga e drejtë është të besojmë në tërë atë çka transmetohet në Kur’an, e pastaj t’i përkushtohemi leximit të asaj që do të na shpie deri në Xhennet, në vend të diskutimeve për detajet e tij dhe polemikave rreth përshkrimit të realitetit të asaj që gjendet në te, nga ajo që nuk e përmend Kur’ani.

---

<sup>13</sup> Sikur njeriu i logjikshëm (i matur) të mendonte mbi ato kënaqësi, do ta konsideronte të neveritshme siç edhe do të ishte i gërditshëm vendi i saj. Mirëpo, All-llahu xh.sh. ka krijuar epshin që e pengon këtë të menduar, siç ka krijuar anestetikun që të pengojë ndjenjën e dhembjes me rastin e intervenimit kirurgjik.

## HYRJA NË XHENNET

Hyrja në Xhennet nuk do të jetë nëpërmes shpresave dhe dëshirave, por me anë të besimit dhe nënshtrimit. “Puna nuk qëndron ashtu, as sipas dëshirës suaj, e as sipas dëshirës së Ithtarëve të Librit. Por është, se kushdo që të bëjë një të keqe, do të ndëshkohet për të...”,- (En-Nisa, 123). “A mos menduat ju se do të hyni në Xhennet e All-llahu pa i treguar (pa u vërtetuar në praktikë) se cilët prej jush kanë luftuar, dhe pa ju treguar cilët prej jush ishin të durueshëm (qëndrueshëm)?”,- (Ali Imran, 142). Kështu, besimtari që do të hyjë në Xhennet do të jetë ai që ka bërë mirë, duke e thirrur All-llahun xh.sh. ka investuar mundin në rrugën e lartësimit të Fjalës së All-llahut xhla-shanuhu, duke punuar në të me trup, me pasuri e me gjuhë, ashtu që të jetë njëri nga ata që kanë luftuar (xhahedu). E nëse për këtë nuk ka mundësi, është i obliguar që – së paku – të mos u nënshtrohet ndikimeve të keqes dhe pasimit të thirrjes së saj, ta shpëtojë veten dhe familjen e tij, dhe me durim ta përballojë atë që e godet në rrugën e lojalitetit ndaj fesë, ashtu që të jetë njëri nga ata që kanë qenë durimtarë (saberu).

E pasi që ta përfundojë llogarinë dhe besimtari të kalojë përtej Urës së Siratit, do të realizohet suksesi i dëshiruar: “E ata që ishin të devotshëm ndaj Zotit të tyre, do të sillen në grupe të Xhennetit, e kur të arrijnë aty – dyert e tij i gjejnë të hapura<sup>14</sup> dhe roja e tij u thotë atyre: “Selamun

---

<sup>14</sup> Derisa në ajetin e cili flet mbi Xhehennemin thuhet: “...e kur të arrijnë te ai, dyert e tij do të hapen” (Ez-Zumer, 71), sepse Xhehennemi sikurse burgu, dyert e të cilit janë të mbyllura dhe nuk hapen përveç me rastin e hyrjes dhe daljes nga ai. Ndërsa këtu sa i përket kësaj – në rastin e Xhennetit thuhet: “dyert e tij

alejkum – qofshi të shpëtuar, ishit të pastër, andaj hyni në të, aty do të jeni përgjithmonë”. E ata do të thonë: “Falënderuar qoftë All-llahu, i cili premtimin e Vet e bëri realitet ndaj nesh dhe na dhuroi vend në Xhennet, që të vendosemi aty ku të duam!” Sa shpërblim i mirë është i atyre që vepruan drejt”,- (Ez-Zumer, 73-74).

## **PËRSHKRIMI I XHENNETIT**

Sa i përket gjerësisë së tij, ajo është si gjerësia e qiejve dhe e Tokës. Dhe mos u habitni prej kësaj, sepse Ahireti është, në raport me këtë botë, si kjo botë në raport me barkun e nënës. A nuk konsideron foshnja në brendinë e nënës se barku i saj është tërë bota e tij? A nuk është ndonjëra nga shtëpitë e dunjallëkut me mija herë më e gjerë se bota e foshnjës në barkun e nënës?

Ky është Xhenneti, i cili është i përgatitur për të devotshmit – të cilët i janë frikësuar All-llahut xh.sh. E kush janë këta të devotshëm për të cilët është përgatitur Xhenneti? Dhe çka është ajo që kanë punuar, që edhe ne ta bëjmë atë e që të jemi me ta? All-llahu xh.sh., ka shpjeguar se të devotshmit janë ata: “...të cilët japin lëmoshë kur janë në bollëk, e edhe kur janë në vështirësi, të cilët e frenojnë zemërimin dhe që u falin (fajet) njerëzve... edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë

---

i gjejnë të hapura”, sepse dyert e Xhennetit përherë janë të hapura, edhe pse askush në të nuk do të hyjë pos me lejën e Zotit – Krijuesit të tij.

(mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetes së tyre, e kujtojnë All-llahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre...”,- (Ali Imran, 134-135).

Këto janë disa cilësi të të devotshëmve, e kush stoliset me to, pas besimit të drejtë dhe dëshmimit të sinqertë të njëshmërisë së All-llahut xh.sh. – teuhidit, All-llahu xh.sh. me fisnikërinë dhe bamirësinë e Vet do t’i vendosë në këtë Xhennet, të cilin ua ka përgatitur.

Në Xhennet ka shumë shkallë. Në të është Xhenneti i begative – dëfrimeve, i cili nuk i është i arritshëm çdokujt: “E që çdonjëri prej tyre dëshiron të hyjë në Xhennetin e dhuntive (pa merita)?”,- (Mearixh, 38). Ai është për ata të cilët kanë prirë me besim, e do të prijnë edhe në Xhennet. “Ata pra, janë më të afruarit (te Zoti), Janë në Xhennetin e begatshëm”.- (Vakia, 11-12).

Në të është kopshti, të cilin All-llahu xh.sh. e quan dhomë (Gurfetu). Atë ua ka premtuar robërve të Të Mëshirshmit, i Cili, në suren “ Furkan” këta i ka përshkruar si ata të cilët i kanë bashkuar besimin e drejtë, sjelljen e ndershme, ibadetet e shumta dhe moralin e lartë. Kjo tregon se dhomat janë gradë e lartë në Xhennet, me të cilat All-llahu xh.sh. i ka nderuar ata të cilët i kanë përmbledhur në vete cilësitë e përsosurisë, me durim kanë bartur barrën e arritjes së tyre dhe largimit të shpirtit nga dëshirat. Zoti ynë po ashtu na ka treguar se në Xhennet ka “...kopshte, vreshta të larta dhe të shtruara për dhe..”,- (En’am 141). Në të është vendi i cili quhet: Xhennetu-l-Me’va – pushimorja e Xhennetit, vendi i cili quhet: Xhennatu’Adn - kopshtet e Adnit, dhe se ai i cili qëndrimin pranë Zotit të vet i është frikësuar, dy kopshte do t’i ketë, e jo një, dhe se në të është ajo që Ai e ka quajtur ilijun. E tërë kjo na tregon se kënaqësitë e Xhennetit do të jenë shumëshkallëshe, dhe se banorët e tij do të jenë në pozita të ndryshme.

## BANORËT E XHENNETIT DHE GJENDJA E TYRE

Do të takohen banorët e Xhennetit me vëllezërit e tyre dhe familjen: “Hyni në Xhennet, ju dhe gratë tuaja, të gëzuar”.- (Ez-Zuhruf, 70). “Ata dhe gratë e tyre janë në hije (flade), të mbështetur në kolltuqe të stolisura”. - (Jasin, 56). “...Atyre që kanë besuar dhe u shkojnë pas pasardhësit e tyre në besim, do t’ua bashkojmë pasardhësit e tyre.”- (Et-Tur, 21). Do të takohen me dashuri e sinqeritet: “Nga gjoksi i tyre urrejtjen do ta largojmë...! Do të radhiten shtretërit dhe divanet (kanapetë) dhe në to do të ulen. Ata janë të mbështetur në divane të renditura...”,- (Et – Tur), 20). “...ata do të rrinë ulur si vëllezër në kanape – njëri përballë tjetrit.” - (Hixhr, 47). Në to është pëlhura nga diç shumë e vleshme, Zoti ynë e ka quajtur “istebrek” (mëndafsh i qëndisur me ar), ndërsa ata janë të rrethuar nga dy kopshte, frytet e të cilave janë afër duarve të tyre, plotësisht të afuara. Në to do të shërbejnë shërbëtoret e reja: “...në mesin e tyre lëvizin shërbëtoret si të ishin margaritarë të ruajtur.” - (Tur, 24). “Aty do të kërkojnë çfarë pemësh të dëshirojnë.”- (Duhan, 55). “Do të shërbehen me pije nga burimi që do të rrjedhë gjithmonë, i kthjellët e i shijshëm për ata që do ta pijnë. Prej saj nuk ka dhembje koke, e as që do të dehen nga ajo.” (Saffat, 45 – 47). Ushqimi do t’u shërbehet:”... në enët nga ari...”- (Zuhruf, 71), e do të jenë të shërbyer me pije “në gota, ibrikë e kupa të mbushura plot pije nga burimi rrjedhës.”- (Vak’u, 18). Do t’u sillen nga ushqimi çka të dëshirojnë: “Dhe pemë të cilat do t’i zgjedhin vetë. Dhe mish shpezësh, çfarë ju ka ëndja... Do të jenë në mes të lëkoneve (lloj druri) pa gjemba, dhe bananeve me fruta palë-palë. Dhe në freskinë e gjerë, pranë ujit rrjedhës dhe mes pemëve të llojllojshme, të cilat kurrë nuk harxhohen, as nuk janë të ndaluara (për t’i marrë), edhe në shtrojat e ngritura”,- (Vakia, 20-34), “...ata në të as vapë as të ftohtë nuk do të ndiejnë. Dhe afër, freskia e tij do t’u jetë, ndërsa frytet

e tij afër duarve do t'i kenë...". "...në fytyrat e tyre do të shihet gëzimi i jetës së lumtur." Fytyrat e tyre janë të gëzuara, me mundin e tyre të kënaqura."

Do të shëtisin në cilën pjesë të duan të Xhenetit, duke u takuar e biseduar: "Përshëndetja e tyre në të është selam – paqe". Nuk do të flasin përveç asaj që është e mirë: "Ata kanë qenë të frymëzuar të flasin fjalë të bukura...",- (Haxhxh, 24). Dhe do t'i gëzohen njëri - tjetrit e do ta pyesin njëri - tjetrin: "Ne, më parë – në familjet tona jemi frikësuar (nga dënimi), e All-llahu na ka dhuruar mëshirë dhe na ka ruajtur prej dënimit të erës (flakës) së nxehtë të zjarrit".- (Tur, 25-27). E ky është fryti i duasë dhe istigfarit: "Ne, më parë (në jetën e dunjallëkut) e kemi lutur Atë, Ai me të vërtetë është bamirës dhe mëshirues.",- (Tur, 28). Kur të bisedojnë do t'ju kujtohen në bisedat e veta ditët e dunjallëkut, gjendja e banorëve të tij, pozitat e tyre në dunjallëk dhe ajo se ku kanë përfunduar në Ahiret: "Dhe njëri prej tyre do të thotë: "Unë kam pasur një shok (mohues), i cili thoshte (me ironi e përbuzje): Vallë edhe ti je nga ata që besojnë, që kur të vdesim e të bëhemi dhë e eshtra, me të vërtetë do të japin llogari?"",- (Saffat, 51-53). Do t'u thotë ai (besimtari – vëllezërve të vet në Xhennet): "A doni t'i shikoni ata?", d.m.th. banorët e Xhehennemit, t'i shikoni në Xhehennem?. Kjo na bën të kuptojmë se do të kenë mundësi t'i shikojnë. "Dhe ai shikon dhe e vëren atë (shokun e vet pabesimtar) në mes të Xhehennemit". Do t'i thotë (kjo na tregon në atë se banorët e Xhenetit dhe Xhehennemit do t'i shkëmbejnë fjalët): "Pasha All-llahun, për pak të më mashtroje edhe mua! Dhe po të mos ishte dhuntia e Zotit tim, edhe unë do të isha bashkë me ty në zjarr",- (Saffat, 54-56).

Zoti i tyre do t'u dhurojë hyri e do t'i martojë me to: "Në to (Xhennete) ka edhe huri (të bukura) symëdha, të ngjashme me margaritarin në guaska të ruajtur."- (Vakî'a, 22-23). Ato i krijoi me formë të re dhe i bëri: "...ato virgjëresha të dashura për bashkëshortët e tyre, dhe moshatare me

ta...”,- (Vaki’a, 36-37). “...ato që përqëndrojnë shikimet e tyre (vetëm në burrat e vet), të cilat nuk i ka prekur kush para tyre, as njerëz as xhinn”,- (Er-Rrahman, 56). “Lutja e tyre në to (Xhennete) është: “Qofsh i lavdëruar o All-llah!”, përsëritja e tyre: “Selam (paqe juve)!”, dhe lutja e fundit e tyre: “Falënderimi i qoftë All-lahut, Zotit të botëve!” (Junus, 10).

Ata thonë: “...falënderojmë All-llahun që na udhëzoi në rrugë të drejtë; ne nuk do të ishim të udhëzuar sikur të mos na udhëzonte All-llahu. Me të vërtetë, të dërguarit e Zotit tonë na e kanë sjellë të vërtetën”, dhe atyre u drejtohet thirrja: “Ky është Xhenneti që u është dhënë në trashëgim, për atë që keni punuar!” (A’raf, 43).

“Aty nuk i godet kurrfarë lodhje dhe nuk do të nxirren kurrë prej tij”,- (Hixhr, 48). “Aty nuk do ta shijojnë vdekjen, përveç asaj të parës në këtë botë.” (Ed-Duhan, 56). “Dhe melaiket (engjëjt) do të hyjnë tek ata nga çdo derë”,- (Er-R’ad, 23) – i përsëritës duke u thënë: “Shpëtimi qoftë mbi ju, meqë keni qenë të durueshëm, e sa përfundim i bukur është ky vend”,- (R’ad, 24). “Aty do të kenë çka t’u dojë shpirti, dhe me çka kënaqet syri.”- (Zuhruf, 71). “Kjo, me të vërtetë do të jetë sukses i madh. Për diçka të tillë, le të angazhohen vepruesit (punëtorët)”,- (Saffat, 60-61). “E për shpërblim të tillë le të garojnë ata që lakmojnë të mirën”.- Mutaffifin, 26).

O Zoti ynë, me mëshirën Tënde e cila përfshin çdo gjë, me faljen Tënde, e Ti je i mëshirshëm dhe falë, na shpëto prej dënimit të Xhehennemit dhe na fut në Xhennet të gëzuar e të qetë.

## XHEHENNEMI

Ajo, që më së pari na bie ndër mend, është mendimi se zjarri i Xhehennemit është si ky i kësaj bote, vetëm se më i ashpër nga ky, madje nuk mund të matet me të nga vrulli i tij i furishëm, por megjithëkëtë e përfytyrojmë si të të njëjtit lloj. Mirëpo, kush e studion më thellë përshkrimin e tij në Kur'an, do të konstatojë se ai është i llojit tjetër. Sepse, po të ishte i të njëjtit lloj, si ky i dunjallëkut, të tërat do t'i digjte dhe do t'i shndërronte në hi. E në Xhehennem ka drurë, ujë, hije edhe pse hija e tij, uji dhe drutë janë për vuajtje, e jo për kënaqje. Zjarri i dunjallëkut e djegë atë i cili futet në të ashtu që vdes e me këtë përfundon edhe dhembja e tij. Ndërsa zjarri i Xhehennemit (kërkojmë tek All-llahu, xh.sh. mbrojtje prej tij), është dhembje e përherhme e banorëve të tij. “Ata nuk do të dënohen (me vdekje), dhe nuk do të vdesin, dhe as që do t’u lehtësohet dënimi në të”,- (Fatir, 36). Ai nuk djeg lëkurën ashtu që ta shkatërrojë, por e djegë mirë dhe sa herë që lëkura t’u digjet – All-llahu xh.sh. ua ndërron me lëkura të tjera, ashtu që përsëri ta shijojnë dënimin. Pronarët e tyre jetojnë, duke medituar, rikujtohen e grinden mes veti. Në Xhehennem ka drurë, por ai është druri “Zekum” i cili: “...mbin në fund të Xhehennetit. Pema (fryti) e saj është sikurse koka e shejtanëve”,- (Safat, 64-65). Në Xhehennem ka ushqim, banorët e tij hanë, por hanë frytet e këtij druri të neveritshëm: “...dhe do t’i mbushin barqet prej saj”. (Saffat, 66). “Pema “Zekum” do të jetë ushqim i mëkatarëve, vlon si katrani i shkrirë në barqet, ashtu si vlon uji i valë”.- (Duhanë, 43-45) Në të ka pije, ujë, por ai është ujë i qelbëzuar, të cilin do ta pijë pabesimtari: “Përpiqet ta përbijë, por nuk mund ta gëlltis atë”,- (Ibrahim, 17). Kur të hanë nga kjo pemë do të pinë pas kësaj ujin e vluar, këtë ujë të cilin Kur’ani e ka përshkruar, dhe nga etja e madhe do të pijnë siç pi deveja e etshme, e pastaj në kokat e tyre do të derdhet ky ujë i

vluar: “Që me atë u shkrihet krejt çka ka në barqet e tyre, e edhe lëkurat”,- (HaxhXH, 20). Në të ka rroba, por ato janë nga zjarri: “Atyre që nuk besuan, u qepen rroba prej zjarri” (HaxhXH, 19).

Në të ka hije, por ajo është nga zjarri: “Mbi ta dhe nën ta do të ketë shtresa të zjarrit...”,- (Zumer, 16). “Dhe në hijen e tymit të zi, në të cilën nuk do të ketë freski as kurrfarë të mire”,- (Vakia, 43-44). Ky është vendbanim i atij i cili i ka dhënë përparësi dunjallëkut në epshet e tij, i cili ka qenë i qëndrueshëm në përgënjeshttrimin e ringjalljes: “Ata, para kësaj (në këtë botë), kanë jetuar në lukse, dhe me këmbëngulje bënë mëkate të rënda. Dhe thonin: “Vallë, pasi të vdesim e të bëhemi tokë e eshtra, a me të vërtetë do të ringjallemi?!”,- (Vakia’ 45-47). “...aty ata kanë dihatje e kërhamzë të vështirë (në frymëmarrje); aty janë përgjithmonë, sa të jenë qiejt e toka, përveç nëse ndryshe e cakton Zoti yt. Vërtet, Zoti yt punon atë që dëshiron”,- (Hud, 106-107).

## HYRJA NË ZJARR

Kur të përfundojë llogaria dhe t’u vërtetohet dënimi i premtuar pabesimtarëve, ata do të jenë të sjellur në Xhehennem grupe-grupe. Vetë Xhehennemi do të zemërohet e do të vajtojë nga mosbesimi i tyre, qëndrueshmërinë në të dhe për mospasimin e rrugës së Pejgamberit të Zotit të tyre. Rojtarët e Xhehennemit habiten shumë me marrinë dhe kokëfortësinë e tyre, ashtu që i pyesin: “Nga zemërimi, ai (Xhehennemi) gati copëtohet. Sa herë që hidhet në të ndonjë turmë, roja i pyet: “A nuk u erdhi askush t’ua tërheq vërejtjen juve?”,- (Mulk, 8). E atyre u mbetet vetëm të pranojnë: “Po”,- përgjigjen ata,- gjithsesi na ka ardhur neve përkujtuesi, por ne i kemi mohuar

ata dhe kemi thënë: “All-llahu nuk ka shpallur asgjë”.- (Mulk, 9). E melaiket në këtë u thonë: “Ju jeni në humbje të madhe!”.

Ata do të pranojnë se kanë qenë të shurdhër, se e kanë eliminuar mendjen e vet, e nuk kanë menduar, sepse po t’i kishin dëgjuar këshillat e të mendonin për vete dhe atë që është rreth tyre, do të vinin të përfundim se All-llahu xh.sh. ekziston, do të besonin e do t’i pasonin pejgamberët dhe nuk do të hynin në Xhehennem. Do të thonë: “Sikur të kishim dëgjuar ose menduar, nuk do të ishim ndër banuesit e zjarrit”,- (Mulk, 10).

## **XHEHENNEMI ËSHTË BURG**

Xhehennemi: “Ka shtatë dyer.”- (Hixhr, 44). Banorët e tij do të jenë të ndarë në to: “...dhe përmes çdonjëres, numër i caktuar i tyre do të hyjnë.” - (Hixhr, 44). Ai është i mbyllur me shula shumë të mëdhenj, si shtylla: “Ai (zjarri) do të jetë i mbyllur mbi ta (si saç), në shtylla të gjata flakëruese.”- (Humeze, 8-9).

Hudhen në të përmes grykës: “Me duar të lidhura”,- (Furkan, 13) – njëri me tjetrin të lidhur. E All-llahu xh.sh. vetëm se u ka përgatitur: “...zinxhirë e pranga, dhe zjarr të madh”. (Dehër, 4).

## TENTIMET E DALJES

All-llahu, xh.sh. e ka vendosur njeriun në Tokë për një periudhë të caktuar kohore, i ka dhënë mendjen me të cilën zgjedh çka dëshiron dhe vullnetin me të cilin realizon atë që e zgjedh. Një pjesë e njerëzve ka zgjedhur rrugën e cila shpie në Xhehennem, dhe ka punuar atë që shpie kah ai, e pasi të kenë arritur në të kanë filluar me përpjekje për dalje nga Xhehennemi dhe premtimeve se, po qe se rikthehen në dunjallëk, do të besojnë e do të jenë të ndershëm. Mendojnë se ai është si provimi i dunjallëkut, kush bie nga provimi në një xhiro, mund të ketë sukses në tjetrën. Nuk dinë se, ai i cili del nga dunjallëku nuk kthehet më, e kush të hyjë në zjarr nuk del më prej tij (ata të cilët vdesin si mosbesimtarë). Është vërtetuar fjala e All-llahut xh.sh.: “E, Ne ua dërguam atyre Librin, të cilin ua kemi shpjeguar gjerësisht, që të jetë udhërrëfyes dhe mëshirë për njerëzit që besojnë. A mos vallë ata presin realizimin konkret të Tij? E, kur t’u vijë ajo që e presin (premtimin dhe dënimin), do të thonë për atë që e kanë harruar më parë: “Pejgamberët e Zotit tonë na kanë sjellë të vërtetën! A ka ndonjë ndërmjetës që angazhohet për ne, apo të kthehemi (në këtë jetë), e që të punojmë dryshe siç kemi punuar!”- (A’raf, 52-53). “Do t’i shohish zullumqarët që, kur ta përjetojnë dënimin, do të thërrasin: “A ka ndonjë mënyrë për rikthim (në dunja)?”,- (Esh-Shura, 44). “Ata, në të, do të thërrasin (duke vajtuar): “O Zoti ynë, nxirrna (prej zjarrit), do të bëjmë vepra të mira, e jo asosh çfarë kemi bërë.”- (Fatir, 37). Do të marrin përgjigje kategorike: “Po a nuk u dhamë juve jetë aq sa, që ai që ka dashur të mendojë, ka mundur të mendojë gjatë asaj kohe, madje juve ju ka ardhur edhe ai, i cili ua ka tërhequr vërejtjen? Andaj, shijoni dënimin, për zullumqarët nuk ka ndonjë ndihmëtar!”- (Fatir, 37).

Do të kërkojnë mbrojtje te rojat e Xhehennemit, siç kërkon i burgosuri mbrojtje te roja e burgut, duke menduar se ata mund t'u sjellin ndonjë dobi, apo t'u largojnë nga ata ndonjë dëm, e do t'u thonë: "...rojeve të Xhehennemit: "Luteni Zotin tuaj që të na lehtësojë dënimin, (madje) qoftë vetëm një ditë!". "A nuk u patën ardhë juve të dërguarit tuaj me argumente të qarta?" – do të pyesin ata. "Po!" – do të përgjigjen – "Lutjuni pra ju!" – do t'ju thonë ata. Por lutja e atyre që nuk kanë besuar e kotë do të jetë".- (Mu'min, 49-50). Kur ta humbin çdo shpresë në ta, do t'i drejtohen Malikut, udhëheqësit të rojave të Xhehennemit: "Do të thërrasin: "O Malik, le të na shkatërrojë Zoti yt. "Do të marrin përgjigje të vendosur, kategorike: "Ju mbeteni këtu". Do të mendojnë që të shpaguehen siç janë shpagueur në dunjallëk me pasuri, por e kotë është kjo: "E sikur të ishte e atyre që nuk besuan, e tërë ajo çka ka në tokë e edhe një herë aq, do ta jepnin kompensim për t'i shpëtuar dënimin të tmerrshëm në Ditën e Gjykimit; e All-llahu do t'i dënojë me dënim çfarë nuk kanë mundur as ta parandiejnë. Do t'ju prezentohen veprat e tyre të këqija që i kanë punuar dhe i përfshinë ata mu ajo me të cilën talleshin."- (Zumer, 47-48).

Këto përpjekje dhe manovrimet e tyre asgjë nuk iu bëjnë dobi, mbeten në Xhehennem: "E me kamxhik të hekurt do të rrahen: sa herë që përpiqen të dalin prej tij nga vuajtjet e padurueshme, kthehen me dhunë në të përsëri..."- (Haxh, 21-22). Do t'u thuhet: "Shijoni vuajtjen me djegie të tmerrshme!" - (Haxh, 22).

## BISEDAT E TYRE DHE GRINDJET

Banorët e Xhennetit janë vëllezër, në divane të kthyera kah njëri-tjetri, nga zemrat e tyre është nxjerrë urrejtja, janë të udhëzuar me fjalë të bukura, në bisedat e tyre nuk ka fjalë boshe, gënjeshtër e mëkat. Ndërsa banorët e Xhehennemit grinden dhe polemizojnë: “Sa herë që një grup hyn në të, e mallkon atë të mëparshmin derisa kur të arrijnë në të të gjithë, grupi i fundit thotë për grupin e parë: “Zoti ynë, këta (paria) na kanë humbur neve (nga rruga e drejtë) pra shtojau dënimin me zjarr atyre!”. (All-llahu) Thotë: “Për secilin (grup) është (dënim) i shtuar, por ju nuk po e dini. Ndërsa të parët e tyre (paria) të mbramëve të tyre ju thonë: “Ju nuk keni përparësi ndaj nesh (pse vetë keni bërë kufër), shijone pra dënimin për atë që e fituat!”,- (A’raf, 38-39). “Ky grumbull së bashku me ju duke u shtyrë në Xhehennem do të hynë!” – Mos paçin komoditet e as mirëseardhje! Ata vërtet do të digjen në zjarr!” . “Jo, juve mos u qoftë as mirëseardhja, e sa vendqëndrim i keq është ky.”. “O Zoti ynë, – ata thonë – atyre që na e përgatitën këtë, dyfishojau dënimin në zjarr!”. E do të thonë: “Ç’është që nuk po i shohim disa njerëz që ne i konsideronim prej të këqijve e që i kemi pas marrë ata në tallje? A mos na u kanë larguar prej shikimit?” Ky është, me të vërtetë, polemizimi i banorëve të Xhehennemit mes veti”.- (Sad, 59-64). “Atëherë pabesimtarët do të thonë: “O Zoti ynë, na i trego ata prej xhinnëve dhe njerëzve, që na kanë shpënë në humbje, që t’i shkelim me këmbët tona dhe le të jenë prej më të poshtërve (në zjarr).”- (Fussilet, 29).

## DIALOGU NDËRMJET BANORËVE TË XHENNETIT DHE XHEHENNEMIT

Më parë veç është përmendur ajo që na udhëzon në atë se banorët e Xhennetit do të mund t'i shohin banorët e Xhehennemit. Në Kur'an theksohet se ata do ta thërrasin njëri-tjetrin e do të bisedojnë: “Ata të Xhennetit i thërrasin banorët e zjarrit e u thonë: “Ne e gjetëm të vërtetë atë që na e pat premtuar Zoti ynë, e ju, a e gjetët edhe ju të vërtetë atë me çka Zoti juaj ju është kërcënuar juve?”. “Po” – do të përgjigjen. Atëherë në mes tyre thërret një zë: “Mallkimi i Allahut qoftë mbi zullumqarët...! Dhe banorët e zjarrit do t'i thërrasin (e t'i lusin) ata të Xhennetit: “Na derdhni pak ujë në ne, apo diçka nga ajo që ua ka dhuruar All-llahu!”,- e ata do të thonë: “All-llahu i ka ndaluar që të dyja këto për jobesimtarët, të cilët fenë e tyre e morën tallje e lojë dhe të cilët i mashtroi jeta e dunjasë...”,- (A'raf, 44, 50-51).

### A'RAF – BEDENET

Ajo çka kuptohet nga ajeti është se “A'raf” është vend ndërmjet Xhennetit e Xhehennemit ku do të qëndrojë një kohë të caktuar ai, veprat e të cilit do të jenë të pakta për të hyrë në Xhennet, ndërsa mëkatet nuk janë aq të mëdha që të hyjë në zjarr të Xhehennemit. E shohin nga ky vend Xhennetin, e dëshirojnë hyrjen në të dhe bisedojnë me banorët e tij, e shohin edhe zjarrin, kërkojnë nga All-llahu xh.sh. mbrojtje prej tij dhe bisedojnë me banorët e tij. E ndërmjet tyre

(banorëve të Xhennetit dhe Xhehennemit) është muri (bedeni): “...e mbi bedene janë njerëz të cilët do ta njohin secilin (të Xhennetit dhe Xhehennemit) sipas shenjave të tyre. Ata i thërrasin banorët e Xhennetit: “Paqja qoftë mbi ju!” – derisa ende nuk kanë hyrë në të, e mezi presin (hyrjen në të). “E kur t’u kthehet shikimi kah banorët e zjarrit, thonë: “O Zoti ynë, mos na bëj neve të jemi me mizorët!”,- (A’raf, 46-47).

Do t’i shohin në Xhehennem njerëzit të cilët i njohin, që kanë qenë zullumqarë në Tokë, janë krenuar me pasuesit dhe turmën e cila i ka përkrahur, ashtu që janë lavdëruar e mburrur me këtë. Do t’i thërrasin e t’u thonë: “Çka ju vleu grumbullimi juaj (në pasuri e numër) dhe ajo që u sollët me mendjemadhësi?” (A’raf, 48). Do të shohin atë ditë se ajo asgjë nuk u ndihmoi, as që ua pakësoi dënimin, se tërë atë e lanë pas shpine, se me të vdekurit në varr nuk zbresin as shoku e as miku, as bashkëpunëtori, as aleati, as ushtria, as ndihmësit. Të gjithë e lënë dhe e braktisin. Zbret në varr vet, do të jetë i ringjallur vet dhe shkon për të dhënë llogari vet. Kjo është e vërteta e qartë, por sytë janë të verbër që këtë ta shohin, mendjet të errësuar që ta njohin këtë. O Zot, na i hap sytë tanë që t’i shohim të vërtetat dhe argumentet të cilat udhëzojnë në Ty, na ndriço mendjet tona që ta dallojmë Rrugën që shpie te Ti, na largo prej sprovave e fitneve, të dukshme e të padukshme, na dhuro kënaqësinë Tënde dhe Xhennetin, e na shpëto nga hidhërimi Yt dhe zjarri, o Ti i cili je shumë i mëshirshëm dhe i cili falë shumë.

## BESIMI NË KADERIN - CAKTIMIN E ZOTIT DOMETHËNIA E KADERIT DHE KADASË

Nga ajetet ku përmendet kaderi, janë:

“Ne çdo send e kemi krijuar me masë të caktuar”,- (Kamer, 49), “...e bëri që në të – të krijohen shumë begati, dhe u caktoi në të (të gjithëve) furnizimin e tyre...”,- (Fussilet, 10). “Edhe Hënës ia kemi caktuar pozitat...”,- (Jasin, 39) “...dhe i cili ka krijuar çdo gjë, e i ka rregulluar si duhet ato!”,- (Furkan, 2). “...tek Ai çdo send është me masë të caktuar”,- (Rra’d, 8).

Kuptojmë se kaderi është ligjshmëri në gjithësinë-kozmosin dhe sistemi me të cilin e ka rregulluar All-llahu xh.sh. E tëra në të është krijuar në përpjesëtim të caktuar. Nuk ka asnjë krijesë, e që para krijimit të tij të mos i jetë caktuar madhësia e tij, numri i atomeve, sasia e elementeve nga të cilat është i përbërë, lloji i tyre, bashkimi apo ndarja, lëvizja apo moslëvizja, e tërë kjo është e caktuar paraekzistencialisht. Do ta shpjegoj dallimin ndërmjet kaderit dhe kadasë me shembullin: “Ndërsa All-llahut i takon shembulli më i lartë”,- (Nahl, 60).

Në ndërtesat të cilat janë duke u ngritur, vëhet pllaka ku shkruan: Projektuesi, inxhinieri..., realizuesi i punëve, ndërmarrësi...! Inxhinieri vizaton planin, cakton lartësinë e ndërtesës, trashësinë e mureve, materialet që do të përdoren, përqindjen e çdonjërit nga ato, pastaj ku do të jenë dyert, dritaret. Ky është shembulli i kaderit. Ndërmarrësi e realizon atë që e ka caktuar inxhinieri. Ky është shembulli i kadasë. Edhe njëra edhe tjetra janë ekskluzivisht në kompetencë të All-llahut xh.sh. Dhe sikurse që inxhinieri mundet, nëse don, të bëjë ndryshime në detajet e planit, ashtu edhe All-llahu xh.sh. nga mëshira e Tij e ka bërë duanë (lutjen) dhe sadakanë

shkaktare të largimit apo heqjes së asaj që ka qenë e caktuar. I vetmi Ai e ka caktuar dhe i vetmi Ai, nëse dëshiron, e largon përmes duasë.<sup>15</sup>

## **SHPËRBLIMI DHE DËNIMI**

Këtë që e përmenda më parë është domethënia e përgjithshme e kaderit. Ai përfshinë çdo qenie të cilën All-llahu xh.sh. e ka krijuar. Ai ka caktuar masat dhe gjendjet, dhe e di se ç'do të bëhet me to (krijesat). Një nga këto krijesa të All-llahut xh.sh. është edhe njeriu. Këtu imponohet problemi për të cilin është debatuar gjerë e gjatë, e kjo është çështja e shpërblimit dhe dënimit. Nëse krejt çka ndodh në kozmos është e caktuar dhe e njohur tek All-llahu xh.sh. që më parë, dhe nëse ligjet e All-llahut xh.sh. janë të pandryshuara, atëherë si të jetë atje shpërblimi dhe dënimi? Përgjigjja e përgjithshme në këtë është, se duhet të bëhet dallimi në mes të pozitës së dukshme dhe të prekshme të njeriut, dhe në mes të attributeve dhe veprave të All-llahut xh.sh. që janë të

---

<sup>15</sup> Sikur njeriu të ishte paraekzistencialisht i detyruar në tërë atë që vepron dhe sikur në këtë të mos kishte mundësi të zgjedhjes, atëherë nuk do të ishte i arsyeshëm dërgimi i peygamberëve, xhahadi, duaja. E duanë e kanë bërë të gjithë peygamberët, hulefaur-rashidinët dhe njerëzit e mirë të të gjithë popujve, duke kërkuar largimin e së keqes dhe fitimin e të mirave. Kam parë te dijetari i shquar, shejhu Muhammed en-Nesifi (All-llahu e mëshiroftë) veprën në dorëshkrim nga Shevkaniu në këtë kuptim. Diçka ngjashëm mbi këtë temë është shkruar.

padukshme, dhe të cilat mendja nuk mund t'i kuptojë e as që mbi to të sjell gjykime dhe për të cilat di vetëm ate çka ka ardhur përmes Shpalljes – Vahjit.

## **NJERIU KA ZGJEDHJE**

Tani do të flas për gjendjen ekzistuese, të dukshme të njeriut e pas kësaj do të flas për tekstet kur'anore dhe të hadithit. Është fakt se njeriu ka liri. Ka mendjen me të cilën mund t'i gjykojë-vlerësojë gjërat materiale, ta dallojë të mirën nga e keqja, të drejtën nga e padrejta. Ka vullnetin me të cilin mund të veprojë mirë dhe keq. Çdo njeri i mençur kupton se namazi është i mirë, ndërsa se zinaja (kurvëria) është e keqe. Çdonjëri ka mundësi, që kur të dalë nga shtëpia të shkojë në të djathtë, në xhami që të falet, apo të shkojë në të majtë, në shtëpinë publike e të bëjë zina.

A dyshon ndonjëri në këtë? Nëse dora ime është e shëndoshë, mund që ta ngris. A ka ndokush nga njerëzit e të thotë se nuk mund ta ngris dorën time? E nëse e ngris dorën time dhe i jap të varfërit një dinar, apo e ngris që ta godas të pafajshmin me shkop, a janë këto dy veprime të njëjta? A nuk është dhënia të varfërit bamirësi e cila meriton shpërblimin, ndërsa goditja e njeriut të pafajshëm, vepër e keqe e cila meriton dënimin? Nxënësi mund t'i kalojë netët para provimit në lojë e zbavitje, kur mund që t'i plotësojë me mësim e përpjekje, a nuk është kështu? E pra atëherë, a ka mundësi ndonjëri të pohojë se mossuksesi i përtacit është padrejtësi, apo që suksesi i të zellshmit është favorizim?

## **NJERIU ËSHTË I DETERMINUAR**

Kam mundur ta lëviz dorën me vullnetin tim, sepse All-llahu xh.sh. m’i ka bërë muskujt e dorës të nënshtruar, por nuk mund t’i dirigjoj muskujt e zemrës e të lukthit. Nxënësi p.sh. mund të jetë mendjemprehtë, që një herë ta lexojë mësimin e ta mbajë mend, e pastaj zbavitet në lojë, ndërsa edhe mund të jetë kokëtrashë, mëson ditë e natë e krahas kësaj asgjë nuk kupton, e nuk mbanë mend. Mund të jetë i lindur në shtëpi (familje) të qetë, që babai të jetë i ditur, e i ndihmon në mësim, ndërsa mund të ndodhë të jetë i lindur në një shtëpi zhurmagjinjsh, nga babai i paditur e grindavec, e kjo i pengon në mësim. Nuk mund t’i dhurojë vetes intelekt, nuk mund t’i zgjedhë vetes prindërit, as kohën në të cilën do të lindet, e as rrethin e shëndoshë në të cilin do të kalojë fëmijëria e tij. Të gjitha këto gjëra njeriu nuk i posedon, sikur që nuk posedon mundësi të bëhet më i bukur, më i gjatë. Ai nga kjo anë është i determinuar.

## **NJERIU ËSHTË I LIRË DHE KA MUNDËSI ZGJEDHJEJE NË KUFIJTË E FUQISË NJERËZORE**

Njeriu është i lirë dhe ka mundësi të zgjedhjes në kufijtë e aftësisë e fuqisë njerëzore, ndërsa ajo se në disa gjëra është i detyruar, nuk e mohon veçorinë e lirisë të ai. Ta marrim për shembull automobilin dhe shkëmbin. Askush nuk kundërshton se automobili mund të lëvizë në kufijtë e fuqisë së motorit të tij, qëndrueshmërisë së tij. Automjeti transportues nuk mund të lëvizë me

shpejtësinë e automobilit garues. Nëse është i konstruktuar që të shkojë për toke, nuk mund të kërkohet nga ai që të ngjitet shkallëve, apo ta shpërthejë murin e të depërtojë përtej tij. Nëse ndonjë pengesë i del në rrugë dhe ia pengon lëvizjen, me këtë nuk e ka humbur vetinë e aftësisë së lëvizjes. Ai nuk është sikur shkëmbi. Ngjashëm edhe njeriu gjatë jetës së tij ndeshet me pengesa të shumta, të cilat e paralizojnë vullnetin e tij, e ndryshojnë drejtimin e tij, në të ndikojnë gjërat të cilave nuk mund t'u shmanget e as t'i ndryshojë. Por kjo nuk e konton lirinë e tij. Ai pra është i lirë, punon sipas vullnetit të vet në suaza të kufijve njerëzorë, e nuk është Zot që të punon ç'të dojë.

## **SHPËRBLIMI DHE DËNIMI JANË TË LIDHURA ME LIRINË**

Shpërblimi dhe dënimi janë të kushtëzuar dhe nëse nuk ka liri nuk ka as dënim. Kush është i detyruar që të bëjë keq, nuk dënohet për këtë shkak. All-llahu xh.sh. na dënon vetëm për atë që kemi mundësi ta zgjedhim, ta bëjmë apo ta lëmë. Njeriut i takon shpërblimi për atë që e bënë (mirë), por edhe dënimi për atë që e gabon.

All-llahu xh.sh. nuk e ngarkon asnjë person përtej aftësisë së tij, dhe nuk lë pas dore asgjë pa marrë parasysh se sa është e imët. Nëse gjykatat njerëzore me drejtësinë e tyre relative i vlerësojnë rrethanat e të akuzuarit, motivet e tij, rrethin e gatishmërinë, dhe ti e konsideron këtë vlerësim të drejtë, atëherë pra a merren këto parasysh gjatë gjykimit të Zotit të botëve, i Cili paraqet drejtësinë absolute? A dënohet mëkatari që është edukuar nga prindër mospërfillës, në rrethin e

degjeneruar, ku ka pasur fëmijë të lënë pas dore e pa përkujdesje prindërore, sikur ai i cili e ka bërë të njëjtin mëkat, por është rritur në rreth më të shëndoshë e më të mirë dhe është fëmijë i prindërve më të kujdesshëm?

## **PESHOJAT E DREJTËSISË**

Shumica e akaidologëve e kanë bërë gabimin më të madh duke e përdorur masën e drejtësisë njerëzore në All-llahun xh.sh. E kam vërejtur këtë duke iu falënderuar ngjarjes, e cila më ka ndodhur personalisht mua, e të cilën tani do ta theksoj me qëllim të marrjes së shembullit e mësimi, ndonëse ky libër nuk është vend për përmendjen e saj.

Në vitin 1931 isha mësimdhënës në shkollën fillore në Siri. Kam qenë në moshën më të mirë të rinisë, në kokë kisha ide të ndryshme, në shpirt iluzione, në gjuhë deklarata dhe entuziazëm. Dhe m'u paraqitën dyshimet në çështjen e kaderit. I pyeta për këtë dijetarët, por nuk gjeta te ata përgjigje të kënaqshme. Fundja, edhe kryelartësia më kanë nxitur të polemizoj me ta. Dhe një ditë në shkollë desha ta edukoj një nxënës me shkop (në atë kohë goditja me shkop ka qenë një nga mënyrat e edukimit). Përnjëherë nxënësi shpërtheu me një nervozizëm të pakontrolluar dhe filloi të bërtasë: “Ky është zullum, ti je mizor!!” Më besoni, kur e dëgjova këtë, shkopi më ra nga dora, e harrova nxënësin dhe shkollën, ndjeva sikur të isha në errësirë, e filloi të më shndrisë kandili i fortë dhe i thashë vetes: “Nxënësi, që e godita me shkop, këtë e konsideron dhunë, ndërsa unë këtë e konsideroj drejtësi, mbase veprimi është një”. Dhe kur të shkojë në shtëpi e t'u ankohet

prindërve, ata do t'i thonë: “Jo, nuk është dhunë kjo, por është e drejtë. Ai të bie për të mirën tënde!” Dhe nëse nxënësi nuk ka të drejtë ta përdorë kriterin e vet joobjektiv në drejtësinë e mësuesit, atëherë si unë t'i përdori kriteret e mia njerëzore dhe peshojat e drejtësisë në All-llahun xh.sh. A nuk është e mundshme që aktin, të cilin e konsideroj tirani, të jetë pikërisht drejtësi?

Fëmija i sëmurë, injeksionin që e merr nga mjeku e konsideron si tirani, ndërsa sipas mendimit të babait të tij, kjo është drejtësi. Sepse, fëmija shikon në dhembjen që e shkakton ai, ndërsa i ati shikon në ndikimin e tij për shërimin e fëmijës. Gjykatësi nuk mund ta marrë vendimin në procedurë derisa të mos i njeh të gjitha detajet dhe ngjarjet e lidhura për atë rast. Ne në të shumtën e rasteve kuptojmë vetëm pjesën e realitetit dhe sjellim gjykime të gabuara pas hulumtimeve jo të plota. Sikur ta zëmë se me ndonjë rast keni bredhur me shokun tuaj në shkretëtirë, e pas ecjes së gjatë kalon aty pari automobili luksoz dhe ju merr me vete, ndërsa shoku yt e nxjerr thikën dhe e gris lëkurën e ulëses, a nuk do ta konsideroni tirani këtë veprim të tij? Pa dyshim që kjo është tirani. Por, sikur ta dije se para teje pret banda e kriminelëve të cilët marrin çdo automobil në gjendje të rregullt, ndërsa heqin dorë nga ata automobila me ulëse të grisura, a nuk do të shndërrohej në sytë e tu akti i shokut tënd nga tirania në drejtësi? Edhe vetë pronari i automobilit po ta dinte këtë fakt do t'i griste ulëset, sepse më tepër ka dëshirë t'i mbetet automobili me ulëse të grisura, se sa ta humbë atë në gjendje të rregullt. A nuk është kjo korrektësi?

Ky është tregimi i Hidrit dhe Musait a.s. kur kanë hipur në anije dhe kur Hidri e shpoi atë. All-llahu xh.sh. na e ka paraqitur si shembull nga i cili kuptojmë se nuk duhet të ngutemi me sjelljen e gjykimeve dhe marrjen e vendimeve, para se t'i shqyrtojmë dhe kuptojmë gjërat.

## TEKSTET NGA KUR'ANI DHE HADITHI MBI KADERIN

Para se të filloj të flas për këto tekste, është e domosdoshme që t'i kemi ndër mend rregullat vijuese:

1. Fushëveprimi i mendjes reduktohet në perceptimin e teksteve (ajetet, hadithet) dhe nuk mund vetvetiu ta kuptojë të vërtetën e kaderit detajisht dhe në të gjitha elementet e tij, sepse mendja, siç kemi thënë, është e paaftë të depërtojë në botën metafizike. Prandaj duhet t'u shmangemi temave e fushave, të cilat nuk i ka shpjeguar nassi (teksti); se:
2. Kur'ani është baza dhe nëse vjen hadithi ahad në kontradiktë me ajetin, e nuk mund të arrihet harmonizimi midis tyre në mënyrë të pranueshme, e marrim ajetin dhe punojmë sipas tij;<sup>16</sup>
3. Është e pamundur që në Kur'an apo hadith sahih të ketë tekst të qartë, i cili mohon ekzistimin e gjësëdit të dukshëm, të prekshëm, sepse Ai i cili e ka shpallur Kur'anin, e ka krijuar realitetin, e All-llahu xh.sh. nuk e mohon atë që e ka krijuar;
4. Shumë tekste nga të cilat kuptohet predestinimi dhe profetizimi i zgjedhjes së njeriut, siç janë ajetet: “Ai ju formon juve në mitër, ashtu si don Ai”,- (Ali-Imran, 6)

---

<sup>16</sup> Është rregull e njohur te dijetarët e terminologjisë së hadithit se Resulull-llahu a.s. nuk flet në kontradiktë me Kur'anin e as atë që i kundërvihet realitetit. E nëse transmetohet nga ai hadith kontradiktor me Kur'anin, apo me realitetin që është i dukshëm, konstatojmë se Pejgamberi a.s. nuk e ka thënë atë edhe në qoftë se senedi është i saktë.

Dhe fëmija që është formuar në gjininë femërore nuk mundet veten ta bëjë mashkull, e as zezaku nuk mund ta bëjë lëkurën e vet të bardhë.

“Dhe Zoti yt krijon ç’të dojë dhe Ai zgjedh; e ata nuk mund të zgjedhin”,- (Kasas, 68).

Pastaj ajetet të cilat tregojnë për ndodhitë kozmike, të cilat janë mbi forcën njerëzore: “A e shihni atë që po e mbillni? A mos ju jepni që prej saj të mbijë (bima), apo Ne japim që të mbijë ajo? Nëse duam Ne, do ta thërrojmë atë (bimën)...”,- (Vakia, 63-65). “Nëse nga All-llahu të godet ndonjë fatkeqësi, atëherë përveç Tij s’ka kush që e largon atë...” , - (En’am, 17).

Pastaj ajetet që i tregojnë rrethanat që shpiten në shpirtdëlirësi apo çorodi, e nuk janë vepër njerëzore: “Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë! Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij.”- (Shems, 7-8).

Pastaj ajetet në të cilat vjen fjala “udhëzim” në kuptimin e të drejtuarit dhe të treguarit: “Ne ia treguam atij rrugën, e ai (do të jetë) ose mirënjohës ose përbuzës”,- (Dehër, 3). “Dhe i sqaruam atij për të dy rrugët”,- (Beled, 10).

Shumica e këtyre ajeteve, siç i kuptoj unë, na i bëjnë me dije gjërat që pjesërisht ndikojnë në shpirtdëlirësinë apo çorodinë e njeriut, e nuk janë vepër e tij.

Kam theksuar se All-llahu xh.sh. nuk e dënon njeriun për këtë. Dhe është e pamundur që All-llahu xh.sh. ta detyrojë njeriun në diç të tillë, që të mos mund t’i ikë asaj, e pastaj ta dënojë për këtë. Këto janë ajetet në të cilat janë ndalur pasuesit e sekteve devijuese – të humbura, që shtrembët i kanë kuptuar dhe gabimisht i kanë përdorur. E është dashur që:

1. Ta bëjnë dallimin ndërmjet ajeteve që flasin për vullnetin, fuqinë, pushtetin dhe udhëheqjen e All-llahut xh.sh., dhe ajeteve që flasin për shpërblimin dhe dënimin.

2. T'i marrin parasysh të dy grupet e ajeteve, e jo të ndalen te një grup. Kush e ka shqyrtuar shumicën e këtyre ajeteve, ka parë se Kur'ani konfirmon lirinë dhe vullnetin e njeriut, në të cilat ndërtohet (fitohet) shpërblimi dhe dënimi. Kur i lexon fjalët e Të Lartësuarit:

“All-llahu shumicën e shpie në humbje, e shumë i udhëzon në rrugë të drejtë”,- (Bekare, 26), në momentin e parë nga to kupton se udhëzimi e humbja janë gjëra të caktuara, të cilat All-llahu xh.sh. ua ka përcaktuar njerëzve, e i ka bërë këta të humbur, ndërsa ata të udhëzuar. Por, nëse tërheq vëmendjen në fjalët e Të Lartësuarit:

“Është udhëzues për të devotshmit”,- (Bekare, 2), “Ai me këtë e shpie në humbje vetëm (njeriun) të poshtrin”,- (Bekare, 26) do të shohë që udhëzimi dhe humbja nuk do të thonë detyrim nga ana e All-llahut xh.sh., por që ato janë përcjellëse të gjendjes së njeriut. Pra, nëse është i devotshëm, Kur'ani i është udhëzimit, e nëse është njeri i degjeneruar, do ta shpie në humbje. Edhe pas gjithë kësaj mbetet dyshimi, andaj bashkëbiseduesi thotë: “Kush do të më tregojë nga të cilët All-llahu xh.sh. më ka bërë, nga të devotshmit, apo nga të këqijtë?”. Por, nëse shikon në fjalët e All-llahut xh.sh.:

“Është udhëzues për ata që janë të devotshëm. Të cilët e besojnë të fshehtë (të padukshmen), e falin namazin dhe prej asaj që Ne u kemi dhënë, ata japin...”,- (Bekare, 2-3). “...me përjashtim të të këqijve, të cilët e thyen besën e dhënë All-llahut, pasi që është lidhur ajo dhe ndërprejnë atë që i ka urdhëruar All-llahu për ta mbrojtur, e edhe bëjnë ngatërresa në Tokë...”,- (Bekare, 26-27), do të kuptojë se në këtë çështje nuk ka detyrim, e se ajo u kthehet veçorive dhe veprave brenda

suazave të lirisë njerëzore e forcës së tij. Ti mund të besosh në të padukshmen-gajb, ta falish namazin, të shpenzosh në rrugën e All-llahut xh.sh., por edhe mund ta shkelish obligimin, ta këpusish atë që duhet ta bashkosh dhe të bësh ngatërresa në Tokë. Këto janë gjëra, kryerja ose moskryerja e të cilave është në fuqinë tënde. Nëse i ke kryer tri gjërat e para, ti je nga ata të devotshmit dhe e ke merituar udhëzimin, ndërsa nëse i ke kryer tri gjërat tjera, ti je nga ata të këqijtë dhe e ke merituar humbjen.

## **DISKUTIMI I PAFRYTSHËM**

Këtu shtrohet pyetja: A e kam bërë të keqen me vullnetin e All-llahut xh.sh. apo jo? A kam mundur të mos e bëj? A jemi të krijuar edhe unë edhe vepra ime? Literatura skolastike është përplot me pyetje të tilla dhe diskutime rreth tyre. Të gjitha ato janë diskutime të pafrytshme, sepse Krijuesi nuk matet sipas krijesave, ndërsa mendja nuk mund të sjell gjykime për All-llahun xh.sh. dhe atributet e Tij. All-llahu xh.sh. nuk i përgjigjet askujt për atë që punon, ndërsa ne do të na pyesë për veprat tona. Ai është i Drejtë, nuk ka dyshim në drejtësinë e Tij. Për ne më mirë është ta shikojmë vetveten, që në mënyrë të drejtë e të dobishme t'i shfrytëzojmë mendjet tona, të punojmë në të drejtuarit e vullnetit tonë kah e mira, e t'i lëmë diskutimet për thelbin e Qenies së All-llahut xh.sh., për të cilat nuk kanë folur paraardhësit tanë (selefu salih), e as që e kanë tërhequr vëmendjen në to.

## KËRKIMI I ARSYETIMIT DUKE U THIRRË NË KADERIN

Ka mëkatarë që i arsyetojnë mëkatet e tyre me kader – parapërcaktim. I thua zinaqarit: “Përse ke bërë kurvëri?” E ai përgjigjet: “Sepse ai më është paracaktuar”. Ky është argument i pabazë e i refuzuar për dy shkaqe:

1. Sepse dhënia e llogarisë dhe dënimi do të jetë për vepër, si dhe për shkaqet dhe nxitjet e veprës. E këtij zinaqari nuk i është zbuluar Levhi-Mahfudhi, e të shohë se i është parapërcaktuar kurvëria, siç pohon, dhe shpejton ta bëjë kurvërinë, duke e realizuar caktimin e kaderit. Jo, por ai vetëm pason epshin, kërkon kënaqësi momentale, dhe i përgjigjet thirrjes së shejtanit. Mushrikët (idhujtarët) që moti janë arsyetuar me argumente të ngjashme, e kanë thënë:

“Sikur të donte All-llahu nuk do t’i bënim shok (nuk do të ishim idhujtarë).”- (En’am, 148). All-llahu xh.sh. u është përgjigjur: “A mos keni ndonjë fakt e të na prezentoni atë neve?”- (En’am, 148), d.m.th. nga keni ditur ju para se të keni bërë shirk se është parapërcaktuar ai? A keni provuar që të besoni, e kjo për ju ka qenë e pamundshme?

2. Sikur të ishte i sinqertë ai që arsyetohet me kader, do të ishte i kënaqur me gjithë atë që All-llahu xh.sh. ia ka caktuar me varfëri, sëmundje, uri, humbjen e personit të dashur, humbjen e pasurisë. Por, është e qartë dhe e dukshme se ai nuk është i kënaqur me këtë, e kjo është caktuar dhe nuk mbështetet në këtë, por punon në grumbullimin e pasurisë, largimin e sëmundjes, urisë, ndien dhembje për humbjen e personit të dashur, e të pasurisë. Përse atëherë i ka nënshtruar forcat e veta e i ka përdorë ndjenjat e veta për arritjen e kënaqësive të kësaj bote, e mbrojtjen nga

dhembja, e nuk e ka angazhuar mendjen e tij për zbutjen e vetëdijes dhe pengimin e shpirtit nga e ndaluara, nga e cila synon, duke e ditur çfarë dënimi meriton pas kësaj?

## **ÇFARË ËSHTË QËNDRIMI YNË, E ÇFARË KA QENË I PARAARDHËSVE TANË PËR ÇËSHTJEN E KADERIT?**

Kundërshtarët e Islamit i akuzojnë muslimanët për pasivitet e përtaci, ngase besojnë në kader. Ndonëse në këtë akuzë ka edhe diç të vërtetë, shkak i kësaj është të kuptuarit e gabuar të besimit në kader nga ana e shumë pjesëtarëve të gjeneratave të mëvonshme të muslimanëve. Shumë njerëz të padijshëm e kanë marrë besimin në kader si arsytim për bërjen e mëkateve, për përtaci e indiferencë, gjersa paraardhësit tanë kanë marrë nga ky besim nxitje për punë e xhihad. Kemi lexuar se riziku-furnizimi është i përcaktuar (“Ajo që është përcaktuar të të vijë, pa marrë parasysh se sa je i dobët, e ajo që i është caktuar tjetrit, nuk do ta fitosh me forcën tënde”), e njerëzit kanë pandehur se kjo kërkon braktisjen e fitimit, lënien e përpjekjes pas dore, të rrimë pa punuar, të presim që qielli të na lëshoj ar e argjend, të udhëtojmë pa të holla e përgatitje.

Këtë e kanë lexuar edhe paraardhësit tanë (selefu-s-salih), dhe e kanë kuptuar se janë të obliguar që të punojnë sa më shumë që munden e ta aktivizojnë tërë forcën e vet për fitimin e pasurisë hallall. E pas punës së investuar kanë qenë të kënaqur me atë që u ka ardhur. Nuk janë zemëruar në Zotin e tyre dhe nuk kanë pasur zili ndaj vëllezërve të vet, të cilët kanë arritur më tepër se këta. Pasuria nuk i ka bërë kryelartë, e as varfëria nuk u paraqiste dhembje. Kemi dëgjuar se afati i

vdekjes është caktuar. Këtë e kemi marrë si arsytim për lënien pas dore të kujdesit e syçeltësisë, përgjegjësisë e ndërhyrjes ndërmjet krimit të bërë me qëllim dhe kaderit i cili ndodh pa krim.

Edhe gjyshërit tanë kanë dëgjuar se afati i vdekjes është i caktuar, e kanë thënë: “Nëse çasti i vdekjes është i caktuar, askush nuk do të vdesë para afatit, madje po hyri në zjarr dhe me gjoks t’u del shigjetave para, e kur të vijë ai afat askush nuk mund ta shtyejë, madje sikur të mbrohet në kështjellën me shtatë mure. Prandaj ta punojmë atë, me të cilën është i kënaqur All-llahu xh.sh. Të luftojmë në rrugën e All-llahut xh.sh. Mos t’i frikësohemi vdekjes, sepse afati i saj është i caktuar, nuk mund të shpejtohet e as të vonohet. Të luftojmë me gjuhët tona kundër të keqes”. Dhe kanë dalë përpara me të vërtetën duke mos u frikësuar nga askush, përveç nga All-llahu xh.sh. Kemi marrë vesh se çdo gjë është e përcaktuar, e kemi lënë pas dore hulumtimin e Ligjit të All-llahut xh.sh. në kozmos, të cilin e ka bërë shkaktarë të dobive e dëmeve. E pikërisht paraardhësit tanë kanë qenë dijetarë, udhëheqës dhe kampionë të këtyre shkencave, të cilat i kanë njohur dhe shfrytëzuar mirë. Rezultati i të kuptuari tonë (të gabuar) është, se jemi rrokullisur nga shkalla më e lartë në greminë, nga piedestali në fund. Me iman-besim kanë qenë sunduesit e botës, udhëheqës e mësues, ndërsa ne jemi bërë të shkelur e të poshtëruar, të udhëhequr nga të tjerët. Me shpatën e të vërtetës kanë çliruar një të tretën e botës së civilizuar, ndërsa armiku jonë me shpatën e të pavërtetës ka pushtuar zemrën e vendeve tona.

## SHKAKU I DHËNIES SË SHENJTËRISË TË VDEKURVE

Pasi që kemi parë (disa prej nesh) se jeta na është shthurur, se ata që janë të gjallë prej nesh janë të poshtëruar dhe pasi që ua kujtuam lavditë e forcës së gjyshërve tanë dhe ndershmërisë së tyre, dhe për shkak të njëmendësisë së shpresës në të kaluarën, dëshpërimi nga poshtërimi i të gjallëve është shndërruar në lartësimin e të vdekurve. Andaj kanë zënë fill format e ndryshe të dhënies së shenjtërisë të vdekurve, të mbështeturit në ta, pritja për ndihmë nga ata. Mendojmë se sukcesi i tyre, e shkatërrimi ynë u japin fuqi të na ndihmojnë. Kemi filluar të ndërtojmë mauzole madhështore, tyrbe të larta e t'u japim shenjtëri, gjë e cila na ka kthyer afër besimit të idhujtarëve – xhahilijetit. Kemi filluar t'u zotohemi këtyre varrezave dhe t'u drejtohemi për ndihmë, në mënyrë të ndaluar. Madje, ndoshta edhe kemi kërkuar nga ata dobi apo dëm, pa shkaqet e dukshme, të jashtme dhe pa ndërmjetësim të prekshëm. E tërë kjo është për shkak të realitetit tonë të keq, e të palakmueshëm nga njëra anë dhe të kaluarës sonë të lavdishme nga ana tjetër.

## ÇRREGULLIM I CILI NUK KA ARSYETIM

Deri në këtë gjendje na solli të kuptuarit tonë i gabuar i besimit në kader, të kuptuarit që na ka bërë që t'i ngatërrojmë tekstet, që flasin për gjërat në të cilat jemi të pavarur dhe të atyre që i punojmë sipas vullnetit tonë dhe tekstet që flasin për gjërat të cilat All-llahu xh.sh. i ka bërë pa vullnetin dhe pa fuqinë tonë. Kjo ngatërresë e çuditshme lind në drejtimet e akaidit. Disa pohojnë se njeriu është i determinuar, nuk ka vullnet, sepse nuk mund të dirigjojë me muskulin e zemrës,

apo p.sh. nuk ka pjesëmarrje në zgjedhjen e prindërve të vet, mesit të parë jetësor, ndërsa kanë harruar se All-llahu xh.sh. i ka dhënë njeriut muskujt të cilët mund t'i dirigjojë, mendjen me të cilën mund (sipas mundësisë) t'i përmirësojë gabimet e mesit të vet dhe të ndikojë në edukimin. Të tjerët kanë shkuar larg në drejtim të kundërt, duke i dhënë lirisë së njeriut më tepër sesa që njëmend i takon. Sipas kësaj kanë ra në mashtrim në çështjen e shpërblimit e dënimit. Ndërsa kanë harruar se All-llahu xh.sh. e ka bërë njeriun përgjegjës në kufijtë e lirisë dhe fuqisë së tij, e nuk e dënon për atë që është i detyruar. Kanë bredhur në diskutime për drejtësinë e All-llahut xh.sh.ndërsa kanë harruar thelbin,e ajo është se drejtësia e All-llahut nuk matet me peshojat e drejtësisë njerëzore. Rruga e shpëtimit në këtë dhe çështjet tjera të besimit është që t'i kthehemi burimit – Kur'anit, të pasojmë rrugën e as-habëve e të tabi'inëve dhe t'i lëmë këto diskutime të pafrytshme , shkaktar i të cilave është hulumtimi i pamjaftueshëm e i mangët i filozofisë primitive e sipërfaqësore greke.

## **BESIMI NË GAJB BOTËN E PADUKSHME BOTA E PADUKSHME**

Tanimë kemi thënë në kaptinën “Parimet e besimit”, se shqisat nuk mund t'i njohin e t'i kuptojnë të gjitha ato që ekzistojnë, dhe se ekzistojnë botë të cilat nuk i njohim me shqisa. Nga këto botë më i afërt na është shpirti, i cili është elementi kryesor i jetës së çdonjërit nga ne. Kush e mohon

ekzistimin e shpirtit? Askush! Kush e ka njohur thelbin e shpirtit? Askush! Botën e dukshme, të njohur, Kur'ani e quan alemu-sh-shehadeti, ndërsa botën e padukshme e quan alemu-l-gajbi. Sa i përket botës së dukshme, të gjithë njerëzit janë të njëjtë në besimin e ekzistimit të saj dhe askush nuk ka përparësi ndaj tjetrit në këtë besim, sepse ai është fryt i diturisë së domosdoshme. Përparësia është në besimin e së padukshmes, gajb. Meritë dhe përparësi ka ai që beson në atë, që nuk e sheh, e dëshmon ekzistimin e saj duke u bazuar në lajmërim. Me këtë dallohen të devotshmit. Prandaj, cilësia e parë me të cilën All-llahu xh.sh. i ka përshkruar të devotshmit është se ata janë “të cilët besojnë të padukshmen”.

## **SI BESOJMË NË TË PADUKSHMEN?**

Si besojmë në gajb, e All-llahu xh.sh. nuk na ka dhënë shqisat me ndihmën e të cilave mund ta njohim këtë gajb? Sikur të mbështeteshim vetëm në shqisa e mendje, me të cilën gjykojmë atë që na vie përmes shqisave, do të mbeteshim në padituri dhe për ne bota e gajbit do të ishte e panjohur. Por, urtësia dhe mëshira e All-llahut xh.sh. ndaj nesh kanë bërë që nuk ia kanë lëshuar mendjen pafuqisë së saj për ta njohur këtë botë të padukshme, por e ka lajmëruar për atë që duhet ta dijë për atë botë. Ky lajmërim nuk vjen nga thellësia e shpirtit, nga brenda, por prej së jashtmi. Kjo nuk është intuitë, as inspirim, as iluminizëm, apo ndoshta konkluzion racional. Nuk është burim forca njerëzore. Ai vjen “nga jashtë” në njëren nga tri mënyrat:

1. Që All-llahu xh.sh. ia dërgoi këto lajme njeriut përmes frymëzimit, apo ëndrrës, apo me ndonjë tjetër mënyrë të “pranimit”, në të cilën njeriu nuk ka kontribut, e as që mund këtë ta arrijë me punën e tij;
2. T’i dëgjojë këto lajme, e të mos e sheh transmetuesin e vërtetë të tyre, vijnë deri te veshi i tij dhe ai i kupton;
3. Që All-llahu xh.sh. njëren nga krijesat e Veta të nënshtruara, që nuk i shohim, të cilat quhen melaike (engjëj), t’ia dërgojë ndonjërit nga njerëzit, të cilin All-llahu xh.sh. e zgjedh, ashtu që ai melek ia dërgon shpalljen e All-llahut xh.sh. dhe i urdhëron që t’ua kumtojë njerëzve. Këto janë tri mënyra të njohjes së botës së gajbit:

“Asnjë njeriu nuk i ka folur All-llahu ndryshe, vetëm se me anë të frymëzimit, ose pas perdes, ose t’i dërgojë të dërguar (melek), e ai t’i shpallë me lejen e Tij atë që do Ai...”,- (Esh-shura, 51).

## **GAJBI NË TË CILIN DUHET BESUAR**

Gajbi në të cilin duhet besuar, e i cili është themel i imanit dhe mohuesi i tij del nga imani – është gajbi që përmendet në Kur’an. Ndërsa gajbi që përmendet në Sunnet, e nuk është i përmendur në Kur’an, mohuesi i tij nuk del nga feja, por është mëkatar i madh. Këtë dallim ndërmjet Kur’anit e Sunnetit duhet ta shpjegojmë më tepër. Vahji-shpallja, të cilën e kumton Pejgamberi a.s. dhe Hadithi të cilin e flet, janë në të njëjtën shkallë të argumentimit. Kur’ani është shpallje e All-llahut

xh.sh. me shprehje e kuptim, ndërsa hadithi është shpallje, me kuptim prej All-llahut xh.sh., kurse të shprehurit është nga Pejgamberi a.s. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ai nuk flet sipas hamendjes së tij – ajo (që flet ai) është vetëm shpallje e cila i shpallet”,- (En-Nexhm, 3-4).

As’habët, të cilët i kanë dëgjuar ajetet që i kumtoi Pejgamberi a.s. dhe hadithin që e shqiptoi, nuk kanë bërë dallim midis tyre sa i përket obligueshmërisë së punuarit me to dhe fuqisë së dëshmimit dhe argumentimit. Dallimi ndërmjet tyre vjen me rastin e transmetimit. Kur’ani është i transmetuar me tevaturo – numrin e madh të transmetuesve nga çdo gjeneratë, ashtu që jemi absolutisht të sigurt se teksti, i cili gjendet në mus’haf është teksti i njëjtë të cilin ia ka shpallur Xhibrili a.s. Muhammedit a.s., e ai ua ka përcjellur as’habëve. Asgjë nga ai nuk është hequr, as nuk i është shtuar diç, e as që është ndryshuar ndonjë shprehje. Ndërsa, sa i përket hadithit, shumica e tyre janë transmetuar individualisht (ahad-ahad). Dijetarët e hadithit kanë bërë përpjekje të mëdha në hulumtimin dhe pastrimin e transmetimit të haditheve, e pastaj në hulumtimin e gjendjes së njerëzve, të cilët e transmetojnë. Në këtë, ata kanë investuar përpjekje të jashtëzakonshme, deri te të cilat arrin fuqia njerëzore. Por edhe krahas kësaj nuk mund të themi me siguri absolute se hadithi, të cilin e transmetojnë koleksionet e hadithit, është nga Resulull-llahu a.s., e se është transmetuar shprehja e njëjtë, siç jemi absolutisht të sigurt, se ajo që gjendet në mus’haf është Kur’ani i shpallur me shprehje e kuptim. Dhe, pasi që akideja është baza e fesë dhe çfarëdo mungese në të shpie në kufër dhe dalje nga feja, atëherë muslimani nuk konsiderohet renegat nga feja (heretik), nëse ekziston mundësia që veprën, të cilën e ka bërë nuk është kufër. Prandaj kemi thënë se ai që mohon dogmën, me të cilën ka ardhur Kur’ani, del nga Islami, ndërsa kush mohon dogmën, me të cilën ka ardhur Sunneti, bën mëkat të madh, por nuk del nga feja. Kjo është, nëse

këtë e mohon nga inati, apo për shkak të dallimit në qëndrime, ndërsa nëse është njohës i hadithit dhe nuk e pranon hadithin për shkak të dobësisë në sened, apo në metn (tekst), nuk është mëkatar.

## **BOTA E GAJBIT**

Botën e gajbit, për të cilën flet Sheri'ati, në të cilën duhet besuar dhe mohimi i së cilës shpie në kufër, e përbëjnë: melekët, xhinnët, librat, pejgamberët, dita e gjykimit, dhënia e llogarisë, shpërblimi e dënimi, kaderi, ajo që përmendet në Kur'an për krijimin e qiejve, tokës, njeriut dhe krejt atë për të cilën flet Kur'ani.

## **DYSHIMI DHE PËRGJIGJJA NË TË**

Materialistëve që besojnë vetëm në atë që e kapin me shqisa, u përgjigjemi me parimin e tretë të besimit, i cili shpjegon se nga mosekzistimi i ndijimit të diçkaje, nuk rrjedh mosekzistimi i detyrueshëm i saj dhe se nuk kemi të drejtë t'i mohojmë gjërat vetëm për shkak se nuk e ndiejmë ekzistimin e tyre. Po ashtu u përgjigjemi me parimin, i cili konfirmon se lajmi i vërtetë është dituri e sigurt, sikur që këtë e jep shqisa. Dhe nëse tashmë është vërtetuar sinqeriteti i Muhammedit a.s.,

në atë çka transmeton nga All-llahu xh.sh. dhe besnikërisht është përcjellë ky lajm, atëherë ne besimtarët kemi besim kategorik në ekzistimin e botës së gajbit.

## **LLOJET E GAJBIT**

### **GAJBI ËSHTË SHUMËLLOJESH**

1. Gajbi, të cilin nuk e kemi përjetuar, e as që kemi qenë dëshmitarë të tij, por e kanë përjetuar njerëzit tjerë, si p.sh. tregimi për Jusufin a.s., All-llahu xh.sh. e quan gajb, sepse Muhammedi a.s. dhe populli i tij nuk kanë qenë dëshmitarë të tij, nuk i kanë parë ato ngjarje, e as që kanë dëgjuar për to. Por fëmijët e Jakubit a.s., Jusufi a.s. dhe vëllezërit e tij, kanë qenë pjesëmarrës e dëshmitarë të atyre ngjarjeve.
2. Gajbi, të cilin njerëzit nuk e kanë përjetuar, e as nuk kanë qenë dëshmitarë të tij, edhe pse shikuar racionalisht, nuk ka qenë e mundur të jenë dëshmitarë të tij, sikur që janë ngjarjet që kanë ndodhur në tokë para krijimit të njerëzve, lajmi për krijesat që më parë kanë banuar në tokë, pastaj krijimi i Ademit a.s. dhe fillimi i ekzistencës njerëzore në tokë. Për këto dimë vetëm atë, që ka arritur përmes vahjit – shpalljes.
3. Gajbi, të cilin shqisat nuk mund ta njohin, as që mund ta gjykojë mendja, e as me imagjinatë nuk mund të kapet, siç janë cilësitë e All-llahut xh.sh., pastaj krijesat të cilat neve na i ka bërë të padukshme, siç janë melekët, xhinnët, djajtë, ndodhitë që kanë të bëjnë me Ditën e Gjykimit, dhënia e llogarisë, shpërblimi e dënimi.

## DYSHIMI DHE PËRGJIGJJA NË TË

Ndoshta dikush do të thotë: Në gajbin, të cilin vetëm All-llahu xh.sh. e di, bën pjesë edhe reshja e shiut dhe njohja e asaj që gjendet në mitrën e nënës. Atëherë si flasin buletinet meteorologjike për atë se çfarë do të jetë moti nesër, i bukur apo me shi? Ndërsa shkencë e zbulon atë që është në barkun e shtatzënës, a është mashkull apo femër?

Përgjigjja: All-llahu xh.sh. është Ai, i cili ka shpallur Kur'anin dhe All-llahu është Ai, i cili e ka krijuar kozmosin dhe atë që ndodh në të. Dhe është e pamundur që në Kur'an të vijë teksti kategorik, i cili mohon ndonjë gjësend ekzistues, të dukshëm e të preکشëm. E nëse hasim në tekst i cili në shikim të parë është kontradiktor me realitetin, më hollësisht e hulumtojnë dhe shohim se kuptimi i tij është ndryshe nga ai, i cili është paraqitur në shikim të parë.

Buletini meteorologjik lajmëron për shiun pas paraqitjes së parashenjave dhe formimit të plotë p.sh., shiu i cili bie në zonën bregdetare të Sirisë. Me zbulimin e ligjeve të All-llahut xh.sh., në kozmos është bërë e qartë se ajri, i cili vjen nga Atlantiku, kalon Gjibraltarin, ndeshet me masën ajrore amull dhe për shkak të temperaturës së ndryshueshme të ajrit të ardhur dhe atij amull formohen retë. E kur meteorologët e shohin këtë – e dinë, duke u bazuar në njohjen e ligjeve të All-llahut xh.sh. se ato re do të drejtohen nga bregdeti sirian. Kjo është njëllë sikur dikush ta ketë vështruar nga dritarja postierin, e ka llogaritur se kur do të mund të arrijë deri te shtëpia e tij dhe t'i ketë lajmëruar anëtarët e shtëpisë, se për pesë minuta do të arrijë postieri. Apo sikur ndokush të shikonte në dylbi, e ta vërente automobilin, i cili i vjen në takim e të lajmërojë për këtë para se ta vërejë dikush tjetër. Ngjashëm kësaj është të informuarit për gjininë e embrionit, pas formimit të tij. Por gajbi për të cilin ka qëllim ajeti, e All-llahu xh.sh. e di më së miri, është çështja e

formimit të reve, reshja e shiut në rajonin ku All-llahu xh.sh. ka përcaktuar thatësinë, pengimin e shiut në rajonin ku Ai ka përcaktuar reshjen e tij, të njohurit e gjinisë së embrionit (dhe veçoritë e tij të cilat më vonë do të paraqiten, - shën.i përkth.) para, apo në momentin e bashkimit të spermatozoidit me vezoren.

## **LIBRAT, MELEKËT DHE PEJGAMBERËT A.S.**

Besimi në melekët, librat dhe Pejgamberët është themel i besimit, pa të cilin nuk ka iman. Melekët janë të dërguarit e All-llahut xh.sh. pejgamberëve, ndërsa pejgamberët janë të dërguarit e All-llahut xh.sh. njerëzve. Librat janë mesazhet, të cilat meleku ia dorëzon pejgamberëve, ndërsa ata ia përcjellin njerëzve.

## **SHPLLJA, MUNDËSIA DHE NEVOJSHMËRIA E SAJ**

Shpallja, logjikisht është e mundshme. Sepse All-llahu xh.sh. është i fuqishëm të krijoj melaike, t'i zgjedhë pejgamberët e të japë dispozita. Mendja këtë nuk e konsideron të pamundshme pas besimit në ekzistencën, fuqinë dhe vullnetin e All-llahut xh.sh. Kjo është realizuar dhe është realitet. Këtë e dëshmon edhe lajmi i vërtetë, e më parë kemi thënë se lajmi i vërtetë është një nga

rrugët e njohjes të së vërtetës. Ne jemi të bindur në vërtetësinë e këtij lajmi, sikur që jemi të bindur në atë që e shohim dhe e dëgjojmë.

Shpallja është e domosdoshme, sepse po të mos ishte shpallja, njerëzit do të dinin vetëm për botën e materies. Metafizika do t'u ishte plotësisht e panjohur. Do të jetonin vetëm për këtë botë, sikur kafshët dhe nuk do të dinin për botën tjetër – Ahiretin. Po të mos ishte shpallja, nuk do të kishte ngritje morale, pa i marrë parasysh të gjitha teoritë etike dhe bazat me të cilat ndërtohet morali, nëse ai nuk është i ngritur e i rrënjësuar në besim. Sepse, në natyrën e njeriut është të dashuruarit në vete, lakmia, të larguarit nga telashet, lënia e asaj në të cilën nuk gjendet kënaqësia e përfitimit. Sikur njeriu të posedonte vetëm një dinar të cilin e ka për darkë dhe kalimthi sheh arkën për ndihmë të varfërve, nëse nuk beson në All-llahun xh.sh. dhe Ditën e Gjykimit, a do ta vente të vetmin dinar në të, e ta kalojë natën i uritur, duke mos e informuar për këtë askënd dhe që askush të mos e ketë parë, kur e ka bërë këtë? Sa i përket besimtarit, ai do ta vente dinarin në arkë, sepse e di që All-llahu xh.sh. e sheh, pa marrë parasysh se a është vetëm apo në shoqëri, e shohin njerëzit apo jo, i falënderohen apo jo, e shpërblejnë për këtë apo jo. Vetëm besimtari e braktisë të keqen, qoftë të jetë vetëm apo me të tjerët. E ai që bën mirësi për lavdërim apo shpërblim, e bënë atë vetëm atëherë kur është në shoqëri të atij i cili do ta lavdërojë, apo shpërblejë. Ai i cili e braktisë të keqen duke iu frikësuar turpit apo dënimit, e braktisë atë vetëm atëherë kur është i sigurt se do ta shohin policët apo njerëzit tjerë. Sikur All-llahu xh.sh. t'ua llogariste njerëzve në Ahiret mëkatet e tyre, e që më parë të mos u ketë dërguar peygamberë të cilët ua kanë mësuar Sheri'atin e Zotit të tyre, do të thonin duke u arsyetuar: “Zoti ynë, përse nuk na çove ndonjë të dërguar që t'u përmbaheshim fjalëve Tua”. - (Ta-ha, 134).

Do të pohonin se sikur t'u vinte shpallja, do të punonin sipas saj dhe se do ta pasonin Sheri'atin sikur ta njihnin. Prandaj, kanë ardhur shpalljet: "...ashtu që pas dërgimit të të dërguarve, njerëzit të mos kenë fakt (arsyetim) para All-llahut...!" (En-nisaë – 165).

## DYSHIMI DHE PËRGJIGJJA NË TË

Disa njerëz thonë: Përse All-llahu xh.sh. nuk i udhëzoi të gjithë njerëzit në rrugën e cila shpie në Xhennet. Përse ua dha epshin, e pastaj i dënon për kurvëri? E ka mbjellë në natyrën e tyre dashurinë për pasuri, e pastaj i dënon nëse e tubojnë në mënyrë të palejuar.

Përgjigjja në këtë pyetje është sikurse pyetja e nxënësit në shkollë: "Përse nuk na i shpërndajnë pyetjet e provimit në fillim të vitit shkollor? Pse i fshehin dhe na detyrojnë që të përgatitemi për provim?". I fshehin që nxënësi sa më shumë të përpiqet, e ta mësojë tërë programin. Nëse jepen pyetjet që në fillim të vitit shkollor, provimi nuk do të kishte kurrfarë kuptimi.

Kjo botë – dunjallëku është vend i sprovave, ndërsa sprova është provim, që të dallohet i dëgjueshmi prej të padëgjueshmit, i drejti prej të padrejtut. Po të mos kishte pengesa në garim, nuk do të dallohej frikacaku nga trimi. Sikur All-llahu xh.sh. të dëshironte, të gjithë njerëzit do t'i bënte një popull. Sikur të donte ka mundur të gjithë t'i krijojë siç i ka krijuar melekët. Por Ai ka dëshiruar t'i krijojë të tillë. Vullnetin e Tij asgjë nuk mund ta pengojë, e as që ndokujt i përgjigjet për atë që punon. Ne jemi nën fronin e Tij, Atij i kthehemi, Ai është Zoti ynë, nuk ka hyjni tjetër përveç Tij, nëse don na dënon, e nëse don na falë. E lusim të na falë e të na mëshirojë. Kërkojmë

strehim te Ai nga dënimi i Tij, sepse nga dënimi mund të shpëtojmë vetëm me faljen e Tij, e nuk mund të fitojmë falje përveç nga Ai.

## MELAIKET

Ekzistimi i melaikeve është i vërtetuar me Kur'an. E kush mohon çkado qoftë nga ajo që është e përmendur në Kur'an, ka dalur nga Islami. Ajo që përmendet në Kur'an për melaiket dhe cilësitë e tyre është:

1. Se janë të krijuar para njerëzve dhe se All-llahu xh.sh. u ka thënë: “Unë do të vendosi në Tokë mëkëmbësin!” – Ata thanë: “A do të jetë mëkëmbësi Yt, ai që në të do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak?”,- (Bekare, 30).
2. Ata janë plotësisht të dëgjueshëm e të përkushtuar: “E ne Ty të madhërojmë e të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty”,- (Bekare, 30) Ata thanë: “...atë që All-llahu e urdhëron nuk e kundërshtojnë dhe atë që e urdhëron e zbatojnë... E lavdërojnë dhe sexhde i bëjnë... E lartësojnë e i falënderohen Zotit të vet dhe në të besojnë”.
3. Kur All-llahu xh.sh. e kompletoi krijimin e Ademit dhe ia mësoi emrat, e pastaj i pyeti për këtë melekët, e nuk ditën derisa Ademi a.s. nuk i lajmëroi për to. E pasi që me këtë u bë e qartë vlera dhe përparësia e tij ndaj tyre, All-llahu xh.sh. i urdhëroi t'i bëjnë Ademit a.s. sexhde (sexhde respekti e përshëndetëse, e jo adhurimi).

4. Nganjëherë marrin formën e gjërave materiale dhe paraqiten në formë të njeriut. Në tregimin për Merjemën ceket: “Ne dërguam tek ajo melekun Xhibrilin dhe ai iu paraqit asaj në formën e mashkullit të përsosur”.- (Merjem, 17).

5. Vendqëndrimi i tyre është qielli. Zbresin në tokë me urdhër të All-llahut xh.sh.: “Dhe ne zbresim (në tokë) vetëm me urdhrin e Zotit tënd.”-(Merjem – 64).

6. Janë të ndryshëm sipas formës e pozitës. All-llahu xh.sh. i ka bërë “melekët të dërguar me nga dy, tre e katër krahë. Ai shton në krijimtari çka të dojë.”-(Fatir-1). “Çdonjërit prej nesh i është caktuar vendi”,- (Saffat – 164). Xhibrili e sjell shpalljen. “Thuaj: “Kush është armik i Xhibrilit (është armik i All-llahut) e ai me urdhrin e All-llahut e zbriti Kur’anin në zemrën tënde...”,- (Bekare – 97). “Vërtet, Kur’ani është shpallje e Zotit të botëve; e sjell Xhibrili besnik në zemrën tënde që të bëhesh nga ata që paralajmërojnë”.- (Shuara – 192-194). Meleku i vdekjes është i obliguar t’ua marrë shpirtat: “Thuaj: “Do t’ua merr shpirtin meleku i vdekjes, i cili është caktuar për ju.”- (Sexhde-11).

Një nga melekët është i obliguar t’i fryjëjë surit-borisë. Njëri prej tyre quhet Mikail. Disa janë të obliguar ta bartin Arshin: “Ata të cilët e bartin Arshin”,- (Gafir – 7). “E atë ditë, tetë (melaïke) e bartin mbi vete Arshin e Zotit tënd.”- (Hakka – 17).

Disa janë të obliguar të kujdesen për jetën e kënaqshme, komode të banorëve të Xhennetit” “Dhe melekët do të hyjnë tek ata nga çdo derë (e u thonë: Paqja e shpëtimiti qofshin mbi ju, me durimin tuaj gjetët shpëtimin...!”,- (Rad, 23-24).

Disa janë të obliguar që t'i mundojnë banorët e Xhehennemit: “Atë (zjarrin) e mbikëqyrin melekë të rreptë e të ashpër...!”,- (Tahrim, 6).

Disa janë të obliguar për shënimin e veprave njerëzore: “Dhe ai nuk e thotë asnjë fjalë e që pranë tij të mos jetë ai që e vigjëlton (mbikëqyrë)”,- (Kaf, 18), “...kurse mbi ju janë përcjellësit, shkruesit e ndershëm te All-llahu” (Infitar, 10-11).

Disa janë të obliguar që ta shpiejnë njeriun në dhënien e llogarisë në Ditën e Gjykimit e të dëshmojnë kundër tij: “E do të vijë secili njeri e bashkë me të edhe përcjellësi edhe dëshmitari”,- (Kaf. 21).

7. Në obligimet e tyre, siç ceket në Kur'an, bën pjesë edhe inkurajimi e ndihma besimtarëve në beteja: “Kur Zoti yt u kumtoi melaikëve se: “Unë jam me ju, pra përforconi ata të cilët besojnë.”- (Enfal, 12).

Ata lutën për besimtarët dhe kërkojnë për ta mëshirë e falje: “Ai ju bekon juve, e edhe melekët e Tij.”- (Ahzab, 43). “...dhe i lutën Atij t'i falë ata që besuan (duke thënë): “Zoti ynë, Ti me mëshirën dhe me diturinë Tënde ke përfshirë çdo gjë, prandaj fali ata që janë penduar dhe që ndjekin rrugën Tënde dhe ruaj ata prej dënimit të zjarrit! O Zoti ynë, futi ata në kopshtet e Adnit, që ua ke premtuar, ata dhe kush ishte i mirë, prej prindërve të tyre, grave të tyre dhe pasardhësve të tyre. Ti vërtet je i Plotfuqishëm e i Urtë! Dhe mbroji ata prej të këqijave, pse atë që Ti e mbronë atë ditë prej të këqijave, Ti e ke mëshiruar atë”.- (Mu'min, 7-8). Ata prezentojnë në namazin e sabahut me besimtarët: “...dhe lutjen e agimit sepse në lutjen e agimit (sabahut) shumë prezentojnë.”- (Isra, 79).

I përgëzojnë besimtarët me lajme të gëzueshme me rastin e vdekjes, ndërsa i qortojnë mëkatarët: “E, s’ka dyshim se ata që thanë: “All-llahu është Zoti ynë” dhe ishin të paluhatshëm – atyre u vijnë melaiket (në prag të vdekjes dhe u thonë): Të mos frikësoheni, të mos pikëlloheni, keni myzhde xhennetin që u premtohet!”,- (Fussilet, 30).

Kur t’ua marrin shpirtat atyre që i kanë bërë zullum vetvetes, melaiket do t’i pyesin: “Ç’është me ju?”, (Nisa, 97). “E sikur t’i kishe parë melaiket kur ua merrnin shpirtat pabesimtarëve (do të shihje tmerr), u binin fytyrave dhe shpinave të tyre!”,- (Enfal, 50).

Pastaj pas kësaj i çojnë në zjarr duke i qortuar: “E ata që nuk besuan, do të sillen grupe-grupe në Xhehennem, e kur arrijnë aty, dyert e tij do të hapen e roja do t’i pyesë: “A nuk ju patën ardhur juve të dërguar nga mesi juaj, të cilët ua lexonin ajetet e Zotit tuaj e ua tërheqnin vërejtjen për ballafaqimin tuaj në këtë ditë?” – “Po” – do të thonë ata – “por fjala (vendimi) e dënimit domosdo është bërë realitet kundër jobesimtarëve”. (Atyre) U thuhet: “Hyni nëpër dyer të Xhehennemit, aty do të jeni përgjithmonë! Sa vend i shëmtuar që është ai për mendjemëdhenjtë!”,- (Zummer, 71-72).

Ata i presin banorët e Xhennetit dhe u shprehin mirëseardhje: “E, ata që janë ruajtur (nga mëkatet), do të sillen në grupe të xhenneti, e kur arrijnë aty, dyert e tij i gjejnë të hapura dhe roja do t’u thotë atyre: “Selamun alejkum-qofshi të shpëtuar nga mëkatet, jeni të pastër, andaj hyni në të, ku do të qëndroni përgjithmonë!”,- (Zumer, 73).

Melekët nuk martohen dhe nuk shumohen, e nuk regjistrohen si “meshku” apo “femra”. Kjo është, përgjithësisht, ajo që ceket në Kur’an për melekët. Ndërsa në Sunnet për ta ka shumë hadithe. Ato janë ahad, por transmetimi i tyre është i besueshëm. Kush mohon çkado që ka

ardhur në Kur'an për melekët apo për diç tjetër, është larguar nga feja. Besimi në melekët është një nga shtyllat e imanit: “Pejgamberi beson në atë që është shpallur nga Zoti i tij, edhe besimtarët-secili beson në All-llahun, melekët e Tij, librat e Tij dhe Të Dërguarin e Tij...!”,- (Bekare, 286).

## **DISA REZULTATE DHE FRYTET E BESIMIT NË MELAIKET**

1. Shtimi i ndjenjës për madhësitinë e All-llahu xh.sh. dhe mëshirën e Tij, sepse i ka obliguar melekët që të luten për besimtarët e të kërkojnë falje për ta.
2. Largimi nga mëkatet, sepse njeriut i bie ndër mend se ata shënojnë krejt atë që thuhet apo veprohet.
3. Guximi në xhihad, kur t'u kujtohet se ata i ndihmojnë muxhahidët me urdhrin e Zotit të botëve.
4. Bën përpjekje për ta fituar Xhennetin, që të jetë nga ata të cilët do të jenë të përshëndetur nga melaiKET.
5. Largimi nga ajo që shpie në zjarr, që të mos jetë nga ata të cilët do të jenë të qortuar nga melekët. Njëri nga frytet e përgjithshme të besimit në melekët është përngjasimi i atyre në nënshtrueshmëri, pendimi në mëkate dhe forcimi i anës shpirtërore të njeriut.

## XHINNËT

All-llahu xh.sh. në Kur'an përmend se ai ka krijuar edhe krijesa të tjera të cilat sytë tanë nuk janë në gjendje t'i shohin në formën e tyre të vërtetë, siç nuk janë në gjendje t'i shohin melekët, rrezet ultra-vjollcë, e infra të kuqe, vibracionin e zërave, rrymën e cila kalon përgjatë telave. Ato krijesa për të cilat flet Kur'ani janë xhinnët. Ajo në çka duhet besuar dhe mohuesi i së cilës del nga feja, është ajo që Kur'ani flet për ta, siç është rasti edhe me besimin në melekët.

## KUR'ANI RRETH XHINNËVE

1. Kur'ani shpjegon se xhinnët janë të krijuar nga zjarri. Kjo nuk do të thotë se ata janë zjarr i cili djegë krejt atë që e prekë, sikur që nuk është e përjashtuar që All-llahu xh.sh. më vonë u ka dhënë natyrë tjetër. Njeriu është i krijuar nga dheu, por ai nuk ka mbetur dhe, por All-llahu xh.sh. i ka dhënë një konstruksion krejt tjetër, e ka bërë të përbërë nga eshtrat, muskujt, nervat, që janë në harmoni me ligjet e Tij, duke qenë se i shndërron krijesat nga një gjendje në tjetrën, krijon nga qeliza krijesa të gjalla me cilësi, formë, e natyrë të ndryshme, krijon nga atomi minerale të peshave, formave e karakteristikave të ndryshme, mundëson që nga toka e thatë të mbien druri me gjethe të gjelbra e lule lloj-lloj ngjyrash.

2. Xhinnët janë të krijuar para njeriut: “E xhinnët i krijuam më parë nga zjarri, nga flaka e fortë”,- (Hixhr, 27).

3. Ata na shohin, e ne ata nuk i shohim. Kjo nuk është aspak e çuditshme p.sh. kush ka dylbi mund ta shohë personin në largësi të madhe, e ai person këtë nuk e sheh. Njeriu është i orientuar në prodhimin e aparateve të shumta p.sh. televizioni, shohim në të njeriun, e ai ne nuk na sheh. Kur’ani thotë: “Ai (shejtani) dhe ushtria e tij ju sheh, prej nga ju nuk i shihni ata”,- (A’raf, 27).

4. Ata kanë obligime e detyrime siç kemi edhe ne, do të japin llogari për veprat e veta, do të jenë të shpërblyer e të dënuar, ndërsa Xhehennemi, All-llahu xh.sh. na mbrojtë prej tij, do të jetë i mbushur me xhinnë e njerëz së bashku. I Lartësuarit thotë: “Xhinnët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë!”,- (Dharijat, 56). “E do të plotësohet fjala e Zotit tënd: “Do ta mbushë, me të vërtetë, Xhehennemin me xhinnë e njerëz bashkarisht!”,- (Hud, 119).

5. Deri te ata ka arritur misioni pejgamberik i Muhammedi a.s. siç ka arritur para kësaj misioni pejgamberik i Musës a.s.: “Ata (xhinnët) thanë: “O populli ynë! Ne dëgjuam Librin, të shpallur pas Musait, i cili vërteton se janë të vërteta edhe ato para tij, i cili udhëzon kah e vërteta dhe në rrugën e drejtë”.- (Ahkaf, 30).

6. Disa nga ata janë të mirë, e disa mëkatarë dhe ka të shumëllojshëm sikur edhe njerëzit: “E prej nesh ka të mirë dhe ka që nuk janë të mirë, ka prej nesh kategori (grupe) të ndryshme... dhe ka prej nesh muslimanë, e ka prej nesh edhe që janë jashtë rrugës (jobesimtarë)...!”,- (Xhinn, 11-14).

7. All-llahu xh.sh. i ka bërë të nënshtruar ndaj Sulejmanit, a.s.: “Ata i punonin atij ç’dëshironte: tempuj dhe përmendore<sup>17</sup>, enë të gjera si rezervoare dhe qypa të mëdhenj – të palëvizshëm (për shkak të madhësisë).”- (Sebe’ 13).

---

<sup>17</sup> Statujat dhe përmendoret janë të ndaluara rreptësisht në Islam.

8. Ata nuk e dinë gajbin, prandaj kanë vazhduar që të punojnë për Sulejmanin a.s. edhe pas vdekjes së tij (nuk kanë ditur se ka vdekur): “E kur ia caktuam atij vdekjen, askush tjetër nuk i njoftoi ata (xhinnët) për vdekjen e tij, përveç krimbit që e brejtë shkopin e tij, e kur u rrëzua ai, për xhinnët u bë e qartë, se sikur të ishin ata që e dinin të fshehtë, nuk do të vazhdonin të qëndronin në mundimin e turpshëm”.- (Sebe, 14).

9. All-llahu xh.sh. edhe atyre ua drejtoi provokimin, siç ua ka drejtuar njerëzve, që të vinë me diç të ngjashme me Kur’anin: “Thuaj: “Edhe sikur të bashkoheshin të gjithë njerëzit dhe xhinnët, për të sjellë një Kur’an të tillë, ata nuk do të mund të bënin si ky, madje edhe sikur t’i ndihmonin njëri-tjetrit.” -(Isra’, 88).

10. Ata i kanë përgjuar lajmet prej qiellit nga melekët, e kur ka ardhur misioni peygamberik i Muhammedit, sal-la-llahu alejhi ve selem, janë penguar në këtë dhe në ta janë drejtuar yjet flakërues: “Dhe ne më parë uleshim rreth tij, nëpër vendvështrime të përshtatshme për të dëgjuar diç, por ai që përgjon tani, do të hasë në shigjeta të zjarra (meteorë) që janë në pritje (pusi)”. (Xhinn, 9).

## **SHEJTANËT**

Shejtanët janë xhinnë pabesimtarë. Iblisi është babai i tyre. Disa dijetarë theksojnë se Iblisi është nga melekët, por e vërtetë dhe e drejtë është se ai është nga xhinnët për arsyet vijuese:

1. All-llahu xh.sh. qartë e thotë këtë në Kur'an: “Të gjithë i bënë sexhde, përpos Iblisi. Ai ishte nga xhinnët, prandaj nuk respektoi urdhrin e Zotit të vet!”, - (Kehf, 50).
2. Iblisi nuk e respektoi urdhrin e Zotit të vet, ndërsa melekët: “...nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai urdhëron”. (Tahrim, 6).
3. Kur’ani qartë pohon se ata janë të krijuar nga zjarri: “Ai (Iblisi) tha: Unë jam më i vlefshëm se ai, më krijoje mua nga zjarri, e atë e krijoje nga balta!”, - (A’raf, 12).

## **KUR’ANI RRETH SHEJTANËVE**

1. Shejtani është armiku i parë i njerëzve. E ka nxjerrë babain e tyre nga Xhenneti, punon për t’i penguar që përsëri të hynë në të, i largon nga rruga e cila shpie tek ai, i mashtron dhe ua zbukuron rrugën e zjarrit. Por edhe krahas kësaj ata e pasojnë dhe i lënë dispozitat e All-llahut xh.sh., duke shkuar pas mashtrimeve të shejtanit. All-llahu xh.sh. ua tërheq vërejtjen, i qorton njerëzit për shkak të kësaj marrëzie të tyre, sepse i përgjigjen e shkojnë pas armikut të vet më të madh, i cili u dëshiron vuajtje dhe dënim, e nuk i përgjigjen Zotit të tyre, i cili i thërret në faljen dhe mëshirën e vet: “Vallë, a në vend Timin do ta merrni për mik atë dhe pasardhësit e tij, e ata janë armiq tuaj? Sa këmbim i shëmtuar është ai i jobesimtarëve”. - (Kehf, 50).
2. Ajeti paraparak na tregon se shejtanët shumohen, se kanë pasardhës, e se të gjithë ata janë pasardhës të Iblisit.

3. All-llahu xh.sh. i ka mundësuar dhe e ka lënë shejtanin që të punojë kundër njeriut, por nuk i ka dhënë fuqinë e dobisë apo të dëmit, e as nuk i ka dhënë forcën, e cila nuk mund të pengohet, por i ka dhënë aftësinë e intrigave: “Me të vërtetë intriga e shejtanit ka qenë e dobët... Asgjë nuk mund t’u bënë dëm, përveç me lejen e All-llahut... Mbi ta nuk ka patur kurrfarë pushteti.”- (Kur’ani).

4. Puna e tij është fanitja, mashtrimi, thirrja në të keqe e poshtërsi: “Shejtani ju frikëson juve me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të shëmtuara...!”,- (Bekare, 267). “Ai u premtonte atyre dhe i joshë me shpresa të kota, e ato që ua premtonte shejtani janë vetëm mashtrime.”- (Nisa, 120).

I nxitë në alkool, bixhoz e të ngjashme: “...punë të ndyta, vepër shejtani”. (Maide, 90), i tërë programi përmbledhet në kob, poshtërsi e përçarje. Pika e parë në këtë program dhe gjëja e parë me të cilën e ka mashtruar Ademin e Havën, është të zbuluarit e trupit: “O bijtë e Ademit, të mos ju mashtroni kurrsesi shejtani, ashtu siç i nxori prindërit tuaj nga Xhenneti, duke ua zhveshur rrobat që t’u duken pjesët e turpshme të tyre”.- (A’raf, 27). Kështu, zhveshja e rrobave dhe ekspozimi i pjesëve të turpshme ka qenë pika e parë e planit të shejtanit. Njëra nga dredhitë e Iblisit është që në sytë e trashëgimtarëve të vet t’ua hijeshojë veprën e shëmtuar, ashtu që ta shohin si të bukur: “Dhe ua ka zbukuruar shejtani atë që e kanë punuar”.- (En’am, 43).

Ai i nxitë shokët e vet që t’ua hedhin besimtarëve dyshimin në fytyra, e t’i largojnë nga thirrja kah e vërteta me polemika e diskutime të ndryshme. All-llahu xh.sh. për këtë na e tërheq vërejtjen e thotë: “E shejtanët i nxisin miqtë e vet që të polemizojnë me ju...!”,- (En’am, 121). Dhe mos iu përgjigjini e mos iu bashkangjitni në idhujtari: “E nëse ju përuleni atyre, atëherë edhe ju me siguri

bëheni idhujtarë.”- (En’am, 121). Shejtani i largon besimtarët nga kujtimi në All-llahun xh.sh., ashtu që ta harrojnë (All-llahun xh.sh.), e mandej të bien në mëkat: “Ata i ka mbizotëruar shejtani dhe i ka bërë që ta harrojnë All-llahun”. (Muxhadele, 19). Por: “Ata të cilët i frikohen All-llahut, posa i prekë ndonjë iluzion (cytje) nga shejtani, ata përkujtojnë (All-llahun), dhe atëherë shohin (të vërtetën)”. - (A’raf, 201).

5. Shejtani me gjithë këmbënguljen e tij, në bërjen e çrregullive, armiqësinë ndaj njeriut, e sulmon atë nga të gjitha anët, vendos prita (pusi), e mashtron me zë, vërsulet me të gjitha mjetet, kërkon pjesëmarrje në pasuri e fëmijë, pranë gjithë kësaj ai nuk posedon asgjë pos mashtrimeve e nxitjeve për vepra të këqija. Nuk mund t’u bëjë dobi e as dëm njerëzve. Kur shejtanët e pabesimtarët do të grinden në Ahiret, do t’ju thotë shejtani: “...po unë nuk pata kurrfarë pushteti ndaj jush (që t’ju detyroj), përpos që ju thirra (në rrugë të gabuar), e ju m’u përgigjët: atëherë, pra, mos më qortoni mua, po qortoni veten”.- (Ibrahim, 22). Kur Iblisi e luti Zotin e vet që t’ia shtyejë vdekjen, Ai ia pranoi lutjen: “Zoti im” – tha (Iblisi) – për atë që më ke shpie në humbje, unë në Tokë do t’ua zbukuroj atyre të këqijat e do të mundohem që të gjithë ata t’i mashtroj, përveç atyre robërve Tu të sinqertë”. - (Hixhr, 39-40). All-llahu xh.sh. tha: “Kjo është rruga ime e drejtë. Ti, me të vërtetë, nuk ke kurrfarë pushteti ndaj robërve të Mi, përveç atyre të humburve, që të pasojnë ty”.- (Hixhr, 41-42). “Me të vërtetë, ai nuk ka kurrfarë pushteti ndaj atyre që besojnë dhe të (cilët) mbështeten te Zoti i tyre; pushteti i tij është mbi ata, të cilët e marrin atë si mbrojtës dhe që i bëjnë All-llahut shokë të barabartë”.- (En-Nahl, 99-100).

6. Ai i poshtëron miqtë e pasuesit e vet, i braktisë në momentet e vështira dhe e shkel marrëveshjen: “Kur shejtani ua zbukuroi veprat atyre e u tha (në Ditën e Bedrit-meshkujve të Mekkes): “S’ka kush që mundë t’ju mposhtë sot juve, unë jam mbrojtësi juaj!”, - e kur u ndeshën

dy palë kundërshtare, ai u tërhoq prapa dhe tha: “Unë nuk kam asgjë me ju, unë shohë atë që nuk e shihni ju (d.m.th. melekët të cilët atëherë zbritën t’u ndihmojnë besimtarëve) dhe unë i frikësohem All-llahut. All-llahu ndëshkon shumë ashpër!”- (Enfal, 48). “Janë të ngjashëm ata me shejtanin kur i thotë njeriut: “Bëhu mosbesimtar!” – e kur ai të bëhet mohues, atëherë ai (shejtani) i thotë:”Unë jam larg prej teje, unë me të vërtetë i frikohem All-llahut, Zotit të botëve!”- (Hashr 16).

## **SHEJTANËT NË FORMË TË NJERIUT**

Kjo është pjesë e veçorive të shejtanit, të cilat përmenden në Kur’an, që me qëllim të përhapjes së amoralitetit, mosbesimit, zbulimit të pjesëve të turpshme të trupit, ua zbukuron në sytë e njerëzve veprat e shëmtuara, ashtu që të mos i braktisin, nxitë dyshimet, polemizon duke u shërbyer me gënjeshtria, nxitë në armiqësi e përçarje midis besimtarëve, e kur t’i përgjigjen dhe fillojnë t’i pasojnë, e iu nevojitet ndihma e tij, e thërrasin që t’u ndihmojë, ai i braktisë. Dhe çdokush nga njerëzit që stoliset me veçori të këtilla, ai është sikurse shejtani: “Thuaj: “Mbështetemi në Zotin e njerëzve, Sunduesin e njerëzve, Hyun e njerëzve. Prej të keqes së cytësit që fshehet. I cili bën cytje në zemrat e njerëzve-qoftë ai (cytësi) nga xhinnët o nga njerëzit”.- (Nas).

Pra kush nxitë në amoralitet dhe ua shfaq atë njerëzve përmes fotografive të neveritshme, tregimeve të paturpshme, apo letërsisë amorale, ai është shejtan në formë të njeriut. Kush thërret në fanatizmin e xhahilijetit (të ri apo të vjetër) dhe në fraksione të cilat ummetin e Muhammedit,

sal-la-llahu alejhi ve selem, e ndajnë në grupacione të shumta, ai bën pjesë në këtë lloj të shejtanit. Kush i pengon apo largon njerëzit nga rruga që shpie në Xhennet, e i drejton në rrugën e Xhehennemit dhe i bënë që ta harrojnë All-llahun xh.sh. dhe Ditën e Gjykimit, ai është po ashtu nga ky lloj i shejtanit: “Dhe thuaj: “O Zoti im, te Ti mbështetem për mbrojtje nga iluzonet e shejtanëve, dhe ty të mbështetem o Zoti im (të më mbrosh), që ata të mos më afrohen!”,- (Mu’minun, 97-98).

## **BESIMI NË PEJGAMBERËT A.S.**

Ajo që Kur’ani pikësëpari e vërteton, është se melekët, xhinnët e pejgamberët janë krijesa të All-llahut xh.sh. dhe robë të Tij. Ai i ka krijuar, me ta sundon dhe ata nuk janë në gjendje vetes t’i bëjnë dobi apo dëm, e lëre më të tjerëve, përveç me lejen e All-llahut xh.sh. Të gjithë pejgamberët janë të gjinisë njerëzore, linden sikurse njerëzit tjerë, vdesin, sëmuren e shërohen. Nuk dallohen nga ata në strukturën fizike, në organe, në qarkullimin e gjakut, në të rrahurit e zemrës, hanë e pinë si edhe njerëzit tjerë. Nuk kanë asgjë hyjnore në vete, sepse atributet hyjnore i takojnë vetëm All-llahut xh.sh. Ata janë vetëm njerëz të cilëve u shpallen Shpalljet. Popujt e mëparshëm i janë çuditur arritjes së shpalljes, prandaj All-llahu xh.sh. u përgjigjet duke u treguar, se nuk ka vend çudia e tyre: “Vallë, pse çuditën njerëzit që Ne ia shpallëm njërit prej tyre (duke i thënë): “Tërhiqju vërejtjen njerëzve! Kurse besimtarët përgëzoi për shpërblimin e mrekullueshëm te Zoti i tyre!”,- (Junus, 2).

Janë çuditur që peygamberi të jetë një nga njerëzit dhe kjo i ka penguar të besojnë: “Po njerëzit, nuk i pengoi tjetër që të besojnë, kur u erdhi atyre shpallja, vetëm se thoshin: “A thua All-llahu dërgoi njeriun për peygamber?”,- (Isra, 94).

All-llahu xh.sh. u përgjigjet se peygamberët rrjedhin nga e njëjta gjini e lloj sikurse ata të cilëve u është dërguar. Njerëzve si peygamber u dërgohet njëri nga njerëzit: “Thuaj: “Sikur melaiket në Tokë të ecnin qetësisht, Ne do t’u dërgonim atyre nga qielli melaikë-peygamber.”- (Isra, 95).

Kanë polemizuar me peygamberët: “Thonë: “Ju jeni vetëm njerëz si ne!”,- (Ja-Sin, 15).”Ne jemi vetëm njerëz sikur ju” – peygamberët e tyre u thonin, por All-llahu e cilëson (me peygamberllëk) kë të dojë prej robërve të Tij”. - (Ibrahim, 11).

Dhe neve bekimin e Vet na e ka dhënë, na ka shpallur Sheri’atin e na urdhëroi që njerëzve t’ua përcjellim e t’ua kumtojmë: “E ata thonë: “Ç’është me këtë peygamber, han ushqim dhe shëtitë nëpër tregje; përse të mos jetë i dërguar një melek së bashku me të, e të jetë qortues!”,- (Furkan, 9).

All-llahu xh.sh. duke iu drejtuar Muhammedit, sal-llahu alejhi ve selem, i përgjigjet: “Ne edhe para teje kemi dërguar vetëm peygamberë, të cilët hanin ushqim dhe shëtisnin nëpër tregje.”- (Furkan, 20). Ata thonë: “Është dashur t’i zbresë atij (Muhammedit) meleku! E, sikur ta dërgonim Ne melekun, puna e tyre do të merrte fund dhe nuk do t’u jepej asnjë afat. E sikur ta bënim Ne atë (peygamberin) melek, do ta bënin gjithsesi me tipare njeriu e ata, përsëri do të dyshonin si më parë”.- (En’am 8-9).

## THELBI DHE REALITETI I PEJGAMBERËVE

Pejgamberi është njeri i cili dallohet me atë se i ka ardhur Shpallja. All-llahu xh.sh. i tha Muhammedit, sal-la-llahu alejhi ve selem: “Thuaj: “Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju, mua më shpallet...!”,- (Kehf, 110). Natyrën e tij njerëzore e dëshmon përdorimi i shprehjes “vetëm” dhe “sikurse edhe ju”. Ai është i ngjashëm me ne në konstruksionin fizik, natyrën e qenies, por ne nuk jemi si ai në moral, cilësi, madhështi. Po të mos ishte Pejgamberi i fundit i All-llahut xh.sh., Muhammedi s.a.v.s., do të ishte pa kundërshtim kolosi e heroji më i madh në histori. Pra, nëse ka qenë sikurse edhe ne, i është lejuar ajo çka na është lejuar edhe neve, atëherë a ka gabuar sikur që gabojmë edhe ne?

Përgjigjja:

1. Gabime ka të shumëllojshme dhe në shumë fusha. Sa u përket gabimeve në komunikimin e Shpalljes në shpjegimin e Sheri’atit, ato nuk mund të ndodhin te asnjë pejgamber: Sepse kur Pejgamberi transmeton e shpjegon Sheri’atin: “Ai nuk flet me hamendje-ajo nuk është tjetër vetëm se Shpallje që i shpallet”,- (En-Nexhm, 3-4). All-llahu xh.sh. thotë: “O njerëz, pejgamberi ua ka sjellur të vërtetën nga Zoti juaj”,- (En-Nisa, 170). Dhe është e pamundshme që Pejgamberi të gabojë pas ardhjes së shpalljes, apo të veprojë diç që i kundërvihet ndershmërisë, drejtësisë e përsosurisë së moralit, sepse All-llahu xhle shanuhu e ka bërë shembull dhe u ka urdhëruar muslimanëve që ta pasojnë në çdo gjë: “Ju keni shembull të mrekullueshëm në Të Dërguarin e All-llahut”,- (Ahzab, 21). Kjo shëmbëlltynë e përsosuri është e dëshmuar te të gjithë pejgamberët: “Te ata keni shembull të mrekullueshëm”,- (Mumtehine, 6). Kjo shëmbëlltynë kërkon mbrojtje nga mëkatet.

2. Gabimi në çështje të Sheri'atit për të cilën Shpallja nuk flet asgjë dhe në të cilën Pejgamberi ka përdorur ixhtihadin.

Ky lloj gabimi mund t'iu ndodh pejgamberëve, por All-llahu xhle shanuhu nuk lejon që ky gabim të mbetet, por ua shpjegon dhe tregon për të vërtetën për atë çështje, sikur që i ka ndodhur Muhammedit s.a.v.s. në rastin me të verbërin, e pastaj me robërit e Bedrit, me ç'rast Pejgamberi ka përdorur ixhtihadin. E All-llahu xhle shanuhu ia ka treguar zgjedhjen e drejtë në atë çështje. Kam menduar për qëndrimin e Resulullahut s.a.v.s. atë ditë kur i ka ardhur i verbëri, e i thashë vetes: Sikur All-llahu xhle shanuhu të mos i kishte shpallur këto ajete nga kaptina “Abese”, e sikur qëndrimi i Pejgamberit të parashtrohej e të ekspozohej para “mendjeve” të kësaj bote, politikanëve e dijetarëve, a do të thoshte ndonjëri nga ata se në qëndrimin e Pejgamberit ka diç që meriton kritikë, apo që të gjithë do të thonin se ajo si ka vepruar Resulullahu është veprim i drejtë? Pejgamberi s.a.v.s. përpiqet t'u afrohet personaliteteve më autoritative në popull e t'i përfitojë për Islam dhe në atë moment vjen një nga pasuesit e tij dhe e pyet për një çështje e cila nuk kërkon zgjidhje urgjente, as që në shtyerjen e zgjedhjes së saj ka dëm dhe mund që ta parashtrijë në çfarëdo kohe tjetër dhe Pejgamberi e shtyen përgjigjen derisa të mos e përfundojë bisedën të cilën e bënte me udhëheqësit e Kurejshitëve. A do të bënte ndokush nga njerëzit diç tjetër? A ka dikush në botë i cili nuk do të thotë se veprimi i tij ka qenë i drejtë? Ai është i drejtë sipas peshojave logjike njerëzore, por pas ardhjes së Shpalljes me peshojë e kriter tjetër, u bë e qartë se kriteri i All-llahut xh.sh. është më i drejtë se kriteri i njerëzve dhe se gjykimi i Atij i cili e ka krijuar mendjen, është më i drejtë se gjykimi i mendjes. Ky është gjykim i urtë e i drejtë, ndërsa të gjykuarit e mendjes është i gabuar.

Ngjashëm me këtë mund të thuhet edhe për qëndrimin e Pejgamberit s.a.v.s. ndaj robërve në Betejën e Bedrit. Vendimi i Pejgamberit është i gabuar në krahasim me vendimin e All-llahut xh.sh. Por, sikur të mos vinte Shpallja duke proklamuar gabimin e Pejgamberit s.a.v.s, vendimi i tij në sytë e mendimtarëve më të mëdhenj do të ishte i drejtë. Ky rast nuk është shembull i gabimit që i ka ndodhur Pejgamberit si njerit nga kolosët e njerëzimit, por në të është dëshmia se Shpallja e qiellit është mbi mençurinë e Tokës.

3. Gabimi në çështjet administrative e luftarake. Ky lloj i gabimit mund t'i ndodh Pejgamberit sepse ai është njeri dhe mendon në këto çështje me të menduarit njerëzor. As'habët në situatat e tilla pyetnin se vendimi të cilin e ka marrë a ka ardhë me shpallje, apo është rezultat i të menduarit (ixhtihadit)? E nëse i lajmëronte se ai vendim nuk është urdhër i All-llahut, xh.le shanuhu, por është mendim individual, ia parashtronin mendimet e veta dhe ai i pranonte apo i refuzonte ato. Kjo ka ndodhur me rastin e zgjedhjes së pozitës për vendqëndrim në Betejën e Bedrit, kur as'habët e pyetën. “O I Dërguari i Zotit, këtë pozitë a ta ka caktuar All-llahu e që nuk mund ta ndryshojmë, apo është rezultat i të menduarit e strategjisë tënde? Dhe kur ua shpjegoi se ai është mendim i tij personal, i propozuan një plan tjetër dhe ai e pranoi atë. Diç e ngjashme ndodhi edhe me rastin e hapjes së kanalit në Betejën e Hendekut, pastaj me rastin e vendosjes së paqes me Gatafanin.

4. Sa u përket gjërave thjesht të kësaj bote, Pejgamberi s.a.v.s. ka folur për to sipas mendimit të vet personal. Mund të ndodhë që të gabojë në çështjet teknike, bujqësore e medicinale të cilat zakonisht i njohin vetëm ekspertët e atyre lëmenjve, siç ka gabuar në çështjen e plehërimit artificial të hurmave. Në këtë nuk ka kurrfarë të mete, apo mungese, sepse nuk mund të kërkohet nga kolosët, e madje qofshin dijetarët më të mëdhenj të botës, të dinjë gjithë atë që e dinë

ekspertët për industri, zejtari, bujqësi, tregti e profesione të tjera. Çështja e plehërimit të hurmeve është çështje agrare, sekondare, për të cilën Pejgamberi s.a.v.s. e ka paraqitur mendimin e vet momental. Nuk i ka obliguar me atë mendim dhe nuk ka thënë se kjo është pjesë e besimit dhe se ky mendim është shpallje nga All-llahu xh.sh. Pasi e ka vërejtur gabimin e vet, ka thënë: “Ju më mirë i dini punët e kësaj bote”.

## PEJGAMBERI NUK E DI GAJBIN

Kur’ani kategorikisht thotë se Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve selem, nuk e di gajbin. All-llahu xh.sh. e urdhëron në Kur’an, që t’i njoftojë njerëzit, se ai nuk e di gajbin: “Thuaj: “Unë nuk u them juve se i kam në kompetencë depot e All-llahut, as nuk pretendoj se i di fshehtësitë, as nuk ju them se unë jamë melek, unë ndjek vetëm atë që më shpallet mua.” - (En’am, 50). “Thuaj: “Unë nuk kam mundësi për vete të siguroj ndonjë dobi, e as të largoj nga vetja ndonjë dëm. Bëhet vetëm ashtu si don All-llahu. Sikur t’i dija fshehtësitë, do t’i shumoja të mirat dhe nuk do të më prekte asnjë e keqe. Unë jam vetëm një qortues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë”. - (A’raf, 188). Resulullahu s.a.v.s. i ka njoftuar njerëzit me këtë dhe ua ka përcjellë këto ajete të cilat kanë mbetur në Kur’an që të lexohen në xhamia e namaze.

## **PEJGAMBERËT JANË TË SHUMTË, NDËRSA THEMELET DHE PARIMET E MISIONEVE TË TYRE JANË UNIKE**

All-llahu xh.sh. thotë në Kur'an se çdo popull ka pasur pejgamber. “E nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur ai i cili e ka paralajmëruar.”- (Fatir, 24). “Çdo popull ka pasur pejgamber.” - (Junus, 47).

Por, All-llahu xhshanuhu nuk i ka përmendur të gjithë ata në Kur'an, por vetëm disa prej tyre: “...edhe pejgamberë, për të cilët të kemi treguar më parë dhe pejgamberë për të cilët nuk të kemi treguar aty”.- (Nisa, 164).

Të gjithë ata janë të dërguar me teuhid-monoteizëm të pastër, besim në Ditën e Gjykimit, e me obligim të pasimit të Sheri'atit. Themelet islame janë të njëjta, ato me të cilat janë dërguar pejgamberët e mëparshëm. “Ai ua përcaktoi juve në fe atë që ia pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty, dhe atë me çka i patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain (I porositëm): Ta predikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të!”,- (Shura, 13). Ka dërguar çdo pejgamber popullit të tij dhe ka bërë misionin e tij pejgamberik në gjuhën e popullit përkatës, ashtu që të mund të kuptojnë e perceptojnë. “Ne nuk kemi dërguar asnjë pejgamber, përpos në gjuhën e popullit të tij, për t'u shpjeguar atyre (e ta kuptojnë)”.- (Ibrahim, 4).

E përfundoi dërgimin e pejgamberëve me misionin e Muhammedit s.a.v.s. dhe e bëri të përgjithshëm e të obliguar për të gjithë. Ndërsa atë e ka bërë vulë dhe pejgamber të fundit dhe pas tij nuk do të vijë pejgamber tjetër, e as që do të dërgohet shpallje e re. Me misionin e tij pejgamberik feja është përkryer e është plotësuar dhuntia: “ Sot ua kam përsosur fenë tuaj dhe e

kam plotësuar dhuntinë Time ndaj jush, dhe jam i kënaqur që Feja Islame të jetë fe e juaj”. - (Maide, 3).

## PYETJA DHE PËRGJIGJJA NË TË

Ndoshta dikush do të pyesë: Përse Muhammedi s.a.v.s. është I Dërguari i të gjithë njerëzve, ndërsa çdo pejgamber tjetër i është dërguar popullit të vet dhe si misioni i tij ashtu edhe shpallja e cila i ka ardhur do të mbeten deri në Ditën e Gjykimit, pa kurrfarë ndryshime?

Përgjigjja: (All-llahu xh.sh. më së miri e di) Sheri’ati islam është karakteristik sipas elasticitetit të vet. Është i përshtatshëm për çdo kohë e vend. Besimi islam (akaidi) dhe ibadetet janë të caktuara me tekste të detajizuara, të hollësishme e kategorike, të cilat nuk pranojnë kurrfarë ndryshimi as plotësimi, ngase akaidi dhe ibadeti nuk ndërrohen me ndryshimin e kohës, e as nuk dallohen për shkak të dokeve të ndryshme. Ndërsa, format kushtetuese (sistemet shtetërore), strukturat ekonomike e administrative, në të cilat ndikon ndryshimi i kohës e dokeve, janë të caktuara me tekste të përgjithshme të cilat paraqesin parimet kryesore të Sheri’atit, kurse neve na është lënë që çdo kohe t’i afrojmë atë çka i përgjigjet, me kusht që të ruhen këto parime e baza.<sup>18</sup> Do ta ilustroj këtë me disa shembuj, të cilët shkurtimisht do t’i paraqes. Islami kërkon që udhëheqësi të jetë i

---

<sup>18</sup> Kjo ka të bëjë vetëm në çështjet për të cilat flasin tekstet e përgjithshme, por çështjet të cilat tekstet (Kur’ani dhe Sunneti) detajisht e hollësisht i trajtojnë e i zgjedhin (e shumica e teksteve janë të tilla) jemi të obliguar që t’i aplikojmë ato dispozita pa marrë parasysh ndryshimin e kohës e hapsirës.

zgjedhur me vullnetin dhe mendimin e popullit, të posedojë karakteristika që i mundësojnë kryerjen e përgjegjësisë së udhëheqjes e qeverisjes, t'i përmbahet kushtetutës islame (Kur'anit) e të këshillohet me individët kompetentë e me ndikim. Ndërsa neve na ka lënë që të caktojmë mënyrën e zgjedhjes (bej'a) të halifes, individët me të cilët do të kuvendojë dhe mënyrën e kuvendimit. Na ka obliguar që të gjykojmë midis njerëzve sipas drejtësisë, ndërsa neve na ka lënë ta caktojmë rrugën që shpie në drejtësi (aspekti teknik i problemit,-vër. e përk.), mënyrën e emërtimit të gjyqtarëve e parimeve të procedurave gjyqësore.

- I ka caktuar parimet e përgjithshme e normat e marrëveshjeve, të cilat kërkojnë aftësinë juridike të palëve kontraktuese, lirinë e tyre, formulimin e drejtë të kontratës, dëshirën e palëve kontraktuese dhe lëndën e kontratës.

- Ka ndaluar llojet e caktuara të marrëveshjeve, nga të cilat rrjedh dëmi i përgjithshëm, apo mashtrimi i njërit nga palët e kontraktuara. Ndërsa neve na ka lënë çështjen e detajeve të të gjitha llojeve të lejuara të marrëveshjes. Ka lejuar iniciativën personale në punë, në transaksione financiare etj. Asgjë nga kjo nuk është e ndaluar, përveç nëse ka tekst të veçantë, i cili atë e ndalon apo hyn në kuadër të parimeve të cilat e ndalojnë.

- Na i ka hapur dyert e “istislahit” (ndërmarrjen e masave të caktuara dhe veprimeve me dobi të përgjithshme për shoqërinë islame). Dhe çdo send e masë, të cilat janë të dobishme për shoqërinë islame, e të cilat Sheri'ati nuk i urdhëron e as nuk i ndalon, nëse udhëheqësi i muslimanëve (halifa) urdhëron që të aplikohet, aplikimi i tij është obligim fetar-vaxhib, siç janë ligjet për veprimtarinë financiare, procedurat gjyqësore, rregulloret administrative, sistemet e komunikacionit, sistemit komunal, etj. Në Islam ka elasticitet, i cili e bën të përshtatshëm e të

volitshëm për çdo kohe e hapësirë. Por, disa juristë të vonshëm, për shkak të të kufizuarit të mendjes e pikëpamjeve, ua kufizojnë e ngushtojnë njerëzve atë që Sheri'ati u ka lënë hapësirë të gjerë ashtu që i detyrojnë, siç thotë Ibn-ul-Kajjimi, në librin e vet “Et-turuku-l-humijje”, të kërkojnë gjerësi në zgjedhjet joislame. Shkaku tjetër është se popujt (në kohën e pejgamberëve të mëparshëm) kanë jetuar në izolim, mes tyre nuk ka pasë afrim as komunikim, përveç me ndihmën e kuajve e deveve. Pas ardhjes së Shpalljes, Muhammedit s.a.v.s., popujt kanë filluar të njoftohen mes vete, i largëti është bërë i afërt, largësitë gradualisht janë zvogëluar, derisa nuk arritën në kohën, kur p.sh. në Amerikë mbahet diskutimi e ai në Kinë dëgjon më parë se sa të dëgjojë dëgjuesi i cili qëndron pranë diskutuesit. E tërë bota është bërë si një shtet, apo një qytet, ndërsa popujt si një popull. Sikur muslimanët ta kryenin obligimin e thirrjes në Islam dhe përcjelljes së mësimit islam njerëzve, kjo thirrje do ta përfshinte tërë tokën.

## **ISLAMI NUK BËN DALLIM MES PEJGAMBERËVE**

Edhe pse në mesin e pasuesve të pejgamberëve të mëparshëm (atyre të cilët thonë e mendojnë se i takojnë ndonjërit nga ata), ka të atillë që ofendojnë, nënçmojnë e sulmojnë pejgamberin tjetër, Islami e urdhëron muslimanin t'i respektojë e t'i lavdërojë të gjithë pejgamberët. E nëse për njërin nga ata flet keq, ofendon apo e nënçmon, e ka braktisur rrugën islame: “Pejgamberi beson në atë që i është shpallur nga Zoti i Tij, edhe besimtarët – të gjithë ata besojnë në All-llahun melekët e Tij dhe pejgamberët e Tij: “Ne nuk e dallojmë asnjërin nga pejgamberët e Tij”. Dhe ata thonë: “Dëgjuam dhe u përulëm”; falna neve o Zoti ynë; te Ti do të kthehemi”.- (Bekare, 285).

Muslimani e don Musain a.s., Isain a.s. dhe pejgamberët tjerë, siç e don Muhammedin s.a.v.s., i respektonte e i lartëson siç e respektonte dhe e lartëson Muhammedin s.a.v.s.

Çifuti që e ka pranuar Krishterimin pas ardhjes së Isaut a.s., nuk e ka humbur Musain a.s., ndërsa e ka fituar Isaun a.s. Krishteri që sot e pranon Islamin, nuk e humbë Isaun a.s. e as Musaun a.s., ndërsa e fiton së bashku me ta Muhammedin s.a.v.s. Le të jetë salavati i All-llahut xh.le shanuhu mbi Muhammedin s.a.v.s. dhe mbi të gjithë pejgamberët e tjerë.

## **KUR'ANI RRETH PEJGAMBERËVE**

Muslimani beson se Kur'ani është fjalë e All-llahut xh.sh., të cilën Xhibrili ia ka përcjellur Muhammedit s.a.v.s., ndërsa ai ua përcolli njerëzve ashtu si e ka dëgjuar nga Xhibrili dhe beson se ajo që është midis kopertinave të Mus-hafit është Kur'ani i tërë, siç e ka sjellë Xhibrili. Dhe kush mohon, apo dyshon në çkado qoftë nga kjo, ka dalur nga Islami. Në Kur'an janë të përmendur 25 pejgamberë, emrat e të cilëve janë përmbledhur në pesë ajete: “Këto janë argumente Tona që ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij. Ne ngrisim në shkallë të lartë atë që duam. Zoti yt është me të vërtetë i Urtë, i Gjithëdijshtëm. Ne ia dhuruam atij (Ibrahimit) Is'hakun dhe Jakubin; secilin e kemi udhëzuar – ndërkaq Nuhin e patëm udhëzuar qysh më parë – nga pasardhësit e tij Davudin dhe Sulejmanin, edhe Ejubin dhe Jusufin, Musën dhe Harunin. Ashtu Ne i shpërblejmë ata të cilët bëjnë vepra të mira – edhe Zekeriaun, dhe Jahjaun edhe Isaun e Iljasin – të gjithë këta

kanë qenë të mirë. Edhe Ismailin, edhe Eljesaun dhe Junusin e Lutin – të gjithë këta i kemi lavdëruar nga të tjerët”.- (En’am, 83-86).

“Dhe përmende, në libër Idrisin! Ai ishte shumë i sinqertë, peygamber, dhe Ne e ngritëm atë në vend të lartë”. (Merjem, 56-57).

“Edhe te (populli) Themudu dërguam vëllain e tyre Salihun... E në Medjen vëllain e tyre Shuajbin”. (A’raf, 73-85) “Edhe Ismailin, Idrisin dhe Dhulkiflin, të gjithë këta kanë qenë të durueshëm”.- (Enbija, 85).

Në Kur’an përmendet edhe Ademi, por nuk është thënë në mënyrë të prerë se ka qenë peygamber. Njëzet e pesë peygamberë. Disave prej tyre iu përmendën vetëm emrat si Idrisit dhe Dhulkiflit, disave u paraqitet historia në pika të shkurtra siç është rasti me Ismailin, Is’hakun dhe Junusin alejhimus-selam, ndërsa disave nga ata u paraqitet historia e tyre detajisht e hollësisht, si Ibrahimit, Musait, Jusufit e Isait alejhimu-s-selam.

Çdo gjë që paraqitet në Kur’an për historinë e peygamberëve dhe ngjarjeve nga jeta e tyre, është e vërtetë që duhet besuar. “Disa nga peygamberët i kemi dalluar më shumë se disa të tjerë. Me disa prej tyre ka folë All-llahu, kurse disa prej tyre i ka lartësuar në shkallë të lartë”.- (Bekare, 253).

## MU'XHIZET

Kur është ngritur Muhammedi s.a.v.s. gjatë kohës së Isra's nga Mekka në Kudsi Sherif, ka shkuar dhe është kthyer brenda vetëm një nate. Kurejshitet në këtë nuk kanë mundur të besojnë, duke e konsideruar të pamundur, sepse kjo nuk është realizuar me mjete të njohura për ta, siç janë devet e kafshët tjera. Mirëpo, ajo që atëherë ishte e pamundur, sot është bërë gjë e zakonshme, e mundur, të cilës askush nuk i çuditet e as nuk e mohon.

Sikur dijetarit më të madh të shkencave natyrore para një apo dy shekujve t'i kishin thënë se njerëzit do të fluturojnë me mjetet nga hekuri e çeliku nëpër ajër, se do të depërtojnë përtej rrethimit ajror, e se fjalimin e folësit dhe ligjërimin e ligjëruesit do ta incizojnë, e pastaj kujt të dëshirojnë t'ia riprodukojnë, edhe në qoftë se ka vdekur ligjëruesi apo folësi, do të thoshte se kjo është e pamundur edhe pse sot kjo ndodh dhe është bërë e njohur. Pra, si është realizuar e pamundshmja?

Përgjigjja: Të pamundshmet i kemi dylojesh: praktikisht e pamundshme, siç janë sendet të cilat i përmenda më parë dhe teoretikisht apo kuptimisht e pamundur, sikur bashkimi i dy kontrasteve, p.sh. ekzistimi dhe mosekzistimi. Ashtu një i njëjti njeri nuk mund njëkohësisht të jetë i pranishëm dhe jo i pranishëm në të njëjtin vend.

Po ashtu edhe ndryshimi i identitetit të ndonjë sendi, ashtu që libri – në kohën derisa është libër nuk është Mu'alakë (njëra nga shtatë këngët e zgjedhura nga koha e injorancës).

Realizimi i asaj që teoretikisht është e pamundur, është i papërfytyrueshëm. Ndërsa, sa i përket praktikisht të pamundshmes, veç kemi parë se si shkenca (të njohurit e ligjeve natyrore nga

njeriu)<sup>19</sup> e ka bërë të mundshme. E pra, a është Krijuesi, i cili i caktoi këto ligje, i paaftë që ta bëjë të mundshme?! Nuk ka kurrfarë dyshimi në fuqinë e Tij që atë ta bëjë. Prandaj, realizimi i të pamundshmes praktikisht është i mundur për All-llahun xh.le shanuhu, pra nëse haberi – lajmi të cilin e transmeton është i vërtetë dhe i saktë, ne bëhemi të sigurt dhe fortë të bindur në realizimin e tij.

## KERAMETET

Në Kur'an janë të përmendura tri lloje ku praktikisht realizohet e pamundshmjia: Lloji që u ka ndodhur pejgamberëve, pas provokimeve të popujve të tyre, si dëshmi e pejgamberllëkut të tyre dhe vërtetim i sinqeritetit të tyre, dhe quhet mu'xhize. Kështu Ibrahim i a.s. është hedhur në zjarr e All-llahu xh.sh. natyrën e zjarrit e ndryshoi dhe e bëri të ftohtë e shpëtimtarë (për Ibrahimin a.s.). Musai a.s. e hodhi shkopin e tij, i cili u shndërrua në gjarpër, e po ashtu me shkop i ra shkëmbit e nga ai buroi uji, pastaj edhe detit i ra e në mes u nda që njerëzit të kalojnë. Isai a.s. me vullnetin e All-llahut xh.sh. i ka ngjallur të vdekurit. Kështu janë të gjitha mu'xhizet në Kur'an. Lloji i cili u ndodhi robërve të mirë të All-llahut, të dashurve të Tij, evlijave siç është p.sh. të gjeturit e ushqimit të Merjemja në tempull-mihrab dhe të barturit e arshit-ronit të mbretëreshës Belkise nga Jemeni në Palestinë për më pak se një lëvizje e syrit, nga ana e atij që i është dhënë

---

<sup>19</sup> D.m.th. ligjeve të All-llahut në kozmos.

dituria nga Libri, kjo quhet Keramet. Dhe lloji që i ndodh kafirit – pabesimtarit, siç është rasti me Samiriun, i cili izraelitëve ua bëri viçin nga ari që pallte, e kjo quhet mashtrim.

Obligim është, së pari: të besohet se të tri këto gjëra janë të realizueshme dhe së dyti obligim është: të besohet veç e veç në tërë atë që është në lidhje me këtë, e përmendur në Kur'an. Sa u përket kerameteve që njerëzit i transmetojnë, duke ua përshkruar disave që i quajmë evlija, ato janë habere – lajme që mund të jenë të vërteta dhe të rrejshme. Prandaj, nëse i ndodh të dashurit të All-llahut, robit të Tij të mirë (evlijasë), e evlija është ai që beson dhe i frikësohet All-llahut.

“Me të vërtetë për të dashurit e All-llahut nuk ka frikë as pikëllim; për ata që besojnë dhe që i druajnë All-llahut”.- (Junus, 62-63). Dhe nëse në vete nuk përmban mëkat dhe beson në të, nuk ke gabuar. E nëse sheh se ajo tek ti nuk është e besueshme dhe e mohon, po ashtu nuk ke gabuar.

Mirëpo, nëse kerameti të cilin dikush vetes ia përshkruan, apo i përshkruhet – përmban në vete mëkat (m'asijjet), apo i ndodh pabesimtarit, apo atij i cili nuk është i devotshëm, atëherë ajo nuk është keramet.

## **MU'XHIZEJA DHE MAGJIA (SIHRI)**

Kur është bërë garimi ndërmjet Musait a.s. dhe magjistarëve (të Faraonit), ata i hodhën litarët dhe shkopinjtë e tyre dhe njerëzve iu dukën si të ishin gjarpërinj, ndërkaq Musai a.s. e hodhi shkopin e

vet dhe ai u shndërrua në gjarpër e i gëlltiti gjarpërinjtë e tyre. Pra, a janë këto gjëra të njëjta? A është vepra e Musait a.s. e të njëjtës natyrë si edhe vepra e magjistarëve të Faraonit?!

Nëse është e të njëjtës natyrë, e pse atëherë magjistarët u bënë besimtarë? Vepra e magjistarëve ishte mashtrim optik për sy dhe gënjeshtër për njerëz. U janë paraqitur d.m.th. kanë bërë që t'i shohin gjarpërinjtë, edhe pse litarët e shkopinjtë edhe më tutje kanë mbetur në gjendjen e tyre të mëparshme, litarë e shkopinj. Ndërsa, sa i përket shkopit të Musait a.s., ai njëmend është shndërruar në gjarpër, dhe sikur atëherë të ekzistonte fotoaparati e fotografia, do të ishte paraqitur në fotografinë e gjarprit të vërtetë, derisa gjarpërinjtë e magjistarëve do të paraqiteshin në formë të litarëve e shkopinjve. Për këtë shkak, magjistarët kaq shpejtë besuan. Ata panë diç që nuk është magji-sihr, mashtrim apo tmerrim. Panë diçka që ua dridhi zemrat e tyre, deri në atë masë që i shtyri të besojnë, dhe që besimi i tyre të arrijë kufirin i cili i ka bërë që t'i kundërvihen Faraonit të mos e përfillin atë. Ata u ballafaquan me madhështinë e All-llahut xh.sh. në të cilën besuan, ashtu që nuk i përfillën kërcënimet e Faraonit, se do t'i kryqëzojë e se do t'ua presë duart e këmbët. Faraoni është në gjendje t'i torturojë vetëm në këtë botë, e ç'është kjo botë në krahasim me Ahiretin, botën e ardhme? Dhe ç'është vuajtja e saj e përkohshme në krahasim me kënaqësitë e përhershme të Ahirtetit? Prandaj, për shkak të kësaj i deklaruan haptazi, në fytyrë dhe duke e përbuzur vendimin e tij: "...e ti bën ç'të duash, atë mund ta bësh vetëm në jetën e kësaj bote!";- (Ta-ha, 72).

Pasha All-llahun, unë jam i lindur në Islam, të parët e mi: baballarët e gjyshërit kanë jetuar në Islam, dëshiroj me gjithë shpirt të kem imanin, të cilin e kanë pasur magjistarët e Faraonit disa minuta pasi që e pranuan Islamin.

## MU'XHIZET E MUHAMMEDIT A.S.

Dy mu'xhizet e tij më të mëdha janë: Kur'ani dhe virtytet e cilësitë e tij të jashtëzakonshme, me të cilat All-llahu xh.le shanuhu e ka bërë të denjë për bartjen e misionit islam. Edhe jetëshkrimi i tij vetvetiu ka qenë mu'xhize.

Ka qenë njeri dhe All-llahu xh.le shanuhu e ka urdhëruar që ta deklarojë e ta pohojë këtë të vërtetë, duke ua zbuluar njerëzve, ashtu që mos ta marrin për zot apo t'i përshkruajnë cilësi hyjnore. I Lartësuar i ka thënë:

“Thuaj: “Unë jam vetëm njeri si ju, vetëm mua më shpallet”. - (Fussilet, 6). “Njeri sikurse ju”, me të gjitha virtytet kryesore dhe përbërjet e vetive njerëzore, megjithatë, në mesin e njerëzve plotësisht e sigurt, nuk ekziston askush si ai në madhësinë e tij, dhe All-llahu xh.sh. nuk e krijoi asnjërin nga bijtë e Ademit, sipas këtij kallëpi dhe të këtij lloji, përveç një njeriu, i cili quhet Muhammed ibn Abdullah, All-llahu e bekoftë atë, babain e tij (sipas feje) Ibrahimin, Musain, Isain dhe të gjithë peygamberët tjerë.

Do të ishte padrejtësi ndaj Muhammedit a.s. dhe padrejtësi ndaj të vërtetës, sikur ta kishim krahasuar me njërin nga një mijë kolosët, të cilët kanë shkëlqyer gjatë errësirës së historisë, nga dita e parë që kur njihet historia. Disa nga këta njerëz kolosalë kanë qenë intelektualë të mëdhenj, mirëpo me ndjenja e retorikë të dobët. Disa kanë qenë elokuentë, me imagjinatë të zhvilluar, mirëpo me ide të rëndomta. Disa janë dalluar në qeverisje e udhëheqje, por jeta e tyre dhe morali kanë qenë në nivel të moralit të njerëzve të thjeshtë e të shfrenuar. Muhammedi s.a.v.s. është i vetmi i cili e përmbledh në vete tërë madhësinë. Çdonjëri nga kolosët ka pasur të metat e

caktuara, të cilat është përpjekur t'i mbulojë e t'i fshehtë, duke u frikësuar që njerëzit të mos i zbulojnë. Mangësitë që janë të lidhura me epshet dhe familjen e tij, apo mangësitë që shpien në dobësi dhe ekstravagancë. Muhammedi s.a.v.s. është i vetmi i cili tërë jetën e vet ua zbulojnë njerëzve, ashtu që jeta e tij paraqet një libër të hapur të cilit asnjë faqe nuk i është mbështjellur, e as një rresht nuk i është fshirë, e lexon kush dëshiron.

I vetmi ai u ka lejuar as'habëve – shokëve të vet që të përhapin e ta shpallin tërë atë që buron nga ai. Merrni p.sh. Aishen, radijall-llahu anha, e cila gjatë jetës së tij dhe me lejen e tij e njoftoi tërë opinionin me sjelljet e tij në shtëpi e me familjen e tij, sepse e tërë veprimtaria e tij është Fe, Sheri'at – legjislacion, dhe sikur në mesin e lexuesve të mos ketë rini e gra, do t'u përmendja ndonjë pjesë të kësaj, e që librat e Hadithit, historisë (sira) e të fikhut janë përplot me këtë.

I kanë transmetuar nga ai të gjitha, madje edhe atë që ndodh në rastet e domosdoshmërisë njerëzore, kështu që jemi njoftuar se si ka ngrënë, si është veshur, në ç'mënyrë ka fjetur, në ç'mënyrë e ka kryer nevojën dhe si është pastruar nga ajo.

Pra, ma tregoni ndonjë kolos tjetër, i cili ka guxim që t'i ekspozohet rrezikut e t'u thotë njerëzve: “Ja e tërë jeta ime dhe të gjithë veprat e mia, mund t'i i shikoni e t'ua tregoni edhe miqve edhe armiqve, e kush nga ata dëshiron le të gjejë në to ndonjë dobësi, apo të metë”. Ma tregoni ndonjë kolos tjetër, e tërë jeta e të cilit është shënuar kaq hollësisht, ngjarjet dhe detajet e të cilit janë të njohura edhe pas një mijë e katërqind vjetësh, siç e njohim ne jetën e Pejgamberit tonë?

Madhështia shikohet në natyrën (karakterin), moralin dhe cilësitë e vetive individuale. Apo në veprat e famshme të cilat kolosi i ka bërë. Apo në gjurmët që i ka lënë në historinë e popullit të vet dhe historinë e njerëzimit. Çdo kolos posedon njërin nga këto kritere, me të cilat matet

madhështia e tij. Ndërkaq, madhështia e Muhammedit s.a.v.s. matet me të gjitha shkaqet e madhështisë dhe kështu ishte kolos i cilësive individuale, kolos i veprave, kolos i gjurmëve, të cilat i la pas vetes.

Kolosët ishin kolosë vetëm në mesin e popullit të tyre, duke u sjellë dobi aq sa u kishin sjellë dëm të tjerëve, siç janë madhështia e trimave luftarakë dhe udhëheqësve pushtues. Apo ka qenë madhështi botërore, mirëpo në sferë të kufizuar: në zbulimin e ndonjërit nga ligjet të cilat All-llahut xhile shanuhu i ka depozituar e fshehur, me qëllim që në arritjen deri te ai ligj ta angazhojnë mendjen në punë; apo në zbulimin e ilaçit të ndonjë sëmundjeje; në vënien e ndonjë teorie filozofike, në hartimin e ndonjë kryevepre letrare, ndonjë novele gjeniale apo në përmbledhjen e poezive të spikatura.

E sa i përket Muhammedit s.a.v.s., madhështia e tij është sipas vëllimit të tij, ka qenë botërore e i ka përfshirë të gjitha sferat e saj.

Ka besuar në atë që ka thirrë, derisa shumica e misionarëve që i njohim më parë edhe sot, flasin me gjuhë të kundërtën e asaj që e punojnë. Deklarojnë para njerëzve atë që nuk e punojnë kur janë vetëm, dhe mbi ta – në çastet e lakmisë, frikës, hidhërimit e nevojave, dominon natyra apo karakteri i shpirttrave të tyre, dhe harrojnë tërë atë që kanë thënë. Nuk flas për askënd personalisht, por do ta përmendi rastin tim: Unë kur mbaj ligjërat apo shkruaj artikuj të cilët thërrasin në rrugë të vërtetë, në bamirësi e udhëzime, përpiqem që shpirtërisht të lartësohem, e posa filloj të ngrihem, më mposhtë barra e natyrës sime dhe dëshirat e shpirtit të prirura kah e keqja, e prapë kthehem në tokë. Njerëzit e vërejnë këtë te vaizi (ligjëruesi) e oratori, ashtu që nuk i japin rëndësi asaj çka ata flasin, e as që vazhtojnë (ligjërat) ka ndikim te ata.

Përkundrazi, Resulullahu s.a.v.s. kurrë nuk ka thirrë në ligjëratë të përgjithshme në të cilën do t'i shpjegonte disa dispozita islame, e as që ka themeluar medrese-shkollë me orë të mësimi e me ligjëratë, as nuk rrinte në hallka-ndeja për vaz, por shpalljen që i vinte e kumtonte në shtëpi, mesxhid, në rrugë, e po ashtu urdhëronte në të mira e largonte nga të këqijat atëherë kur këtë e kërkonte nevoja. Mirëpo, këtë e fliste me gjuhë e me praktikë, e shprehte atë me fjalë e me vepra. Morali i tij ka qenë Kur'ani. Ju i dëgjoni këto fjalë, por nuk mendoni për domethënien e tyre, e domethënia e tyre, vëllezër, është: Se të gjitha veprat e tij e çdo veti e tij është moral – ajete të cilat mësohen, ligjëratat të cilat mbahen, hallkat – tubimet e derseve, ndejave e vazeve, se se të gjitha ato shqiptojnë atë që urdhëron Kur'ani.

Ka falur namazin e natës kiajmu-lejl, aq saqë këmbët i janë ënjur dhe vazhdimisht nga All-llahu kërkonte falje, e i është thënë: A nuk ti ka falur All-llahu xhile shanuhu të gjitha mëkatet e mëparshme dhe ato të ardhshmet?”. Në çka ai është përgjigjur: “A të mos jem rob-shërbëtorë i Tij falënderues?”

Nëpërmjet të gjitha veprave është gjendur në namaz (ibadet), ngase çdo vepër e mirë dhe largimi nga e keqja, si edhe puna në dobi të shoqërisë, nëse me të dëshirohet arritja e kënaqësisë së All-llahut, i llogaritet atij i cili i bënë ato si namaz. Do të ndiejë kënaqësi me sjelljen e një shembulli për imanin e tij, besimin e fortë të tij në atë që thërriste dhe vendosmërinë e tij që atë ta zbatojë në praktikë me këmbëngulje, e cila gjë ishte mbi çdo konsideratë, e si hyrje për atë shembull do të shërbehem me një ilustrim nga realiteti:

Sikur vajza nga familja më me renome, e familjes së ndonjë kolosi apo guvernatori të ishte akuzuar për hajni, çka mendoni a do të burgosej, siç do të ishte burgosur ndonjë jetime e mjerë

sikur ta kishte bërë ajo vjedhjen? Dhe a do të zbatohet ndaj saj dispozita ligjore, siç do të zbatohet ndaj jetimes së mjerë, apo në rastin e saj do të intervenonin një mijë duar, që t'ia fshehin krimin, t'ia lehtësojnë gjykimin, apo t'ia zbusin dënimin?

I njëjti rast i tillë ndodhi në kohën e Resulullahut s.a.v.s. Një vajzë me prejardhje nga njëra prej familjeve kurejshite më me renome, familja Beni Mahzum, familja e Velidit (i quajtur Vehid-i vetmi) familja e Halidit (ibni Velidit) kryetarit të udhëheqësve në fushëbetejë, familja e tretë me renome pas familjeve Hashimi e Umejje, ka vjedhur. Dhe pasi që është ndërmjetës i cili do të angazhohej për të, duke menduar se Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve selem, – pasi që e kanë njohur se e do mëshirën e faljen, do t'ia falë, ai përnjëherë pasi që ia hapën bisedën për këtë u hidhërua, duke u shpjeguar se popujt e mëparshëm e kanë përjetuar shkatërrimin, për shkak se, kur ndonjë i pasur e me autoritet në mesin e tyre ka bërë ndonjë krim (hajni) e kanë lënë, e kur këtë e ka bërë ndonjë i dobët e i pafuqishëm e kanë dënuar. Me atë rast, i shqiptoi fjalët të cilat në jetën islame përcaktuan themelin e fortë e të qëndrueshëm dhe vërtetuan se dënimi nuk pranon kurrfarë ndërmjetësimi, e as që ka falje në të: “Pasha All-llahun, sikur edhe Fatimeja (bija e Muhammedit) të kishte vjedhur, do t'ia kisha këputur dorën”.

Kjo për te ka qenë diç e natyrshme, sepse, ai ka jetuar për misionin dhe me misionin – daven. Dëshirat e tij kanë pasuar atë që i është shpallur dhe e gjithë ajo që e lidhë për njerëzit nga: lidhjet farefisnore, miqësitë e interesat, të gjitha këto shpëputen nëse dalin si pengesë në rrugën e d'avetit – thirrjes në rrugën e drejtë. Ai është liruar prej të gjitha kërkesave. Nuk synonte jetën e vetmuar të murgjive – asketizmin, apo aplikimin e urisë, sikur që e bëjnë këtë disa të cilët pohojnë për vete se janë të devotshëm – asketë. Nuk i ka veshur përherë rrobat e varfërisë, e as që është përpjekur gjithmonë të jetë me rroba të leshit (sufë). Ka ngrënë atë që i është ofruar, e nëse nuk i ka pëlqyer

– nga ajo që nuk është e ndaluar – nuk e hante, as nuk e nënçmonte, e as nuk është e njohur që ndonjëherë ushqimin e ka qortuar. E kur nuk kishte ushqim e duronte urinë, derisa nuk e ka rraskapitur ashtu që e lidhte gurin për stomaku. Ka veshur atë që e gjente (që ka pasur), duke mos u përmbajtur nga petkat e shtjerrura, të cilësisë së caktuar e as ngjyrës së caktuar. Ndonjëherë e vente imamën (turbanin) mbi kapuç, ndonjëherë imamën pa kapuç e ndonjëherë kapuçin pa imame.

Në vete mbante këmishën dhe mantelin, vishte burdën (lloj i mantelit) e xhyben, por jo siç janë këto të sotmet të gjata e me mëngë të gjera, por xhybe me mëngë të ngushta. Imama nuk ka qenë si këto të sotmet, por sikur imamat e njohura nga Ehlu-l-hixhazi (krahinë në Arabinë Saudite), copë e pëlhurës, e cila mbështillet rreth kokës, e nëse nuk ka nevojë për të hedhet mbi krah, përdoret për ndonjë nevojë në paqe apo për lidhjen e robërve në luftë, e ndonjëherë për këtë është përdorur edhe rripi. Imamet janë domosdoshmëri natyrore në Hixhaz me diellin që përcëllon. Ata me ato i kanë mbrojtur kokat nga përcëllitja e rrezeve të Diellit, prandaj është dhënë: “Imamet janë kurotat e arabëve”. Pejgamberi s.a.v.s. sa i përket imames, nuk i është përmbajtur ngjyrës së caktuar, e në ditën e çlirimit të Mekkes e kishte imamen e zezë.

Në Islam nuk ka rroba të ndaluara, përveç atyre, të cilat zbulojnë atë çka duhet të jetë e mbuluar. Ndërsa gruas muslimane nuk i lejohet që të zbuloj asgjë, përveç fytyrës e shuplakave të dorës (pranë të huajit), ndërsa për meshkujt përveç mëndafshit, rrobat të cilat janë të lidhura posaçërisht me pjesëtarët e ndonjë feje përveç Islamit – ashtu që sikur dikush t'i vishte do të mendonte se është njëri prej tyre, siç janë p.sh. rrobat e murgjve, pastaj që mashkulli të veshë ekskluzivisht rrobat e femrave apo femrat të veshin rrobat specifike të meshkujve, si edhe ato rroba në të cilat ka teprime e shpenzime pa masë. Pos kësaj të gjitha rrobat tjera janë të lejuara në Islam.

Pejgamberi s.a.v.s. nuk i ka ndaluar stolitë të cilat All-llahu xh.sh. i ka krijuar për robtë e Tij, si dhe ushqimet e shijshme, sikur t'i gjente ato nuk do t'i refuzonte, mirëpo, nuk ka qenë lakmues për to e as nuk e ka marrë këtë për brengë të vetme e më të madhe të kësaj bote. Po ashtu ka qenë i liruar nga dëshirat për pasuri e renome, e ju e dini se kurejshitet i kanë ofruar pasuri sa të dojë, nëse dëshiron pasuri, i kanë ofruar pushtet e qeverisje mbi ta nëse dëshiron renome e pozitive dhe nuk linin asgjë nga ajo që dinin që shpirtrat për to pretendojnë dhe e dëshirojnë, e që të mos ia ofronin duke shpresuar se ndoshta do të heqë dorë nga misioni (da'veti) i tij, por Resulullahu s.a.v.s. i refuzoi të gjitha ato që ia ofruan ata.

Po ashtu ka qenë i liruar nga instinkti seksual, megjithatë një grup orientalistësh, të cilët e kanë studiuar jetën e Resulullahut s.a.v.s.. me të perceptuarit (mendjen) e pazhvilluar të tyre të dunjasë, janë mashtruar duke e vlerësuar me kritere me të cilat i vlerësojnë kolosët e tyre, ashtu që kur panë se i ka martuar nëntë gra, thanë se është njeri e pshor (i dhënë pas epsheve), duke e numëruar në atë grup të pushtuesve e letrarëve të cilët i njihnin. Kështu që Napoleoni p.sh. e ka detyruar tërë popullin, me gjithë qeverinë dhe parinë e tij, që t'i nënshtrohen duke i sjellur një vajzë polake të cilën e dashuron. Edhe më shumë se kjo, e detyroi babain e asaj vajze, që ta shtrengojë bijën për të bërë mëkat të cilin nga ajo e kërkonte, duke e vënë çlirimin e Polonisë peng të realizimit të kësaj dëshire të ndytur e të shfrenuar. Por, nuk ka qenë ky vetëm mëkat i Napoleonit, por edhe Aleksandër Dumasi (Dima), Bajroni, Gëte, Bodleri e dhjetëra të tjerë këtyre të ngjashëm, të gjithë kanë qenë të njëjtë. Biografite e tyre janë prezente, kur të arrish në cilëndo nga ato (biografi), te analizat e ndodhive të tyre seksuale, hunda do ta kundërmojë erën e keqe të ndytësirave.

Kanë ardhur me këto pikëpamje e konceptime ta studiojnë jetën e Pejgamberit s.a.v.s., ashtu që me mendimet e tyre për të – larg nga të njohurit e psikologjisë, historisë së Muhammedit s.a.v.s. dhe larg nga objektiviteti e virtytet në studim e hulumtim, të paraqesin se ai ka qenë njeri i dhënë pas epshit.

Koha më e shprehur e dëshirës seksuale, në aspektin e vigjilencës e mallëngjimit, është koha ndërmjet pjekurisë (kur njeriu hyn në moshën madhore) dhe moshës njëzet e pesë vjeçare të jetës. Kjo është kohë e rrezikshme në të cilën çdo djalë e vajzë e mençur duhet të ketë kujdes nga tërë ajo që shpie në mëkat, siç është lakuriqësia dhe përzierja me gjininë tjetër, përqëndrimi i shikimit në atë që është e ndaluar dhe animi i të menduarit për të, qoftë të jetë ajo përzierje (shoqërimi mes dy gjinive) në emër të shkencës apo studimit.

E ku ka qenë Muhammedi s.a.v.s. në këto vite dhe çfarë ishin ndodhitë e rinisë së tij? Ka qenë i lirë, në vendin e lirisë dhe sikur ta dëshironte imoralitetin (kënaqësinë e epsheve), nga kjo nuk do ta ndalonin as mbikëqyrja, e as traditat. Moshatarët e tij në mesin e rinisë janë zhytur në këto kënaqësi, në këtë nuk i ndalonte as feja e as ligji.

Jeta e Muhammedit s.a.v.s.i është e njohur edhe miqve edhe armiqve, i është eksponuar shikimit të çdo kritiku, prandaj tregoni se a gjeni në të, që ai në këto vite ka qenë nga ata me pasione djaloshare, nga ata me epshe të vrullshme, ata të cilët i jepen kënaqësisë së epsshit?

Me një rast mendonte që të fillojë të merrret me ndonjë nga lojërat, me të cilat merreshin moshatarët e tij, por All-llahu xh.sh. zbriti në sytë e tij gjumin, ashtu që i kaloi ajo për çka mendonte. E sikur të ishte marrë me diç nga kjo, a do ta heshtnin atë armiqtë e tij – mushrikët, të cilët gjakonin që kundër tij të luftonin dhe në çfarëdo mënyre ta lëndonin. Është martuar kur i

pati njëzet e pesë vjet dhe a thua u martua me ndonjë virgjëreshë të bukur apo e martoi të vejën dyzvetjeçe, gruan që mund të ishte në moshën e nënës së tij? Edhe bashkëshortet tjera të tij, a nuk kanë qenë shumica e tyre të veja të cilat i martoi për shkak të interesit e dobisë së përgjithshme? All-llahu xh.le shanuhu i lejoi më tepër se katër gra, duke i lejuar me këtë më shumë se muslimanëve tjerë, mirëpo përkundër kësaj, e ka privuar nga e drejta të cilën ia ka lejuar çdo burri, e ajo është e drejta për ndarje – shkurorëzim.

Megjithatë, fuqia seksuale nuk është dobësi apo e metë, e si të jetë e metë kur ajo është shprehje e burrërisë? E në çka do të pasqyrohet burrëria nëse jo në atë? Mirëpo, është dobësi dhe e metë që njeriu të jetojë vetëm për shkak të saj, të mendoj vetëm për të dhe ta kryejë atë përmes të ndaluarës – rrugës së haramit. E sa i përket tregimit të martesës së Resulullahut s.a.v.s. me Zejneben, ky është tregim në përsëritjen e të cilit armiqtë e tij ripërtypen (bëjnë gara), derisa thashethemet (mendimet) e tyre për këtë nuk meritojnë madje as përgjigje, për shkak se (në realitet) bazohen në shtrembërimin e qëllimshëm të fakteve, apo në moskuptimin e qartë.

Zejnebjja ishte vajzë e bukur e fisnike, nga kushërinjët e afërt të Resulullahut s.a.v.s. Sikur të mendonte për të, do ta martonte dhe kjo, sikur të dëshironte, për të dhe familjen e saj do të ishte dëshira më e madhe. Mirëpo All-llahu xh.sh. e bëri atë nyje mes reformave shoqërore në Islam. Në njërën nga to, objekte sprove ka qenë ajo, ndërsa në tjetrën, vetë Resulullahu s.a.v.s.

Islami dëshiroi që me martesën e Zejnebes, e ajo ishte nga familja më me renome arabe, për Zejdin, robin e adoptuar i cili në sytë e kësaj shoqërie nuk konsiderohej i denjë për atë, ta çrrënjosë atë krenari të xhahilijetit e ndjenjën e ndasisë klasore. Është martuar për të kundër vullnetit të vet dhe vullnetit të familjes së saj, ashtu që jeta i ishte zinxhirë i pandërprerë i

kundërshtimeve e mosmarrëveshjeve, dhe kështu që të dy e dëshironin ndarjen. Mirëpo, Resulullahu s.a.v.s., ia ndaloj që ta braktisë, duke i thënë: “Mbaje gruan tënde dhe frikësoju Allahut!”. Derisa nuk u mbush kupa, e kaloi masën saqë nuk ishte e mundur më të durohet... dhe e lëshoi gruan!

Këtu vjen prova tjetër, e ajo është më e rëndë dhe më e mundimshme. Resulullahu s.a.v.s. duhet ta bartë barrën e kësaj me martesën e Zejnebes, me qëllim që me këtë ta heqë e ta zhvlerësojë ligjin e bijësimit, dhe shpjegoi se gruaja e birit të adoptuar nuk i është e ndaluar atij i cili e ka adoptuar (natyrisht pasi që i biri ta lëshojë). Vështirësia në këtë sprovë pasqyrohet në ekspozimin e Muhammedit s.a.v.s. ndaj rrezikut që shoqëria në të cilën gjendej, të mendojë se e ka martuar gruan e birit të vet. Kjo ka qenë njëra nga skenat më të rënda të cilat Resulullahu, salall-llahu alejhi ve selem, i ka përjetuar, por edhe krahas kësaj e ka duruar atë, i kënaqur me caktimin e Allahut xh.sh..

Prandaj, tregimi nuk qenka i tillë çfarë e përfytyrojnë dhe e supozojnë ata, dhe tërë atë që ata e kanë thënë për të janë vetëm tregime boshe, të cilat nuk meritojnë përgjigje, dhe nuk e kam theksuar këtë vetëm se me qëllim që t’ua shpjegoj të vërtetën atyre lexuesve të cilëve nuk e kanë të njohur.

Fuqia fizike triumfon mbi rezistencën materiale, ndërsa guximi e vendosmëria triumfojnë mbi armikun. Mirëpo, ekziston një forcë më e madhe, sepse ajo triumfon mbi atë që është më e madhe se materia e armiku. Ajo është fuqia e moralit – ahlakut. Ajo triumfon mbi shpirtin e njeriut, veset, instinktët, shtytjet, dëshirat e synimet e tij.

Kjo është çështje e pranuar shoqërore për të cilën Resulullahu s.a.v.s. në shumë mënyrë e në raste të ndryshme është shprehur, e ka thënë: “Nuk është i fortë ai, i cili armikun e ngadhënjën, por i fortë është ai, i cili në hidhërim e përmban veten”. Kjo është e vërtetë, të cilën keni mundësi edhe vetë ta ndjeni. Kështu, nëse forca me të cilën e ngadhënjën kundërshtarin vlerësohet, p.sh. me një, atëherë forca e cila të nevojitet ta ngadhënjesh hidhërimin tënd, ta shush zjarrin e tij në zemër e të dukesh i qetë në lëvizje, në zë e në të folurit tënd, vlerësohet në njëqind, sepse kjo është njëqind herë më e rëndë se ajo e para. Provo t’i afrosh njeriut të zemëruar të cilin mllëfi e ka verbëruar dhe nuk sheh asgjë para vetes, e tento që ta përkujtosh në sjelljen e bukur – ahlak, butësi e falje, dhe shiko se a do të hasësh në një nga çdo dhjetë mijë njerëz, i cili do të përgjigjet në gjendje të tillë? Përfytyro se një njeri ta ka mbytur personin ty më të dashur e më të këndshëm, e pastaj ka ardhur te ti duke iu nënshtruar thirrjes sate e ti je da’i (misionar), a do t’i harrosh lotët të cilat i ke derdhur për të afërmin dhe të dashurin tënd, dhe pikëllimin në zemër... e t’ia falish?

Resulullahu s.a.v.s. ia ka falur Vahshit, vrasësit të Hamzës, pasi që ai e pranoi Islamin, megjithatë, e mposhti natyra njerëzore në atë çka nuk i kundërvihet Islamit e as nuk i bëhet dëm njeriut, e i tha: “Mos më dil para sysh”, ashtu që Vahshi i largojë shikimit të tij.

Edhe Hindës, gruas së Ebu Sufjanit, urrejtja e së cilës ndaj Muhammedit s.a.v.s. dhe misionit të tij e ka arritur kufirin që të bëjë atë çka nuk do ta kishte bërë asnjë grua, çka nuk do ta bënte njeriu, ujku, e as macja e egër. E copëtoi gjoksin e Hamzës së vdekur, ia nxori zemrën dhe e ngrëni...! Hindës, e cila në luftë kundër Resulullahut s.a.v.s. ka bërë marrëzira, Resulullahu s.a.v.s. ia fali, lidhi me të betimin për besnikëri dhe e pranoi Islamin e saj.

Edhe banorëve të Taifit (krahinë në Arabinë Saudite.), për të cilët keni dëgjuar se çfarë kanë bërë me Resulullahun s.a.v.s., ua fali pasi që e pranuan Islamin. E, ja edhe skena më e madhe, shembulli i lartësuar në të gjithë shekujt: banorët e Mekkes të cilët atë dhe as-habët e tij i kanë nënshtruar ndaj çdo lloj torturash e mundimesh, e kanë shqetësuar fizikisht edhe shpirtërisht e në fe, kanë thënë për të atë që e kanë thënë, e kanë ofenduar atë dhe as-habët e tij, i kanë shkëputur lidhjet me të, e kanë bojkotuar, e kanë mbyllur në ngushticat mekkase, i kanë vënë ferra nëpër rrugë, derisa ka qenë në sexhde ia kanë hedhur zorrët dhe plancin e deveve mbi kokë, e kanë përqeshur në mënyra të ndryshme dhe e tërë kjo nuk ka zgjatur një ditë, apo dy, as një vit apo dy, por trembëdhjetë vjet të plota. Pastaj kanë luftuar kundër tij dhe farefisën e as'habët e tij ia kanë mbytur, derisa nuk i zuri dhe i vendosi pranë vetes rreth Qa'bes, të përlulur e pa mbrojtje. Dhe erdhi çasti i hakmarrjes. Jo, lene fjalën hakmarrje, sepse asaj nuk i ka hije në këtë vend, çasti i dënimit të Sheri'atit i cili do të paraqesë përgjigjen në vargun e gjatë të sulmeve e ofendimeve, dhe ja si iu thotë: “Çka mendoni se do të bëjë me ju?”. Ata e përkujtojnë tërë atë që e kanë bërë edhe e dinë se çka meritojnë, megjithatë, po ashtu e sjellin ndër mend moralin e Muhammedit s.a.v.s. dhe i dinë idealet e tij dhe thanë: “Ti je vëllai fisnik, bir i vëllait fisnik”. E pastaj heshtën, duke pritur vendimin definitiv dhe po të ishte vendimi që të gjithë të vriten, nuk do të gjendej asnjë historian, qoftë mik apo armik, i cili do ta qortonte madje me një fjalë. Megjithatë, vendimi i Resulullahut s.a.v.s. ishte diç tjetër. Ka qenë befasi të cilën askush nuk e ka pritur, befasi e cila e ka habitur shekullin e tij dhe çdo shekull i cili vijoi pas tij. Ju tha: “Shkoni, jeni të lirë”.

Më vjen keq që këtë skenë (veprim të Resulullahut s.a.v.s.) kështu shkurtazi e paraqita, ndonëse kam pasur dëshirë që asaj t'ia kushtojë një kapitull të tërë e t'ua ndriçoj ashtu siç duhet të jetë e ndriçuar. Sjellja e tillë kërkon forcën e dhjetë mijë mundësve (luftëtarëve).

Çuditëm përse shkrimtarët e mëvonshëm të Sires (jetës së Muhammedit s.a.v.s.) përpiqen që t'i përmendin sa më shumë mu'xhize, gjerësisht duke folur për to dhe duke shtuar edhe ato që fare nuk kanë ndodhur. Përse kjo ju nevojitet? Çka ju nevojitet kur çdo skenë nga jeta e Resulullahut s.a.v.s. dhe çdo faqe e personalitetit të tij është një nga mu'xhizet më të mëdha?!

E ç'është mu'xhizja? A nuk është ajo që njerëzit janë të paaftë ta bëjnë?! Sinqeriteti dhe besnikëria e tij janë mu'xhize.

Nuk do t'u sjell shembuj të shumtë, sepse hapësira është e kufizuar, por do ta përmendi vetëm një, ngjarjen pranë leximit të së cilës kam kaluar me qindra herë, duke e lexuar si lajm të zakonshëm, derisa një ditë nuk e vërejta befasi... dhe ja përnjëherë çudia - mu'xhizja. E sa ka në Siren e Resulullahut s.a.v.s. lajme të ngjashme? Të gjithë e dinë se Resulullahu s.a.v.s. me rastin e hixhretit në Medine e ka lënë në vendin e tij hazreti Aliun, që t'ua kthejë kurejshitëve amanetet – gjërat e dhëna në besë, të cilat kanë qenë te ai për t'ua ruajtur, pra a keni menduar ndonjëherë për tregimin e këtyre amaneteve?

E ka lënë hazreti Aliun që t'ua kthejë kurejshitëve, e jo muslimanëve, sepse Pejgamberi s.a.v.s. ka qenë i fundit që e bëri hixhretin, duke mbetur në Mekke siç mbetet kapiteni i anijes së dëmtuar, duke mos e braktisur atë derisa të mos zbresin të gjithë udhëtarët e të arrijnë deri te barkat për shpëtim. Ky është virtyt të cilin kalimthi e përmenda. Tregimi i amaneteve – gjërave të dhëna në besë, përbëhet në atë se kurejshitet edhe përkundër gjithë asaj çka ka qenë në mes tyre e Resulullahut s.a.v.s. – nuk kanë mundur të gjejnë askënd të cilit do t'ia besonin gjërat e tyre të vlefshme për t'ua ruajtur, përveç Muhammedit s.a.v.s. Pra, përfytyroni dy palë të ndryshme midis

të cilave dominon lufta, beteja me gjuhë, dorë, parime dhe fe, pastaj anëtarët e njërës palë ia besojnë pasuritë e veta dhe ia lënë në kujdes njeriut nga pala tjetër – pala kundërshtarë!

A keni dëgjuar ndonjëherë për ndonjë rast të tillë? Dhe si do t'ia jepnin në ruajtje atij kundërshtari, nëse morali i tij – ahlaku dhe amaneti – besnikëria nuk paraqesin një nga mu'xhizet dhe nëse çdo dyshim në këto nuk është një absurditet? I tillë ka qenë Muhammedi s.a.v.s.! Kur në Ditën e Bedrit, Resulullahu s.a.v.s. para betejës i rreshtonte radhët e ushtrisë së vet, e në dorë kishte një shigjetë, hasi në Suad ibnu Gazijetin se si kishte dalur jashtë rreshtit, kështu që e shtyri me shigjetë në pjesën e barkut dhe i tha: “Rreshtohu o Suad”.

Ky u përgjigj: “O I Dërguari i All-llahut, më ke shkaktuar dhembje, ndërsa All-llahu të ka dërguar me të vërtetën dhe me drejtësinë”. Përfytyrone këtë skenë: Komandantit të ushtrisë i kundërvihet ushtari i thjeshtë me këto fjalë. Ç'mendon, si do të veprojë me të? Ta dënojë? Ta lë? Apo do të jetë aq zemërgjerë e fisnik e t'ia falë? Apo do të ngrihet mbi këtë e të thotë: “Më fal, unë të kërkoj ndjesë? “Mirëpo ai, Resulullahu s.a.v.s., ka bërë diçka që askush nuk do ta bënte, as që ndokujt do t'i shkonte ndër mend ta bënte, ia zbuloi barkun e vet, ia dha shigjetën e i tha: “Ma kthe-zbatoje kisasin!”

Ka lejuar që mbi të të zbatohet kisasi, d.m.th. që fyerja e shkakuar t'i kthehet, e ai është Sejjidul-Besher, i pari i njerëzimit. I tillë ishte Muhammedi s.a.v.s.! E tërë jeta e tij ka qenë mu'xhize dhe të gjithë kolosët e botës janë të paaftë të lënë pas vetes një sire-histori të tillë. Në çdo pjesë të saj shihen dinjiteti e madhështia: në fuqinë e konstruktin sportiv të trupit të tij, në shpirtin e tij nismëtar, në atë që fitorja asnjëherë nuk do ta dërdëlliste deri në atë masë e ta bëjë kryelartë e as humbja ta dëshpëronte deri në atë masë që ta mllëfoste apo t'ia humbte vullnetin.

Muxhizja gjendet:

Në qëndrueshmërinë e vendosmërinë e tij në betejat e ashpra, saqë edhe as'habët më të guximshëm janë strehuar pas tij, në trimërinë e tij, para së cilës bienin kreshnikët më të mëdhenj, në përrulshmërinë e tij ndaj të varfërit e të mjerit dhe kujdesit ndaj grave të varfëra, të vejave e plakave, në pranimin e tij të së vërtetës dhe përcjelljen e sinqertë të Shpalljes së All-llahut xh.sh., ashtu që i shpalli edhe ato ajete të cilat zbritën që ta fajësojnë e ta qortojnë. Në respektimin e tij të kontratave e marrëveshjeve dhe ruajtjen e fjalës së dhënë, pa marrë parasysh sa mundime e vështirësi të shkaktojë ruajtja e saj, dhe e gjithë kjo pa marrë parasysh a ka të bëjë me sjelljen e tij personale apo me çështjet shtetërore.

Në ndjenjën e shijen e tij të rafinuar, në aplikimin e rregullave të ushqimit dhe vënien e themelit të pastërtisë. Në sjelljen e tij me as-habët, meqë ai i ka mësuar dhe me ta ka vepruar. Ka jetuar ashtu siç kanë jetuar edhe ata, me ta është këshilluar dhe propozimet e tyre i ka pranuar, është ulur atje ku gjente vend të lirë, në fund të mexhilit, ashtu që ai i cili do të vinte për ta parë, do të shikonte në fytyrat e të pranishmëve dhe do të thoshte: “Kush është nga ju Muhammedi?” Sepse Muhammedi s.a.v.s. nuk është dalluar nga ata as në të ulur as në rroba, në të gjitha ishte sikur ata.

Në sjelljen e tij të bukur e të virtytshme me gratë, në sjelljet në shtëpi e në familje, në shakanë e tij të sinqertë dhe në kthjelltësinë e shpirtit të tij, në atë se ka qenë i dashur në zemrën e çdonjërit, në modestinë e tij dhe refuzimin që të konsiderohet për mbret.

Në atë se ka jetuar jetën e varfërisë duke hequr dorë nga pasuria, e jo nga paaftësia për ta poseduar. Po të dëshironte, pallati i tij do të ishte më i madh se pallatet mbretërore e oborret e

perandorëve, mirëpo ai e ka zgjedhur Ahiretin e ashtu që gjerësia e të gjitha shtëpive të grave të tij (nëntë grave të tij) nuk e ka kaluar njëzet e pesë metërshin.

Shtëpia e Aishes, radijall-llahu anha, është përbërë nga dhoma e ndërtuar nga balta e qerpiçët dhe ka qenë aq e ngushtë saqë nuk ka qenë e mjaftueshme për fjetje e namaz njëkohësisht, ashtu që kur Resulullahu, sal-lall-llahu alejhi ve selem, në të falte namazin e natës, e largonte këmbën e saj që ta bëjë sexhden. Ndërsa, sa i përket ushqimit të tij, Aisheja r.a. tregonte se kalonin edhe nga dy muaj të tërë, e zjarri në shtëpinë e Resulullahut s.a.v.s. nuk është ndezur që buka në të të përgatitet. Dhe kur i është thënë: “Me çka atëherë jeni ushqyer”? – është përgjigjur: “Me ujë e hurma”.

Ky ka qenë ushqimi i familjes së Resulullahut s.a.v.s. Pastaj në bukurinë e të shprehurit e retorikën e tij, në çka ka qenë më elokuenti e më retoriku.

Në tërë këtë pasqyrohet mu’xhizja, si dëshmi se All-llahu xh.sh. nuk e ka zgjedhur për mision më të lartësuar, e as që e bëri pejgamber të fundit derisa për këtë nuk e përgatiti me përgatitje e cila e bëri njërin nga bijtë e Ademit a.s., i cili nuk ka konkurrent në virtytet e tij, All-llahu e mëshiroftë dhe e shpëtoftë. All-llahu më së miri di se kujt do t’ia besojë misionin e Vet.

## BESIMI NË LIBRA KUR'ANI

Kur'ani është mu'xhizja e Muhammedit s.a.v.s. Ata që kanë menduar se Kur'ani është vepër e Muhammedit a.s., kanë mohuar se ai është peygamber, megjithatë ia kanë përshkruar atributet hyjnore. Mirëpo, ne muslimanët, dëshmojnë: “Se vetëm All-llahu është meritör për adhurim e se Muhammedi (s.a.v.s.) është rob dhe i dërguar i Tij”.

E dëshmojmë këtë sepse njeriu nuk është në gjendje ta shkruajë Kur'anin dhe është e mundur vetëm të vijë nga All-llahu xh.sh. Prandaj, ata që kanë thënë se e ka shkruar Muhammedi s.a.v.s., i kanë përshkruar cilësi hyjnore! E nëse nuk është kështu, atëherë, ma tregoni njeriun që ka qenë analfabet, nuk ka shkruar e as nuk ka lexuar, siç ishte Muhammedi s.a.v.s. – njeriu i cili kurrë në jetën e tij nuk ka qenë në shkollë, as që ka ekzistuar në vendin e tij shkolla, i cili aq më tepër, nuk ka jetuar në ndonjë qendër të madhe kulturore, por në fshat të fshehur në mesin e kodrave të zeza të shkretëtirës, për të cilin fshat nuk kanë ditur as Bizanti as Persia, e as që në të ndokush e ka njohur filozofinë greke apo romake, apo ka dëgjuar për letërsinë indiane e persiane. Në fshatin ku nuk ka pasur shkencëtarë, hulumtues apo intelektualë të arsimuar të asaj kohe. Pastaj, nuk ka dalë nga ai fshat përveç në vende të ngjashme me të apo pak më të mëdha, siç është (Busra) në Siri-Hevran, duke mos mbetur në të më tepër se një ditë, apo disa ditë.

A është e mundur që njeriu i cili ka jetuar në këso kushte ta shkruajë Kur'anin?

Janë të njohura biografite e të gjithë gjenive e të talentuarve, historitë e të gjithë popujve në të gjithë shekujt, pra a ekziston (ngjarje) i ngjashëm me këtë?

Mocarti e ka shkruar pjesën muzikore para moshës dhjetëvjeçare; Beshshari në të njëjtën moshë ka shkruar poezi, befas është paraqitur gjenialiteti e talenti i autores Xhejn Ejri dhe motrës së saj, shkrimtares së librit të njohur “Shkrepat e Orkanit”.

Shekspiri pas vetes ka lënë pasuri të njohur letrare edhe pse nuk llogaritet ndër shkrimtarët dhe arsimuesit më të mëdhenj të kohës së vet. E tërë kjo është e mundshme. Është e mundshme që ndonjë i ri i panjohur të shkruajë librin e të sjellë në të tregime madhështore, apo teori të re shkencore, për shkak se është i talentuar ndërsa talenti (gjenialiteti) nuk është i kufizuar vetëm në intelektualët, e as në të diplomuarit universitarë dhe ndonjëherë paraqitet atje ku fare nuk e pret. Mirëpo, talentet e shkencës, letërsisë e artit, të cilët historia i ka njohur, e kanë kaluar kohën e vet për një shekull, ua kanë shkuar bashkëkohësve të vet pesëdhjetë apo qind për qind, tregon se përparësia e tyre është e kufizuar. Ajo është përparësi logjike dhe e pranuar.

Por, në historinë njerëzore nuk ka njeri që ka jetuar në rrethanat në të cilat ka jetuar Muhammedi s.a.v.s., e të ketë ardhur me librin i cili në fushën e stilit letrar paraqet formën më të lartësuar të së bukurës; në fushën e legjislatimit – ligjit në kulmin e përsosurisë; në fushën e metafizikës e lajmeve për gajbin (të fshehtë), vjen me atë që nuk i është e njohur askujt nga njerëzit, as që është e aftë mendja e njeriut vetvetiu për ta njohur; në fushën e shkencave natyrore tregon në ligje e shfaqje të cilat askush nuk i ka njohur në shekullin e tij, në shekullin pas tij, e as në dhjetë shekujt pas tij; aludon në ligje të cilat janë zbuluar një mijë e treqind vjet pas tij, e në ligje që sot e kësaj dite ende nuk janë zbuluar.

All-llahu xh.sh. i ka urdhëruar që me atë libër t’i provokojë të gjithë njerëzit e xhinnet: të vijnë me dhjetë sure të ngjashme me këtë, të vijnë me një kaptinë, e ata ishin të paaftë që ta bëjnë këtë! E

ky provokim edhe sot e kësaj dite është i pranishëm (vazhdon), sikur që edhe paaftësia (e njeriut që t'i kundërvihet) arrin deri në ditët e sotme.

Mbinatyrrshmëria – vlera e Kur'anit është e vërtetuar dhe e saktë, mirëpo mos gjurmoni në vendet e tij siç kanë bërë retorikët, sepse ajo vlefshmëri nuk fshehet vetëm në fjalët e tij, as vetëm në lajmet e tij për gajbin (të padukshmen), e as në cilëndo çështje, për të cilën kanë thënë se është objekt i moralit të tij vetvetiu, por në të si tërësi. Sikur vajza e bukur, bukuria e së cilës nuk fshehet vetëm në tenin e lëkurës së saj, apo vetëm në sytë e saj, e as në cilëndo pjesë të trupit të saj veçmas, por bukuria e saj është në të të tërën, – edhe pse çdo vështrues i Kur'anit i sheh “i'xhazin” (mbinatyrrshmërinë) e tij nga këndi prej të cilit e vështron.

Ndoshta është i njohur tregimi i shefit të repartit për “vërtetimin e identitetit të personave” i cili e pranoi Islamin kur i dëgjoi fjalët e Të Lartësuarit: “Po si jo, ne mund t'ia bëjmë mollëzat e gishtërinjve ashtu si i ka pasur”,-(Kijame, 4).

Është ndalur e ka menduar: “Përse i ka përmendur pikërisht “mollëzat e gishtërinjve?” Çka fshehet në këtë? Fshehen majat e gishtërinjve, këto mu'xhize të mrekullueshme të Zotit, sepse sa njerëz ka në tokë, e në mesin e tyre nuk ka dy, mollëzat e gishtërinjve të të cilëve nuk përputhen plotësisht.

Ky vërtet është fenomen i mrekullueshëm, i cili megjithatë, tani rishtas është zbuluar, dhe nuk ka qenë i njohur për askënd në kohën e Muhammedit s.a.v.s., e as në dhjetë shekujt më pas. Është pra e pakontestueshme se Muhammedi s.a.v.s. e ka pranuar nga All-llahu xhle shanuhu se Kur'ani është të folurit e All-llahut xh.sh. Në Kur'an gjenden me qindra sinjale të ngjashme e paralajmërimi, çdo ditë paraqitet ndokush, i cili zbulon njëërën nga ato dhe sa herë që dikush me

kujdes ta studiojë Kur'anin, zbulohen anët e reja të vlefshmërisë së tij, të cilat ata që kanë qenë para nesh nuk i kanë njohur, sepse vlera e tij është e pashtershme.

Për këtë shkak nevojitet që Kur'ani vazhdimisht në çdo kohë të bëhet tefsir (të komentohet), ta bëjë tefsir letrari, juristi, astronomi, psikologu, sociologu e historiani. Çdonjëri nga ata në të do të gjejë hapësirë për shkencën dhe specializimin e tij, si edhe dëshminë nga suaza e atij specializimi e shkence, se Kur'ani është fjalë e All-llahut xh.sh.

Mu'xhizet e Pejgamberëve të mëparshëm kanë ndodhur e kanë kaluar, mirëpo, mu'xhizja e Muhammedit s.a.v.s. është e pranishme dhe për çdo ditë përtërihet. Mu'xhizet e pejgamberëve të mëparshëm janë argumente mënjanë kategorisë së shpalljes për saktësinë e pejgamberllëkut, mirëpo mu'xhizja e Muhammedit s.a.v.s. është vetë Shpallja të cilën e ka marrë. All-llahu i mëshiroftë, i shpëtoftë vëllezërit e tij, lajmëtarët e fesë dhe pejgamberët.

## BESIMI NË LIBRAT

Ne besojmë në Kur'an dhe në të gjithë librat e shpallur për të cilët na lajmëron Kur'ani, e ato janë: “Suhufet e Ibrahimit a.s.”, “Suhufet e Musait a.s.” d.m.th. “Tevrati”, “Zeburi” i Davudit a.s. dhe “Inxhili” i Isait a.s.

Kur'ani është gjykatës mbi ta dhe mizan (peshojë) me ndihmën e të cilit dihet ajo që është e vërtetë dhe e saktë, nga ajo që është e shtrembëruar dhe e ndryshuar. All-llahu i Lartësuar thotë:

“Ne ty (o Muhammed) ta kemi shpallur Librin (Kur’anin) me të vërtetën, vërtetues i librave të mëparshëm dhe garantues i tyre...”,- (Maide, 48).

Prandaj, besojmë në atë për të cilën na lajmëron Kur’ani në lidhje me ata libra dhe e konsiderojmë pabesimtar atë që e mohon këtë. Ato lajme nga ata libra të cilët pajtohen me Kur’anin, besojmë se kanë mbetur të vërteta e të sakta dhe se shtrembërimi nuk ka arritur deri te ato, ndërsa lajmet që janë në kontradiktë me Kur’anin, besojmë se janë shtrembëruar dhe ndryshuar.

## **SUHUFET E IBRAHIMIT A.S.**

All-llahu xhile shanuhu na ka njoftuar se në suhufet e Ibrahimit alejhis-selam përveç tjerash kanë ardhur, e edhe në suhufet e Musait alejhis-selam janë të përsëritura këto fjalë: “Se asnjë mëkatar nuk do t’i bartë mëkatet e tjetrit dhe se e njeriut është vetëm ajo që vetë e punon dhe se munda i tij do të shihet dhe se sipas tij do të shpërblehet apo dënohet dhe se te Zoti yt do të kthehen përsëri...!” (e deri në fund të këtyre ajeteve), (En-Nexhm, 38-42). Si dhe fjalët e All-llahut xhile shanuhu: “Shpëtimin do ta arrijë ai që pastrohet (nga të këqijat) dhe që e përmend emrin e Zotit të vet dhe falet! Por, ju më tepër e duani jetën në këtë botë, e ajo botë është më e mirë dhe e përhershme. Këtë e kenë, vërtet, edhe në broshurat (librat) e lashta, në broshurat e Ibrahimit e të Musait”. (A’la, 14-19).

## TEVRATI

Tevrati është shpallur nga All-llahu xh.sh. Në të gjendet udhëzimi për njerëz dhe dispozitat e All-llahut. I Lartësuarit thotë: “E si e kërkojnë ata gjykimin tënd, kur ata kanë Tevratin, në cilin janë dispozitat e All-llahut? Ata edhe pas vendimit nuk do të ishin të kënaqur sepse nuk janë kurrfarë besimtarësh. Ne e kemi shpallur Tevratin në të cilin është udhëzimi dhe drita”. (Maide, 43-44). Siç na njofton All-llahu xhle shanuhu, se nga dispozitat e Tevratit janë edhe këto fjalë të Tij: “Ne u caktuam atyre në të (në Tevrat) kundërmaset ndëshkuese: njeriu (mbytet) për njeriun, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin, por edhe plagët kanë kundërmaset...!”,- (Maide, 45).

E se në të gjendet lajmi i gëzuar për ardhjen e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve selem: “...atyre të cilët do ta pasojnë Pejgamberin, lajmëtarin e fesë, i cili nuk do të dijë as të lexojë e as të shkruajë, të cilin e gjejnë të paralajmëruar në librat e veta, në Tevrat dhe Inxhil...!”,- (A’raf, 157) dhe përshkrimi i besimtarëve: “Muhammedi është pejgamber i All-llahut, kurse ata që janë me të janë të ashpër ndaj mosbesimtarëve, por të mëshirshëm ndërmjet veti; i sheh si përkulen dhe bien me fytyrë për toke (në sexhde), duke dëshiruar mirësinë e All-llahut dhe kënaqësinë e Tij, në fytyrat e tyre shihen shenjat, gjurmët nga të rënë me fytyrë për toke (sexhde). Ky është përshkrimi i tyre në Tevrat...!”,- (Fet-h, 29).

## ZEBURI

All-llahu xh.sh. thotë: “E Davudit i patëm dhënë Zeburin” , - (Nisa, 163). Na ka lajmëruar se në Zebur është e shkruar se Tokën do ta trashëgojnë robtë e mirë të All-llahut. I Lartësuar thotë: “Ne kemi shënuar në Zebur, pas Tevratit, se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robtë e Mi të mirë”.- (Enbija, 105). E ndoshta me fjalën Tokë këtu mendohet në Xhennetin, për shkak të fjalëve të All-llahut xh.sh. (ku për ata të cilët do të hynë në të, thuhet):”Ata do të thonë: “Falënderimi i qoftë All-llahut që na plotësoi premtimin e Vet e na dha në trashëgim tokën, që të vendosemi në të ku të duam!” Sa i mrekullueshëm është shpërblimi i atyre që kanë punuar (sipas dispozitave të All-llahut)!”, - (Zumer, 74).

## INXHILI

All-llahu xh.sh. thotë: “...kurse atij (Isait) ia dhamë Inxhilin ku kishte udhëzime e dritë, vërtetues i Tevratit, të shpallur para tij...!”,- (Maide, 46). Na ka treguar se Inxhili është i shpallur dhe se përmban dispozita (legjislative) të Sheri’atit: “(E zbritëm) Që pasuesit e Inxhilit të gjykojnë sipas asaj që e ka shpallur All-llahu në të”.- (Maide, 47).

Në të zëvendësohen dispozitat e Tevratit: “...për ta vërtetuar autenticitetin e Tevratit, të shpallur para meje dhe t’ua lejoj disa gjëra që i keni pasur të ndaluara...!”,- (Ali Imran, 50). Edhe në të, si edhe në Tevrat, gjendet lajmi i gëzuar për ardhjen e Muhammedit s.a.v.s.

Ne besojmë në të gjitha ato që All-llahu xh.sh. i ka shpallur: Suhufet, Tevratin, Zeburin, Inxhilin dhe i nderojmë të gjithë pejgamberët, në mesin e të cilëve edhe: Ibrahimin, Musain, Davudin e Isain a.s.

## **PËRFUNDIM KY ËSHTË BESIMI ISLAM**

Ai i cili e pranon, beson në tërë atë që transmetohet në Kur'an për krijimin e qiejve, Tokës e njeriut, dhe pas kësaj paraqiten gjurmët e këtij besimi në punën dhe veprimin e tij, ai është musliman i vërtetë. Ai vepron në pajtim me dispozitat e Kur'anit, të cilave u beson dhe nuk kënaqet vetëm me të lexuarit e tij, pa e kuptuar, as me të studiuarit e tij, pa e shquar, por e pranon si kod (kushtetutë) në jetën e vet, e lejon atë që ai e ka lejuar, e ndalon atë që ai e ka ndaluar, punon atë që ai e urdhëron, ndërsa largohet nga ajo që ai e ndalon.

Nëse “religjionet” e njerëzve janë të lidhura vetëm për tempujt, Islami nuk është i lidhur vetëm për mesxhid, shtëpi e treg, për pallatin qeveritar, për luftë e paqe, por Islami është i pandarë nga muslimani, e shpjegon atë që është e lejuar dhe atë që është e ndaluar, me të është kur është në vetmi, ku është në familje, në tregti e në punë. Çdo vepër e muslimanit bie në njërin nga pesë kategoritë e obligimeve fetare, nga të cilat thelbësor (fillestar) është lejimi-muhabi. Nëse fetë tjera përbëhen vetëm nga ceremonitë fetare (kultet, dogmat, lutjet), Islami është ibadet, kod civil, penal e ndërkombëtar, sistem administrativ e shkollë morale. Islami është shkencë e politikë, punë

(veprim) e luftë-xhihad. Hapeni cilindo libër të fikhut (sheriato-juridik) dhe shikoni në përmbajtjen e tij, do t'i shihni në të të gjitha këto lëmi.

Ibadetin në Fenë Islame nuk e përbëjnë vetëm namazi e agjërimi, por çdo vepër që është e dobishme për njerëzit, nëse bëhet në emër të All-llahut xh.sh. (d.m.th. nëse ai që e bën atë dëshiron që me të ta arrijë kënaqësinë e All-llahut), është ibadet.

Nëse fenë që përbëhet vetëm nga lutjet e kanë ndarë nga shkenca, Islami është fe e shkencës dhe e shkoqitjes. Fjala e parë e cila është shpallur në Librin e Islamit ka qenë: “Ikre”, - lexo, mëso, studio, e jo fjala “katil-lufto, mbyt” e as “mbledh pasuri”, apo “heq dorë nga kjo botë”. E pas kësaj fjale të parë e cila është shpallur, d.m.th. fjalës “Ikre”, është përmendur shkenca, dhe All-llahu xh.le shanuhu nuk i ka dhënë njeriut mëshirën e Vet e mirësinë me atë pse i ka dhuruar pasuri, fuqi apo famë, por me atë pse ia mësoi atë që nuk e ka ditur.

Studimi i çdo shkence që është e nevojshme për bashkësinë islame apo shoqërinë, bëhet e obliguar për ata të cilët për këtë kanë mundësi farzi kifaje (obligimi kolektiv të cilin nëse e lë pas dore bashkësia e tërë, të gjithë anëtarët e saj bartin përgjegjësi, e nëse një pjesë e bashkësisë e kryen këtë obligim duke i kënaqur me këtë nevojat e bashkësisë, bie përgjegjësia nga të tjerët), pra a ekziston atëherë në botë fe përveç Fesë Islame e cila të studiuarit e kimisë, mjekësisë e informatikës e konsideron obligim të rreptë fetar?

Islami është fe e pasurisë dhe All-llahu xh.sh. në Kur'an pasurinë e ka quajtur të mirë (hajr) e ka thënë: “Dhe ai është, për shkak se e do pasurinë, punëdashës”. (Adijat, 8).

Ndërsa në ajetin e testamentit (vasijjetit) ka thënë: “...nëse lë (pas vetes) të mira...”, d.m.th. – pasuri,- (Bekare, 180). Muslimanët duhet të jenë të pasur , por me kusht që të mbledhin hallall pasuri të lejuar dhe që pasurinë ta kenë në dorë e jo në zemër. Pasuria dhe e tërë ajo që gjendet në Gjithësi i është nënshtruar njeriut. Muslimani ndien se është rob i All-llahut xh.sh., mirëpo njëkohësisht Ai është sundues i asaj që gjendet në Gjithësi dhe disponon me të si pronarë. Nxjerr dobi të cilat All-llahu xh.sh. në to i ka deponuar, për shkak se ai (njeriu) pretendon nga ajo që është e dobishme, por nuk e lavdëron personalisht, e as që bën shenjtëri, sepse sikur të fillonte ta lavdëronte e ta bënte të shenjtë shkak i dobisë, do të shndërrohej në rob të tij dhe me këtë do ta bënte ortak të All-llahut xh.sh. në ibadet, adhurim.

All-llahu xh.sh. pasurinë e ka bërë mjet të ekonomizimit, e në qoftë se e ke grumbulluar dhe e ke fshehur duke mos u shërbyer me të, je bërë rob dhe shërbëtor i saj, ndërsa Pejgamberi i Zotit, Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: “Është shkatërruar robi i dirhemit (dinarit)”.

Rrobat janë bërë për mbrojtje nga të ftohtit dhe për ta mbuluar trupin, por nëse i lartëson dhe i lavdëron (adhuron) – shkak i vetë asaj duke i ruajtur dhe mbrojtur, e të mos shërbehesh me to, bëhesh rob i tyre e është thënë: “Është shkatërruar robi i rrobave (veshjes)”.

Islami nga muslimanët dëshiron që ata të jenë besimtarë të sigurtë, ta pasojnë Sheri’atin – Ligjin e All-llahut xh.sh. dhe që krahas kësaj të jenë më përparimtarët, më të fortit, më të arsimuarit dhe populli më i pasur, ashtu që me këtë ta arrijnë të mirën e kësaj bote dhe të mirën e Ahiretit – botës së ardhshme.

Sikur që dëshiron nga çdo musliman, që pos kësaj ta dijë se është i obliguar që edhe të tjerët t'i njoftojë me Islamin dhe t'i ftojë te All-llahu xh.sh. me urtësi e me këshillë të bukur, duke mos i detyruar njerëzit që me dhunë ta pranojnë atë:

“Në fe nuk ka shtyrje me dhunë”,- (Bekare, 258). Për besimtarin është detyrë t'i prezentojë virtytet dhe bukuritë e Islamit, që në ata ta zgjojë dëshirën për to dhe që të mos thërret vetëm me fjalë (gjuhë), por me praktikë (vepra) – që bashkësia islame apo shoqëria të jetë kopje e personifikuar e parimeve islame, e jo fotografi e shëmtuar dhe e deformuar e tyre, e cila refuzon nga vetja dhe largon, siç është sot rasti me muslimanët. Që misionari (da'ija) të jetë menjeprehtë dhe i aftë për të sjellë argumente, ta njohë Islamin e të dijë ta prezentojë atë. Të jetë i arsimuar në mënyrë bashkëkohore (në nivel të kohës së vet), ashtu që njerëzve t'u drejtohet me gjuhën e tyre, të jetë i këndshëm e i butë, e jo i vrazhdë e i ashpër, e as arrogant e i pamëshirshëm.

Ta dijë se Islami nuk i frikësohet diskutimit, e as që shmanget nga ai, se çdo çështje në të ka dëshminë dhe argumentin e vet dhe që të kërkojë argument madje edhe nga ai i cili pohon diç në kundërshtim me Islamin: “Thuaj: “Sillni argumentet tuaja, nëse thuani të vërtetën!”,- (En-Neml 64). “E ai që pos All-llahut adhuron zot tjetër, duke mos pasur kurrfarë argumenti për këtë...!”,- (Mu'minun, 117). E sikur edhe të ketë argument, megjithatë është e pamundur të argumentohet diçka që i kundërvihet besimit – teuhidit.

Po të kishte misionar të tillë, e tërë kjo botë do të hynte në fenë e All-llahut xhle shanuhu, e kjo fe është e shpallur nga All-llahu xhle shanuhu dhe Ai ka premtuar se do ta ruajë: “Ne, me të vërtetë e kemi shpallë Kur'anin dhe, Ne me të vërtetë do ta ruajmë atë!” - (Hixhr, 9).

Islami, pra mbetet, nuk do të zhduket, e fitorja dhe fundi i takojnë vetëm atij, mirëpo ne (muslimanët) ose do t'i kthehemi fesë sonë (Islamit), e të na takojë nderi i fitores në këtë botë dhe shpërblimi i All-llahut në botën e ardhme, ose All-llahu xh.le shanuhu do të na zëvendësojë me një popull tjetër, i cili do ta pranojë Islamin e të marrë mbi vete përgjegjësinë e mbrojtjes dhe thirrjes në të.

I mbështetemi All-llahut xh.sh. nga ajo që të na zëvendësojë me një popull tjetër dhe e lusim Atë të na kthejë drejt Fesë sonë Islame, ta caktojë fitoren e saj me duart tona, të na i falë mëkatet e të na mëshirojë.

Duaja jonë e fundit është:

Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve